



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23, 24 DHE 29 DHJETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23, 24. I 29. DECEMBRA 2016. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o ilegalnoj izgradnji zida na severnom delu Mitrovice, prema zahtevu Parlamentarne grupe AAK

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të caktuar me vendim të seancës plenare të 22 dhjetorit 2016.

1. Debat parlamentar lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës

Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar si çështje urgjente debatin lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës si dhe ka propozuar një projektrezolutë, e cila u është shpërndarë deputetëve.

Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për debat parlamentar është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 22 dhjetor 2016.

Sipas renditjes, fjalën e ka zoti Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar, në emër të propozuesit.
Zoti Pal.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues,
I nderuar kryeministër,
Ministra,
Kolegë deputetë,

Sa i përket debatit të sotëm dje u dakordua që seanca të mbahet në orën 15:00, por tani po shtyhet dhe nuk e di pse kjo ka ndodhur, kur saktësisht kryetari i Parlamentit e ka propozuar vetë kohën që seanca të mbahet në orën 15:00.

Prandaj, unë kërkoj, me që edhe deputetëve u ka rënë koncentrimi, e lus edhe kryeministrin që të ketë mirëkuptim që seanca të ketë efektin e vet të shtyhet për të mërkurën, në orën 10:00, me që mendoj se nuk e arrin efektin e vet dhe mendoj që edhe pse çështja është urgjente, ndoshta deri të mërkurën këta qeveritarët do ta rrënojnë murin dhe nuk kemi nevojë për debat.

Prandaj, kërkoj që seanca të shtyhet për të mërkurën.

(Ndërprerje)

KRYESUESI: Zoti Pal, me Kushtetutë Parlamenti shkon në pushim, edhe me Rregullore deri më 15, 16 janar, kështu që ne jemi këtu në sallë, askush nuk ka harruar asgjë, nëse doni e mbajmë,

nëse jo, mund ta tërhiqni edhe e lëmë. Nëse kryetari jua rregullon hesapet për të mërkurën, le të jetë ashtu, po unë e kam sot në rend të ditës dhe e kam ndërmend ta mbajmë debatin. As nuk mundesh ti ta ndryshosh, as nuk mundet kryeministri.

Ti mund ta tërheqësh kërkesën për debat e pastaj e bën kërkesën e re. Ose duam t'i zbatojmë rregullat ose jo. Zoti Pal e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Sa i përket propozimit tim për ta shtyrë seancën e sotme, është e drejtë, por nëse vendos ky Kuvend që të mbahet seanca të mërkurën nga propozuesi, unë nuk di pse thyhet Rregullorja e Kuvendit, sepse nuk është e saktësuar në Rregullore të Kuvendit data kur shkohet në pushim.

Prandaj, unë mendoj që nëse është vullneti i të gjithë deputetëve, mirë, po nuk është vullneti, fillojmë debatin, vazhdojmë debatin. Faleminderit!

KRYESUESI: Domethënë ti po paraqet mocion për ta shtyrë debatin, unë kam obligim t'i pyes grupet parlamentare edhe e qes në votim, ky është obligimi imi, nuk kam asgjë kundër kësaj. Po për shkak të festave unë po them që është më mirë ta mbajmë sot se të mos e mbajmë hiq, sepse të mërkurën nuk të vijnë njerëzit, janë përgatitur për pushime edhe nuk vijnë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike si mendon sa i përket kërkesës së zotit Lekaj në emër të AAK-së.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është i gatshëm të vazhdojë këtë debat sipas agjendës, por nëse është një kërkesë e tillë dhe nëse kemi një gatishmëri të kryeministrit dhe të Qeverisë që duhet të jetë në këtë debat, e që kjo të bëhet në një datë tjetër në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, pra pas Vitit të Ri, atëherë ne mund të pajtohemi në këtë drejtim, nëse jo, mund të vazhdojmë kështu.

KRYESUESI: Jo, ky po thotë të mërkurën, nuk po thotë pas Vitit të Ri. Në emër të LDK-së, Sali Morina.

SALI MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së është që të vazhdohet debati, nëse ka mundësi që të mbahet pas Vitit të Ri edhe ne pajtohemi, përndryshe për të mërkurën nuk jemi që të vazhdojë ky debat. Faleminderit!

KRYESUESI: Pali të mërkurën po e kërkon. Glauk, në emër të AAK-së.

GLAUK KONJUFCA: Mendoj që kur po thirreni në Rregullore, problemin kryesor e ka që tregon kur fillon sesioni i ardhshëm, por nuk tregon kur duhet ta përfundojmë, edhe pse...

KRYESUESI: Unë ju tregova kur..

GLAUK KONJUFCA: Qysh kur...?

KRYESUESI: Unë tregova kur se ashtu e kemi

GLAUK KONJUFCA: T'i po e shpall krye më vete kur a? Nuk ke të drejtë!

KRYESUESI: ...Po ju s'mund të na mbani në punë me zor, o burrë!

GLAUK KONJUFCA: Jo, more, me zor, po veç pak. Këtu thotë neni 69...

KRYESUESI: A je a s'je të shtyhet seanca?

GLAUK KONJUFCA: Unë jam të mbahet seanca kur kërkon propozuesi. Unë mendoj që ka të drejtë të kërkojë propozuesi dhe t'i nuk ke të drejtë ta interpretosh Rregulloren që ne duhet të shkojmë në pushim.

KRYESUESI: Unë kam të drejtë, unë në këtë rast e interpretoj, jo ti.

GLAUK KONJUFCA: Më 23 dhjetor nuk ke të drejtë të thuash ne shkojmë në pushim.

KRYESUESI: Unë e interpretoj, jo ti.

GLAUK KONJUFCA: Po s'ke të drejtë ta interpretosh nëse e ke gabim, a po më kupton?

KRYESUESI: Në emër të "Nismës", kush e ka fjalën? Valdete Bajrami.

VALDETE BAJRAMI: Kryesues,

Edhe "Nisma" është në përkrahje të Grupit të Aleancës, kështu që do të ishte mirë të jetë të mërkurën. Nuk e di pse po ngurrohet të mërkurën, katër ditë pushim, edhe vijmë të mërkurën në mëngjes e debatojmë.

KRYESUESI: Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Kryesues, tash ta kthejmë pak në seriozitet, se “mos bërtit” e “po bërtet”, “o ku je Shaip”, je duke e kryesuar seancën, e ke Rregulloren përpara, nëse ke vullnet të na e japësh fjalën mirë, nëse jo, atëherë bile ta kuptojmë.

Unë e pata një propozim krejt jashtë kësaj teme, meqenëse ti e citove Ligjin për faljen e borxheve, mendoj që nuk është e tepërt në rast se e kthejmë edhe një herë në rivotim dhe meqenëse po parashihet që nuk do të ketë seancë deri më 16 janar, nuk kemi asnjë arsye që ai ligj të mos rikthehet edhe një herë në votim, edhe besoj shumë që kolegët deputetë do t'i japin votën për.

Sa i përket debatit të sotëm, në rast se mendoni që deri pas Vitit të Ri nuk duhet të ketë seancë, atëherë ne e vazhdojmë seancën sot. Mendoj që nuk kemi asnjë arsye, sepse edhe ju po e interpretoni sipas vullnetit tuaj Rregulloren.

Nëse ke paraparë të shkosh diku në pushim, kallëzo, dhe me kaq u krye.

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Faleminderit! Më lejoni vetëm të theksoj se kur e kemi pasur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit kemi biseduar me kolegun Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e kërkesa ka qenë për interpelancë. Pastaj gjatë kohës së seancës kolegu Pal Lekaj ka kërkuar që interpelanca të futet në rend të ditës ditën e djeshme.

Ndërkohë, i nderuar kolegu Pal Lekaj, kam bashkëbiseduar me kryeministrin e Republikës së Kosovës, kemi shkuar një hap më tej. Interpelanca, ju e dini, se është shumë e shkurtër, e kemi dashur të bëjmë debat, jo interpelancë, ta keni parasysh. Ky është dallimi, vetëm pak Glauk, ta jap fjalën, vetëm ta qartësojmë vendimmarrjen si kemi shkuar proceduralisht. Asnjëri nuk jemi as më patriot, po të shikojmë në bazë të rregullores. Kemi shkuar në debat të japim mundësi, se të gjithë jemi të shqetësuar për murin në veri, edhe të dihet saktësisht, më të shqetësuar se ne ndoshta janë qytetarët e Mitrovicës.

Kryeministri ka shprehur gatishmërinë të futemi në debat, seanca e ka votuar, në qoftë se seanca nuk e voton shtyrjen e debatit, kot bashkëbisedojmë. Seanca duhet ta votojë tash, të jenë 61 deputetë. Në qoftë se e kërkojnë këta shtyrjen nga sot, atëherë e shtyjmë për të mërkurën. Atëherë duhet të shkojmë në votim, të mos krijojmë politizim, shkojmë në votim drejtpërdrejt. Bekim, nuk kemi nevojë.

Kolegë deputetë, a ka dikush prej grupeve parlamentare që s'e ka thënë qëndrimin.

Zoti Pal Lekaj, si iniciues, edhe pse ne e kemi ndërruar, nuk është çështje e pushimeve, por nuk kemi nevojë të shtyhet, edhe nesër mund ta mbajmë, hiq nuk i ikim, jua krijojmë mundësinë, debatit për çështjen e murit nuk po i ikim, të bashkëbisedojmë.

Urdhëro, zoti Pal Lekaj!

PAL LEKAJ: Unë i falënderoj të gjithë deputetët që kanë qenë korrektë dhe e kanë shqyrtuar mënyrën më të mirë të mundshme, edhe mënyrën më serioze çështjen e murit të Mitrovicës dhe askush nuk pati dilema, por dilemë e patën sepse ju keni potencuar dje dhe kemi vendosur që seanca parlamentare, debati të zhvillohet në orën 15:00. Mu për këtë mendoj që edhe deputetët, edhe duke u nisur nga punimet e djeshme të seancës, edhe të sotme, është e natyrshme që debati të ketë kuptim dhe të debatohet drejt dhe mirë është që të fillojmë nesër. Unë pajtohem me ju që edhe nesër të mbajmë seancë.

KRYETARI: Unë do ta propozoj në votim. Dëshironi sonte ta vazhdojmë menjëherë seancën e debatit për Mitrovicën ose nesër. Në rend të parë e qes në propozim sonte për ta vazhduar, edhe në të dytin e vendos propozimin tuaj, ju u kërkoni deputetëve kur të doni, e pastaj e qes në votim prapë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë në mënyrë elektronike, jo me dorë, për vazhdimin e seancës që ta kemi debatin parlamentar për murin në Mitrovicë sonte. Ta votojmë një herë këtë, pastaj e qesim propozimin e dytë, cili të kalojë me më shumë vota, ai mbetet. Urdhëro, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Këtu po diskutohet për një mocion, kërkesën e deputetit Pal Lekaj, në emër të Grupit Parlamentar, pra edhe si thirrës i kësaj seance, për t'u shtyrë seanca për të mërkurën, ky është mocioni. Nuk ka nevojë të votojmë a po e mbajmë sonte a jo, se për sonte është votuar dje, por është votuar për orën 15:00, jo për orën 17:30. Tash e kemi një mocion, mos i bëni dy!

KRYETARI: A po doni pra të shkojmë vetëm sipas propozimit të Palit. Zoti Pal Lekaj, urdhëro, kërkoni deputetëve formën si dëshironi edhe një herë ose të shkojmë në votim, më nuk hap diskutim. Shkojmë në votim. Sonte gjithsesi e kemi të përfunduar, sonte do ta kemi në qoftë se nuk kalon propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar, Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar deputetë,

Kërkoj mirëkuptim, e thashë arsyen dhe prapë po e përsëris, për shkak të lodhjes së deputetëve dhe për shkak të rënies së koncentrimin për ta pasur një debat të mirëfilltë propozoj që seanca të mbahet të mërkurën, në orën 10:00. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, vëmendja juaj është te propozimi i zotit Pal Lekaj. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim, votojmë tash:

68 deputetë kanë votuar, 31 janë pro propozimit të zotit Pal Lekaj, 34 janë kundër, 3 abstenime. Do ta kemi debatin parlamentar sonte. Faleminderit!

A dëshironi pauzë në qoftë se jeni lodhur, 5-10 minuta në qoftë se doni, menjëherë vazhdojmë. Vazhdojmë.

Zoti Daut Haradinaj, pa u futur drejtpërdrejt në pikë.

DAUT HARADINAJ: Po, domethënë përfundimisht vazhdon debati. Por e propozova rikthimin e Ligjit për faljen e borxheve, i cili deri diku nuk pati qartësi se çka po bënim dhe mendoj që duhet të rikthehet, për shkak se po duket që nuk do të ketë seancë deri më 16 janar, e nëse bën, domethënë ne e hedhim në votim, a mund ta rikthejmë edhe një herë atë ligj nëse edhe Qeveria është dakord?

KRYETARI: Na lejoni vetëm 2-3 minuta të konsultohemi e të mos bëjmë gabime procedurale.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kisha kërkuar për të na u lehtësuar puna të mos kemi kritika publike. Nënshkruani 40 deputetë, e bëjmë një seancë të jashtëzakonshme, menjëherë pas kësaj, i kemi 10 minuta, edhe ne si Kryesi e mbajmë një mbledhje formale dhe menjëherë e mbajmë seancën sonte. Urdhëro, zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Ligji për faljen e borxheve, edhe Ligji për parandalimin e dhunës në sport, janë dy ligje të cilat i trajtuam, por nuk pati kuorum për votim. Prandaj, kërkoj që të dyjat të jenë në votim....

KRYETARI: Nënshkruani 40 deputetë, krijojmë seancë të jashtëzakonshme, ka unanimitet, për 10 minuta i kryejmë të gjitha këto. Po shoh se ka edhe unanimitet edhe nga Qeveria, edhe nga deputetët.

Ne si Kryesi 5 minuta na duhet mbledhje të kemi në sallën 301, e përfundojmë. Vazhdojmë debatin ndërkohë, në qoftë se bëhet kjo, ne e kryejmë sonte, me shefat e grupeve parlamentare.

1. Debat parlamentar lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka propozuar si çështje urgjente debatin lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës si dhe ka propozuar një projektrezolutë, e cila u është shpërndarë kolegëve deputetë.

Propozimi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për debat parlamentar është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 22 dhjetor 2016.

Në emër të propozuesit të çështjes, zoti Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e merr fjalën.

PAL LEKAJ: Të nderuar qytetarë të Mitrovicës e të Kosovës,
Kolegë deputetë,

Historia e botës është e njohur me ndërtime apo ngritje muresh. Muri i Hadrian-it në Angli dhe pritrat mbi lumenjtë Rin e Danub, të cilat ishin ngritur për të mbrojtur qytetërimet nga sulmet e vërshimit të barbarëve, edhe paritë e qytet-shteteve i mbronin kështjellat e veta me mure rrethuese. Madje edhe qytete të tëra rrethoheshin me mure, me qëllim që qytetarët e tyre ta përfitonin e ta përjetonin mbrojtjen dhe sigurinë.

Prandaj, nëse do të duhej të ndërtohej një mur për t'u mbrojtur, ai do të duhej të ndërtohej në kufij me barbarinë e Serbisë në fund të shekullit XX dhe këtij shekulli, e jo të lejohet ndërtimi i një muri me brendi të Kosovës, në zemër të Mitrovicës.

Ky mur, mu në zemër të Mitrovicës, nuk do të ishte ngritur kurrë nëse brenda kokave të atyre që e ndërtuan dhe po e mbrojnë nuk do të ishin ringjallur muret e paragjykitimit dhe, dihet, paragjykimi pjell mosbesim, mosbesimi dyshim, dyshimi paranojën dhe paranoja urrejtjen, e rrjedhimisht e logjikisht del që muri në Mitrovicë nuk është asgjë tjetër vetëm se një “mur birë muri”, sepse Vuçiqi e Daçiqi me këtë logjikë të mureve po tregojnë se janë bijë koke të murit të Milosheviqit, i cili për t'u prishur u desh të përdoren çekanë të mëdhenj.

E kur i shikojmë këto, këtë Qeveri të Kosovës, e kuptojmë pse ato koka muri të Serbisë ndërmarrin këso risqesh e ndërtojnë mure në Kosovë, sepse nuk ka kush t'u dalë përpara, e krejt logjikisht mund të kuptojmë pse Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida politike, ekonomike e të sigurisë të përgjithshme, e në veçanti kur bëhet fjalë për pjesën veriore të Kosovës, të cilat janë zgjedhje e disa kokë mureve që nuk pranojnë të njohin shtetësinë e Kosovës, ani pse marrin paga e mëditje prej buxhetit të këtij shteti.

Mosnjohja e shtetit të Kosovës, targat në dëm të Kosovës, diplomat e shtetit të Kosovës që nuk njihen, po ashtu kodi telefonik, gjeografik, tash së fundi, si pa të keq lejohet të ndërtohet apo vazhdon të mbijetojë një mur, i cili betonizon ndarjen e asaj pjese nga pjesa tjetër e Kosovës. Për të mos mjaftuar me kaq, kemi pasur e kemi raportime se aty mbrapa po ndërtohet edhe një objekt, i cili me të drejtë konstatohet se është i dyshimtë dhe kujt po i dedikohet.

Pyetje logjike është: A ka mundësi që kryeministri, bashkë me zonjën Edita Tahiri, të na shpjegojnë në detaje a kanë qenë në dijeni për këtë mur? Nëse po, pse nuk është informuar Kuvendi e qytetarët? Nëse jo, pse po lejohet edhe pas gati një muaj të qëndrojë aty ai mur?

E kemi thënë në vazhdimësi se ekzistenca edhe më tutje e grupeve kriminale dhe strukturave paralele serbe në një situatë të përshtatshme për Serbinë mund të kthehet në një rrezik edhe më të madh se sa kjo me murin për sigurinë e brendshme të shtetit të Kosovës.

Qytetarë të Kosovës dhe të Mitrovicës,

Ju kolegë deputetë,

Këto veprime të fundit, muri dhe ndërtesa, nuk duhet lejuar, sepse janë dy gjëra të këqija që po presin edhe veprimin e tretë, i cili do të ishte goditje edhe më e rëndë për sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit tonë. Po e presin edhe krijimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, e kështu rrjedhimisht do të përmbushej panorama siç e mendoj Serbia, një shtet brenda Kosovës.

Që është e papranueshme për ne kurdo që të na vijë dita të marrim vendime për atë pjesë të vendit tonë, Mitrovica nuk do të tolerohet si dysh, por vetëm një. Nëse sot dikush e ka pranuar heshtas një ndarje de fakto të asaj pjese, dijeni që për neve ajo kurrë s'do të lejohet të ndodhë si e tillë, e ju qytetarë, e dini që ne e mbajmë fjalën.

Mitrovica do të bëhet njëjtë, sikurse Peja, e cila përkundër tendencave të njëjta sikur për Mitrovicën dikur, sot është unike dhe e tëra e Kosovës. Ju themi qytetarëve të Mitrovicës që të durojnë edhe disa ditë, sepse po vjen koha kur bashkë me ta, atë do ta bashkojmë e do ta bëjmë një.

Kolegë deputetë,

Bashkimi i Mitrovicës dhe heqja e murit të ndërtuar është konform entuziazmit fillestar për një Kosovë të zhvilluar, për një veri të integruar që ishte kur e shpallën Kosovën të pavarur më 2008.

Mjerimi është se kjo Qeveri çdo ditë e çdo vit këtë entuziazëm po e kalon në një skepticizëm të përgjithshëm, kjo për fajin se vetë Qeveria ndodhet në një pikë të vdekur.

Qeveria e Serbisë po e shfrytëzon këtë për interesat e veta dhe vazhdon të financojë një situatë për një qytet të ndarë të Mitrovicës, në pjesën veriore të Kosovës, sepse një paqe dhe një integrim i asaj pjese nënkupton me automatizëm edhe humbje të influencës së saj mbi serbët e Kosovës, e rrjedhimisht edhe mbi Kosovën.

Pra, Serbia para syve të Qeverisë së Kosovës vazhdon të forcojë një aleancë me serbët në atë pjesë vetëm për të shtyrë përpara interesat individuale të saj, jo pse merakoset shumë për serbët si qytetarë të Kosovës së pavarur.

Sa herë që Qeveria ka nënshkruar marrëveshje me Serbinë në Bruksel apo kudo tjetër, na kanë thënë se me këto po e largojmë ndikimin e Serbisë mbi Kosovën, por gjendja reale në këtë pjesë e thotë krejt të kundërtën, është ende më e përkeqësuar.

Në këtë pjesë kemi ende targa ilegale që e mohojnë shtetësinë e Kosovës, flamuj të Serbisë gjithandej, emërtime vetëm në gjuhën serbe, përmendore të carëve të Serbisë e prishje të shesheve me emrat e heronjve të UÇK-së, ndërtime muresh e barrikadash, bllokada sa herë t'u teket disa banditëve, kjo nuk ka emër tjetër vetëm serbizim të asaj pjese e tendosje të situatës.

Dhjetëra herë u kemi thënë se bisedimet duhet të kenë platformë e orar, e jo sa herë t'u teket Isa Mustafës dhe Edita Tahirit e argatëve të tjerë të sorollaten në Bruksel. Nëse e keni vetëm për mëditje, sa për diçka tjetër po shihet që jo, na tregoni, Kosova është në gjendje t'ua japë ato mëditje dhe pa shkuar atje hiq, vetëm mos e merrni në qafë më tutje këtë vend.

Pse nuk po e shpenzoni këtë energji të dialogut me Serbinë për shtrirjen e sovranitetit e temave të brendshme që janë në interes të qytetarëve të Kosovës?

A nuk po ju vjen keq në çfarë situatë e keni sjellë vendin nëpërmjet një dialogu pa krye e pa vizion, të tërin në interes të vetëm njëres palë, asaj të Serbisë.

Pse nuk e merrni mundimin t'ua shpjegoni Serbisë e disa banditëve të saj në Kosovë edhe një herë e mirë e paqësisht, ama për herën e fundit, si të tillë, sikur me gjithë këtë zell e qejf se ngrenë mure ndarëse disa përfaqësues serbë në Kosovë të kishin lejuar të ndërtohen ura komunikimi sa më e jetueshme do të ishte jeta, sa më paqësor do të ishte rajoni ynë dhe sa më e tashme dhe e ardhshme do të ishte shpresa për një jetë më të mirë?

Prandaj, si Qeveri e Kosovës, ani pse jeni shumë të paaftë, ndërmerrni diçka të mos ndodhë të kemi edhe më tutje mure e barrikada të Kosovës, sepse na shkoi jeta duke prishur pengesa që po i ndërton Serbia edhe më shumë në Kosovë.

A na e thoni çka do të ndërmerrni që të mos përsëriten këto gjëra, por thoni konkretisht me hapa, çka, qysh, kur dhe pse, se mjaftë më me demagogji. Faleminderit për vëmendje.

Të nderuar kolegë deputetë,

E në të njëjtën kohë do t'i lexoj edhe disa kërkesa si formë rezolute, të cilën besoj i keni të gjithë. E për të qenë sa më e pranueshme prej të gjithëve, jemi të hapur që të thoni ju edhe fjalët tuaja

dhe rekomandimet apo kërkesat pas këtij debati për rezolutën, e cila nuk duhej të devijonte nga qëllimi i dhënies përgjegjësi për përgjegjësit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Lekaj!

Tani është radha e kryetarëve apo përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Partia Demokratike e Kosovës, zoti Zenun Pajaziti, të bëhet gati zoti Ismet Beqiri ose Sali Morina, a zoti Sadri Ferati.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Ministra,

E kemi dëgjuar ditët e fundit këtë shqetësim jo vetëm nga deputetët, por edhe nga qytetarë të shumtë. E mbështesim kërkesën dhe e përgëzojmë edhe zotin deputet, parashtrues të kërkesës, që sot në emër të grupit të tij parlamentar e ngriti këtë kërkesë dhe po ashtu e falënderoj edhe kryeministrin që sot është këtu me ne që të na japë më shumë informacione për këto çështje që janë kaq të ndjeshme edhe me interes për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Muri në veriun e Mitrovicës është një mur i urrejtjes, i ndarjes dhe i rikthimit të kaluarës sonë të dhimbshme.

Ky mur pa dyshim se ka dëmtuar arritjet që janë bërë në normalizimin e marrëdhënieve dhe në arritjet që janë bërë në lirinë e lëvizjes, në marrëdhëniet mes qytetarëve të etnive të ndryshme në vendin tonë. Pa dyshim që ky mur paraqet simbolin më të shëmtuar që është prezantuar dhe është instaluar nga Beogradi kohët e fundit.

Ky mur që u bë natën, jo tjetër veçse errët, veçse terr reflekton në marrëdhëniet mes njerëzve, në marrëdhëniet mes komuniteteve dhe në imazhin e Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës është një shtet i të gjithë qytetarëve, pavarësisht përkatësisë etnike. Institucionet e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare në Kosovë duhet të jenë të vëmendshëm që paqja e krijuar ndër vite të mos cenohet. Këtu duhet të theksohet veçanërisht roli i institucioneve të vendit tonë, qendrore dhe lokale, i institucioneve që kanë përgjegjësi të merren me këto çështje dhe sidomos në raport me bisedimet dhe po ashtu edhe roli i BE-së që është rol jo vetëm ndërmjetës, por rol me përgjegjësi të theksuara dhe duhet veçuar po ashtu që edhe serbët që jetojnë atje dhe që janë përfaqësues të qytetarëve edhe në Kuvendin e Kosovës dhe institucionet e vendit tonë duhet të marrin përgjegjësitë e tyre që të mos lejojnë që aktet e tilla të kthejnë mbrapa marrëdhëniet tona dhe pozitën e tyre në vendin tonë.

Muri i ndërtuar në veriun e Kosovës është i papranueshëm, ilegal dhe si i tillë duhet të rrënohet. Duhet të rrënohet madje menjëherë.

Ka kaluar koha e mureve që ndanin njerëzit, ka kaluar koha e regjimeve të tilla që ishin, ato fashiste që i ndanin me mure njerëzit nga prona e tyre, nga familjet e tyre.

Si deputetë të Republikës së Kosovës ne pa dyshim që jemi të shqetësuar dhe kërkojmë edhe ne si grup parlamentar veçanërisht që ky mur të rrënohet dhe përpos urës, të mos ketë diçka që mund të pengonte komunikimin e lirë dhe qasjen e lirë të qytetarëve në atë pjesë të vendit tonë.

Ajo që më së shumti po ashtu na shqetëson është edhe mungesa, është thënë disa herë, mungesa e informatave rreth këtyre zhvillimeve. Pa dyshim që kemi qenë të gjithë të befasuar kur papritur kemi lexuar një informatë, e cila tregonte se një mur po ndërtohej aty.

Zoti kryeministër,

E nderuar ministre e Dialogut, Edita Tahiri,

Këto çështje besoj në praninë tuaj do t'i kemi më të sqaruara sot. Po ju e dini fort mirë që ka pasur pyetje nga qytetarët, të cilat duhet t'i dimë të gjithë ne.

A keni qenë ju në dijeni për këtë mur? A është e vërtetë që keni pranuar ose ka pranuar dikush që ky muri i urrejtjes të ridizajnohet me shkallë, siç u tha? Sa janë të vërteta informatat që kanë qarkulluar në media se ka një marrëveshje mes Zyrës së BE-së, kryetarit të komunës atje dhe homologut të tij në veri që muri të zvogëlohej pastaj për disa centimetra? Nëse këto janë të vërteta, institucionet e Kosovës duhet të dinë, t'i thonë dhe të japin llogari.

Po ashtu unë besoj se në çfarëdo forme apo madhësie apo dizajni ky mur është i papranueshëm, ky mur është i papranueshëm, jam i sigurt, edhe për të gjithë qytetarët pa dallim që jetojnë atje.

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Bashkësia ndërkombëtare, sidomos BE-ja si ndërmjetësuese e dialogut, duhet të jetë e kujdesshme në këtë rast dhe po ashtu edhe raste të tilla që kanë karakter të tillë.

Shoqëria e Kosovës është më proevropiane se sa shumica e vendeve ndoshta të BE-së, ky besim që kemi në BE-në nuk duhet të cenohet, as të keqpërdoret.

Orientimi ynë politik drejt Bashkimit Evropian është i pakompromis, mirëpo kjo marrëdhënie jona me BE-në duhet të funksionojë më së shumti edhe në bazë të mirëbesimit.

Ky mur po ashtu i vë në pikëpyetje edhe sukseset e arritura të dialogut mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Paramendoni fazën tjetër, për të cilën janë të interesuar edhe miqtë tanë të zhvillimit të dialogut për çështje të tjera. Sa edhe si, me çfarë dinamike dhe entuziazmi do të bëhen kur kemi pengesa kaq serioze, në këtë rast me këtë mur. Ne duam paqe për qytetarët tanë, e jo konflikt, siç po synon Serbia me këto veprime.

Pra, në mënyrë të përsëritur ne duhet të themi dhe duhet të bëjmë që muri duhet të rrënohet, institucionet e Kosovës duhet të jenë pakompromis në ruajtjen e sovranitetit, por edhe të paqes së brendshme mes komuniteteve të ndryshme. Krahas këtyre aktiviteteve që tashmë duhet të bëhen, sepse jemi gjetur para aktit të kryer, institucionet duhet të mendojnë edhe për projekte të tjera, përcjellëse, të cilat ndikojnë mirë në paqen, në lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Ne nuk duhet të lejojmë që ky provokim i hapur nga Serbia të na shpërqendrojë karshi objektivave tona politike. Vetë fakti që ne po merremi edhe me seancë në Parlamentin e Kosovës për këtë çështje flet shumë se sa jemi të shpërqendruar nga debatet e tjera që duhet t'i bënim për zhvillimin e asaj pjese, për zhvillimin dhe normalizimin e ekonomisë, e cila do ta zhvillonte këtë regjion pa dallim që do të ishte në interes për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Lëvizja e lirë për të gjithë qytetarët duhet të garantohet atje. Duhet të themi botërisht dhe duhet ta themi hapur kush janë ata të cilët po e pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve? Ata që po vendosin mure, apo ata që po kërkojnë heqjen e këtyre mureve dhe lëvizjen e lirë për të gjithë qytetarët?

Të nderuar të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike pret nga ky debat që ne të sjellim një vëmendje më të shtuar për institucionet e Kosovës në raport me këtë zhvillim, në raport me këtë pengesë dhe në raport me këtë mur, i cili ka dëmtuar pa dyshim proceset dhe imazhin dhe presim po ashtu që ky mur jo të na ndajë tash, edhe ne këtu, po të na bashkojë të gjithëve që jemi në këtë sallë, pa dallime politike, por edhe pa dallime etnike. Do të kishte qenë mirë sot t'i kishim edhe përfaqësuesit e komunitetit serb që gjithë së bashku të bënim gjithçka që është e mundur që të krijojmë një imazh tjetër, t'i hiqim muret, të vendosim bashkërisht që atje të ketë lëvizje të lirë për të gjithë qytetarët dhe mesazhi të ishte inkurajues për të gjithë qytetarët që jetojnë atje.

Jam i sigurt që muri i ka frikësuar qytetarët serbë që janë atje, ata i mban të izoluar, ata i mban më shumë të bashkuar me informata të errëta, të cilat u vijnë çdo ditë dhe nuk u lënë mundësi bashkimi, bashkëpunimi me fqinjët e tjerë që jetojnë aty dhe po ashtu i ndan nga zhvillimi dhe nga prosperiteti atje.

Ne kundërshtojmë fuqishëm këtë mur dhe i mbështesim institucionet në çfarëdo mënyre që kjo pengesë të evitohet.

Ne vazhdojmë ta inkurajojmë dialogun dhe kërkojmë të jenë të vëmendshëm në gjithçka që bëhet në këtë drejtim në raport me Beogradin dhe po ashtu si grup parlamentar kërkojmë sa më shumë transparencë për gjithçka që bëhet në procesin e dialogut dhe në aktivitetet tona me Beogradin.

Dhe po ashtu i ftojme të gjithë, edhe qytetarët, pa dallim, që të japin kontributin e tyre, duke përfshirë edhe komunitetin serb që të mos lejojnë provokime të tilla dhe të mos lejojnë pengesa të tilla që më së shumti do t'u prishin punë atyre dhe të gjithë atyre që ua donë të mirën të ardhmes dhe fëmijëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, kolegu Sadri Ferati nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Pra këto ditë prejse janë hequr pjesët e punishtes përnjëherë është paraqitur një mur, i cili ka zgjuar debate të shumta, herë-herë duke mos qenë të sigurt edhe duke mos e kuptuar realitetin çka po ndodh atje, por në çdo rast gjithçka ishte irituese.

Ne do të dëgjojmë edhe informacione më të ngushta që na interesojnë, se rivitalizimi i urës çka ka paraparë deri në fund dhe, në realitet, çka është ky mur, a po e kuptojnë të gjithë, a e kemi të gjithë pasqyrën se çka është ajo?

Për diçka jam shumë i sigurt se ky mur ka mesazh, ky mur po flet vetvetiu dhe ky mur ka dy faqe. Po ta shikosh nga jugu, duke marrë parasysh se çfarë ka kaluar ajo pjesë e Republikës së Kosovës, sidomos në periudhën e pasluftës, duke rikujtuar edhe një herë momente të vështira, datën 2 shkurt, kur para syve të KFOR-it dhe të Policisë së UNMIK-ut shqiptarët rrahën, tërhiqen zvarrë dhe 11 viktimë përfundojnë po atë natë, për të cilën asnjëherë deri më sot askush nuk ka dhënë përgjegjësi dhe të nesërmen KFOR-i shqiptarëve u thotë se ne nuk mund t'u sigurojmë dhe pastaj ndodh edhe zbrazja e asaj pjese të Mitrovicës.

Edhe unë besoj që shumica e qytetarëve mendojnë se Mitrovica është zbratur kohën e vështirë të luftës dhe të Milosheviqit, por unë po ju them se jo. Mitrovica është zbratur më 2 prill, pas përfundimit të luftës dhe kjo traumë që e kanë pasur qytetarët e Kosovës, duke përmendur edhe ngjarje të tjera të dhimbshme edhe largimi nga institucionet nga spitali, gjykatat, ngjarjet e vitit 2004, pengesa që atje të ndërtohet xhamia, pra të krijohet një nostalgji për gjithë atë pjesë atje.

Dhe, fillimi i dialogut ishte një shpresë për qytetarët e Mitrovicës, por edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe kur pritej që do të implementohen marrëveshjet, të cilat do të krijojnë parakushte për lëvizje të lirë, normalizim të jetës, rënies së tensioneve, bashkëjetesës dhe

krijimit, pra, të një zhvillimi dhe të një avancimi, neve përnjëherë na mbin një mur dhe s'ka qysh tjetër të konsiderohet se ai është një monstrum, kur shikohet nga kjo pjesë. Sepse kur pret të lindë liria dhe aty lind mur, s'ka qysh thuhet ndryshe se është një monstrum, kur shikon nga jugu. Kur shikohet nga veriu ai mur është në një farë forme gjithmonë mbajtje e situatës së rëndë, e cila është atje, pra ajo pasqyron gjendjen reale të atyre që sot krijojnë politikën në atë pjesë dhe atyre që i përçojnë politikën ditore dhe ekstreme nga Beogradi, duke krijuar edhe në këto momente frikë se shqiptarët janë të rrezikshëm që do të mund të kalojnë urën dhe të dalin këndeje.

Ka mbase dy vjet që atje është marrë vendimi që ajo pjesë, ajo rrugë do të mbyllet për automjete. Dhe tani varianti i vetëm pra është qarkullimi për qytetarë, por për ta bërë më të frikshme ata kanë paraqitur këtë mur që nuk është e rastësishme. Dhe ai mur mbjell frikë për ata qytetarë, por është shpresë e pasqyrimin dhe e mbajtjes së kësaj gjendjeje nga ajo politikë që e kemi në atë pjesë. Dhe, sigurisht që ne nuk na befason, ngase është e vetmja mënyrë që kjo politikë të mbetet në pushtet.

Ne nuk do të lëshohemi tani, se formimi i institucioneve lokale atje krijojnë edhe kompetenca me ligjet pozitive të Republikës së Kosovës dhe atje do të menaxhohen edhe përgjegjësitë, por ne asnjëherë nuk jemi indiferentë dhe do të vazhdojmë të bashkëpunojmë dhe të bëjmë presion që ato ligje dhe ato të mira të komunës të jenë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës atje.

Duhet të përmend edhe të shkoj përtej këtij muri, ngase unë dua të flas se cila është situata reale në veri dhe muri është vetëm një produkt i vogël i asaj gjendjeje reale që ne e kemi atje.

Pra, ne jemi dëshmitarë edhe sot e kësaj dite të pengesës së qarkullimit të lirë, kur pengohen ministrat e Republikës së Kosovës, kryeministrat. Kur vjen Gjuriqi në Kosovë dhe demonstroi me hyrjen ilegale se ai po shëtiti lirshëm në territorin këtu.

Unë do të them diçka që pikërisht sjellja e Gjuriqit për një diçka më ka bërë të sigurt dhe optimist. Një numër i madh i politikanëve para se t'ua tregojnë realitetin qytetarëve, e luajnë letrën e patriotizmit dhe pikërisht sjellja e Gjuriqit mua më bën të garantoj se asociacioni nuk do të ketë as kompetenca legjislative, as ekzekutive dhe ai patriotizëm i Gjuriqit është faza kur ai duhet të pranojë se asociacioni do të formohet në plotni në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ne jemi të vetëdijshëm edhe për shumë përparime, nuk po të dëgjoj, por...

(Reagim nga salla)

... Jo, jo kam shumë respekt, thashë do të formohet, e thashë do të formohet në plotni, pra në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Gjuriqi do të detyrohet pastaj t'ua pranojë qytetarëve të tyre se Kosova më nuk do të figurojë brenda Kushtetutës së Republikës së Serbisë, pra do të fillojë dalëngadalë jo ta njohë, të pranojë se Kosova është shtet dhe është një Republikë që po ecën fuqishëm drejt afirmimit dhe integritit të saj në strukturat euro-atlantike.

Dhe këto janë ato lëvizjet e mjera dhe të fundit që po i bëjnë disa politikanë të Beogradit duke nxitur situata të ngjashme në veri.

Prandaj, unë mendoj që sot ky debat megjithatë duhet të mos u përngjajë shumë debateve të hershme, kur janë shfrytëzuar për politika ditore dhe duke i parë debatet e nxehta në Prishtinë, shpeshherë është harruar se ku u fillua, a filluan në Mitrovicë dhe qytetarët e Mitrovicës nuk kanë parë produkte nga ai përkushtim yni i zjarrtë me deklaratat tona.

E unë do të kisha dëshiruar që qytetari i Mitrovicës në fund të këtij debati vërtet të shohë se do të ketë ndonjë rezultat, do të ketë një ndihmesë konkrete për ta dhe në këtë drejtim, përveç se një përkushtim akoma më i madh në sundimin e ligjit në atë pjesë, të ndodhë edhe implementimi i plotë i marrëveshjeve të deritashme.

Unë mendoj se janë pjekur kushtet të kërkohej që Kosova ta ridizajnojë dialogun dhe që fuqishëm të përfundojnë temat që lidhen me partneritetin me Serbinë sa i përket, pra, inkuadrimit në strukturat ndërkombëtare, por assesi të bisedohet për çështjet e brendshme të Kosovës.

Pastaj, të punohet fuqishëm në lirimin përfundimtar të të gjitha pronave për shqiptarët, sepse janë të fundit për të cilët ne bisedojmë sot për lirimin e pronave, nga se ju e dini se sa fuqishëm është punuar më herët për lirimin e pronave të të tjerëve dhe kanë mbetur të fundit shqiptarët në atë pjesë që akoma i kanë të uzurpuara pronat dhe nuk u kthehen.

Nga ana tjetër, të krijohen fonde që t'u ndihmohet shqiptarëve në meremetimin e njësisve banesore, qoftë ato banesa apo shtëpi, sepse deri tash nuk kanë qenë të ndihmuar.

Të krijohet një mundësi, një projekt apo fonde, në mënyrë që të punësohet ajo pjesë e shqiptarëve në atë pjesë, ngase sa unë kam informacione, krejtësisht janë të punësuar 2-3 shqiptarë në administratën e Komunës në veri, ndërsa ata të gjithë janë të papunë, por edhe të pashpresë dhe në këtë drejtim, unë mendoj që duke i ndihmuar qytetarët në atë pjesë në punësim, duke i ndihmuar në mirëqenie, duke i ndihmuar që ata ta kenë një jetë të dinjitetshme, duke e zbatuar ligjin dhe duke e krijuar avancimin e mëtejshëm të sovranitetit të Kosovës në atë pjesë, unë mendoj që sikur të ishin kolegët këtu, domethënë deputetët nga Lista serbe do të kisha porositur që të jenë shumë të kyçur, e të angazhuar, në mënyrë që të mos lejojmë që edhe në këtë fazë

politikat ekstreme në atë pjesë të bëhen pengesë e dorës së shtrirë nga Prishtina dhe që në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare ne duhet të ecim përpara.

Prandaj, të nderuar deputetë, ne nuk i kontribuojmë situatës me eufori dhe me deklarata ditore dhe të mendohet se pengesa e gjithë asaj gjendjeje të vështirë atje është “jam unë apo je ti në pushtet”, ngase atëherë do ta kishim minimizuar këtë problem dhe do të ishte joreale.

Prandaj, të gjithë bashkë për një Kosovë të integruar, për një veri të integruar, për të drejta të barabarta, për një pozitë të fuqishme shqiptare...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupit “Vetëvendosje”, zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Kur i dëgjon njeriu diçka zyrtarë publikë që kanë pasur funksione të rëndësishme në qeveritë e kaluara, por edhe këta të tanishmit, duke folur për problemin e ndarjes së Kosovës, edhe të veriut të Kosovës, ajo që bie në sy dhe të bën përshtypje natyrisht është një dyfytërsi dhe një qëndrim shumë i pandershëm me këtë çfarë na ka ndodhur deri tash. Pse?

Se zakonisht theksi i tyre vendoset te strukturat ilegale të Serbisë, te veprimet e tyre kriminale. Kjo është në rregull dhe dëmet e tyre janë të hatashme, të papërshtatshme. Ata janë ajo forca, ai gjeneratori i vërtetë që e mban Kosovën e ndarë, veç mos harroni - po aq të dëmshme sa këto struktura që i kanë shkaktuar gjithë këto krime, që e kanë bërë spastrimin etnik të Kosovës, po aq e dëmshme është edhe një politikë këtu vendore që u është përshtatur strukturave të paligjshme të Serbisë edhe veprimeve të tyre. Këtë nuk bën ta harrojmë.

Se problemi do të kishte qenë shumë më i vogël nëse ne vetëm do të ishim përballur me strukturat e paligjshme të Serbisë, me krimet e tyre. Por, këtu ka qenë një përshtatje me atë që e kanë bërë strukturat e Serbisë në Kosovë dhe historinë po mundohen ta shpjegojë kronologjikisht edhe pak nga pak. Për shembull: decentralizimi etnik në Kosovë. Kjo ka qenë një politikë zyrtare e Qeverisë së Kosovës, e cila i është përshtatur asaj të Serbisë, kërkesave të Serbisë.

Edhe zoti Ferati, edhe Lutfi Haziri, deri te PDK-ja me Hashim Thaçin e me krejt këta, krejt këta i kanë kontribuar asaj situatë në veri të Kosovës, edhe ndarjes së veriut të Kosovës. Sepse, strukturat paralele të Serbisë, në njërin anë, i spastrojnë shqiptarët, unë pajtohem me zotin Ferati, mirëpo si u bë në fund që rezultati të jetë ndarja e Mitrovicës në dy komuna, së cilës vetë ju i keni kontribuar më së shumti.

Domethënë, atje ka qenë një veprimtari ilegale e Serbisë e kështu me radhë, por mbi këtë veprimtari ilegale po flenë do politika zyrtare, po zhvillohen do politika zyrtare, të cilat në fund

Mitrovicën po ta ndajnë në dy komuna, e këtu tani po votohet si Plani i Ahtisarit. E vija administrative e ndarjes po shkon bash ashtu qysh e kanë spastruar strukturat e Serbisë veriun e Kosovës. A është edhe ky problemi? Unë mendoj që edhe ky është problemi i Kosovës, jo veç pse atje po vepron strukturat e Serbisë, po pse do politika po e legalizojnë atë veprimtari. Ky është problemi më i madh i Kosovës. Se kur u vendos atje barrikada në veri të Kosovës, atje nuk dolën disa banditë të thjeshtë kështu për të treguar vendosjen e barrikadës në veri.

A e dini kush ka dalë që ta arsyetojë vendosjen e barrikadës në veri? Goran Rakiqi ka dalë në media. Goran Rakiqi ka dalë dhe ka thënë që ai e ka vendosur barrikadën mbi urë. Goran Rakiqi, zonja dhe zotërinj, nuk është një bandit ilegal. Ndonëse për banditë pajtohem goxha që është, por është i pajisur me pushtet lokal zyrtar të Republikës së Kosovës që ju vetë si koalicion mazhoritar e keni votuar. Kush e shndërroi barrikadën që ishte atje, me zall fillimisht e me dhe, kush e bëri shesh të betonuar? A e bënë do banditë të thjeshtë, apo ky Goran Rakiqi? Goran Rakiqi e bëri!

E tash, kur ai sheshi i betonuar u shndërrua në mur atje, për të cilin po ankohe mi të gjithë këtu, kush doli e tha nuk do të rrënohet? A do banditë të thjeshtë, apo kryetari i Komunës së veriut të Mitrovicës, që ju vetë e keni krijuar si komunë. Ky është, zonja dhe zotërinj, problemi i vërtetë. Këtu problemi i vërtetë nuk janë thjesht vetëm strukturat ilegale, janë edhe njerëzit zyrtarë, bashkëpunëtorët tuaj, që i keni krijuar ju vetë, që e vë barrikadën, e betonon urën, e ndërton murin dhe pikërisht këta njerëz i shndërrojnë këto tema në tema të negociatave pastaj kur shkon Edita Tahiri, shkon Isa Mustafa e këta njerëzit politikë.

Pra, atëherë, më 25 korrik, ju kujtohet kur në vitin 2011 intervenoi Qeveria e Hashim Thaçit atje kishe për ta rregulluar veriun e Kosovës. Këtu në fjalimet tona në Parlament, në diskutimet tona, ne thoshim atëherë që këtu janë dy mundësi: ose po intervenohet përnjëmend për ta shtrirë sovranitetin atje, ose ky është improvizim që veriu i Kosovës të përfundojë në tavolinë me Aleksandër Vuçiqin. Unë mendoj që pesë vjet mbrapa prej përvojës sonë jemi të bindur për këtë të dytën, që ai ka qenë një improvizim për të përfunduar veriu në negociata.

E çka na thanë në negociata? Në negociata na thanë që do të bisedohet për t'i integruar strukturat e Serbisë në institucionet e Kosovës dhe krejt kjo u paraqit prej Edita Tahirit dhe kryeministrit Mustafa si një integrim i Kosovës dhe si një bashkim i Kosovës, por mbi të gjitha si shpërbërje e strukturave të paligjshme të Serbisë në Kosovë. Unë mendoj që kjo nuk ishte një shpërbërje e strukturave të Serbisë në Kosovë. Ky ishte një transformim i strukturave të Serbisë në Kosovë.

Pse po them kështu? Po them, sepse këtu është ndërruar vetëm uniforma për shembull, ka qenë atje një kontingjent i MUP-it që ka punuar për MUP-in e Serbisë dhe këtu ka qenë procesi që ka derivuar prej negociatave të Brukselit që kontingjentin e MUP-it ta pranojnë në Policinë e Kosovës, për shembull. Po shtrohet pyetja, me vetë faktin që ata e kanë ndërruar uniformën, a ka

ndryshuar edhe përcaktimi i tyre politik? Ky është thelbi. A ka ndryshuar përcaktimi politik i pjesëtarëve të MUP-it veç pse e ka ndërruar uniformën?

Pra, nuk ka ndryshuar! Pse? Se ata janë që po e ndërtojnë murin, ata janë që po e ndërtojnë barrikadën, ata janë që po e bllokojnë urën, ata janë që e pamundësojnë shtrirjen e institucioneve të Kosovës në atë pjesë. Pra, këtu ka ndodhur vetëm transformimi i strukturave të Serbisë. Përveç kësaj, këtu me disa vendime që vetë ju po flisni këtu e po ankoheni për strukturat ilegale të Serbisë, ju e keni fajin më së shumti dhe përgjegjësinë kryesore se në këtë Kuvend, me dorën tuaj që e keni ngritur përpjetë, u amnistua me ligj kriminelin i strukturave të paligjshme të Serbisë. Ju e keni votuar Ligjin për amnistinë këtu. Me dorën tuaj e keni ndarë drejtësinë në veri të Kosovës, qysh e di unë. Drejtësia është ndarë në baza etnike. Sa gjyqtarë me qenë serbë, e sa ty Vuçiqi të t'i vendosë, e sa prokurorë shqiptarë pjesa tjetër të t'i vendosë.

Pra, këtu me vendime në këtë Kuvend, përgjegjësinë e keni më së shumti ju që po ankoheni kundër strukturave të paligjshme të Serbisë. Pastaj, procesi që po i thonë “procesi i përfshirjes së strukturave të sigurisë në institucionet e Kosovës”, për shembull: policia, intelijenca, pjesëtarët e inteligjencës, e kështu me radhë. Këtu është vendosur më shumë nëpërmjet intervistimit të atyre njerëzve me disa deklaratave formale, se që është vendosur me informacion bazik, institucional shtetëror që e ka shteti i Kosovës për këta njerëz. Çka do të thotë kjo? Për shembull, nëse një pjesëtar i MUP-it në shkurt të vitit 2000 është marrë me spastrimin etnik të shqiptarëve dhe ka kryer vepra shumë të rënda penale, e institucionet tona nuk e kanë asnjë informacion të saktë për të, ai sot bëhet pjesëtarë i Policisë së Kosovës.

Jam i bindur që kjo ka ndodhur me shumë persona dhe të pretendosh që kjo është shuarje e strukturave të Serbisë, kjo është me të vërtetë sikur të shohim ëndrra me sytë hapur.

KRYESUESI: Sadri Ferati e ka fjalën për replikë.

SADRI FERATI: Po! Për respekt, edhe unë mendoj që tani debati nuk duhet të vendoset në tensionime, sepse tema është shumë e rëndësishme. Do të kalojë shumë nga ajo, veç po dua të jua kujtoj që ne po flasim për sundimin e ligjit në atë pjesë.

Dhe, kolegu sa akuzoi njerëzit që e kanë implementuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, po bie në kundërshtim me vetveten. Prandaj, po unë nuk ndihem asnjëherë keq që e kam implementuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sa më fuqishëm që implementohet Kushtetuta në çdo pjesë të Kosovës, ne shkojmë më afër qëllimit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Të dilet në televizor shumë shpesh dhe të thuhet “bashkimi i Mitrovicës”, Mitrovica duhet të jetë një qytet e vetë të jesh personi kryesor që i ke kontribuar ndarjes së tij në dy komuna, unë nuk e di si ta quaj këtë, përpos një hipokrizi shumë të padurueshme të një funksionari politik që vetë i ka kontribuar ndarjes së Mitrovicës.

Nuk ka bashkim të Mitrovicës! Nuk ka doktrinë për një komunë të Mitrovicës pa u zhbë vendimet e Sadri Feratit, Lutfi Hazirit e krejt deri te Hashim Thaçi e PDK-ja që i kanë krijuar ato dy komuna dhe kufiri i bie përmes lumit. Atë pjesë ty Serbia ta ka spastruar me struktura paralele, të paligjshme, me veprime kriminale. 12 mijë shqiptarë i ka dëbuar prej atje. Dhe, këtu nuk ka kurrfarë përgjegjësie për këtë punë që ka ndodhur, për ndarjen e Mitrovicës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, s’ka më! Nga “Nisma”, kush është? Valdete!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Kryeministër.

Para pesë vjetëve e filluat dialogun me Serbinë në Bruksel, dialog që qytetarëve iu proklamua si dialog teknik, e që realisht u shndërrua në politik. Dialog i cili e futi vendin tonë në obligime të padrejta, të cilat tash po na kushtojnë edhe me ndarjen e vendit. Dialog në të cilën as si palë nuk jemi të barabartë. Çka fituam ne nga ky dialog, si qytetarë dhe si shtet? Apo çka u ofruat ju qytetarëve me këtë dialog? Ju ua ofruat asociacionin, fusnotën, ndarjen e sistemit të drejtësisë, ndarjen e doganave, ndarjen e energjisë, ndarjen e telekomunikacionit, e shumë ndarje të tjera.

Dhe, në fund, për ta mbyllur këtë vit, ju nëpërmjet bisedimeve në Bruksel e keni arritur edhe marrëveshjen për ndarjen e vendit, ashtu siç i keni arritur të gjitha marrëveshjet në mënyrën më jotransparente dhe krejt të fshehur. Këto të gjitha janë derivat i marrëveshjeve të arritura në Bruksel, e edhe ndarja që po i bëhet vendit me këtë mur. Derisa ju vazhdimisht jeni thirrur se në Bruksel po bisedohet për t’i larguar barrikadat në veri, po bisedohet për ta liruar urën e Ibrit, në fakt ju keni biseduar për ndarjen e vendit dhe kjo përfundimisht po shihet, sepse muri tashmë është atje.

Ju e keni filluar këtë dialog pa asnjë agjendë, pa asnjë afat kohor se sa do të zgjasin këto bisedime, se cilat do të jenë temat që pritet t’i diskutojnë. Ju atje keni shkuar me duar në xhepa, sepse kjo tashmë është dëshmuar edhe me rezultatet fatale që vendi po i përjeton sot. Ju në këto bisedime, në vend që t’i hapni rrugë vendit tonë që të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare, e në vend që të punoni që sa më parë qytetarëve t’u ofrojmë liberalizim të vizave, e në vend që të kërkonte nga Serbia ta njohë vendin tonë, ju nuk e bëtë këtë, sepse ju interesonin gjërat personale që t’i rehatoni më shumë se ato shtetërore.

Ju këtë dialog e keni filluar dhe po e vazhdoni vetëm për përmirësimin e imazheve tuaja personale, të gjithë ju të cilët jeni të përfshirë, pa dallim. Ju as që ju ka interesuar se çka po dakordoheni me palën serbe, sepse me ndihmën tuaj Serbia e fitoi liberalizimin e vizave, sepse me ndihmën tuaj Serbia është futur në Kosovë, sepse me ndihmën tuaj Serbia e solli Listën serbe, e cila nuk i përfaqëson interesat e serbëve të Kosovës, por është vegël e Beogradit, sepse me ndihmën tuaj, Serbia përfundimisht ia arriti qëllimit të saj dhe falë juve sot Mitrovica po ndahet me një mur.

Të gjitha këto ju i keni bërë në mënyrën më të fshehur, pa e pyetur as këtë Kuvend, as qytetarët, sepse ju e keni ditur që qytetarët dhe ky Kuvend nuk do ta pranojë një ndarje. Ky mur, ashtu siç është ndërtuar, duhet të largohet sa më parë.

Zonja Tahiri, sa herë që është kthyer nga Brukseli, vendit tonë i ka ndodhur diçka e keqe. Sa herë ajo ka deklaruar diçka, çdoherë ka dalë e kundërta. Si duket, është inspiruar nga zoti Thaçi. Fatkeqësisht, ju që nga ardhja në krye e kësaj Qeverie e keni vazhduar rrugën e shkatërrimit të vendit. Ju i shkatërruat institucionet, e shkatërruat të ardhmen e rinisë, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, drejtësinë dhe përfundimisht e shkatërruat edhe të ardhmen e qytetarëve të Mitrovicës. Në këtë rast e kam fjalën vetëm për shqiptarët, sepse serbët ia arritën qëllimit të vet.

Ju ia mundësuar palës serbe që t'i arrijë qëllimet, që nuk patën mundësi t'i arrijnë në vitet '98-'99, pra ta ndajë Kosovën. Ju sollët dështimet më të mëdha me nënshkrimin e dy marrëveshjeve tashmë të dëshmuara se janë tepër të dëmshme për vendin. Me krijimin e Gjykatës Speciale, ju dështuat po ashtu edhe në krijimin e ushtrisë, derisa po jeni bash ideatorë të ndarjes së vendit.

Marrëveshja nga e cila po rrjedh edhe ndarja e Mitrovicës, e që nga ju u proklamua si sukses i madh, sepse serbët dhe strukturat e Serbisë po integroheshin, unë e kam një pyetje: Si po integrohen ato struktura? Duke ndërtuar mur, kështu po u bëka integrimi, apo siç keni deklaruar ju, se mur nuk ka në veri? Si është e mundur që ju, zoti Mustafa, të mos lejoheni të shkoni në veri të vendit dhe t'i shfrytëzoni rrugët malore për të arritur atje? Si është e mundur që zyrtarët e Serbisë të jenë ata që vendosin për të ardhmen në veri. Si e shpjegoni ju, edhe përkundër faktit që zyrtarët e Serbisë e kanë të ndaluar hyrjen në Kosovë, ata hyjnë pa asnjë telashe derisa juve ju pengojnë për qarkullim të lirë në vendin tuaj?

Në veri, zoti Mustafa dhe zonja Tahiri, është ndërtuar ai mur. Në veri nuk janë shuar asnjëherë strukturat paralele. Duhet t'i tregoni opinionit se nuk jeni ju që vendosni dhe nuk jeni ju Qeveria e cila ka efekt dhe ndikim në pjesën veriore. Tashmë kjo është e qartë dhe po dihet. Sepse, shqiptarët në veri nuk guxojnë të ndërtojnë në pronat e tyre private. Sepse, atyre u shkatërrohen pronat brenda natës dhe ju vazhdimisht u bëni thirrje t'i ndërpresin punimet në pronat private të tyre, e kjo realisht nuk vlen për palën serbe.

Deklaratat tuaja për murin ishin se jo s'ka mur, ndërsa ishte ndërtuar mbi 2 metra. Tjera thoshte se muri do të rrënohet, e tjetri thotë se nuk e di që ka mur, e tjetri thotë që nuk është mur, por janë shkallë. Apo sinqerisht po ju duket si perceptcion edhe muri në veri?!

Përfundimisht, këtu pajtohem me zonjën Tahiri se bisedimet duhet të marrin kah tjetër, gjithsesi, por jo me ju zonjë dhe jo me këtë Qeveri, sepse ju dhe vetëm ju jeni përgjegjës për të gjitha marrëveshjet e dëmshme që ia sollët vendit tonë dhe normalisht jeni përgjegjësit kryesorë për ndarjen e vendit.

Paska qenë e kotë e gjithë lufta, se të mbrohet Kosova me gjak dhe në liri të ndahet me pëlqimin e 2-3 vetave, ta dini që kjo është e papranueshme. Dhe, ju që keni bërë marrëveshje për këtë mur, ju duhet të na tregoni si dhe kur e keni bërë këtë marrëveshje. Sepse, ne e dimë që në momentin kur zonja Tahiri deklaroi diçka, përgatituni që të ndodhë e kundërta.

Pra, ky është rreziku, prandaj ju nuk keni të drejtë dhe as nuk duhet të ju shkojë mendja ta lejoni atë mur. Krejt në fund, edhe po më vjen keq që interesimi i deputetëve është në numër kaq të vogël për këtë temë, dua t'ju them se pavarësisht përkufizimeve apo qëndrimeve që ju po i jepni në lidhje me murin çdo ditë, ju duhet ta dini se kuptimi bazë i atij muri është ndarja e Mitrovicës.

Ai mur është i papranueshëm dhe sa më parë duhet të largohet i tëri dhe ju që e keni dhënë pëlqimin për ndërtimin e tij duhet të jepni llogari.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, e dëshiron fjalën? Zoti Bajrami.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Poštovani poslanici,

Poštovani građani Kosova,

Poštovani Bošnjaci u Mitrovici, u Leposaviću,

Svi zidovi koji se podižu za podjelu bilo gradova ili nekih mesta, su neprihvatljivi, pogotovo za nas Bošnjake koji imamo jako loše iskustvo sa zidovima i stvaranjem veštačkih podjela u gradovima u Bosni. Nažalost, matrica tih podjela i inspiratori tih podjela su uvek isti i dolaze iz nacionalističke i šovinističkih krugova u Beogradu.

I ovom prilikom, u ime Koalicije VAKAT, nas dvoje poslanika, i u ime grupa “6+” želim da osobim podizanje ovoga zida i da podržim Vladu Kosova u sve napore da se taj zid ukloni. Dakle ohrabrialo nas je što smo unazad dvije godine koliko toliko imali napredak na sjeveru u integraciju i tog dijela teritorije Kosova u institucije iz zakonodavnih ustavni okvir Republike Kosova. Nadamo se da će ti iskoraci biti nastavljeni, i ohrabrujemo Vladu Kosova i premijera i sve ministra da nastave u ovom pravcu, jer svi smo svesni da jako teško pregovarati posle toliko

godina i dogovarati, i ponovo pregovarati i ponovo dogovarati sve te poteze tamo koji se vuku, i koji nažalost se i dalje diktiraju, ili ko će, kao što sam rekao, iz Beograda. Ja želim ovom prilikom, poštovani Premijeru i ministrice Tahiri, da vas podsetim da smo mi Bošnjački predstavnici bili protiv onoga sporazuma koji je dvoetnički, i ovom prilikom će podvući da se nažalost pokazalo da je tako, bez obzira na mnogo vaše obećanja da to baš nije tako, ispalo da jeste, jer na žalost o tom sporazumu nemamo zaposlenog nijednog studiju Bošnjaka na sjeveru, niti imamo zaposlenog nekog tužioca. Ispalo je da su se započeli samo sudije Srbi i Albanci, to je fakt i to ne može niko da menja.

Ja želim i ovom prilikom da vas pozovem da se ispoštuje zaključci i pisma i zahtevi koji ste dobili od predstavnika Bošnjaka na sjeveru Kosova. Od legalnih izabраниh predstavnika, kao što je g. Nedžad Ugljanin, delegat u Skupštini Mitrovice, i takođe naši legalni predstavnici u opštini Leposavić, kao što je porodica Salković, iz koje je i narodni heroj koji ubijen 2010. godine na sjeveru, nažalost i do današnjeg dana nije se otkrivene ubice, to je Rafletić Šefko Šalković.

Da ovde javno kažem da njegova supruga koja ima malu kćer nije mogla nedavno da se zaposli na jednom prostijem mjestu u opštini Leposavić, iako je primljeno 80. novih službenika. Konkurisala je za jedno jako prosto radno mesto, jer je marka koja hrani dete, udovica je, i nije bila primljena. Takođe primljen nijedan Bošnjak tamo. Primljeno je, po nekim informacijama koje dobijam sa terena, tek troje četvoro Albanaca. Dakle i mnogi Albanci na sjeveru imaju problema i paradoks bude veći s obzirom da prate ova naša istupanja ovde, oni se kao nama obraćaju za pomoć, misle da mi možemo nešto da im pomognemo.

Mi ćemo najbolje pomoći Bošnjacima na Kosovu da, nemamo ovde ministra za obrazovanje, a koje će obrazovanja na bosanskom jeziku u Mitrovici, dakle u Mitrovici koja je potpunom kontrolom kosovske Vlade. Nažalost Bošnjaci u Leposaviću, još uvijek nemaju ona prava koje imaju Bošnjaci u Srbiji da se školuju na bosanskom jeziku. Oni i dalje prate nastavu na srpskom jeziku. To je kršenje običnih ljudskih prava. Bošnjaci su izborili u Bosnu i Hercegovine nastavu na bosanskom jeziku i posle formiranja armije Bosne i Hercegovine to je najveći historijski potez u Bosni. Mi ne možemo da dozvolimo danas da o tome ne smijemo da govorimo na severu. Naši predstavnici ne smeju o tome da govore. Dakle Vlada Kosova, odnosno Ministarstvo za obrazovanje treba da se pozabavi ovim pitanjem. Bošnjaci su tamo ostali da žive u znatnom broju, nažalost u većem broju od koliko je bilo prije rata su se iselili sa tih prostora. Međutim oni trebaju da ostanu i opstanu, a Vlada Kosova mora da povede računa i o tom dijelu stanovništva.

Mi činimo napore koliko možemo. Moramo da radimo neke oprezne korake jer nažalost oni nemaju tamo slobodu govora i ne smeju da iskažu redovno sve svoje zahteve. Ovom prilikom dakle sa naše strane imate punu podršku da se taj zid ukloni, pozivamo i predstavnike Evropske Unije i međunarodne zajednice da pomognu u ovom pravcu, jer smatramo kao što sam rekao na početku da svi zidovi samo vode ka podjelama i podizanje zidova je odavno završena moda u

Evropi. Zadnji Berlinski zid srušen je davno, Kineski zid već služi vjekovima za atrakciju. Ne treba nam na Kosovu novi zidovi, trebaju nam mostovi koji će spajati i ovom prilikom pozivam naše kolege poslanike i Srpske zajednice koje trenutno nisu ovde, a koji su napravili jedan iskorak i vratili se u Skupštini Kosova, da također naprave iskorak i zajedno sa nama grade ove mostove i da zajedničko živimo u Kosovu svi ravnopravno, i da idemo napred ka Evropskoj Uniji. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të pranishëm,

Sinqerisht edhe ky debat që sot po e zhvillojmë, sipas mendimit tim, është krejtësisht i panevojshëm. Institucionet përgjegjëse për atë pjesë në veri të Kosovës të quajtur “mur” është dashur të reagojnë me kohë dhe mbi të gjitha është dashur që ne si ligjvënës të na njoftojnë rreth detajeve të marrëveshjeve të Brukselit, në mënyrë që të mos diskutojmë për gjëra kot dhe “post festum”.

Uroj që pas këtij diskutimi, Qeveria dhe institucionet përgjegjëse të jenë në nivel të detyrës dhe ta heqin atë objekt të ndërtuar pa leje. Reagimi është dashur të jetë varësisht nga niveli i përgjegjësisë institucionale.

Më lejoni të them se çështjet me rëndësi për Kosovën na obligojnë të gjithëve. Këto çështje, siç është muri dhe çështjet tjera, nuk janë as partiake, as të OJQ-ve, por janë të të gjithë neve së bashku. Kërkojnë një qasje institucionale, një aktivizim bile edhe qytetar dhe të gjitha bashkë. Mendoj që Evropa promovon diçka tjetër, jo atë që ne shohim në veri të Kosovës. Evropa promovon hapje të kufijve. Ngritja e murit përtej Ibrit është bërë me dhunë, tinëzisht dhe jo me ligj. Prandaj, edhe largimin e tij duhet bërë ndoshta me të njëjtin zhargon.

Të gjithë atyre që synojnë ta rrënojnë shtetin, më e pakta që është që Qeveria t’u përgjigjet në rrënimin e atij muri shëmtarak dhe t’i sjellin para drejtësisë ideatorët e kësaj shëmtie. Ndërtimi i murit në pjesën veriore të Mitrovicës është tërësisht i paligjshëm dhe si i tillë është i papranueshëm. Ai nuk ka asnjë synim praktik që do të lidhej me planifikimin urban të asaj pjese të qytetit. I gjithë dialogu i Brukselit për atë pjesë të Kosovës është zhvilluar me synimin për ta integruar atë pjesë në kuadër të sistemit juridik të Kosovës dhe akoma më shumë për ta integruar ekonomikisht, politikisht e në çdo aspekt tjetër.

Askush nuk mund të thotë se ndërtimi i një muri në mes të qytetit është element integrimi, por dua të sqaroj që kundërshtimi ynë ndaj murit në veri nuk është një betejë me serbët, e aq më pak me Bashkimin Evropian. Në fakt, kundërshtimi i një projekti të tillë është mbrojtje e vlerave dhe parimeve mbi të cilat ka lindur dhe funksionon Bashkimi Evropian.

Republika e Kosovës është vendi me standardet më të larta të mbrojtjes së pakicave shikuar nga aspekti kushtetues dhe ligjor. Por, më tutje këto rregullime kushtetuese dhe ligjore janë përkthyer edhe në gjëra praktike për komunitetet pakicë. Në këtë kuptim, mendoj se veprimet që pengojnë integrimin e veriut janë abuzim me të drejtat që Kosova ka ofruar për pakicat dhe në thelb është një qasje politikisht jokorrekte dhe moralisht e padrejtë.

Ngado që ta kundrosh çështjen e murit të ngritur atje del se ai duhet të hiqet. Muri atje është një shëmti, shëmti që i hedh hije të keqe Evropës, shëmti që i hedh hije të keqe Kosovës, shëmti që u hedh hije të keqe përpjekjeve të dy palëve, e minon konsolidimin e vlerave evropiane. Para kësaj shëmtie nuk duhet të ketë stepje, e as ndalje. Duhet thënë “stop” ideologjive mesjetare. Këto ideologji kanë filluar të përparojnë karshi një ngathtësie apo neglizhence institucionale, që nuk dëshiroj të them - edhe një indiference evropiane.

Mbi të gjitha, nuk mund të ankohe mi për indiferencën evropiane, sepse punët tona duhet t'i kryejmë vetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka fjalën

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues i kësaj seance.

Tani muri në Mitrovicë është marrë si shkas për të cilin po zhvillohet një debat më i gjerë. Unë mund të them se do të ndihesha shumë më lehtë po të ishte kjo çështje private imja, e Isa Mustafës dhe Edita Tahirit, edhe po të mos kishim disa rezoluta të aprovuara në këtë Kuvend lidhur me dialogun, që datojnë pak më herët se sa kur unë kam ardhur kryeministër i vendit, po të mos e kishim një ligj për ratifikimin e marrëveshjes së parë, e cila po ashtu e ka datën e caktuar kur është bërë, po të mos ishim bashkëpjesëmarrës të kësaj. Edhe ata që sot e kanë bërë kërkesën për këtë debat, sepse atëherë kanë qenë pjesë aktive e dialogut dhe unë s'kam asgjë kundër, sepse ne si parti politike, përderisa unë s'kam qenë në Qeveri, e kemi përkrahur dialogun. Në krye të Lidhjes Demokratike, ne e kemi përkrahur dialogun, por s'kemi marrë pjesë në dialog.

Unë kur kam ardhur kryeministër, i kam respektuar të gjitha dokumentet që qeveria e atëhershme i ka nënshkruar, obligimet, të cilat i ka marrë shteti i Kosovës, dokumentet dhe ligjet, të cilat i ka ratifikuar ky Kuvend i Republikës së Kosovës.

Privatisht s'kam pasur asnjë prekje me njerëzit në veri, as s'kam bërë kontrabandë me ta, as s'kam blerë, as s'kam shitur, as s'kam importuar naftë, as s'kam shitur xehe, as s'kam vënë barrikada, as s'kam hequr barrikada. Kështu që them problemin ta shtrojmë pak më ndryshe. Dhe unë qëndroj prapa kësaj, qëndroj edhe prapa marrëveshjeve, të cilat unë i kam nënshkruar në Bruksel në gusht të vitit 2015, për periudhën për të cilën unë e marr përgjegjësinë.

Edhe prapa kësaj marrëveshje që ka të bëjë me rekonstruimin e urës mbi Ibër, edhe me shndërrimin e rrugës kryesore në shëtitore. Mirëpo, unë me përgjegjësi të plotë ligjore e etike them se në asnjë moment në Bruksel nuk është diskutuar për murin dhe muri s'ka qenë pjesë e këtij projekti. Pjesë e këtij projekti ka qenë rekonstruimi i urës mbi Ibër, dy rrethrotullime, njëri në pjesën veriore dhe njëri në pjesën jugore dhe shndërrimi i rrugës "Mbreti Petri" ("Kralj Petar") në shëtitore, të cilin ne e kemi pranuar dhe e kemi nënshkruar.

Pse e kemi pranuar? E kemi pranuar në mënyrë që t'i heqim barrikadat nga ura dhe ta lëshojmë urën që të ketë qarkullim të këmbësorëve, të ketë qarkullim të automjeteve, të ketë qarkullim të çiklistëve dhe të ketë komunikim ndërmjet pjesës jugore dhe pjesës veriore të vendit.

Çdo tentativë e dikujt për arsye populiste e arsye tjera që tani të thuhet se jeni marrë vesh për murin, unë ju them jo, për murin s'është diskutuar kurrë. Për murin e kemi thirrur Bashkimin Evropian pasi është vërejtur se është ngrehur, kemi bërë vërejtje, ka shkuar Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka marrë masa, i kanë ndalur punimet, edhe pse kompetenca i inspektimit, kompetenca e ndërtimeve është kompetencë komunale në pjesën veriore, sepse ky mur nuk bie në kategorinë e tretë, por bie në kategorinë e dytë, që rregullohet me Ligjin mbi ndërtimin dhe përgjegjësitë edhe për menaxhimin e murit, edhe për kontrollin e murit, edhe për ndërtimet atje, edhe për rrënimet, janë përgjegjësi komunale dhe ne duhet ta zbatojmë ligjin.

Dhe, ligji thotë qartë se neni 31 i Ligjit për ndërtime parasheh që të gjithë punonjësit përgjegjës dhe inspektorët në organet kompetente që veprojnë në kundërshtim me këtë ligj, ndaj të gjithëve do të merren masa ndëshkuese financiare dhe penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dhe, ne duhet ta aplikojmë ligjin, sepse ligji e adreson qartë se kush është përgjegjës për ato objekte atje. Sa u përket barrikadave, ne kemi pasur mbi 20 barrikada në veri të vendit, janë hequr një nga një. Dhe, dialogu ka ndikuar që barrikadat në veri të vendit të hiqen. Ne kemi pasur bartje të punëtorëve të Doganave dhe policëve me helikopterë në vijat kufitare, në mënyrë që ata ta bëjnë punën e tyre dhe heqja e barrikadave ka mundur që ata tash shkojnë në mënyrë normale që të komunikojnë atje.

Ne kemi arritur që t'i zhbëjmë strukturat paralele për të cilat janë zhvilluar biseda, ose është zhvilluar dialog në Bruksel, jo të gjitha, sepse nuk kemi arritur dhe unë mendoj që kjo është e arritur e madhe. E kemi zhbërë mbrojtjen civile atje, që i ka pas rreth 800 pjesëtarë, i kemi zhbërë edhe strukturat paralele, të cilat kanë lëshuar dokumentacion dhe tash atë e kemi zëvendësuar me strukturat zyrtare të Republikës së Kosovës, kemi marrë masa që ta vëmë kontrollin në rrjetin telefonik dhe që ta marrim kodin telefonik. Kemi edhe çështje tjera, për të cilat kemi arritur marrëveshje për IBM-në ose për menaxhimin e integruar të kufijve dhe, edhe në këtë aspekt po punohet dhe ata kufij po i menaxhojmë, unë s'mund të them se s'kemi probleme.

Por, tash ato probleme nuk mund t'i hedhim ne te njëri dhe tjetri, sepse të gjithë kur po shkojmë në Mitrovicë ne po ndalemi te një tel atje. Asnjëri, edhe pse po tregojmë trimëri këtu, s'po e kapërcen atë tel. Edhe tash kur po shkojnë për ta vështruar murin, po shkojnë deri te një tel, po e vënë dorën aty si në Mekë, dhe pastaj po ndalen. E në qoftë se jeni trima, shtyjeni telin, dilni andej. Unë s'jam për atë që këtë ta bëjnë, mirëpo jam për atë që ta kemi parasysh se duhet ta respektojmë ligjin, se edhe ai mur duhet të rrënohet sipas ligjit, se për atë mur s'ka dhënë askush leje që të ndërtohet, për atë mur s'ka dhënë askush pajtim që të ndërtohet. Nuk është pjesë e Marrëveshjes së Brukselit dhe si të tillë ne i kemi bërë vërejtje Brukselit dhe i kemi thënë merreni ju tash përgjegjësinë, sepse ju po e ndërtoni urën, ju jeni pajtuar që rruga të shndërrohet në shëtitore, dhe ju tash duhet ta merrni përgjegjësinë që ta detyroni Beogradin dhe ata që kanë bashkëpunuar me të ose e kanë ndërtuar që ajo çështje të rrënohet.

Edhe, po ashtu, do të kërkojmë prej organeve ligjore që atë ta bëjnë. Mirëpo, Qeveria nuk është ajo e cila ose bën marrëveshje për mur, ose merret me mur. Ne do të merremi me murin në pikëpamje të ligjit, sepse ligji duhet të zbatohet. Ai mur është joligjor, është ilegal, dhe ne kemi thënë qartë se nuk do të pranojmë në asnjë rast të zhvillojmë dialog për murin, sepse po të ulemi të bisedojmë për murin ne ulemi bisedojmë për një objekt ilegal në mënyrë që atë ta legalizojnë, dhe ajo nuk do të bëhet. As nuk bëhet shkallë.

Domethënë, si Qeveri s'pajtohem kurrë që të diskutojmë për të. E them me përgjegjësi më të madhe. Çështjet e tjera mbeten. Ne kemi biseduar edhe me kryetarin e Kuvendit, edhe me Presidentin, jemi marrë vesh qartë që aty lëshim nuk ka, se është një çështje e cila është bërë jashtë marrëveshjes, jashtë vijës sonë dhe ajo duhet të trajtohet në mënyrën ligjore dhe ai mur duhet të shkojë. Ai mur duhet të hiqet dhe për atë mur debat nuk ka. Dialog nuk ka.

Mirëpo, unë nuk mund të them se nuk do të ketë dialog për çështjet tjera, sepse ne nuk kemi alternativë tjetër si ta zgjidhim atë problem. Në rezolutë është thënë duhet ta ndalim dialogun derisa të na pranojë Serbia. Po nëse na pranon Serbia, ne po e ndalim, mirëpo të gjithë po na thonë që ne duhet t'i zgjidhim disa probleme përpara, të krijojmë kushte, ta marrim përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përkrahjen e Bashkimit Evropian, ashtu siç e kemi marrë që

të pranohemi në Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, që do të marrim edhe përkrahjen e tyre edhe më vonë.

Kemi shtete të Bashkimit Evropian, të cilat nuk na kanë pranuar, të cilat na e kushtëzojnë pranimin e tyre me stabilitetin në këtë regjion dhe ne atë duhet ta bëjmë, përndryshe askush nuk ka dëshirë. Në qoftë se Pali ka shumë para, unë hiç nuk e kundërshtoj që të m'i japë ai disa para, mirëpo unë kurrë s'kam kërkuar para nga Pali dhe s'kam nevojë as për paratë e Palit, as për paratë e rrugës për Bruksel që të zhvilloj debat atje.

Në qoftë se atij i janë thelluar xhepat, e kanë rënduar paratë, është problem i tij. Kur të rëndojnë paratë, thonë të rëndon edhe koka. Mirëpo, unë këtu nuk dëshiroj të merrem me këto çështje, prandaj me përgjegjësinë më të madhe ju them se muri është joligjor, muri nuk ka lindur në bazë të projektit as të Brukselit, as që ne e kemi aprovuar dhe muri duhet të trajtohet sipas ligjit.

Sa i përket dialogut, në krye të Qeverisë, në të cilën jam, unë do ta vazhdoj dialogun, sepse nuk shoh alternativë tjetër dhe sa i përket edhe zonjushës ministre, e cila është përgjegjëse për këtë pjesë të dialogut, unë mund të ju them se nuk është shumë e dëshiruar që të jesh në pozitën dhe në lëkurën e saj. Ajo e ka bërë punën me përgjegjësinë më të madhe. E ka një punë shumë të rëndë, shumë të vështirë dhe e ka pasur përkrahjen tonë për këtë punë dhe e ka përkrahjen edhe më tutje, përderisa ajo është shumë e përgjegjshme për punën e saj, të cilën e bën atje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Parlamentit, zoti Kadri Veseli. Kush do replikë? Pal Lekaj!

PAL LEKAJ: Zoti kryeministër!

E përmendët ratifikimin e marrëveshjes këtu në Kuvend për dialog, por mos e fyej këtë Kuvend, sepse asnjëherë nuk besoj që asnjë deputet që e ka pak ndërgjegjen e shtetbërjes që u ka dhënë kompetenca për të ndërtuar mure dhe e thatë që në njërën anë po e thoni që ne do ta rrënojmë murin dhe në tjetrën anë thirrni në kompetencat e komunës veriore. Tani kush do të veprojë kështu?

Kur e thoni që muri është bërë në mënyrë ilegale, çka pritni zoti kryeministër dhe nuk keni shkuar në Bruksel për të dialoguar që të ndërtoni mur, nuk keni shkuar në Bruksel për ta shkatërruar shtetin e Kosovës dhe ne po e themi këtu nëse ka zot shtëpie, nëse kemi shtet, atëherë mos thirrni që individë të caktuar të rrënojnë mure. Kanë rrënuar edhe individë të caktuar atëherë kur është dashur që t'i rrokin armët, por tani kemi ligj dhe kemi shtet dhe mos bëni thirrje që ta hidhni përgjegjësinë te qytetarët, sepse atëherë përgjegjësia, sikur sot që ju bie ju, do të bjerë edhe pas reagimit qytetar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Po tani zoti Pal, unë mendoj që ne shqip po flasim dhe unë asgjë tjetër s'po them, vetëm se po adresoj me ligj, sepse as mendjen si kryeministër nuk e kam të veproj jashtë ligjit.

E kujt është përgjegjësia ligjore për murin? Dhe, po ashtu në gjuhën shqipe thashë se në asnjë rast ne nuk kemi biseduar për murin, as s'ka qenë muri kurrë në asnjë rast objekt i diskutimit, as i dialogut në Bruksel. Dhe, s'kemi nevojë ta hedhim atë në tavolinë. Sa i përket marrëveshjes, askund në marrëveshje nuk shkruan, as në ratifikim të marrëveshjes ndërtimi i murit. Kurrkund! Do të thotë, nuk e ka ratifikuar ky Parlament ndonjë marrëveshje, në të cilën është përmendur muri. E ka ratifikuar marrëveshjen e cila ka shumë pika, për të cilat duhet të dialogohet dhe të gjendet zgjidhje në dialogun e Brukselit, përfshirë edhe Asociacionin e Komunave me shumicë serbe, edhe vënien e drejtësisë në veri të vendit, edhe shumë probleme tjera, të cilat unë mendoj se janë zgjidhur dhe që ka rezultate të zgjidhjes së këtyre problemeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Zoti Pal Lekaj, faleminderit për iniciativën, për aq sa edhe të gjithë kolegëve deputetë Kuvendit të Republikës së Kosovës, edhe kryeministrit të Republikës së Kosovës kur kemi bashkëbiseduar dhe ka qenë më tepër se gatishmëri të bisedojmë për çështjen e murit në pjesën veriore, i cili është një shqetësim i gjithë neve, dhe të paktën ky është mendimi im si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mirë, është që zakonisht krejt adresimin për çështjen e murit dhe shqetësimin tonë ta bashkëbisedojmë duke pasur besim te njëri-tjetri se asnjëri nga ne brenda institucioneve nuk e ka dashur këtë muri.

Sido që të jetë, ne duhet ta adresojmë shqetësimin tonë, i cili është real. Një mur ka ndodhur në pjesën veriore të Mitrovicës. Pas gjashtë vjetësh përpjekjesh tona, ju jeni vetë dëshmitarë sa herë jemi ballafaquar po në këtë Kuvend me kritikën, të cilat kanë qenë ndoshta nganjëherë reale, por edhe joreale për çështjen e dialogut. Duhet të jetë te kolegët tanë të Bashkimit Evropian një kampanë e alarmit se si po shpërblehen përpjekjet tona korrekte që pas gjashtë vjetëve nga shëmtia e bllokadës së urës mbi lumin Ibër, ta kemi një park - një shëmti po ashtu, duke u tentuar ta zbukurojë dhe në fund për t'i dalë një marre, që ka qenë shumë e madhe dhe shumë e rëndë për ta vënë një mur në mënyrën ilegale dhe në mënyrën më të keqe të mundshme.

Të jetë një mur në shekullin XXI në mes të Evropës, kjo jo veçse është e papranueshme, por kjo është më shumë se sa turp. Kjo ne që jemi angazhuar na rikthen krejt pjesën në pikën zero, e

humb kuptimin e procesit të dialogut për çka ne jemi shumë të përkushtuar që të kemi komunikim, që të kemi përmirësim të situatës të komunikimit ndërmjet komunitetit shqiptar dhe serb, që të evitohen manipulimet, të cilat i bën Beogradi zyrtar, veçanërisht duke tentuar që ta mbajë pjesën veriore të atdheut të vet nën influencë me manipulime mbi qytetarët serbë, veçanërisht duke i mbajtur në presion psikologjik se në qoftë se ka lëvizje dhe komunikim do të vijin shqiptarët dhe do t'ju zhbëjnë nga toka, derisa nuk e pranojmë faktin se sot në kryeqendrën tonë në çdo lokalitet urban ka lëvizje, ka një bashkëjetesë ku kolegët tanë serbë, bashkëqytetarët tanë mund të lëvizin lirshëm, nuk i ngacmon askush, por përkundrazi. Kjo është ajo çka ne duhet të punojmë bashkërisht si Kuvend dhe si institucione, po ashtu Qeveria e Republikës së Kosovës. Të jemi edhe më shumë të vendosur në këtë drejtim.

Muri as nuk duhet të rrënohet, as nuk duhet të mendojmë në atë, muri duhet të largohet sa më shpejt. Ky është mesazhi i cili... kjo është për atë arsye se jemi takuar dhe duhet ta sensibilizojmë këtë pjesë. Në qoftë se, muri në pjesën veriore nuk largohet brenda kohës së caktuar, mirëbesim, atëherë ne do të veprojmë si institucione të Republikës së Kosovës edhe murim do ta rrënojmë. Konsekuencat për këtë do t'i bartin të gjithë ata që kanë lejuar me qenë aty, por nuk është mirë të kemi një moment të tillë, i cili nuk do t'i konvenojë askujt. Por, ne do ta bëjmë, të jemi të besueshëm në këtë, kemi bashkëbiseduar me kryeministrin, me presidentin, kemi pasur disa takime, nuk ka qenë një, bashkërisht për këtë çështje. Nuk kemi dashur në asnjë moment ta politizojmë këtë çështje në mënyrë të tejskajshme për hir të popullizmit, kemi pasur edhe iniciativa konkrete, ja ku është edhe kryeministri, presidenti nuk është aktualisht. Muri do të rrënohet, muri do të rrënohet, edhe mirë është të rrënohet sa më shpejt nga ata të cilët e kanë ndërtuar.

Në qoftë se, brenda një kohe të caktuar nuk do të rrënohet nga ata të cilët e kanë shkaktuar, atëherë muri i cili është ilegal pavarësisht kompetencave të kryetarit të komunës së veriut, nuk e ka lejen e autoriteteve qendrore. Paramendoni, në qoftë se dikush do të ndërtonte një mur, i nderuar Pal Lekaj, kryetari ynë Rasimi në Deçan kah Manastiri, çfarë logjike do të kishte. Paramendoni, ta ndërtojë një mur kryetari ynë i Prishtinës, Shpendi, kah Graçanica. Nuk bëhen këto gjëra kështu. Duhet sa më shpejt të largohet muri.

Ajo që dëshiroj ta potencoj, me respektin e madh për ju të gjithë, është se është mirë që ne gradualisht në këtë proces të jemi më të vëmendshëm, por të njëjtën kohë edhe më transparentë, për arsye se gjendjen e kemi të tillë. Transparenca na e eviton çdo keqkuptim që mund të jetë në mes nesh, veçanërisht procesin e dialogimit. Të njëjtën kohë, çfarë kisha kërkuar, i nderuar zoti Pal Lekaj, në rezolutën e juaj të futen, janë investimet në veri, duhet të fillojë... është ndalur ndërtimi i shtëpive në pjesën veriore. Qe tre vjet nuk ka asnjë ndërtim të shtëpive në pjesën veriore. Janë investuar deri në 2013-ën rreth 8 milionë e gjysmë, ka tre vjet që nuk ka investim. Ka qenë aksioni "Ndihmo edhe ti", më vjen keq ta them, kanë mbetur ende rreth 200 mijë euro të cilat nuk janë shpërndarë.

Nuk dua ta lidh me kontekst politik, por duhet me pas guxim më shumë. Kemi ndërtuar shtëpia, diku afër 90 shtëpi dhe më shumë kemi rindërtuar edhe disa të tjera më herët. Pse është ndalur procesi i ndërtimit të shtëpive? Nuk po flasim për shtëpi për kolonizim, siç po tentojnë me e bë me atë koloninë tjetër të shëmtuar në “Kodrën e Diellit” kah Zveçani, por po flasim për shtëpi që kanë qenë të djegura të bashkëqytetarëve tanë. Në të njëjtën kohë duhet me insistua 400, mbi 400 apartamentet, të cilat mbahen ende, një pjesë e tyre janë liruar, po të kthehen qytetarët tanë, lëvizja e lirë të jetë andej.

E keni parë edhe ju të gjithë, derisa ne bashkëbisedojmë në këtë vend, qytetarët e pjesës veriore nuk kanë shumë rrugë, njëra nga rrugët ju ka shemb nga shirat. Nuk duhet me u vonua, ajo ka punë rezervë shteti, me reagua menjëherë, me investua. Fat i mirë, që e kemi kaluar një edhe me shumë lutje, një shkollë të cilën e kemi kaluar tash në buxhet në 2017-ën, ka qenë amendament i Partisë Demokratike të Kosovës, por të njëjtën kohë duhet me u përforcua sistemi shëndetësor, të njëjtën kohë. Më vjen keq ta them, por asnjë... pothuajse shumë pak e fare, ka pjesëtarë tanë qytetarë të Republikës së Kosovës të komunitetit jo serbë që janë në Policinë e Kosovës, forcën e sigurisë së Kosovës. Duhet dhënë mundësi këtyre njerëzve të rekrutohen. Të njëjtën kohë, shumë shpejt e keni, do t’ju vijë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është iniciativa e cila ka ndodhur edhe nga deputetët, Ligji për integrimin e qytetarëve të pjesës veriore, e përkrahim, ajo është vetëm në proces. Besoj që Qeveria nuk na e vonon mbi një muaj, në janar ta kalojmë bashkërisht.

Ata njerëz kanë nevojë të mos i lëshojnë shtëpitë e veta, pjesa e madhe e tyre paguajnë banesa me qira, nuk është duke u ndihmuar, siç ua ka ndihmuar në të kaluarën, me qira. Është dashur të paktën shteti, derisa bisedojmë për pjesën veriore, t’i marrë të gjitha përgjegjësitë e qirave të tyre, të cilat i kanë shtëpitë e tyre të uzurpuara në pjesën veriore.

Të gjitha këto mund të krijohen edhe është mirë që të ishin edhe në rezolutën e juaj. Përkrahjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës do ta keni. Besoj se të të gjithë deputetëve do ta keni edhe të ecim përpara. Sa i përket çështjes së murit debatojmë, të sensibilizojmë edhe muri duhet të largohet, sa nuk është bërë vonë. Kur të bëhet vonë përgjegjësinë dikush do ta marrë, çfarëdo që shkaktohet. Fare qartë e them, do të shkojnë eskadronët e shkatërrimit të atij muri, do të nisen nga ministria e ambientit. Këtë të jeni të sigurt, nuk është mirë të jetë kjo kampioni e alarmit, këtë e kemi bashkëbiseduar edhe me kryeministrin edhe me presidentin e Republikës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ali Berisha.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryesues!
Përsëritje për të gjithë deputetët!

Sinqerisht, jam shumë i befashuar sot me fjalimin e kryeministrit të Kosovës. Në vend se të merret me trajtimin e problemit të madh që e kemi, trajton çështje sikur të ishte bartës i ndonjë OJQ-je. Është bartës kryesor i funksionimit të këtij shteti.

Kryeministri i Kosovës flet për kontrabandë dhe njerëz që bëjnë kontrabandë. Kush është përgjegjës që të funksionojë shteti e të mos bëhet kontrabanda atje? Kryeministri i Kosovës është njerëzit që të dalin në veri dhe në atë pjesë kur nuk ka qarkullim të lirë, kush është përgjegjës për ta mundësuar qarkullimin e lirë të njerëzve?

I pari i shtetit është bartës i institucionit ekzekutiv të kësaj Kosove. Ku e kemi sot Kosovën? Të ndarë në shumë pjesë të saj, ku njerëzit nuk mund të qarkullojnë të lirë, ndërsa kryeministri i Kosovës silltet sikur me qenë në opozitë apo sikur me qenë ndonjë organizatë joqeveritare. Është përgjegjës për zbatimin e gjithë asaj që është ekzekutive në këtë Kosovë.

Qeveria dhe kryeministri duhet të tregojnë pse u ndërtua ky mur. U ndërtua apo u lejua të ndërtohet, është njëllor. A nuk mjaftonte një urë për ta ndarë Mitrovicën, po duhej të ndërtohej edhe një mur?

Ndërtimi i atij muri aty tregon se dikush nuk po bën asgjë për ta integruar atë pjesë, madje mund të thuhet se po kontribuon që ajo të mos integrohet. Ndërtimi i këtij muri aty do të thotë se vetëdijshëm po lejohet thellimi i problemit të veriut të Mitrovicës. Një herë u hoqën sikur s' dinin asgjë për atë mur. U tha, se ky mur është ilegal dhe duhet të shembet, më vonë dolën deklarata që është pjesë e një projekti, për të cilin ishin pajtuar edhe Qeveria e Kosovës që të ndodhë, kurse tani si për të mos u dukur kaq i madh ky mur, po thuhet se këtij duhet t'i hiqen disa centimetra dhe të bëhen shkallë. Pse shkallë? Pse po mashtrohet populli?

Çështja që shtrohet sot është, çfarë po bisedohet në Bruksel? Për integrimin e pjesës veriore e forcimin e shtetit apo për çintegrim dhe dobësimin e shtetit të Kosovës. Këto marrëveshje dhe ndërtimi i këtij muri e bëjnë pikërisht këtë të fundit. Edhe vetë projekti i rivitalizimit të urës është bërë në atë formë, që të lehtësohet mundësia e bllokimit kurdo që e ka në plan Serbia dhe vartësit e qeverisë së Serbisë, që veprojnë në Kosovë.

Rruga që na çon drejt integritimit të veriut të Kosovës kalohet me heqjen e pengesave, që bëjnë çintegrimin e saj dhe jo me vendosjen e pengesave. Nëse në emër të integritimit ju po promovoni dhe po mundësoni lëvizje të lirë të qytetarëve të Kosovës, ideve, mallrave, kapitalit, e tjerë... nga jugu në veri dhe anasjelltas, ju realisht e keni thelluar ndarjen, pengesat dhe integrimin dhe kjo gjithnjë e më tepër, është kah bëhet e dukshme. Kushdo që ndjek këtë rrugë, me vetëdije apo pa të, po e bëni gjithnjë e më kompleks bashkimin e asaj pjese të Kosovës.

Integrimi i Mitrovicës arrihet me moslejimin e ndërtimit të mureve ndarëse, për më tepër, me heqjen e të gjitha pengesave, që nga ndërtimi i murit e deri te masat dhe veprimet kushtetuese të institucioneve për shtrirje të autoritetit dhe kontrollit të shtetit, në mënyrë që të vendoset ligjshmëria edhe në këtë pjesë të shtetit të Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Dialogu me Serbinë në Bruksel është komprometuar skajshmërisht dhe si i tillë ky proces rezulton të jetë vazhdimisht i dëmshëm për shtetin e Kosovës. Meqë ky lloj dialogu ka rezultuar me disa marrëveshje të firmosura nga Qeveria e Kosovës, si pasojë Kosova po paguan kompromise të rënda, po i mundësohet Serbisë të ndërhyjë sa herë të dojë në çështje të brendshme të Kosovës, po e bën Serbinë vendimmarrëse në Republikën e Kosovës, po e ndanë pasurinë e vetë Republikës së Kosovës dhe tani, së fundmi, po i ndërtohen edhe mure të ndryshme në pjesë të ndryshme të Kosovës.

Kah dhe ku po na shpie kjo rrugë e funksionimit të kësaj Qeverie? Edhe sa pengesa e mure do të ngrihen në këtë shtetin tonë?

Nëse vazhdohet kështu, ndarja do të thellohet edhe më shumë, do të përshkallëzohet edhe më dukshëm dhe do të shtrihet edhe në pjesë tjera të Kosovës, kudo aty ku arrin dhe ka mundësi Serbia.

Duke ndjerë peshën e përgjegjësisë, si të gjithë ju deputetë, po edhe qytetarë, ne duhet që sa më shpejt të veprojmë. Nuk guxojmë të lejojmë situata të tilla, pasi që nëse lejohet kështu situata të tilla kanë me na u përsëritë edhe në lokalitete tjera. Të kontribuojmë që të zbatohen ligjet e Republikës së Kosovës në çdo cep të saj dhe të mundësohet lëvizja e lirë e qytetarëve, që sigurohet me Kushtetutën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Informatën për ndërtimin e murit e kam përjetuar ashtu si të gjithë qytetarët, si një peshë tepër të rëndë, si një sprovë që kërkon që tërë potencialin duhet ta akumulojmë, të hartojmë një strategji, që më në fund tu themi “stop” këtyre që po ndodhin në Kosovë.

E ndaj mendimin po ashtu, me shumë kolegë, se Kosova ka bërë shumë koncesione. Ka bërë me të vetmin qëllim, që Kosova të jetë e lirë, e pavarur dhe të zhvillohet si një shtet normal pa pengesa. Pengesat na janë shtruar në shumë prizma dhe shumë forma. Ahtisarin nuk e ka kërkuar Kosova, as rolin e tij, atë e ka kërkuar bashkësia ndërkombëtare dhe e ka vendosur Këshilli i Sigurimit bashkë me Kombet e Bashkuara.

Rezultati dhe produkti i tij për ne ka qenë shumë i dhembshëm, sepse kemi bërë koncesione të rënda me të vetmin qëllim, që më në fund do të jemi një shtet i pavarur dhe të mendojmë për të ardhmen e saj. Janë bërë koncesione që po na hakmerren e do të na hakmerren edhe në të ardhmen, edhe pse kur është nisur ai proces është thënë se procesi i Ahtisarit do të jetë komplet, nuk do të jetë parcial. Nëse ka pengesa në një parcialitet, atëherë i tërë projekti do të bjerë. Kjo nuk ka ndodhur. Kemi krijuar... katundet në komuna ua kemi shndërruar, kemi krijuar shtet mbi shtet përmes sistemit fetar-kishtar, që për mua ato janë kisha të Kosovës, kisha të Kosovës, qofshin ata serbë ose shqiptarë, kemi krijuar eksterritorialitet të tyre, se nuk e dimë krejt çfarë po ndodhë. E çka nuk kemi krijuar me favore, në kuptimin që Kosova më në fund, Bashkësia Ndërkombëtare t'i aplaudojë se po bën koncesione, në kuptimin e asaj që të krijohet një shtet normal.

Unë mendoj, se është koha që duhet të ridizajnohet i tërë diskutimi. Qeverinë dhe qeveritë tona i fajësoj, nëse ka marrëveshje të cilat nuk janë publike dhe unë ju them, nëse i bëni sot mund të bisedojmë dhe të pranojmë justifikime, por nëse e leni për nesër, kjo është përgjegjësi e çdonjërit, duhet të përgjigjet çdonjëri për atë.

Ka qenë një pikë shumë e këndshme për mua, kur kam dëgjuar reagimin e parë të ditës të kryeministrit, kryetarit të shtetit, kryetarit të Kuvendit dhe kanë qenë shumë të qartë, se muri duhet të rrënohet. Iniciativa që të kemi një debat, është kërkuar nocion, por Qeveria ka kërkuar debat, e kam mirëpritur shumë. Të diskutojmë, të shohim ku janë çështjet. Nëse ata thonë se kanë stagnuar dhe s'kanë fuqi më tutje t'i ecin këto procese, atëherë është një çështje tjetër, që mund të bisedojmë. Por, sot kur ata me tërë fuqinë e vetë po e zbrazin, së paku në mënyrë deklarative, ne duhet të nisemi këtu, të pozicionohemi këtu, t'i rrokim për fjalësh, siç thotë populli. Nuk është momenti krejt arsenalin e armiqësisë ta zbrazim tash kur nuk e ka kohën, nuk e ka vendin, sepse ajo, të nderuar opozitë, ju lë një hije të keqe, e dëmton Kosovën, por edhe juve ua lë një hije të keqe, se po trafikoni me gjëra kombëtare, të lutem, të lutem... këtu duhet të jemi unikë të gjithë dhe ta "rrahim një tel", po ju këtë po e trafikoni për vota për pushtet dhe kjo është e dhembshme. Po ua them troç, kjo është shumë e dhembshme dhe binduni... unë kam durim do t'ju dëgjoj, ju kam dëgjuar shumë herë çfarë nuk më ky pëlqyer, i kam dëgjuar të gjitha ato. Prandaj, ju lutem, dëgjoni, shënoni e urdhëroni përgjigjuni.

Shumë procese janë tërhequr. Nëse nisemi ashtu, do të nisemi "Pse UÇK-ja u tërhoq?", kush e ndali kolonën e shqiptarëve për të shkuar e rrënuar atë mur? T'ua përkujtoj, e ndali KFOR-i në vitin 2000, jo sot. Kush tha, e ndava Mitrovicën? E tha gjenerali francez! Prandaj, duhet të ulemi bashkërisht ta bëjmë strategjinë dhe t'i themi Bashkësisë Evropiane "boll më me koncesione, se s'mund të ecim më tutje", le ta kuptojë kush të dojë, si të dojë.

Dhe, unë mendoj se sot kjo temë duhet të jetë e jo lufta për të nxjerrë poenë politike, që nesër në vota të kem diçka. Ajo është turpi i çdonjërit që e kërkon dhe nuk do të doja që në këtë situatë të

gjendet edhe një i vetmi, që kërkon diçka të tillë. Krejt diskutimet diskutuan dhe e zbrazën arsenalin e vet të akuzave, shpifjeve e sharjeve dhe shkuan. Ku është ajo Valdetja e “Nismës”, e zbrazi dhe shkoi. Pse s’rri këtu? A mendon ti se je më e ditura dhe çdonjëri duhet të të japë përgjegjësi. Po, ti duhet të dëgjosh, bre zonjë, unë të kam dëgjuar shumë herë. Unë së paku kam qenë më së paku që kam folur në këtë Kuvend, prandaj ki durim, të pëlqej a s’të pëlqejë, ajo është punë e jotja, po ti ke folur krejt çfarë ke folur është si të vishë në pushtet, e jo si të ecën Kosova. As s’e ke ndërmend atë punë. Me këto nuk vihet aty.

Pra, sot ne duhet ta hartojmë një strategji, t’i themi Evropës se nëse vazhdoni kështu, këtë kastë politike e digjni, do t’i digjni edhe kastat tjera. Sot ju vendosim juve, nëse Evropa nuk ndërron qëndrim, do të bëni gabime edhe më trashanike dhe do të digjeni edhe më shpejt. Proceset i shohim atje, kush po e shkakton atë. I kemi bërë koncesione, kërkojmë koncesione, këtu duhet të pozicionohemi. I kemi pranuar komunat, katundet ua kemi bërë komuna me shumicë serbe, i kemi detyruar 40 km, në vend të 2 km të ecin për të shkuar për ta nxjerrë një dokument, që t’ua ruajmë ato. Këto janë të dhembshme, këto janë të rënda, këtë llogari duhet t’i kërkojmë Bashkësisë Ndërkombëtare, sepse ata na kanë shti në këtë proces.

Të lutem! Nëse duhet, ty po të them pra, se ke qenë njëri prej komandantëve, pse e lëshove? UÇK-ja u tërhoq. Më fal, kolegët tu po e vërtetojnë, unë s’kam qenë në veri. Le, dalin shumë çështje.

Pra, unë po insisto, faktorit ndërkombëtar duhet t’i thuhet, popullata po hesht, por popullata po akumulon energji negative, kështu nuk zgjidhen problemet. Me këto kështu si po ecë Serbia, ajo po zbaton memorandumin e tretë dhe ajo nuk do t’i lejohet, nuk e kemi lejuar as të dytin, kemi pranuar krejt të shpërngulemi e të shfarosemi, por nuk e kemi pranuar, nuk pranohet as ky. Kështu e forcojmë delegacionin tonë dhe delegacionit tonë do t’i japim platformë dhe ajo ta mbrojë atë platformë. Kështu ndërtohet shteti e jo të kapim gjithçka që na vjen për dore, se si ta fitojmë një votë dhe të ecim përpara, ne të vijmë. Po ju garantoj, pas dy javësh, nuk shkojnë dy javë le të vijë një kastë, në këto rrethana po të njëjtat veprime ka me i bë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Selimi, se ia ka përmendur emrin!

REXHEP SELIMI: Besoj që m’u drejtove, the “Ti je kon njëri prej tyre dhe pse e lëshove Mitrovicën, ke qenë në UÇK”, a the kështu? A është kjo thirrje pse unë s’kam vazhd... dakord, nëse është kështu, atëherë, a është kjo thirrje pse unë s’e kam vazhduar luftën edhe pas 12 qershorit? Sepse, ju po i referoheni vitit 2000. Në vitin 2000 UÇK-ja nuk ka qenë atje e në vitin 2000 është zbrazur prej shqiptarëve veriu i Mitrovicës.

Nëse më thoni që unë kam pasur mandat të vazhdoj luftën, atëherë unë do tu përgjigjesha. Kështu që, dua të ju them edhe një herë, është krejt e padrejtë t’i thuhet opozitës se po i qet hijen

e zezë pse është ngritur muri në mes të qytetit të Mitrovicës. Edhe një herë dua të ju them, ai nuk është thjesht një mur, ai është një barrikadë e zhvendosur herë në urë, herë përtej urës, herë me një grumbull dhe, herë me një pjesë betoni. Referojeni si barrikadë dhe mos e lulisni, tash gjoja ky qenka njëfarë sheshi dhe qenka njëfarë muri ilegal. Nëse është mur ilegal, atëherë shkoni shkatërrojeni, sepse ju jeni ata të cilët duhet ta garantoni lëvizjen e lirë, sovranitetin e shtetit, zbatueshmërinë e ligjit, e jo tash t'i thuhet opozitës "Pse ti po reagon?". Nëse opozita reagon, ka të drejtë. Nëse opozita u bën përgjegjës juve, ju jeni ata që do të duhej të përgjigjeshit. Prandaj, dua të them edhe një herë, ajo nuk është një mur i thjeshtë, ajo është një barrikadë. E kush me e heq këtë barrikadë, ju që s'keni qenë në gjendje as një vazo me lule ta hiqni prej aty e po e hiqni barrikadën!? Prandaj, pak më avash, lëshoni rend, se ka kush e heq atë barrikadë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë, zoti Sadriu.

ALI SADRIU: Unë nuk thash, që nuk është barrikadë, nuk thash që nuk po mundemi. Fatmirësisht, nuk e thanë as të parët tanë, prej kryetarit, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit e Editës. Të gjithë thanë është mur dhe që duhet me u heq. Prandaj, kjo platformë bie. Nuk keni qenë në gjendje... po, nuk kemi qenë në gjendje, se e dimë të gjithë pse s'ka qenë në gjendje Kosova të luftojë me Serbinë, se ka qenë armata e tretë në Evropë dhe Kosova ka mundur, e din mirë, edhe 100 vjet me luftua, pa ndihmën e miqve ne s'ishim këtu. Në këtë proces kemi hyrë me bindjen ndaj tyre dhe unë jam për atë që mu atyre miqve tu themi "Boll më koncesione në Kosovë." Po, ju s'po i lypni koncesionet për Kosovën por po lypni koncesione për të ardhur në pushtet dhe kjo nuk u bie mirë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti. Replikë? Ta ka përmendur emrin a? Hajde, zoti... jo, jo s'ta ka përmendur emrin, s'është marrë me ty. Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit e qytetarë të Republikës,
Për bindjen time, Kosova i ka dy probleme themelore. Problemi i parë është ndarja e qytetit të Mitrovicës dhe problemi i dytë është papunësia enorme.

Pothuajse, çdo problem tjetër mund të derivojë prej këtyre dyjave. Pra, problemi i parë është ndarja e qytetit të Mitrovicës. Dialogu me Serbinë i deritanishëm, për të ashtuquajturin normalizim të marrëdhënieve e ka abnormalizuar Kosovën. Prej fusnotës në emërtim të shtetit deri te ngjitësi maskues te tabelat e automjeteve. Ndërkaq, për këtë murin nuk mund të thuhet se ndanë Mitrovicën, por ai është aty për ta pamundësuar edhe më shumë bashkimin. Ndarja është bërë më herët.

Në mesin e qershorit të vitit 1999 është bërë ndarja fizike përmes urës, që bashkon brigjet e lumit Ibër. Në librin e tij "Luftëtarët e paqes", kryeadministratori i atëhershëm i Kosovës, Bernard Kushner shkruan, tash po citoj pjesën e librit: "Kolonat franceze të ngarkuara për këtë zonë gjatë

futjes së aleatëve më 12 qershor 1999 duke vendosur fushimin në jug të qytetit, nuk e ndoqën policinë e Beogradit, por u ndalën në urë, duke futur radhazi ndonjë njësit të vëzhgimit më në veri, ku zbuluan pjesëtarë të policisë dhe të vrasësve që bartnin skalpet dhe flokë grash shqiptare, të varura në hallkat e rripit. Me urdhër të kujt ishin ndalur te ura forcat tona çlirimtare?”, pyet Bernard Kushneri. “Kurrë nuk kam mundur ta mësoja saktësisht, por ky është një gabim i madh politik.

Ky ndalim i papritur, jo vetëm bëri nga Mitrovica një qytet të ndarë, por shkaktoi një eksod masiv, një ndjekje reciproke e të përhershme të refugjatëve të nemitur e të privuar nga të gjitha dhe u ofroi serbëve një territor strehimi të papritur në kufi me Serbinë, që ende drejtohej nga Millosheviqi. Shumë shpejt, vullnetarët serbë organizuan në veri të urës një polici të udhëhequr me mjeshtri nga Oliver Ivanoviqi, sportist e mëhershëm profesionist. Ai si njeri i guximshëm politik që ishte, u bë për UNMIK-un një bashkëbisedues i vështirë dhe po aq i sinqertë, sa mund të jetë njeriu në ato rrethana. Ai organizoi një njësit të armatosur të bridgewatchers (rojat e urës), njerëz të armatosur të të gjitha tendencave, që nga njerëzit më të ndyrë e më brutalë deri te patriotët më të devotshëm, të cilët e kishin shtabin e tyre në “Dolçe Vita” përballë urës, ku shënuan territorin e lirë serb e të cilët nëpërmjet komunikimit me radiolidhje mund të mblidheshin me alarmin e parë,” përfundon citati.

Dhe pak më tutje, vazhdon Bernard Kushneri në po atë libër: “...por, komandanti francez i zonës ishte kundër lëvizjeve tona që rrezikonin autonominë serbe në pjesën e epërme të qytetit të Mitrovicës.”

Pra, vet ish-kryeadministratori i UNMIK-ut Bernard Kushner, ankohet në bashkëkombësin e vet francez, gjeneralin francez, që nuk ka lejuar që të shkohet më tutje në veri të Ibrit. Pra, kur disa thonë po i shkruajmë letra Bashkimit Evropian, po i themi këtë gjë ose atë gjë KFOR-it. Vetë Bernard Kushneri tregon që ata nuk janë aspak të pafajshëm në këtë aspekt. Pra, ne e kemi shpallur pavarësinë e shtetit tonë. Çështja është çfarë do të bëjmë ne, se vetë Bernard Kushneri tregon që ka fajësi të KFOR-it francez atje.

Më tutje, para luftës 53% të banesave në veriun e Mitrovicës ishin të shqiptarëve, sipas një raporti të grupit ndërkombëtar të krizave. Kur kësaj i shtohet fakti se familjet shqiptarë kanë dukshëm më shumë anëtarë se sa ato serbe, atëherë bëhet e qartë se shumica dërrmuese e popullatës atje ishin shqiptarë. Pra, edhe pse është ndarë Mitrovica në mes të qershorit '99 edhe më tutje në veri të qytetit shumica kanë qenë shqiptarë. Pra, ti e ke pasur shumicën përkundër ndarjes. Mirëpo, në natën ndërmjet 3 dhe 4 shkurtit të vitit 2000, janë vrarë 11 shqiptarë me dhjetëra të tjerë janë keqtrajtuar, lënduar ose plagosur, ndërsa 1564 familje me 11364 anëtarë janë dëbuar. Të gjitha këto kanë ngjarë pas mbarimit të luftës. Të gjitha këto u pranuan si viktima të luftës, sepse këto ishin më kollaj të pranohen si të tilla.

Ka pasur vajtım në Prishtinë, por ka pasur terror në Mitrovicë dhe dy herë Mitrovica ka pasur ditë hidhërimi, teksa në Prishtinë festohej, edhe në mesin e qershorit '99, por edhe kur u shpall Pavarësia e Kosovës, në mesin e shkurtit 2008, sepse shpallej diçka në Prishtinë e pësonte Mitrovica dhe veriu i Ibrit.

Pra, janë dy faza të njëpasnjëshme, të cilat e kanë tjetërsuar veriun e Ibrit. E para është mesi i qershorit të vitit '99 dhe e dyta është mesi i shkurtit të vitit 2000.

Policia e EULEX-it, porsi dikur ajo e UNMIK-ut, është thjesht mbi ligjin, kurse strukturat e Serbisë janë jashtë ligjit. Këtu qëndron thelbi i situatës kriminale atje. Kemi një fuqi mbi ligjin dhe kemi një fuqi jashtë ligjit. Policia e EULEX-it dhe KFORI nuk japin përgjegjësi për dështimet, kurse kriminelët nuk dënohen për suksesin e tyre, suksesin kriminal natyrisht. Dihet se KFOR-i më së paku çarmatos atje ku më së shumti duhet, në veriun e Kosovës. Në veriun e Kosovës është dhënë amnisti edhe me miratimin e deputetëve të mazhorancës në këtë Kuvend dhe jo vetëm të mazhorancës, fatkeqësisht, por kjo është bërë pa çarmatosje paraprake dhe sërish, është dhënë fond zhvillimor për veriun e Kosovës, përsëri pa çarmatosje paraprake. Nuk është bërë çarmatosje e veriut para se të bëhet amnistia dhe është dhënë fondi për veriun pa pasur kurrfarë çarmatosje. E ju e dini, që avancimi i statusit të Kosovës nga pjesë e okupuar nga Serbia nën administrim ndërkombëtar të UNMIK-ut, ka qenë e lidhur me çarmatosjen e UÇK-së, pra UÇK-së ia kanë marrë armatimin, ka ndodhur demilitarizimi dhe ke pasur një avancim të statusit të Kosovës, ndërkaq në veri të Kosovës kurrë s'ka pasur demilitarizim e çarmatosje.

Por, Mitrovica nuk është vetëm çështje patriotik, nga të qenit dikur qyteti më i pasur i Kosovës, Mitrovica duke qenë e ndarë është shndërruar në qytetin më të varfër dhe ai është i vetmi qytet në Kosovë, të cilit i është zvogëluar popullsia. Qysh para trembëdhjetë vjetëve në një raport të saj Iniciativa Evropiane për Stabilitet pat thënë, që në veri të Mitrovicës dhe në Zveçan jetohet me mesatarisht 95 euro në muaj, 60% të të cilave sigurohen nga Beogradi dhe 23% nga Prishtina, ndërkaq në jug të Mitrovicës njerëzit jetojnë me vetëm 37 euro në muaj nga të cilat 37% sigurohen nga Qeveria e Kosovës dhe 40% nga sektori privat. Merreni me mend, qysh para 13 vjetëve mesatarisht në veri të Ibrit është jetuar me 93 euro në muaj, ndërkaq në jug me 37 euro në muaj.

Sipas anketës së UNDP-së nga viti 2010, në jug të Mitrovicës 47,2% të familjeve të ardhurat i kanë më pak se 211 euro në muaj, gati gjysma i kanë të ardhurat më pak se 211 euro në muaj. 40,5% i kanë nga 212 euro në muaj në 500 euro në muaj dhe vetëm 2,6% kanë mbi 500 euro në muaj.

Pra, Mitrovica është në gjendjen më të rëndë, qyteti më i varfër i Kosovës, përkundër pasurive dhe potencialit të Trepçës, qyteti me urën më të madhe vazhdon të mbetet i ndarë. Mirëpo, këtu natyrisht, se përderisa fajin e ka Serbia dhe natyrisht edhe KFOR-i francez në vitin 1999,

përgjegjësi kanë edhe politikanët shqiptarë, përkatësisht ata që ishin më të thirrur që të bëjnë për Mitrovicën.

Ne të gjithë e dimë se Mitrovicës në këto vitet e pasluftës i janë hedhur sipër edhe Serbia edhe SHIK-u. SHIK-u askund s'ka qenë më i fuqishëm, se sa në Mitrovicë. Të dyja këto ishin e vazhdojnë të jenë të fuqishme në Mitrovicë, në ndërkohë që s'bëjnë luftë me njëra tjetrën, besoj e keni vërejtur këtë gjë. Flasin këtu në Kuvend, eksponentë të ndryshëm, për meritat e tyre për çlirim të Kosovës, por nuk flasin edhe për përgjegjësinë që e kanë për ndarjen e Mitrovicës. Është shumë me rëndësi eksponentë të caktuar të UÇK-së se ku kanë qenë në qershorin e vitit 1999, ne po e dimë çfarë kanë bërë francezët, ne po e dimë se çfarë ka bërë Serbia, por këtu ka edhe pyetje pa përgjigje. Sepse, qershori i vitit '99 dhe shkurti i vitit 2000 janë vendimtarë.

Pra, në njërën anë kemi politikanë që duan t'i marrin meritat, mirëpo në anën tjetër s'duan të flasin për përgjegjësi. Fatkeqësisht, kjo historia e popullit tonë përfundon e privatizuar në biografi personale, mirëpo le t'i pasurojnë këto biografi personale edhe me përgjegjësi që s'po na jepen në pyetjet të cilat janë legjitime.

Unë këtu dëgjova teksa thuhet, se muri është shëmti. Shikoni, nuk mund të ndërtojmë politika serioze me kategori estetike, "shëmtia" e "bukuria". Nuk është çështje "shëmtie" e "bukurie", kjo është çështje e të drejtave, është çështje morale, çështje etike, çështje politike, shtetërore e kombëtare, vetëm ashtu do të zgjidhet drejt.

U pa një garë e Thaçit, Veselit dhe Mustafës, se cili do ta rrënojë murin e si, a me eskadronë, ekskavatorë apo ku di unë se si. Pra, kjo garë me cilën ministri do të bëhet, vetëm sa e mobilizon Serbinë, e paralajmëron atë dhe i demobilizon shqiptarët. U thuhet shqiptarëve, s'keni nevojë të brengoseni se Qeveria e kryen këtë punë. Mirëpo, a e keni vërejtur, nuk tregojnë kur, s'ka afate kjo gjë. Po, këta edhe po të tregojnë kur, janë të rrezikshëm, sepse e lënë punën në gjysmë, si më 25 korrik të vitit 2011. Pra, me "Zajednicën" është shkelur Kushtetuta e kryeministri nuk foli asnjë fjalë për këtë, por shtratin e këtij muri më të ri e ka ndërtuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe dy minuta po t'i jap unë, pasi po do...

ALBIN KURTI: Por, shtratin për këtë mur e ka shtruar më 25 gusht të vitit 2015 ky kryeministër, i cili ka pranuar që rruga, siç quhet atje "Mbreti Petër", të jetë zonë e këmbësorëve. Pse të jetë zonë e këmbësorëve? Cili është kuptimi që kur ta kalosh urën, mandej duhet të shkosh ose majtas, ose djathtas, ose të parkohesh e të ecësh më këmbë. Ky është gabim trashanik. E kur thua, që ajo është zonë e këmbësorëve, natyrisht që bëhet një shesh ku pushojnë këmbësorët. Ka

qenë gabim fatal, pika 3 e marrëveshjes për Urën e Ibrit, thotë që “Mbreti Petër” bëhet zonë e këmbësorëve.

Ky është shtrati, ky është bazamenti i murit të cilin ne po e shohim atje dhe në vend se të na bëjnë neve premtime, le ta bëjnë ekzekutimin e premtimeve mbase edhe pa na i dhënë ato, sepse këta janë ekzekutivë, nuk janë këtu për të premtuar që të dëgjojnë strukturat e Serbisë e të demobilizohen shqiptarët, por të kryejnë punë në përputhje me Kushtetutën e ligjin, përkatësisht interesat e të drejtat e popullsisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Time Kadrijaj i ka 7 minuta.

TIME KADRIJAJ: I ka marrë të grupit të vet. Faleminderit, nënkryetar!

Shkoi kryeministri, se desha t’i them, që sot e kish krijuar një komision për me e mat territorin e Kosovës, desha ta pyes a ke me nis pikërisht prej murit që u ndërtua në urën e Ibrit, e ta matësh territorin e Kosovës?

Shqiptarët në veri të Mitrovicës janë refugjatë që 17 vjet në vendin e vet, pa asnjë perspektivë për jetë, pa të drejtat më elementare dhe nuk guxojnë të kthehen në shtëpinë e tyre. Kjo është turp. 17 vjet pas rënies së murit të Berlinit në Gjermani, një tjetër mur u ngritët në zemër të Evropës duke ndarë përmes një qytet të Republikës së Kosovës.

Ura e Ibrit nuk është më simbol i ndarjes së Mitrovicës, pengesa është zhvendosur pak metra tutje, ku është ndërtuar një mur i lartë 2,5 metra, ky mur prej betoni tani është zhvendosur në mes të rrugës, që çon për në Zveçan.

E vërteta është se ndërtimi i murit është bërë nga drejtuesit e Mitrovicës veriore e në kundërshtim të plotë me ligjet e Kosovës dhe me planin për revitalizimin e urës si deklaroheq Qeveria jonë, që palët janë dakorduar në Bruksel. Nëse është kështu, Qeveria e Kosovës është dashur dhe duhet urgjentisht të veprojë me forcën e ligjit. I kemi dëgjuar deklaratimet e ministres për Dialog, mirëpo kryetari i Mitrovicës veriore, Goran Rakiqi, ka thënë se muri nuk do të largohet dhe se për ndërtimin e tij janë në dijeni edhe BE-ja edhe Prishtina zyrtare.

Andaj, ne si deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, si përfaqësues të drejtpërdrejtë të qytetarëve të shtetit tonë, me të drejtë shprehim shqetësimin tonë dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës, për ndërtimin e murit të Mitrovicës, si një mur i ndarjes, urrejtjes dhe simbol i nxitjes së konfliktit dhe themelimit të urrejtjes ndëretnike, një gjë e tillë është e papranueshme.

Ne si deputetë dhe ju si qeveri duhet pasur parasysh, që Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës në vend dhe qeveria si ekzekutiv duhet të veprojë urgjentisht në parandalimin e devijimit të projektit të dakorduar në Mitrovicë. Ura e Mitrovicës duhet të shërbejë për të

bashkuar qytetarët që jetojnë në të dy anët e saj. Çfarëdo ndarje, përfshirë edhe ndërtimin mureve ndarëse, është i papranueshëm. Organet shtetërore të jenë më përgjegjëse për funksionimin shtetëror. Menjëherë dhe pa hezituat duhet të veprojnë të gjithë bashkë, edhe ministrja për dialog, edhe ministri i Punëve të Brendshme, edhe ministri i Punëve të Jashtme, edhe kryeministri, edhe presidenti i vendit, sepse nuk duhet të rrinë duarkryq karshi këtij problemi.

Kryeministri deklaroi se është votuar për dialog. Askush nuk i ka thënë kryeministrit që të degradohet dialogu dhe tash çfarë kuptimi ka që të vazhdojë dialogu. Njësoj si deri tash, nëse vendimet nuk implementohen, kur marrëveshjet nuk normalizohen, kur lëvizja e lirë e qytetarëve pengohet e kur kushtet e jetës aspak nuk përmirësohen e mos të flasim për qytetarët shqiptarë të pjesës së veriut, që edhe ashtu të paktë, jetojnë në kushte të vështira e në një liri minimale. Ata edhe sot jetojnë në frikë e pasiguri. E pse po ndodhë kështu? Sepse, në atë pjesë të Kosovës nuk zbatohen ligjet e Republikës së Kosovës. Thjesht, atje nuk ka rend dhe ligj. Andaj, është mirë që dialogu të ndalet, meqenëse nuk po implementohen të gjitha marrëveshjet dhe është e turpshme se si qytetarët dhe zyrtarët e Republikës së Serbisë vijnë dhe sillen në Kosovë në mënyrë ilegale e shteti nuk vepron, ndërsa kryeministri i Kosovës shkon dhe ndalohet të shkojë në pjesën veriore të vendit.

A ka kërkuar deri tash dialogu duhet të kushtëzohet, duhet të kushtëzohet me të pagjeturit, duhet të kërkojë falje për të gjitha krimet që ka kryer në Kosovë, ndërsa deri sot ata këtë nuk e kanë bërë.

Qytetarët e Kosovës, si ata në jug edhe ata në veri, duhet të kenë parasysh se nëse nuk respektohet ligji nuk do të kenë të ardhme evropiane. Ne kemi bërë koncesione të panumërta për komunitetin serb, konkretisht, por prapë s'po shihet se këto barrkada fillin e kanë në Beograd e jo në veri. Mitrovica ka nevojë për ura dhe jo për mure. Andaj, Qeveria duhet të veprojë urgjentisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Sot po debatojmë për një temë që me dhjetëra, ndoshta edhe me qindra herë është debatuar në këtë Kuvend, në forma të ndryshme.

Natyrisht, se shqetësimet janë shumë legjitime, por veprimet e mangëta në këtë drejtim neve na bëjnë që për të satën herë me diskutua për të njëjtën temë dhe mos me pas kurrfarë rezultati nga debati.

Unë fillimisht dua t'i them zotit Ali Sadria që i referohet kryetarit të grupit, se Valdëta është gjeneratë e re dhe nuk vuan nga ajo që e keni ju lepurin në bark, siç thotë populli, dhe ende e

cilësoni Serbinë si armatë e tretë në Evropë, sepse duke e pasur këtë logjikë, domethënë e keni lënë Kosovën ku e keni lënë edhe ende keni drujtje me u marrë me Serbinë.

Përndryshe, do t'i rikthehem temës në vazhdimin e shqetësimeve që kam paraqitur vazhdimisht në këtë Kuvend, problemi mendoj se është më shumë se Beogradi, por që po hezitohet të thuhet. Deri para një kohe kam menduar se padituria janë duke i bërë Qeveria këto veprime, mirëpo me kalimin e kohës po bindem, se nuk është në pyetje mosdija por është në pyetje se këta janë futur në vallen që dikush e ka konstruktuar copëtimin e Kosovës dhe të gjitha veprimet dhe mosveprimet i bëjnë me qëllim për të realizuar projektin djallëzor për atë pjesë të vendit.

Bisedimet, ju e dini, që kanë filluar si bisedime teknike, por intervenimi i policisë që është bërë, që koha po tregon se është bërë me qëllim, është bërë për të legalizuar bisedimet politike, bisedime të cilat Serbinë e kanë bërë palë në zgjidhjen e problemeve të brendshme të Kosovës, ose thënë ndryshe, e kanë rikthyer në Kosovë.

Legalizimi i copëtimin të vendit, që po bëhet nga kjo qeveri është shqetësuese dhe me pasoja të mëdha, jo veç për Kosovën dhe për Rajonin. Arsyetimi i kryeministrit se kjo çështje dhe kjo problematikë fillon me qeveritë e kaluara, duke u thirrur në rezoluta dhe ligje, me të vërtetë është më shumë se qesharake. Edhe unë me atë zhargonin tim po i them kryeministrit, në rast se Hashimi është futur llugave, detyrimisht edhe ti duhet të futesh llugave, a po?

Në anën tjetër, ju para se të bëheni kryeministër, keni pas premtuar qasje ndryshe në raport me bisedimet me Serbinë, por koha po dëshmon se jeni vazhdimësi e të zezave të mëdha, që këtij vendi i ka bërë Hashim Thaçi dhe ju po i kurorëzoni tash me veprime konkrete.

Muri është pjellë e bisedimeve me Serbinë dhe nuk është veç muri. Ne e dimë dhe i gjithë opinioni, se atje është duke u ndërtuar një koloni, që quhet "Lugina e Diellit", atje e dini se janë blerë të gjitha pronat e shqiptarëve nga buxheti i veçantë i Serbisë, që janë elemente të mjaftueshme, se Serbia është me projekt të caktuar duke spastruar atë pjesë, për të ardhur në momentet shqetësuese, që me gjasë nuk do të jenë larg.

Amnistia e kriminelëve që kanë shpërngulur me dhunë mbi 12 mijë shqiptarë, kanë vrarë dhe djegur shumë shtëpi në atë pjesë të vendit, ka qenë gabimi i radhës, tashmë po duket, i qëllimshëm, të cilët janë inkorporuar gjoja në institucione të Kosovës, por që janë të dirigjuar prej Serbisë dhe Beogradit dhe për këtë dëshmon vetë momenti, kur as edhe kryeministri dhe ministrat e kësaj Qeverie, në rast se s'u jep leje Beogradi nuk mund as të lëvizin. Dhe, arsyetimet banale të kryeministrit, se "megjithatë unë kam arritur ku e kam pasur destinacionin", ju keni qenë duke i thyer këmbët duke ikur nëpër mal, që është fatkeqësi, sepse një grumbull kriminelësh që ju i paguani, ju dalin me të njëjtin kamion, që i kanë dalë edhe ministrit Hoti.

Në një debat në Komisionin për Politikë të Jashtme, ministri Enver Hoxha në një moment, a i ka rrëshqitur goja apo ka thënë të vërtetën, për të cilën unë kam kërkuar për afër dua muaj përgjigje nga ministri i punëve të brendshme, i cili me qëllim nuk ka ardhur për tu përgjigjur. Një nga deklaratat e tij ka qenë se në atë pjesë të vendit veprojnë tri deri në katër organizata joqeveritare, që financohen nga Rusia. Pra, këtu është krejt problemi, që thash në fillim, se çështja është pak më larg se Beogradi.

Pjesëtarët e këtyre organizatave që mbështeten nga Rusia u zunë, sipas mediave, edhe në puçin në Mal të Zi, në grusht shtetin e përgatitur dhe ditët e fundit në media ka qenë se 518 persona të këtyre organizatave financohen nga Rusia.

Tash shtrohet pyetja se cili është interesi i Rusisë në atë pjesë? Unë do të rikthehem diku në shkurt apo janar të këtij viti kur kemi debatuar dhe kur kam ngritur këto shqetësime, kam thënë se në atë pjesë po përgatitet një Krime e Ukrainës, sepse logjika politike e Karpateve të Rusisë është evidente në rajon dhe tash nuk është ndonjë zbulim se gjithnjë e më shumë është prezentë, e fuqishme dhe e ka nxjerrë kokën edhe në Kosovë.

Kjo çështje, me një fjalë, duhet trajtuar pak më thelbësisht dhe jo me deklaratat e kotit, deri edhe deklaratat ofenduese, duke krahasuar me gjela zërat e arsyeshëm kundër murit, sepse gjelat, zoti Mustafa, duhet t'i mbani në kotecin personal tëndin, por në këtë rast ju pyes çka u bë me pulat tuaja, të cilat kokorisinin nga Brukseli se me fuqinë e ligjit do ta heqim atë mur, brenda javës, e tash jemi në javën e tretë.

Këtu u dëgjua edhe “muhalife” dhe pallavra se muri rrezikon sukseset e dialogut. Është krejt e kundërta. Dialogu ka prodhuar mure dhe copëtimin e Kosovës.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, të opozitës e mazhorancës, është moment i duhur, ndoshta edhe moment i fundit, që ne të kemi qëndrime të qarta rreth bisedimeve, të kërkojmë që bisedimet të ndërpriten dhe të gjithë ata të cilët i kanë bërë dëm sovranitetin dhe funksionalitetin të vendit, duke shkelur ligjet dhe Kushtetutën e vendit, herët a vonë, të paralajmërohen se do të japin përgjegjësi për këtë dëm të jashtëzakonshëm që po i bëjnë Kosovës dhe perspektivës evropiane, jo më tash vetëm të Kosovës, por edhe të rajonit.

Duke qenë pjesë e lojërave të ndyra që bëhen nga politika deri edhe në Azi, unë mendoj se politikanët tanë jo vetëm duhet të ndëshkohen nga qytetarët, por edhe nga ky Kuvend dhe sigurisht të mos e harrojmë një thënie popullore: “Në rast se pitja është hëngër, tepsia ka mbetur”, dhe nga të gjitha ato marrëveshje jotransparente që fshihen pas tyre, në një moment do të dalin në shesh dhe do të jepni llogari. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka ministrja për Dialog, Edita Tahiri.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues,
Kryeministër,
Kryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Sot në këtë debat po bisedojmë për një problem shumë serioz, i cili natyrisht se ka prekur interesat kombëtare të shtetit tonë, për një mur ilegal që është shfaqur para disa ditësh, sigurisht me dirigjimet e Serbisë dhe grupet ilegale. Por, ajo që mua më takon t'ju informoj dhe e di se u kërkua edhe transparencë më e madhe, prandaj po ju them atë që e tha edhe kryeministri se Marrëveshja e Brukselit për revitalizimin e urës nuk ka paraparë mure, as nuk ka pasur bisedime për mure, as marrëveshje për mure, asnjëherë.

Ndoshta pyetjet janë me vend, por mua më është dukur absurde pyetja: A thua, mos është bërë ndonjë bisedë apo marrëveshje për mure në Bruksel?

E para. Ne shqiptarët 100 vjet luftuam ta rrëzojmë murin tonë. Ne nuk i durojmë muret. Tjetër se jemi shtet demokratik dhe kemi themele demokratike që u sigurojnë liri njerëzve dhe lëvizje të lirë. Pra, kemi vënë themele të shtetit demokratik, por ne shqiptarët nuk i durojmë muret.

Unë po ju them personalisht. E kam pasur nënën nga Shqipëria. Është martuar në Kosovë, më 1944. 45 vjet ka jetuar në Prizren dhe nuk e ka parë familjen, edhe ka vdekur pa e parë. E, pra, po ju them si formim prej fëmijërisë deri sot, muret ne i kemi ndier në shpirt e në mendje, na u kanë kthyer në traumë.

Prandaj, të bisedohet për mure në Bruksel apo të pyetet, a thua, mos ka marrëveshje, po ju them, është e pakuptimtë.

Ju e dëgjuat edhe kryeministrin, kryetarin e Kuvendit, presidenti ka qenë i qartë. Muri do të hiqet. Është kundër ligjit, është kundër marrëveshjes, por është edhe kundër interesave kombëtare të shtetit të Kosovës, pse ne kemi hyrë në dialog? Pikërisht për ta vënë kufirin në veri dhe e vëmë.

Ju e dini se para dialogut të Brukselit kufiri verior ka qenë krejt i hapur, ne nuk e kemi kontrolluar pas 2008-ës se u dogjën pikëkalimet kufitare dhe pastaj arritëm të vendosim autoritetet shtetërore.

Pra, pse e kemi vënë kufirin? Sepse, nëpërmjet vënies së kufirit integrohet pjesa veriore e vendit.

Por, para se të flas më shumë për dialogun dhe rezultatet, desha të bëj një konstatim që sonte e vërejtja dhe më erdhi mirë.

Shikoni, ndoshta e vërejtët, të gjithë jemi të bashkuar kundër murit. Pra, nuk është vetëm ligji i Kosovës që është kundër murit, por edhe vullneti politik i gjithë spektrit politik të Kuvendit, të institucioneve, Presidencës, Qeverisë, të qytetarëve. Prandaj, edhe ky mur hiqet, sepse vullneti politik përcakton me çfarë mase e zbaton ligjin.

Ju e dini se kur ka intervenuar NATO-ja në Kosovë dhe e ka bombarduar Serbinë, nuk ka pasur ligj, sepse Këshilli i Sigurimit nuk ia dha autorizimin, por ishte vullneti politik i SHBA-së e i aleatëve perëndimorë dhe u bë bombardimi. Prandaj, unë sonte dëshiroj të konstatoj se vullneti politik që po shprehet për këtë rast, e unë uroj të kemi këtë unitet edhe në sfida të tjera që kanë të bëjnë me interesa strategjike të vendit.

Jam e bindur se ky mur, jo vetëm që do të hiqet, por edhe mos harroni se që nga momenti kur ka filluar ky dialog ka pasur mbi 20 barrikada, dhe ne ishim vetë dëshmitarë që u hoq një barrikadë te ura, u vë një park barrikadë. Të gjitha janë hequr. Pse? Sepse kishte qëndrueshmëri të shtetit të Kosovës në procesin dhe vizionin që të zhbëhen strukturat paralele, por janë zhbërë vetëm në fushat ku kemi marrëveshje, jo në të gjitha, dhe unë vazhdimisht e them, në të gjitha fushat ku kemi bërë marrëveshje janë zhbërë strukturat paralele.

Së pari kemi zhbërë MUP-in, përkatësisht policinë paralele të Serbisë në Kosovë dhe sot kemi Policinë e Kosovës në veri.

Shikoni, unë di shumë mohime për këtë çështje, por po më duket se shikimi për veriun po bëhet ose me televizion ose me debat.

A ka mundësi që Parlamenti të krijojë grupe pune që këtë që po e them unë, se nuk ka më polici paralele në veri, le ta vërtetojnë, dhe mandej me fakte, edhe për mua edhe për Qeverinë do të ishte ndryshe biseda. Mirëpo, vetëm me televizione e lajme nuk vërtetohet kjo çështje.

(Ndërhyrje)

Zaf, të kam pasur nxënës, rri tash i qetë. Zaf, rri pak qetë dhe më dëgjo. Të lutem, më dëgjo!

Po ju them, urdhëroni, si i kemi rekrutuar këta policë, kanë kaluar verifikimet e sigurisë, dokumentet i kam në zyrë dhe urdhëroni shohim cilat janë verifikimet. Agjencia Kombëtare e Inteligjencës së shtetit tonë e ka bërë verifikimin, e EULEX-i, e pastaj ka ndodhur integrimi i tyre.

Kush nuk beson, zyra ime është e hapur, me gjithë dokumentet. E njëjta është me shuarjen e Mbrojtjes Civile. Ju lutem, urdhëroni, bëni monitorimin në veri se a ka më individ që mban

uniformën e kësaj strukture? Me fakte! Të njëjtit janë integruar me verifikime të sigurisë, me institucionet që i përmenda dhe Policinë e Kosovës.

Tjetër çfarë shuarje kemi bërë? Doganat paralele: janë shuar zyrat që japin dokumente paralele. Por, ajo që është më kryesorja, askush s'ë ka besuar se në Jarinjë dhe Bërnjak pas pavarësisë, kur u dogjën pikat, do të jenë autoritetet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Unë ndoshta po flas sikur me më përgjegjësi. Nuk e kam veç pse jam në dialog. E kam sepse pas luftës, prej shqetësimit të strukturave paralele në veri, e që ne mbetëm vetëm duke i diskutuar në Parlament ato vite, kam bërë studime dhe doktoraturë për këtë problem.

Pse? Desha t'ia lë, sepse nuk e dija a do të mbetem në politikë, gjeneratës tjetër politike të merret me këtë punë.

Po jua them, nuk duhet të fajësohemi mes vete pse u krijuan strukturat paralele, sepse ato na i krijoi UNMIK-u. Ju e dini shumë mirë, dikush e përmendi Francën, KFOR-in e librin e Kushnerit. Përtej francezëve është UNMIK-u që lejoi hyrjen e Serbisë me struktura paralele në veri. Ky është fakt i ditur, dhe pastaj UNMIK-u e mohonte, ndërsa në vitin 2003 doli OSBE-ja me raportin e parë zyrtar se në Kosovë ka struktura paralele serbe.

Prandaj dialogu i Brukselit po kontribuon për shtrirjen e sovranitetit dhe shuarjen e strukturave paralele, por, po e përsëris, vetëm aty ku marrëveshje, ka shuarje, ende ka struktura të mbetura. Dhe, ju e dini se ne e kemi kushtëzuar: nuk do të ketë asociacion pa rënë në zero strukturat paralele të mbetura në veri. Dhe, sa për asociacionin, po u them nuk ka dalë nga ky dialog. Asociacioni ka dalë nga Plani i Ahtisarit.

Po a duhet të kritikohet? Ju e dini se Plani i Ahtisarit e solli pavarësinë e Kosovës.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ia mundësoni, edhe 2 minutë!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Shpejt do ta përfundoj dhe, më vonë, ndoshta ma jepni edhe një herë fjalën.

Pra, ju lutem! Plani i Ahtisarit e solli pavarësinë, por na i solli edhe këto probleme, si decentralizim më i rëndë, asociacione, e të tjera. Por, nëse peshohet strategjikisht, Plani i Ahtisarit hapi rrugë që ne të deklarojmë pavarësinë, që sot të jemi në rrugën zyrtare të integritimit evropian, që sot ne të vendosim lidhjet me NATO-n, të marrim kodin telefonik ndërkombëtar, që ende ndokush dyshon se a e morëm prej ITU-s.

Ju lutem, hyni në ueb-faqen zyrtare të ITU-s, e gjeni vendimin dhe aty Kosova është e rreshtuar në listën e shteteve që e kanë marrë kodin.

Nuk po e zgjas, sepse do të më ndërpritet fjala nga kryesuesi, por po ju them se me 10 janar vendosim kontrollin në drejtësi, janë shuar strukturat paralele të drejtësisë, nuk ka gjykatë dhe prokurori serbe që punon më në veri. Po ashtu, po ju them se asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive, as nuk do të ketë ndonjë funksion të nivelit të tretë të qeverisjes, por çfarë është më e rëndësishme, statuti i asociacionit do të respektojë plotësisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Dhe, në fund, çfarë dëshiroj të them? Ne jemi duke hyrë në fazën e fundit të dialogut. Faza e fundit ka të bëjë me njohjen reciproke, ka të bëjë me respektimin e sovranitetit të njëra-tjetrës në mes dy shteteve sovraane dhe të pavarura, Kosovës dhe Serbisë, dhe vendosjen e demarkacionit mes dy shteteve.

Le ta shfrytëzojmë këtë konsensus sonte, këtë pajtim që e arritëm sonte për të qenë bashkë në fazën e tretë të dialogut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Xhevahire Izmaku!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe qytetarë,

Fillimisht unë e falënderoj ministren, paraprkisht për fjalën dhe informacionet dhe shpresoj se pas këtyre informatave edhe opozita do të jetë më e qetë dhe do të besojë më shumë në deklaratat publike se sa në hipoteza se si ka mundur të jetë një vendim, i cili është i fshehur nga Qeveria për çështjen e urës.

Ne sot po marrim pjesë në debat, që e mendoj të qëlluar dhe orientues, mbi ngjarjen e pakëndshme, për ne deputetët sigurisht dhe befasues, dhe jo vetëm për ne, por edhe për të gjitha institucionet në vend.

Asnjëri nga ne nuk ka qenë i përgatitur për një projekt të tillë në periudhën kur filluan rezultatet e para nga këto bisedime maratonike dhe sigurisht të duhura për shtetin tonë.

Në këtë huti mbi zhvillimet e fundit në veri u gjendën edhe institucionet ndërkombëtare, duke pritur ne një kohë të gjatë për të marrë një deklaratë të qartë dhe shpeshherë atë e morëm të pakoordinuar në mes të zyrave përkatëse.

BE-ja, si garantuese dhe koordinuese e procesit të dialogimit, nuk ishte në njohuri për këtë plan bllokues nga politikat e Serbisë në atë pjesë.

Nga ky debat kërkesa jonë duhet të dalë e qartë: muri duhet të hiqet dhe Qeveria sigurisht se ka obligim për ta hequr, ashtu siç ka vepruar edhe me barrikadat.

Serbia do të vazhdojë sigurisht edhe me provokime të reja, andaj institucionet tona duhet të veprojnë me vendosmëri.

Serbia u dëshmuar se nuk është një fqinj i mirë, është shtet që ka bërë gjenocid në vazhdimësi ndaj të gjithë tjerëve që e rrethojnë, prandaj s'ka logjikë që të shpresohet se kjo ndryshon politikë, por konsideroj se dialogu duhet të orientohet në temën e njohjes reciproke në mes të dy shteteve, sepse vetëm kështu ka shpresë për normalizim të marrëdhënieve ndërshtetërore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ne sot nga ky debat mendoj se duhet të dalim më të bashkuar politikisht, duke përkrahur Qeverinë dhe krejt institucionet shtetërore drejt veprimeve politike për largimin e këtij muri famëkeq, për zhbërjen e të cilit kërkojmë edhe nga bashkësia ndërkombëtare bashkëveprim dhe përkrahje.

Nëse ata që e ndërtuan nuk binden ta largojnë, këtë duhet ta bëjmë ne, sigurisht duke evituar tensione dhe me maturi të madhe politike. Këtë sapo e tha edhe kryetari i Kuvendit.

Veriu i vendit, me këto politika po vazhdon pafundësisht të prodhojë jostabilitet dhe ndërkombëtarisht ta paraqesë Kosovën si vend të pasigurt. Temat e vazhdueshme mbi jostabilitetin e veriut po ndikojnë edhe në investime të huaja direkte. Veriu i Kosovës, dhe rrjedhimisht Kosova, në saje të kësaj pjese, mbetet vend shumë i pasigurt edhe pas 17 vjetëve të përfundimit të luftës.

Institucionet tona duhet fuqishëm t'u përgjigjen kërcënimeve dhe planeve për ndarje. Ky është një obligim që buron nga detyrimet tona shtetërore. Një plan për integrimin e veriut konsiderojmë se është urgjent dhe ndryshe, ne rrezikojmë të krijojmë një oazë të krimin të organizuar dhe destabilizimin e gjithë vendit nga kjo pjesë.

Arrestimi i policëve dhe raportet e vazhdueshme për krim e kontrabandë në atë zonë duhet të na vënë në alarm të gjithëve. Pra, është kohë e fundit që veriu i vendit të fillojë integrimin dhe normalitetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Tërmkolli! Nuk është këtu, atëherë, e ka fjalën Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Kjo pikë e rendit të ditës natyrisht se e ka relevancën e vet dhe nuk mund ta përjashtojmë të vërtetën se i ka emocionet e veta, sepse këto ditë ndërtimi i këtij muri te çdo qytetar të këtij vendi ka ngritur emocione.

Unë falënderoj Grupin Parlamentar të AAK-së që ka marrë iniciativën për të bërë debat për këtë pikë të rendit të ditës, pra për murin në Mitrovicën e veriut, por konsideroj se ne kur diskutojmë këso tema, natyrisht se duhet të kemi kujdes. Pra, të japim mesazhin dhe të dimë se për çka po bëjmë një debat të tillë.

Në qoftë se ne sonte këtu kur të mbyllet ky debat, konsideroj se është dashur t'u japim qytetarëve një mesazh, se kur bëhet fjalë për temë të tillë, siç është muri, ne të gjithë jemi bashkë.

Këtë duhet ta dëgjojnë qytetarët e vendit, duhet ta dëgjojë Serbia dhe bashkësia evropiane, se Kosova nuk lejon brenda asnjë qyteti të territorit të Republikës ngritje të mureve.

Kjo, në një formë, po thuhet, por po mbetet anash dhe ne më shumë po orientohemi kush kujt t'ia drejtojë gishtin, që është këtu më patriot, më tradhtar, më kështu e më ashtu, që këto gjëra janë të papranueshme dhe shumë të dëmshme.

Në qoftë se ne mendojmë që Kosovën e ndihmojmë duke gjykuar kështu njëri-tjetrin si sonte nga fjalët që po i dëgjoj, fatkeqësisht, jo vetëm nga opozita, por edhe nga zoti Veseli që i numëroi ankesat me të drejtë se çfarë ndodh në veriun e vendit për vite të tëra dhe tha: "Duhet pasur guxim".

Unë s'e di kush ju ka ndalur të mos veproni deri tash, as juve, as për momentin kush është në opozitë, sepse ne këtu nuk jemi veç sot, por Kosova i ka 16-17 vjet pas lufte dhe që të gjithë, të gjitha partitë politike kanë pasur momentin kur është dashur të jenë përgjegjës.

Bile, zoti kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së, që e morët një shembull dhe krahasim dhe thatë se ne e mbajmë fjalën, në atë mënyrën e bërjes fushatë politike për këtë çështje. Thatë ne e mbajmë fjalën duke bërë krahasimin me Pejën, qysh ju e keni shpëtuar Pejën nga kjo ndarje, e Mitrovica nuk është shpëtuar.

Unë, i nderuar koleg, kisha thënë se paskeni gabuar shumë, në qoftë se është ajo e vërtetë që e paskeni lënë, pra paskeni mundur ta shpëtoni Mitrovicën e s'paskeni shkuar ta shpëtoni, kurse Pejën e paskeni shpëtuar. Nuk është ashtu, koleg i nderuar!

Shumë nga kolegët e mi, edhe për herë të parë me zotin Kurti u pajtova shumë, qysh e elaboroi çështjen atje. Pra, nuk është këtu çështje individi: kush e bëri, kush s'e bëri, sepse Kosova është një projekt yni dhe i ndërkombëtarëve që për shumë gjëra është dashur të bëhen kompromis, herë me qejf e herë pa qejf, por ne jemi këtu ku jemi.

Dhe, unë nuk jam për t'i ikur përgjegjesisë askush, cilido subjekt politik kur ka qenë në pushtet, por që sonte të dalim nga ky takim pa keqkuptim, duke drejtuar gishtin që të gjithë se Isa Mustafa qenka ai pse e paska lejuar të bëhet muri, e kjo është e padrejtë.

Muri është i papranueshëm dhe përveç se është shkelje ligjore, është vërtet edhe fyerje dhe provokim për ne. Këtë duhet thënë njëzëri, ta dëgjojë Serbia dhe ta dëgjojë bashkësia evropiane që është faktor me ne në negociata dhe bashkëpunim nëpërmjet BE-së.

Duhet të themi se ne assesi nuk pajtohemi të ketë mure të tilla, çfarë është bërë në veri të Mitrovicës.

Njëkohësisht kërkoj që Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë përgjegjësinë dhe të rrënojë murin duke u bazuar në ligje. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse çdo qytetar ka emocione për atë mur, që është i papranueshëm, po ritheksoj dhe ne nuk kemi nevojë t'i lëmë hapësirë askujt që të keqpërdorë edhe këtë vepër shoviniste të Serbisë, por ne duhet t'i kryejmë detyrat tona, Qeveri e nderuar dhe ne duhet ta rrëzojmë atë muri. Muri nuk mund të ekzistojë aty.

Konsideroj se nuk na shkon për shtati dhe nuk kemi nevojë t'ia drejtojmë gishtin njëri-tjetrit ose të bëjmë pyetjen pse Serbia nuk pajtohet që Kosova të jetë e pavarur, dhe të mos ketë më probleme? Këtë e dimë të gjithë. Serbia ka ambicie, dhe nuk i ka hequr ato, të ndërhyjë në Kosovë, ta pengojë Kosovën.

Prandaj, ne duhet të jemi të bindur secili me vetveten dhe të bashkëpunojmë korrekt kur diskutohet për këto gjëra dhe t'ia bëjmë me dije Serbisë se Kosova njëherë e përgjithmonë është shtet i pavarur dhe njëkohësisht t'i thërrasim institucionet ndërkombëtare dhe t'u themi se gjithçka e ka durimin, gjithçka e ka kufirin e vet dhe ne kemi qenë e kemi bërë kompromise, por edhe ne i kemi kufijtë ose vijat e kuqe.

Prandaj, unë uroj dhe besoj që sonte të dalim të gjithë të unifikuar, njëzëri se nuk do të ketë mur në asnjë komunë të Republikës së Kosovës dhe ky mur do të shembet sa më shpejt.

Zoti kryeministër, vërtet kërkojmë që shumë shpejt këto procedura të zbatohen dhe ai mur të largohet nga aty. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka kërkuar kryetari i Kuvendit, zoti Veseli.

KADRI VESELI: Më fal, edhe mua ma ka përmendur emrin, për atë edhe paraqitem.

Thashë, na keni ndihmuar shumë, zonja Gaxherri, duke na e bërë me gisht non-stop. Do të ishim të unifikuar, por po na e bën shumë me gisht!

Pal, po ta jap fjalën, por mos e ço as ti më gjatë se unë.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zonja Gaxherri!

BESA GAXHERRI: Zoti Veseli! Sinqerisht sonte e kam pasur ndërmend të kritikoj kur deshët ta filloni seancën, sepse ashtu ishte nevoja, por tash ma dhe mundësinë dhe më detyrove të them!

Guximi, që e the, kërkohet. Po, prej nesh kërkohet guxim, prej të gjithëve, përkushtim, vullnet dhe jo vetëm fjalë.

Shembulli konkret, zoti kryetar, jeni ju, që asnjë seancë nuk e mbajtëm si duhet dhe oraret nuk respektohen. Ne jemi qe 48 orë ditë e natë në seancë, e ne i kemi pasur oraret e rregullta, t'i mbajmë seancat e rregullta, të mos tubohen pikat e rendit të ditës sikur që po na i tubon dhe pastaj këtu po lodhemi e përplasemi, kështu që hiq nuk je shembull i mirë, zoti kryetar dhe u detyrova të ta them.

Tash s' di sa të kam ndihmuar, por të ndihmova.

KADRI VESELI: Pal, kërkoj falje! Vërtet, pak më parë isha në gjysmë shaka, me replikë. Por, kjo është e vërtetë.

Zonja Gaxherri, asnjë veprim deri tani nuk e kam bërë unë, por është vendimi juaj, i seancës.

Dje, siç e dini, keni marrë vendim ju. Edhe sot morët vendim. Unë e futa shumë mirë propozimin e zotit Pal Lekajt, i cili kërkoi të shtyhet deri të mërkurën. Këtë e vura në votim! Prandaj, këtë që e thatë nuk është korrekte, të më fajësoni, për arsye se ishin të gjitha opsionet e hapura.

Janë edhe 40 deputetë të paraqitur për diskutim, të them për hir të publikut, vendimin e morët ju. Ndoshta nuk ishte prezent kur votuam, por vendimmarrja ishte juaja, jo imja.

(Ndërhyrje)

Po, ke të drejtë! Pra, kisha kërkuar falje, edhe pse kryesuesi e ka të drejtën, ndoshta po e keqpërdor pozicionin.

KRYESUESI: Po, veç asistenti nuk ka të drejtë të japë fjalën, kur është shefi këtu.

KADRI VESELI: Kërkoj falje, pra!

KRYESUESI: Po, merreni fjalën!

BESA GAXHERRI: Po, ne duke i bërë këto replika, zoti kryetar, ne veç po bëjmë shkelje të Rregullores. Unë thashë, këtë e keni bërë vazhdimisht dhe mos u mundo të jesh krejt i pafajshëm, sepse ne i kemi marrë vendimet.

Ju jeni kryetar i Kuvendit, ju jeni menaxheri. E atëherë, procedurat si shkojnë, ti e ke Kryesinë, i ke vendimet e Kuvendit dhe ato i dimë të gjithë. Por, ju jeni ai i cili duhet menaxhuar kohën, duhet menaxhuar seancat, të bëni rendin e ditës me kohë dhe të gjitha të tjerat, kështu që, zoti kryetar, na ke ndihmuar, mirë është.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pal e keni fjalën.

PAL LEKAJ: Zonja Gaxherri, kam respekt për hir të gjinisë, por ajo që mund të them është se më vjen çudi kur ju këtu derdhni lot krokodili dhe nuk veproni.

Përgjegjësia bie mbi ekzekutivin, prandaj çdoherë fajtori e ka vajin në buzë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besa, për kundër-replikë.

BESA GAXHERRI: Zoti Pal! Nuk e di sa më kuptove, dhe ti tash merre si të duash. Nuk është çështja as për lot krokodili dhe as t'i iket përgjegjësisë, se s'e thashë unë këtë hiq.

Mirëpo, unë po them, kur të bëhen këso tema, ne duhet të jemi korrektë: a të bëjmë fushatë politike dhe ta drejtojmë gishtin te njëri-tjetri, apo vërtet po na dhimbset territori, a vërtet s'po duam mure në mes të Kosovës, kjo duhet të ndahet. Dhe kur ne nuk duam mur në mes të Kosovës, atëherë jemi shumë më korrektë me vetveten. Kjo është.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Donika Kadaj.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Është çudi se prej që filloi ky debat, më shumë se 20 herë dëgjuam prej Kadri Veselit që tha: “po bëj hajgare. tash po bëj hajgare, tash e kam përnjëmend”. Po mendoj se tema nuk është për të bërë hajgare, por është e vërtetë se ju po bëni hajgare.

Në fakt, hajgare e keni bërë shtetin. Për hajgare e keni bërë, sepse në këtë Kuvend sa herë që ka tema të rëndësishme, ju bëni hajgare. Seancat i thirrni natën, vendimet më të rëndësishme, duke ia nisur prej koalicionit e te Trepça dhe mbrëmë Ligji për buxhetin i keni mbajtur dhe i keni marrë natën. Po, nuk është hajgare. Respektoni të paktën peshën dhe rëndësinë e këtij problemi, sepse vetë jeni përgjegjës. Se realisht, ata të cilët e kanë braktisur Mitrovicën në vitin 2000, po e braktisin edhe sot, edhe sonte.

(Ndërrhyrje)

E keni braktisur në vitin 2000, kur 12.000 shqiptarë dhunshëm janë dëbuar, janë vra, janë dhunuar, janë nxjerrë nga shtëpitë e veta, kurse ju keni vrapuar, keni këqyrë të pasuroheni dhe keni bërë hajgare. E ato hajgaret tuaja, prej asaj kohe hajgaret tuaja po na kushtojnë edhe sonte, kështu që ndaleni hajgaret, sepse u teprua pak me hajgare.

Muri nuk është projekti i fundit. Ju, s'i ka as 2-3 muaj, lejuat të ndodhë “Lugina e diellit”. Të njëjtit, bashkë, Editë, Isa Mustafa, të gjithë keni qenë në këtë Parlament kur keni ardhur dhe keni deklaruar fuqishëm në këtë Parlament dhe për këtë ekzistojnë transkriptet, se do ta ndalni atë projekt, që është shovinist, që është kolonizues, që nuk e ka lejen e Ministrisë së Ambientit. Po ai nuk u ndal. Zëvendëskryeministri shkoi dhe e preu shiritin dhe po vazhdoni.

(Ndërrhyrje)

Po e preu, kryeministër! A je kryeministër? A është zëvendësi juaj! Çka ndodhi në ndërkohë, pse nuk morët masa ta rrënoni, mos të lejoni t'i ndërtojnë ato shtëpi. Dhe, tash kur të fillojë kolonizimi, prapë do të thoni se do ta ndalim, por a bën të shohim, kur?

Do të thotë, nuk është se na keni befasuar, sepse vendimet të cilat i keni marrë nuk janë vendime të cilat kanë filluar dje ose po merren sot. Ne e kemi parë dhe e dimë se çfarë vendimesh merr ky koalicion qeverisës. E dimë, dhe e keni dëshmuar në vazhdimësi, edhe gjatë qeverisjes së Hashim Thaçit, edhe tani qeverisjen e Isa Mustafës. Po ashtu e dimë edhe udhëheqjen e këtij Kuvendi nën Kadri Veselin, e thashë. Njerëz të nëntokës, të cilët po udhëhiqni natën. Të gjitha vendimet po i merrni natën.

Mbrëmë buxheti ka kaluar në orën 1 të mëngjesit. Dhe, krejt çka po ndodh, çdo ligj, çdo vendim dhe çdo marrëveshje merret me procedurë të përshpejtuar dhe larg syve të opinionit, edhe larg

deputetëve, sepse ju nuk e bëni hesap këtë Kuvend. Absolut nuk e bëni hesap as Kuvendin, as deputetët, as popullin.

Kështu ka ndodhur edhe me bisedimet ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë në negociatat në Bruksel. Kuvendi është shpërfillur në mënyrë të vazhdueshme. Deputetët nuk janë njoftuar për marrëveshje të nënshkuara asnjëherë, ose kur është bërë një gjë e tillë marrëveshjet veçse janë kryer. A s'ka ndodhur kështu edhe me demarkacionin? Ne e kemi nxjerrë një rezolutë, e Hashim Thaçi ka nënshkruar marrëveshjen dhe ka thënë se do të vijë të na tregojë në Kuvend pas nënshkrimit të marrëveshjes se çka ka bërë.

Ky Kuvend ka miratuar shumë dokumente që kanë kërkuar transparencë qeveritare ndaj deputetëve. Mirëpo, ju këtë shtet e keni bërë shtet jonormal dhe e keni defunksionalizuar.

As këtë Kushtetutë, as ligjet e këtij shteti nuk arrini t'i zbatoni në terren. Pra, në njërën anë, në Perëndim keni nënshkruar marrëveshje të falni tokën, të falni bjeshkët e Rugovës, e në anën tjetër, nuk mund të ushtroni autoritetin e shtetit në veri të vendit as 16 vjet pas luftës, dhe kjo nuk nënkupton që të shkojë Edita të pijë një kafe andej. Jo!

Kjo nënkupton 12 000 shqiptarë të kthehen në shtëpitë e veta. Jo t'u paguhet qiraja, por të kthehen në pronat e veta.

E kam thënë në ditën e parë pas ngritjes së murit se kjo është përgjegjësi puro e shtetit, sepse ndërhyrja do të duhej të vinte nga shteti. Dhe, një shtet, në këtë fazë, 16 vjet pas çlirimit do të duhej të kishte ushtrinë e vet, por s'e ka, sepse ju s'e keni bërë.

Po e keni "fitin". Sot një vit me "fit" keni ndërhyrë në Lëvizjen "Vetëvendosje", ka qenë ndërhyrja më brutale prej periudhës së Milosheviqit. Populli në Kosovë nuk ka parë ndërhyrje më brutale të forcave të policisë se vitin e kaluar, më 28 nëntor.

E keni edhe krejt shërbimin, të cilin e keni vënë në funksion për të sajuar akuza të pabaza ndaj aktivistëve, ndërsa para syve ju ndërtohet në mënyrë ilegale, duke shkelur kushtetutshmërinë e vendit, muri dhe nuk bëhet asgjë. Madje, kam dëgjuar deklaratat tuaja që s'e keni parë murin. S'e keni ditur që po ndërtohet muri?! Unë s'e di a keni sy, a dini të lexoni projekte, nuk duhet të jesh as arkitekt, as inxhinier për të parë murin në projekt. Qysh thotë një përfaqësues i Qeverisë se nuk e kam parë në projekt murin!? A po dini, është e pakuptimtë!

Ose, ministrja përgjegjëse, sepse shkoi. Thotë, murin e heq BE-a. BE, të nesërmen në komision, përfaqësuesja thotë jo. As nuk është projekt yni, as nuk e heqim, as nuk ju ndihmojmë ta hiqni, le të përfundojë me negociata në Bruksel.

Po duhet të jepni llogari për këto veprime! Dhe, në të paktën, ta njihni vetveten. Ju sonte po mundoheni ta bindni opozitën se Kosova është shtet sovran dhe i pavarur. Po s'ka nevojë!

Bindeni vetveten dhe veprimet tuaja le të jenë konform këtij fakti dhe konform Kushtetutës e ligjeve dhe s'keni nevojë të na bindni neve. Ne e dimë! Njiheni vetveten! Po thirreni në Bashkimin Evropian, e Bashkimi Evropian po thotë: "Jo! Nuk është projekt yni, nuk e përkrahim dhe nuk ju ndihmojmë ta hiqni".

Është shkelur territori i Republikës së Kosovës, është ndërhyrje në territor. Është agresion i një shteti fqinj, i cili paraprakisht ka kryer gjenocid, masakra e njëqind të zeza të tjera. Dhe ju vini këtu e thoni se ky është një problem i vogël lokal dhe ne do ta heqim murin.

Sot, i ashtuquajtur president i Kosovës, i cili, po e kujtoj, është zgjedhur nën tytat e snajperëve dhe të protestave qytetare, tha, po e citoj: "Ndërtimi i murit është joligjor, është në kundërshtim të plotë me të gjitha marrëveshjet e Brukselit".

Por, a i takon një presidenti të jetë deklarativ?

Si duket, aty në zyrën e vet, ai është tash si në njëfarë qelie të burgut se nuk po e thërret kurrkush jashtë Kosovës. Rrjedhimisht, përpos Maltës, nuk mbërriti ta realizojë asnjë vizitë diku jashtë vendit, e ndërkohë që nuk mund të shkojë as në Mitrovicë, sepse si president nuk mund të shtrijë autoritetin kushtetues në gjithë vendin, as 16 vjet pas çlirimit.

E njëjta është edhe me kryeministrin Isa Mustafa, i cili nuk mund ta zbatojë politikën e brendshme të vendit, e as të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore të përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës. Pra, këta që janë në pushtet e lejojnë dhe bëjnë sehir para ndërhyrjes territoriale që po i ndodh vendit tonë. Dhe, përveç përgjegjësisë morale, keni edhe përgjegjësi penale për lejimin e këtyre shkeljeve, për mosveprimin dhe kapitullimin para Serbisë.

Kosova është shtet sovran dhe i pavarur, ndërsa Isa Mustafa, Kadri Veseli e Hashim Thaçi janë të varur dhe peng të veprimeve të tyre, prandaj kurrsesi, për asnjë moment s'po gjejnë kurajë të sillen si burrështetas konform përgjegjësisë që kanë marrë.

Ky pushtet që ka pushtuar çdo hapësirë në shtet e në shoqëri, kur vjen puna për ta mbrojtur veten nuk mendon dy herë për t'i ndërsyer të gjitha forcat kundër qytetarëve. Por ky pushtet, të njëjtit njerëz, kur duhet mbrojtur sovraniteti i vendit nga ekspansioni i Serbisë, vetëm rrinë e bëjnë sehir.

Pra, ju që sot po qeshni këtu, jeni shumë servilë ndaj Serbisë, jeni servilë ndaj bashkësisë ndërkombëtare, ndërkaq jeni tiranë e shtypës dhe mospërgjegjës ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Hajdar Beqa e ka fjalën. Le të bëhet gati Ilir Deda, e pastaj Shukrije Bytyqi.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit, nënkryetar, kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot ne, si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës po bisedojmë për një çështje e cila i ka shqetësuar të gjithë qytetarët e Kosovës dhe neve si deputetë, e konsideroj edhe të gjitha institucionet.

Muri në Mitrovicë, i cili u ndërtua natën, rrëfen qartësisht për mentalitetin ndarës dhe destruktiv të Beogradit dhe për politikën e tyre destruktive karshi Kosovës, ndërkohë që të dy shtetet tash e sa kohë dialogojnë për normalizimin e marrëdhënieve.

Nuk mund të ketë normalizim të raporteve mes dy shteteve kur ditën bisedohet e natën ndërtohet muri. Ky mur nuk është një akt i thjeshtë simbolik, mirëpo është një realitet, një realitet i vrazhdët që nuk duhet të injorohet nga institucionet, një realitet i vrazhdët që edhe përgjigjen duhet ta ketë po ashtu të vrazhdët nga institucionet e vendit tonë.

Ky mur, tashmë të gjithë e kanë thënë, duhet të rrënohet tërësisht, duhet të hiqet nga aty. Kjo nënkupton se edhe ideja për dizajnimin e tij me shkallë ose me mbrojtëse, gjithashtu duhet të jetë e papranueshme për ne.

Nëse Bashkimi Evropian, si lehtësues i dialogut me Kosovën e Serbinë, nuk ndërhyr për rrënimin e tij, nuk kërkon nga autoritetet lokale serbe të pjesës veriore të Mitrovicës që të shembet ai muri, atëherë institucionet e Republikës së Kosovës duhet të dalin me vendim të qartë për veprim. Pra, duhet të veprojnë me forcën e ligjit dhe për këtë nuk duhet pasur asnjë lloj hezitimi për rrënimin e atij muri, i cili u ndërtua paligjshëm.

A i është drejtuar Qeveria e Republikës së Kosovës me kërkesë të qartë Bashkimit Evropian lidhur me këtë muri? Jo për të marrë qëndrim se çfarë mendon por për të kërkuar me këmbëngulje dhe pa asnjë kompromis që ai mur të rrënohet? Nëse po, atëherë cila është përgjigjja e Bashkimit Evropian, që është garantues i marrëveshjeve të arritura në Bruksel mes dy vendeve.

Deri më tash kemi parë vetëm një deklaratë të Bashkimit Evropian, e cila thotë se qëndron vetëm prapa projektit për rivitalizimin e urës mbi lumin Ibër, e që është interpretuar si qëndrim kundër murit, por nuk kemi parë ultimatume. Pse nuk ka një afatizim, i cili tregon datën e rrënimin të këtij muri, që u shfaq më shumë se dy javësh në veri të Republikës së Kosovës.

Ne sot, konsideroj, se nga këtu duhet të dalim me qëndrime konkrete për këtë mur, por edhe me një datë konkrete se kur do të shembet ai muri.

Të gjithë ne këtu po dakordohemi se ai muri është vendosur paligjshëm, është pengues për integrimin e vendit, është muri pengues për lëvizjen e qytetarëve, andaj mendoj se rekomandimet e sotme duhet mbështetur të gjithë që muri të ketë një datë të caktuar se kur duhet të hiqet. Ne duhet të dalim sot me qëndrime të përbashkëta që muri të hiqet këtë vit dhe në vitin e ardhshëm të mos kemi probleme të tilla e t'i bartim te qytetarët edhe këto shqetësime.

Lëvizja e lirë duhet garantuar në Mitrovicë dhe ajo garantohet pa mure e barrikada. Ky është kusht për normalizim të marrëdhënieve në mes të dy shteteve, për relaksim të raporteve ndëretnike brenda vendit, por do të duhej të ishte kusht për vazhdimin e mëtejshëm të dialogut. Në të kundërtën, dialogu i Brukselit duhet rimenduar seriozisht. Faleminderit!

KRYETARI: Ilir Deda e ka fjalën, të bëhen gati zonja Shukrije Bytyqi e Anton Çuni.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Zonja e zotërinj,

Kolegë të nderuar,

Është një lloj demagogjie irituese, e cila vjen prej zyrtarëve qeveritarë për një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, ku shkelet sovraniteti i shtetit tonë. Dhe, mbajtja e një posti publik ekzekutiv nënkupton përgjegjësi të tillë, e jo personalizim çfarë po dëgjojmë ne sot.

Ne këtu s'po diskutojmë për personalitetet private, të kryeministrit apo ministres për Dialog, por për përgjegjësinë e tyre për ndërhyrje të Republikës së Serbisë në çështje të brendshme të Republikës së Kosovës.

E tash, duhet përkujtuar se Qeveria si degë ekzekutive i subordinohet Parlamentit dhe kjo në praktikë do të thotë: "Ju duhet t'u përgjigjeni pyetjeve të deputetëve".

Ky debat nuk është për t'u shtyrë se kush është më i mençur, por është konform përgjegjësive kushtetuese që ne i kemi si deputetë dhe që mbikëqyrim kyçjen tuaj dhe obligimin tuaj kushtetues në mënyrë sa më konkrete për të na dhënë përgjigje sidomos për shkelje të sovranitetit të shtetit. Pikë! Këtu përfundon ndarja e pushteteve.

E tash, çka ka ndodhur? Një park të një komune të Kosovës ju e keni internacionalizuar. Keni shkuar e keni bërë marrëveshje ndërkombëtare për një çështje të nivelit komunal, për një rrugë, e cila ka pasur rëndësi dhe nuk ka qenë vetëm rrugë lokale, dhe atë rrugë e keni shndërruar, e keni mbyllur dhe keni lejuar që Serbia, me pakujdesinë tuaj, ta ripërkufizojë apo për të tentuar që ta

ripërkufizojë territorin e Kosovës, ose më konkretisht, të tregoni se autoriteti i cilit shtet shtrihet në lumin Ibër?

Dhe, tash ju po thoni: “A e dini qysh, për këtë punë, ne kemi shkelje ligjore”. Po, ka shkelje ligjore! E çka po bën Qeveria e Kosovës për ta zbatuar ligjin? Atë përgjigje nuk na e dhatë.

Për këtë arsye është ky debat. Ne duhet të dimë çka do të boni dhe kur do t’i përmbushni deklaratat pompoze se muri nuk do të ekzistojë. Kur s’do të ekzistojë muri? Nesër, pasnesër, më 28 dhjetor, më 15 janar? Ju duhet të dilni me periudhë kohore sa më konkrete dhe të na tregoni brenda kësaj kohe: “Ne ju garantojmë juve, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, se muri nuk do të ketë në veri”.

Apo, do të bëhet ajo çka ka ndodhur deri sot në këtë proces të dialogut, e që është se Serbia vjen e krijon problem, ne japim deklaratat sa më pompoze të mundshme dhe në fund shkohet e negociohet atje për problemin të cilin e ka krijuar Serbia.

Sa për përkujtim, në vitin 2013 apo 2014 Nagip Arifi, kryetar i atëhershëm i Bujanocit, vendos ta ndërtojë një rrugë në Tërrnoc. Qeveria e Serbisë e suspendon vendimin e Kuvendit të Bujanocit dhe qeverisjes lokale të Bujanocit dhe thotë: “Ju po përziheni në planin magjistrat”, që s’ka pasur lidhje me plan magjistrat, brenda 24 orëve.

E ne, kemi pritur që sa të mund ta kemi këtë debat dhe jo të thirremi me një unitet të rrejtshëm, i cili nuk është produkt i një konsultimi politik. Dhe tash, të gjithë po themi muri s’duhet të ekzistojë. Atë po e dimë, që s’duhet të ekzistojë, por Qeveria duhet të na tregojë kur do ta heqë atë mur, apo, pasi të gjithë po thonë muri s’duhet të ekzistojë, hajde po e bëjmë një rezolutë. Hajde po e obligojmë Qeverinë, deri më 31 dhjetor të hiqet muri.

Kështu bëhet, kështu sillet një parlament i një shteti, apo një qeveri e një shteti, i cili mendon apo pretendon të jetë, e tash ne çka po presim prej BE-së, që BE-ja të vijë në komunë aty të na e heqë një mur, mos, ju lutem! Ne nuk mund të sillemi me mentalitetin e një province apo të një komune. Jemi shtet i pavarur, kemi obligime të zbatojmë ligje, t’i kapim e ta zbatojmë ligjin. Askush nuk po thotë: “Çohu, pushtoje veriun me polici e me FSK”, po atë mur rrëzoheni, se s’jeni marrë vesh për atë mur. E, nëse nuk jeni të aftë ta çoni këtë dialog përpara, ndërroni njerëzit që po udhëheqin, konsultohuni me njerëz të tjerë, s’kanë filluar aftësitë diplomatike me një doktoratë në Kosovë, ju lutem. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Bytyqi e ka fjalën, zoti Anton bëhet gati. Kërkoj falje, zonja Bytyqi, para se të fillosh fjalën.

Derisa deputetët po flasin, salla po zbrazet, dikur po frikësohem se veç unë do të mbetem në sallë, veç po flasin, kjo është pak papërgjegjësi, pothuajse sa për konsum, pastaj po largohen nga salla. Urdhëro, zonja Bytyqi!

Kërkoj falje prapë, zonja Bytyqi, përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozim, ta dëgjojmë. Zoti Sali Morina, pastaj e vazhdoni ju gjithsesi fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit, kryetar!

Tash, me që po e shohim edhe kohën, edhe deputetët pak a shumë nuk janë duke qëndruar në sallë, unë ju kisha lutur, në këtë rast iniciuesin e këtij debati dhe partitë politike që janë këtu të gjejnë një gjuhë të përbashkët, të paktën bile këta deputetë që do të diskutojnë të shkohet me një pesëminutësh, pa u hyrë në hak të tjerëve që kanë folur nga 10 minuta, por nëse e arrijmë një marrëveshje të tillë, mirë të të ishte, që të shkohet me nga 5 minuta, për shkak edhe të kohës dhe mosprezencës së deputetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Lekaj, ky është vullneti i deputetëve, se nuk kemi kuorum të marrim asnjë vendim. Ne mund të diskutojmë, më mirë të vazhdojmë diskutimet se nuk ka kuorum. Vetëm në qoftë se e marrim si këshillë, secili deputet të vetëpërkufizohet në 5 minuta, përndryshe 10 minuta i ka. Urdhëro, zoti Lekaj.

PAL LEKAJ: Unë e kuptoj deputetin që me të vërtetë edhe kjo ishte arsyeja pse kërkova që nesër në mëngjes, o të mërkurën të mbahet seanca debati, kur më të freskët do të ishin deputetët dhe jo tani të vijmë në atë për këtë çështje kaq serioze që deputetët të lodhen dhe të mos jenë në maratonë për një çështje çfarë është muri që e ndan veriun dhe Kosovën.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Bytyqi e ke fjalën, më s'mund të marrim asnjë vendim, vetëm është çështje e diskutimeve, nuk kemi kuorum. Urdhëro, zonja Bytyqi!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot fjalimin tim do ta filloj me një pyetje drejtuar kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Zoti kryeministër, kur Republika e Kosovës do të jetë vërtet shtet i pavarur, sovran, demokratik dhe i pandashëm?

Është shumë shqetësuese se 17 vjet pas luftës, 8 vjet pas pavarësisë, ne ende të diskutojmë për ndërhyrje të Serbisë në punë të brendshme të Republikës së Kosovës, e veçanërisht edhe me ndërtimet e mureve, ndërtimet e shtëpive e shumë çështje të tjera.

Bisedimet në Bruksel ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe atij serb për çështje të ashtuquajtura teknike, e më pastaj kryekëput politike pa kushtëzime, pa vizion të qartë, pa projekt afatgjatë janë shkaku kryesor i prurjes së shtetit në këtë gjendje, çfarë po përjetojmë dhe po e shohim në çdo ditë.

Kjo Qeveri dhe Qeveria e mëparshme i kanë sjellë vetëm dëme Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj. Ata vazhduan me dialog pa e analizuar mirë, me një dialog pa transparencë dhe duke e anashkaluar kryekëput Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Ne jemi gjithmonë për dialog, jo vetëm me Serbinë, por edhe me të gjitha shtetet fqinje, por bisedime të vërteta dhe bisedime të barabarta e transparente, bisedime ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovrane, por jo njëra palë të përfitojë e tjetra të humbë.

Tani ditët e fundit kemi shqetësim pas shqetësimi në Mitrovicën e veriut, kemi hapjen e tri pikave të karburanteve nëpërmjet kompanive të ndryshme që vijnë prej aksionarëve rusë dhe serbë, ku aty është hapur një pikë në Mitrovicën e veriut, një në Zubin Potok dhe një në Zveçan.

Unë e kisha pyetur kryeministrin e Republikës së Kosovës çka ka bërë ai dhe Qeveria e tij për shqiptarët e zhvendosur? Çfarë mirëqenie ka siguruar për ta? Vërtet është shumë shqetësim ndërtimi i shtëpive në Kodrën e Diellit që shumë kohë ishte thënë prej kësaj Qeverie se nuk do të vazhdojë, se nuk do të ndërtohen ato shtëpi dhe nuk do të bëhet kolonizimi i asaj pjese, po vërtet shtëpitë u ndërtuan dhe po vazhdojnë.

Ne e dimë se secili shtet ka të drejtë të bëjë donacione në shtetin tjetër, po duhet të dihet qëllimi i donacionit, karakteri i tij dhe donacioni duhet të shkojë nëpërmjet Qeverisë së atij shteti.

Unë kisha shtuar shumë pyetje për kryeministrin. Kisha dashur të di se çka fitoi Republika e Kosovës nga këto bisedime? Natyrisht që Republika e Kosovës nuk fitoi asgjë, ndërsa Serbia fitoi shumë.

Të nderuar qytetarë,

Koalicioni qeverisës në krye me kryeministrin Isa Mustafa për dështimet e tyre të njëpasnjëshme, si në fushën politike, ekonomike, sociale, arsimore, shëndetësore e në shumë fusha të tjera, të cilat i dinë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, u mundua që çdo herë faturën t'ua adresojë qytetarëve dhe koalicionit opozitar. Por ne me plot të drejtë u themi se ju jeni përgjegjës të gjitha këtyre dëmeve të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Të bisedohet për të ashtuquajturën “Park i Paqes” dhe për rivitalizimin e urës mbi lumin Ibër me muaj të tërë është absurde dhe është e pajustificueshme, duke anashkaluar çështjet me rëndësi vitale për jetën e qytetarëve dhe, çka është më e keqja, më në fund ai park i ashtuquajtur i paqes

u shndërrua në një mur të ndarjes dhe për këtë, kryeministër, si dhe herëve të tjera, ju bëni fyerje ndaj qytetarëve, shoqërisë civile dhe ndaj opozitës me fjalët tuaja “krekosje politike nga disa këndes”.

Gjithashtu, kryeministri para disa ditëve na tha të gjithëve se gjelat nuk e rrënojnë murin, ata këndojnë mbi mur, murin e rrënon ligji. Plotësisht pajtohem kryeministër se murin e rrënon ligji, por çështja është pse ju nuk po e zbatoni ligjin, pse s’po e rrënoni murin, kur pritet ta rrënoni ju murin?

Ne vërtet fillimin e këtij muri e dimë, por mbarim e tij nuk mund ta dimë dhe as që mund ta them, por një gjë dua të them me bindje të plotë se po nuk u rrënuar muri dhe rrënjët e këtij muri famëkeq, fundi i këtij do të jetë goxha i gjatë dhe do të jetë goxha problematik.

Andaj, kryeministër, ju nuk jeni të bëni deklarata të thata me gjithë bartësit tuaj, por jeni që ta caktoni një afat kohor. Ne dhe qytetarët e Republikës së Kosovës kërkojmë të dimë saktë kur do të rrënohet muri? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Anton Çuni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Largimi i forcave dhe i administratës serbe nga Kosova nuk do të thotë se Serbia ka hequr dorë nga territori i Kosovës apo nga një pjesë e saj.

Çdo ditë jemi dëshmitarë të ndërhyrjeve të ndryshme të Serbisë, të cilat mund të cilësohen si minim i përpjekjeve dhe proceseve për ndërtimin dhe zhvillimin e Kosovës si shtet i lirë, i pavarur dhe demokratik.

Në vazhden e pengimit të proceseve mund të shihet edhe ngritja e murit në pjesën veriore të Mitrovicës.

Ky akt nuk ka asnjë kuptim tjetër, përveçse edhe një tentimi të ulët dhe të vrazhdë i pengimit të forcimit të shtetit të Kosovës.

Serbia llogarit se me një të afërme mund të ndodhë një destabilizim global, fragmentarizim i NATO-s dhe i BE-së dhe faktorizim i Rusisë dhe i aleatëve të saj në arenën ndërkombëtare dhe veçanërisht në territorin e Ballkanit.

Deri në plotësimin e këtyre parakushteve, ajo fuqishëm investon në destabilizimin politik e ekonomik të Kosovës. I saboton të gjitha proceset integruese në organizata ndërkombëtare. Pengon fuqishëm ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse, e nxit krimin dhe korrupsionin, i nxit lëvizjet ekstreme dhe radikale, krijon incidente për të prodhuar tensione ndëretnike dhe shumë aktivitete të tjera, të cilat përfundimisht për qëllim e kanë të nxitin kriza sociale, humbje të kredibilitetit të institucioneve të Republikës së Kosovës, komprometimin e institucioneve dhe shoqërisë para faktorit ndërkombëtar, mbajtjen e Kosovës në varësi ekonomike ndaj Serbisë dhe, në fund, paraqitjen e shqiptarëve të Kosovës si faktorë destabilizues dhe luftënxitës.

Muri në Mitrovicë është thjesht provokim për shqiptarët, për institucionet e Kosovës që të reagojnë pa sens dhe takt politik.

Qëllimi i tyre është që t'i nisim kompanitë për rrënimin e murit, të përcjella me forca të mëdha të policisë dhe të shoqëruara me numër të madh të protestuesve.

Mënyra e tillë e reagimit mund të prodhojë dhunë deri në përmasa të gjakderdhjes nga të dyja anët.

E kjo situatë do ta kthejë rolin e KFOR-it dhe të Policisë së EULEX-it që do të thotë, kthimin e telave gjemborë, thasëve me rërë dhe makinave të blinduara.

Kjo situatë e krijuar do ta ndihmonte Serbinë që me plotësimin e parakushteve të cekura më lart, në një të ardhme të afërm t'i shpallë si kufij shtetërorë.

Mendoj që para se të merremi me murin e Serbisë, ne duhet të merremi apo t'i shembim muret mes vete.

Ato mure shemben nëse krijojmë së paku pajtueshmëri si ta luftojmë krimin dhe korrupsionin, si ta rrisim cilësinë e arsimit dhe shërbimit të shëndetësisë, si t'i ruajmë vlerat tona, me të cilat ne synojmë Evropën, si ta forcojmë miqësinë me SHBA-në dhe shtetet mike të Evropës. Kur t'i arrijmë këto, kur t'i heqim këto mure në mes vete, atëherë jemi të gatshëm të heqim çdo mur që ngrihet nga Serbia. Atëherë fuqishëm do të godasim çdo mur që bën çfarëdo ndarje kudo në Kosovë.

Në këto rrethana, në këto kushte, me këto tensione politike, Qeveria, pozita dhe opozita duhet të veprojnë me racionalitet.

Veprimet e pamatura mund ta komplikojnë situatën dhe kjo situatë të merret për pretekst për ngritjen e më shumë mureve edhe më të larta.

Unë nuk jam ithtar i aventurave, ekzibicioneve dhe përpjekjeve të kota sa për sy e faqe. Nuk dua të na përsëriten situata me ndërhyrjen e policisë në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak më 25 korrik 2011.

Unë mbështes dhe përkrah punën sistematike të llogaritur mirë, me rezultate të sigurt deri në ato përmasa sa që pas veprimeve të fuqishme, Serbia kurrë të mos mendojë më ngritjen e mureve, por të na respektojë si fqinj të barabartë.

Kosova është shtet i ri, ka nevojë për të gjithë ne, për angazhimin tonë të përbashkët që ta ndërtojmë, ta forcojmë sa më shumë, në mënyrë që të gjithë bashku të mund t'i gëzojmë të mirat që vendi ynë i ofron.

Prandaj, me këtë rast i ftoj edhe deputetët serbë që të ndihmojnë në heqjen e mureve. Heqja e mureve krijon perspektivë të mirë për Kosovës, për të gjithë qytetarët e saj, po ashtu edhe për serbët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip Muja e ka fjalën, pa grup parlamentar, Bekim Haxhiu të bëhet gati.

SHAIP MUJA: Këtu a po doni të jemi seriozë a joseriozë, të flasim seriozisht, se pasi është bërë natë, tuten njerëzit e ikin më shpejt.

Unë mendoj që propozuesi, zoti Pal, duhet ta orientojë takimin nga prononcimet që i dëgjuat këtu, ju i patë që edhe kryeministri, edhe kryeparlamentari, si partner i koalicionit, u zotuan që do ta aplikojnë ligjin për ta rrënuar atë mur. Prandaj, qëllimi juaj i debatit është kryer, ndërsa ne po bëjmë biseda e po analizojmë pse ka ardhur deri këtu.

Unë mendoj që muri i Mitrovicës, si muri i ri i Berlinit, i cili i ndante dy Gjermanitë, qoftë në planin territorial, ashtu edhe atë politik e strategjik të orientimit Perëndim-Lindje. Këto janë qëllimet, të cilat janë dizajnuar shumë shekuj, shumë dekada përpara nga Serbia që dihen në literaturë që nga Ivo Adriqi, Çubriloviqi e Milosheviqi e institutet gjeostrategjike që i kanë pasur për kantonizimin e Republikës së Kosovës dhe ndarjes së shqiptarëve që pjesërisht apo edhe një pjesë ia kanë arritur.

Muri i Mitrovicës është edhe paaftësi e Bashkimit Evropian që adresimin e problemeve nuk e trajton për zgjidhje, por për improvizime. Nuk e trajton për të siguruar identitetin e Kosovës, por për të parë se sa Serbia është dorëshlire në Kosovë dhe e gatshme të lëshojë pe.

Muri i Mitrovicës është keqpërdorimi më flagrant i të drejtave të njeriut, qoftë të popullit shqiptar në përgjithësi dhe ashtu serbëve në veçanti.

Drejtuesit komunalë janë grup regresiv në Mitrovicë, marionetë shkatërrues të jetës së atyre qytetarëve, të cilët mendojnë se po i drejtojnë nga progresi, e në fakt janë duke i drejtuar drejt ferrit, drejt izolimit, drejt Lindjes.

Deputetët tanë serbë që sonte nuk janë këtu kishite qenë mirë t'i dëgjonim arsyetimet e tyre, pse është bërë ky mur? Ata sigurisht na shohin në televizor, a është qëndrimi i tyre apo kërkesë e Vuçiqit? A është kërkesë e komunitetit apo e kriminalitetit politik? Ata qartë, si partner që i shfrytëzojnë këto institucione, duhet të deklarohen, ne nuk e dimë.

Kolegët tanë haptas duhet të deklarohen që o janë të shantazhuar e të frikësuar, o janë marionetë e implementuar në duar të Vuçiqit e vuçiqëve të tjerë në Serbi, që të përfitojnë në planin e tyre personal, e jo në interesin nacional serb.

Në ua bëjmë të qartë që angazhimet tona janë integruese, jo dominuese, janë pragmatiste, jo dogmatiste. Angazhimet tona janë për një shoqëri në Bashkimin Evropian e NATO, jo për një shoqëri, e cila nga mëngjesi me fjalë flet për BE-në, e në darkë ciceron me Rusinë duke shantazhuar Bashkimin Evropian.

Të nderuar kolegë,

Në veçanti, serbë, aq më shpejt ju filloni të jeni vetvetja, aq më shpejt ju do të lidheni me komunitetin tuaj, aq më shpejt do t'i kuptoni hallet e tyre që jua kanë besuar, nëse ashtu është besimi i tyre që ju t'i përfaqësoni. Aq më shpejt ju të hiqni dorë nga keqpërdorimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, aq më shpejt do të jetë më mirë.

E kam thënë shumë herë dhe po e përsëris prapë, EULEX-i duhet të adresohet atje së bashku me KFOR-in, është edhe kërkesë e njerëzve atje. E kanë thënë edhe disa deputetë të Listës serbe.

Mungesa e prezencës së EULEX-it dhe e KFOR-it është sjellja e kriminalitetit atje.

Mitrovica është lënë si poligon i kriminalitetit politik, ekonomik, që nëse nuk veprohet seriozisht, do të jetë burimi dhe i shumë të këqijave që mund t'i ndodhin regjionit dhe mund të ndodhë që faji të mos mbetet askund, përveç në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, e cila e përdor Rezolutën 1244 në interesat kur u vyen atyre dhe Bashkimit Evropian e NATO-s.

Kjo është dëshira e tyre që nuk e duan paqen, që nuk e duan Kosovën pjesë të Bashkimit Evropian, e atyre që kriminalitetin ekonomik e shndërrojnë në sukses politik nacional serb, e atyre që interesat radikale fetare ortodokse e myslimane duan t'i shndërrojnë në mite të luftës për "tokën e shenjtë".

Këto janë të njohura me shekuj nga kisha dhe politika serbe, e cila neokolonializmin e tanishëm do ta quajë si fakt historik të atëhershëm. E atyre që në institucione të studimeve gjeostrategjike serbe që para dhe gjatë luftës në Kosovë paraqitën harta kantonale, paraqitën plane demonstruese për Kosovën.

Serbisë duhet adresuar saktë dhe Vuçiqit qartë mesazhet se nëse vërtet në Kosovë po përdoren këta deputetë për qëllimet e tij, ne nuk kemi kohë të presim pa kuptim e pa qartësim, nëse ju këta serbë i keqpërdorni që përmes OSCE-së ju i siguronin edhe votat për të ulur në parlamentin e për të ndalur perspektivën e Kosovës dhe fëmijëve tanë, duhet të merremi vesh qartë: a dëshironi edhe një herë luftë, a dëshironi forma të tjera të bisedimeve, a dëshironi konfigurim gjeografik për shtetet njënacionale apo çka kërkoni? Neve na është bërë mjaftë nga lëshuarja pe dhe kompromiset, tutje “pilafti ujë nuk mban”. Përgjegjësi do të kenë së pari institucionet ndërkombëtare, Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe NATO-ja në përgjithësi dhe Serbia në veçanti. Ne pala shqiptare, pala e cila duhet të kuptojmë se serbët duhet t'i lirojmë duke bashkëpunuar me ta nga mentaliteti i të shtypurit, duhet t'i lirojmë me bashkëpunim nga mitet e ndërtuara si mure artificialisht në kokat e tyre, se Kosova është “djep i Serbisë”, duke i qetësuar se lufta që bëmë ishte luftë me interes edhe për shqiptarët, edhe për serbët, sepse ne u lirruam nga një tirani e paparë milosheviqiane okupuese dhe ju serbët nga një demagogji e Serbisë së madhe. Fati jonë nuk bazohet në mure, por në ura lidhëse, jo në mure ndarëse, por në institucionet shtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu, të bëhet gati zonja Teuta Haxhiu, menjëherë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuar ministre Tahiri,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet tema, duke e falënderuar edhe propozuesin, është e qëlluar, por mendoj që këtë temë ne do ta trajtonim në një përmbajtje krejt tjetër, jo të fokusuar vetëm në një mur apo një veprim të strukturave ilegale serbe në veri, por për ta trajtuar veriun në tërësi si problematikë, si problematikë e shtrirjes së sovranitetit të institucioneve të Kosovës, por edhe të integritit.

Fillimisht dua të shpreh respektin e thellë për dëshmorët e veriut, për Enver Zyberin, Avni Haradinajn, Sefer Haradinajn e të gjithë shqiptarët sot që qëndrojnë në veri dhe ata janë heronjtë, ata presin nga ne, ata presin nga që vërtet në veprimet tona të bëjnë veprime, diskutime dhe të nxjerrim projekte e vendime, të cilat do të jenë në shërbimin e tyre.

Tani kjo tema e murit është shndërrua në një temë “hajt diçka për Mitrovicën” dhe pastaj të kthehemi në akuza politike të ndërsjella, ose për të folur diçka për simpatizantët tanë politikë. A duhet të trajtohet ky problematikë në këtë nivel, mendoj që jo. Mendoj që vërtet problematikën duhet ta trajtojmë pa ngjyrimë politike dhe ta trajtojmë që jo në aspektin e një muri të cilën e

ngritën disa struktura me një mentalitet të Mesjetës, të barrikadimit prapa mureve, por jo sot për të mbrojtur qytetarët e veriut, të cilët sytë i kanë nga institucionet e Kosovës, për t'u integruar, për të jetuar lirë dhe për të lëvizur të lirë, por për të mbrojtur kontrabandën dhe bizneset në veri.

Ky mur nuk u ndërtua pse serbët në veri frikësohen nga shqiptarët, por u ndërtua për t'i mbrojtur ata që sot i rezistojnë integritet të institucioneve tona atje dhe frika se ata do të pësojnë pastaj nga ky integritet i institucioneve të Kosovës dhe shtrirjes së institucioneve të Kosovës në veri.

Kur diskutojmë për këtë problematikë gjithsesi mund dhe duhet të analizojmë edhe një pasivitet të institucioneve komunale në jug karshi kërkesave të qytetarëve në veri, në veçanti të kërkesave të shqiptarëve në veri.

Gjithsesi ne duhet të bëjmë një analizë më të thellë, duke e pasur në konsideratë se sot institucionet tona janë në dy pikat kufitare në veri, por edhe se janë mbajtur zgjedhjet e para të lira demokratike me ligjet e Kosovës atje, por edhe dëshirën e atyre qytetarëve që dolën në ato zgjedhje për të pasur institucione me votën e tyre dhe institucione demokratike.

Dhe, gjithsesi deri në vitin 2008 ne kishim një situatë krejt tjetër në veri, kishim një fluks të shqiptarëve dhe zhvendosje të tyre nga veriu në jug. Për herë të parë prej pasluftës ndryshimi i zhvendosjes së shqiptarëve fillon në vitin 2008. Pas vitit 2008 shqiptarët fillojnë të kthehen nga jugu në veri dhe deri në vitin 2013, deri sa udhëhiqte kryeministri i atëhershëm Hashim Thaçi dhe Partia Demokratike, në Mitrovicë kemi pasur të ndërtuara 202 shtëpi në veri dhe kemi pasur numrin e shqiptarëve të kthyer në veri. Prej vitit 2013 kemi një stagnim, asnjë shtëpi nuk është ndërtuar më në veri, edhe ajo çka është siguruar në të kaluarën, një pagesë e qirasë për banorët e veriut, është ndaluar nga qeverisja e Agim Bahtirit, nuk është paguar dhe nuk ka pasur mbështetje për të.

Ky pasivitet i qeverisjes lokale në Mitrovicë që tani është kurorëzuar edhe me një bashkëqeverisje tjetër pas ndërtimit të murit si lloj shpërblimi. Mendoj që nuk është mënyra e duhur e zgjidhjes së problemeve. Gjithsesi ne duhet të fokusohemi që tani kjo problematikë e murit në asnjë rrethanë të mos fokusohet si tentativë e problematikë të cilën vërtet e prodhuan ata që e ndërtuan atë mur, se qëllimi ishte vendosja e vëmendjes te muri dhe jo te kërkesat e institucioneve të Kosovës në veri, sepse ata po përballen me rrezikun e kërcënimeve të strukturave paralele atje.

E tha ministrja për Dialog se strukturat në veri janë shuar. Faleminderit!

Dhe, ne e dimë saktë që në uniformë nuk veprojmë më, kanë mbetur elemente të caktuara të strukturave ilegale në veri, të cilat po i rrezikojnë dhe kërcënojnë strukturat e zgjedhura nga vota e qytetarëve atje.

Prandaj, kjo duhet të thuhet qartë edhe në bisedimet me bashkësinë ndërkombëtare, sepse të gjitha strukturat në veri ilegale dhe ato biznese, kriminale të lidhura drejtpërdrejt me Qeverinë e Serbisë duhet të shuhet dhe të arrestohen. Këto janë veprime të cilat qytetarët në veri i presin nga institucionet tona, nuk mund të lejohen që kur ka kërcënime, shantazhe dhe gjuajtje me armë në veri, Policia të rrijë duarkryq dhe të mos veprojë. Pavarësisht kush janë ato, cilat struktura dhe cilët individë bëjnë pjesë aty. Unë di se disa kanë qëllimin që vërtet ta politizojnë çështjen në nivelin e brendshëm, sepse asnjëherë nuk e kemi dëgjuar të përmendin veprimin e strukturave të BIA-s në veri. Po veprimi i Agjencisë sonë të Inteligjencës, por informatat që i ka ajo Agjenci, të gjitha këto duhet të jenë në shërbim të shtrirjes së sovranitetit të Republikës së Kosovës në veri, e në veçanti integrimin e qytetarëve atje.

Ne e dimë që prej vitit 1999 nga veriu deri në vitin 2008 janë shpërngulur 13 mijë qytetarë shqiptarë.

Me paratë e biznesit të kontrabandistëve të veriut janë blerë 400 prona shqiptare në veri, vetëm për shtëpinë e të respektuarit Ali Kadriut janë dhënë, janë afuar 1.8 milionë euro. E dini që ajo ishte shtëpi simbol i kthimit të shqiptarëve në veri, ishte shtëpia e piktorit të respektuar, heroit Kadri Kadriut dhe kur filluam ndërtimin e asaj shtëpie kishim edhe disa pamflete që thoshin në atë kohë dhe disa protesta për të penguar ndërtimin në veri nga shqiptarët për qëllime politike që ne nuk duam ndërtim të shtëpive në veri, duam siguri në veri. Përkundër këtyre pengesave që të tjerët i bënë, Partia Demokratike në atë pjesë ndërtoi shtëpinë e Ali Kadriut dhe ndërtoi edhe 202 shtëpi të tjera dhe do të duhej të vazhdojë edhe tutje, sepse po të vazhdonim ne me kthimin e shqiptarëve në veri, sigurisht që serbët nuk do të kishin kohë të merreshin me ndërtimin e mureve çfarë është ai tani.

Gjithsesi, do të ishte mirë që këtë debat, për ta trajtuar edhe më mirë, edhe më qartë, edhe pa asnjë dilemë mendoj që do të duhej të ishte pjesë e materialit tonë për seancë, të ishte projekti detal i revitalizimit të urës në veri. Ta kishim ne përpara dhe të shohim se çfarë marrëveshje vërtet është bërë, kjo do të ishte një çështje shumë transparente dhe e nevojshme për ne dhe për të gjithë qytetarët e vendit. Aty do të vërehej edhe marrëveshja dhe gjithsesi do të vërehej edhe mungesa e ekspertëve të komunës së Mitrovicës në trajtimin e këtij problemi, sepse nuk do të duhej të shkonte në këto bisedime vetëm zoti Agim Bahtiri, por kishte nevojë të shkonin arkitektët dhe profesionistët e fushës. Nuk do të lejohej mbyllja e rrugës “Kralj Petar” dhe të vështirësohet pastaj qarkullimi i atyre qytetarëve të Suhodollit dhe të Tre Rrokaqiejve nëse ata do të kenë nevojë për të shkuar në spitalin regjional të Mitrovicës që ndodhet në veri. Atëherë cila është rruga alternative që ju afrova atyre, nëse është mbyllur rruga “Kralj Petar”? Do të duhej të mendohej vërtet në këto bisedime nga përfaqësuesit e Mitrovicës, nga ta të cilët ishin pjesë e bashkëqeverisjes me Agim Bahtirin dhe ata që janë sot, sepse nuk do të lejohej mbyllja e asaj rruge, e cila ka ekzistuar prej fillimit.

Mendoj që ishte një papërgjegjësi totale e qasjes, të cilën e kanë pasur zotërinjtë në ato bisedime dhe si produkt i asaj, sot ne kemi këtë mur dhe tentativën e bllokimit më tepër të biznesit të strukturave ilegale atje, se sa kërkesën për mbrojtje të qytetarëve, se qytetarët serbë të veriut dëshirojnë vërtet integrimin dhe atë e kanë dëshmuar në zgjedhjet e fundit. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Haxhiu, fjala për ju.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Krejt fjalimin tim që e kam përgatitur do ta lë komplet, do të flas diçka për të cilën mendoj se është me rëndësi.

Paraprakisht, kryetar, më duhet seriozisht edhe një herë të falënderoj për përkrahjen e mbrëmshme të amendamentit për masakrën e Mehës. Në fakt, për respektimin e Rregullores, se nuk lejuat të manipulohet me votat e deputetëve, çka edhe një herë publikisht i falënderoj të gjithë.

Derisa ju e kishit fjalën si deputet, vërtet për një moment mendova që shumë nga fjalitë tuaja ishin të deputetëve të opozitës. Mirëpo, kryetar, sinqerisht kjo nuk është krejt e mjaftueshme. Pse? Ju kujtohet në fillim të mandatit i kisha bërë një pyetje kryeministrit Mustafa për shkarkimin e ministrit Jablanoviq, i cili erdhi si rezultat i protestave dhe pakënaqësive të qytetarëve, se nuk mjafton të jesh ekonomist i diplomuar për ta udhëhequr vendin. Vërtet kjo u dëshmuar, për derisa bëtë të pamundshmen që të jeni në qeverisje që të dy partitë dhe qeverisja nënkupton veç privilegje. Përgjegjësia është shumë më e madhe, ashtu duhet të merrej po të kishte vetëm pak dinjitet. Vërtet kjo nuk po ndodh, fatkeqësisht.

Tani po ndalem edhe te një çështje që e kam ngritur kohë më parë.

Para dy muajve i kisha bërë një pyetje kryeministrit Mustafa, në fjalën që e kishte në Kuvend rreth rezolutave që nxjerrim në Kuvend, që unë kisha ngritur një shqetësim për mosrespektimin e tyre dhe tani jo vetëm se e kam atë shqetësim, por e kam dilemën shumë të madhe se çfarë po bëjmë ne sot këtu? Sot po diskutojmë 37 deputetë, kush prej pozite e kush prej opozite, kishte edhe buçet dëshirash, urime përshëndetje prej Besa Gaxherrit, kishte, besa, edhe prej deputetëve të pozitës që merreshin me opozitën se kush po flet më shumë për vota, e të nderuar deputetë, kolegë, ju prej pozite, e çka, qeverisje po doni, opozita çka ka? Nuk lejohet të flasim, besa edhe për pyetje parlamentare shumë herë nuk na jepet e drejta të bëjmë pyetje parlamentare, të cilat janë shqetësime të qytetarëve. Atëherë opozita normalisht se duhet të flasë dhe të flasë pozita duhet qëndruar në fjalë, nuk mjafton vetëm të flasësh, por të veprosh, e që të veprosh, kush është përgjegjës? Pse po i merrni atëherë përgjegjësitë, përderisa nuk jeni të gatshëm? Prandaj, duhet të dilni, nuk është kur turp të dilni e të thoni: “Nuk mundem më”.

Për shembull, konkretisht zonja Tahiri. Sa mirë kishte qenë të thotë: “Po, sinqerisht ka shkuar deri këtu, kam udhëhequr delegacionin e Kosovës, kam parë shumë mangësi, asnjëherë nuk e dëgjoj opozitën, sepse vërtet është zë i arsyes për t’i ndalur bisedimet dhe për t’i parë marrëveshjet se cilat janë respektuar”. Po cilat marrëveshje u respektuan, asnjë. Pra, edhe një herë çështja e kësaj rezolute që do të nxirret këtu, kryetar i Kuvendit, se çka do të bëhet me këtë dokument, shumë dokumente të tjera, në fakt, po për një rezolutë të nxjerrë kohë më parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës që kryeministri tha se shumica prej tyre bien ndesh me ligjet në Kosovë. Sikur vetëm një nga rezolutat e Kuvendit që u nxorën këtu të kenë rënë ndesh me ligjet në Kosovë, atëherë ne si Kuvend seriozisht nuk jemi të denjë dhe nuk bëjmë asgjë. Në përfundim, përderisa grupet parlamentare nxjerrin një dokument, atëherë çka po bëjmë ne me këtë dokument që sonte po diskutojmë, po debatojmë?

Në fund unë e kam dilemën: A do të bëhet diçka me këtë rezolutë që nxirret sonte? E unë sinqerisht ju them shumë skeptike jam.

Zonja Tahiri tha në fjalën e vet që vullneti politik, pra se janë zhbërë strukturat paralele. Unë i them edhe një herë zonjës Tahiri që strukturat paralele veç i keni veshur me uniformë, por i keni veshur me uniformë institucionale, pra i keni legalizuar, i keni shtirë brenda institucioneve të Kosovës që është edhe më keq.

Dhe, mbi të gjitha, Listën serbe që e kemi këtu, e kemi produkt të strukturave paralele në Kosovë, produkt të strukturave paralele, në fakt, të “rojave të urës”, ajo është produkt.

Përrjashtimisht nga deputetët serbë që kanë qenë në mandatin e kaluar, sinqerisht tani krejt çka ndodh që vjen në Kuvendin e Kosovës e keni parë dhe delegohen e asnjëherë nuk kundërshtohen, nuk kundërshtohen kur ata flasin dhe keqpërdorin jo vetëm Kuvendin, por edhe të gjitha institucionet e tjera.

Ka shumë prej ministrave që asnjëherë, edhe kryeministri, nuk kanë qenë të gatshëm të respektojnë Kushtetutën, as nuk kanë flamuj brenda hapësirave të hyre, as nuk respektojnë Kushtetutën, asgjë. Këta asnjëherë s’kanë pasur guximin të thonë: “stop, jeni varës të mi, shkoni”.

Megjithatë, çka në fund, edhe një herë po i kthehem. Çka, kush duhet të marrë hapa? Ne po e nxjerrim një dokument, kush do ta zbatojë atë? Kush, unë nuk e di, sinqerisht nuk e di, se nuk e kam asnjë fije besimi që do të bëhet diçka.

Prandaj, si kryetar i Kuvendit, bashkë me të gjithë deputetët ta respektojmë këtë vullnet të shumicës. Ata vërtet i dhanë kah këtij dialogu që të bëhet një dokument, por dokument i zbatueshëm dhe të merren hapa konkretë. Kur, jo të mbetet kjo në dëshira, pra kur do të rrënohet

muri dhe le të ndërpriten bisedimet, nuk ka më çka të vazhdohet. Tani mos na thoni se ndoshta të diskutohet kahu i bisedimeve. Po ndërprisni bisedimet, ndërprisni bisedimet edhe këqyrni çka keni bërë deri sot dhe kthehuni, ku keni gabuar, thoni kemi gabuar, diskutoni gjërat me deputetë në Kuvend, mos i mbani fshehtë, mos i mbani për vete.

Pra, edhe një herë, ju lus që dokumenti që nxirret sonte më tepër të monitorohet në zbatimin e tij, në afate kohore sa po respektohet, në të kundërtën, ne nuk bëjmë asgjë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Së pari më duhet të them që unë kisha përgatitur një fjalim për këtë seancë, mirëpo në ndërkohë si grup parlamentar kemi marrë një letër nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, zoti Agim Bahtiri dhe u nxita ta lexoj pikërisht pas akuzave dhe shpifjeve të deputetit Bekim Haxhiu.

Pra, po e lexoj letrën e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, zotit Agim Bahtiri:

“Të nderuar deputetë,

Siç e dini, qyteti i Mitrovicës që nga paslufta është i ndarë në dy pjesë, atë jugore dhe atë veriore. Kjo ndarje është rezultat i represionit të Serbisë para dhe gjatë luftës dhe nëpërmjet strukturave paralele pas lufte.

Pasojë e këtij represioni përveç ndarjes është edhe spastrimi etnik i lagjeve veriore të banuara me shqiptarë. Po jua rikujtoj se edhe veriu i Mitrovicës deri më 4 shkurt 2000 ka qenë i banuar me shumicën absolute të shqiptarëve, strukturë kjo që u ndryshua sidomos në natën mes datën 3 dhe 4 shkurt kur nga dhuna e llahtarshme e ekstremistëve serbë, të drejtuar nga strukturat paralele joligjore, nga atje u dëbuan rreth 12 mijë shqiptarë.

Vetëm gjatë kësaj nate bandat kriminale serbe vranë në mënyrë më mizore në shtëpitë dhe banesat e tyre 10 shqiptarë, plagosën me armë zjarri 25 sish dhe keqtrajtuan fizikisht në mënyrën më brutale qindra të tjerë.

Që nga atëherë jeta e përditshme në qytetin e ndarë ka qenë e mbushur me incidente ndëretnike, herë më pakë e herë më shumë.

Sipas disa statistikave që kemi, prej qershorit të vitit 1999 deri në fund të dhjetorit 2013 në Mitrovicë ka pasur mbi 9 mijë e 800 incidente ndëretnike, ndërsa që nga janari i vitit 2014 deri më tani ne kemi pasur më pak se 10 incidente ndëretnike, gjë që flet për një situatë relativisht të stabilizuar në aspektin politik e të sigurisë.

Të nderuar deputetë,

Ju në mbledhjen e djeshme e miratuat buxhetin për vitin 2017. Nuk pashë që në këtë buxhet të keni ndarë fonde të posaçme për kthimin e shqiptarëve të dëbuar me dhunë nga veriu i qytetit, të ushtruar nga bandat kriminale serbe, por as fonde për përmirësimin e jetës së shqiptarëve që akoma jetojnë në lagjet veriore, të cilat fatkeqësisht akoma nuk kanë trajtim të njëjtë me qytetarët serbë që jetojnë në këtë pjesë të qytetit. Ata vërtet kanë probleme të shumta ekzistenciale dhe nuk bëjnë jetë të dinjitetshme.

Ndërkaq të gjithë e dimë se Qeveria e Serbisë vetëm për strukturat e saj joligjore në shëndetësi ndan për çdo vit mjete për pagat e 1800 punëtorëve të punësuar në institucionet shëndetësore, ku pjesa dërmuese e tyre, në fakt, punojnë në strukturat tjera joligjore të shtetit të Serbisë.

Po ashtu Qeveria serbe ndan mjete jashtëzakonisht të mëdha edhe për shërbime të tjera dhe investime të fuqishme në ndërtimin e banesave, me qëllim të kolonizimit të këtyre hapësirave, në ndërkohë që institucionet e Kosovës mbështesin vetëm deklarativisht qëndrimin e shqiptarëve në lagjet veriore.

Vërtet për mbetjen e shqiptarëve në pjesën veriore të qytetit është bërë fare pak, pasi që kur unë kam ardhur në krye të Komunës së Mitrovicës i kam gjetur vetëm 120 mijë euro të mbledhura nga aksioni “Ndihmo edhe ti”.

Ndërkohë që me mjetet e buxhetit të Komunës kam furnizuar me material ndërtimor në vlerë prej 180 mijë euro rindërtimin e shtëpive të shqiptarëve në veri, që është shumë tejet e vogël për rindërtimin e të gjitha shtëpive të shqiptarëve të shkatërruara nga ekstremistët serbë në të gjitha lagjet veriore.

Vlen të theksojmë se në këtë drejtim një ndihmë e ka dhënë edhe Bashkia e Tiranës, në krye me Lulzim Bashën, në vlerë prej 100 mijë dollarësh, më shumë nuk është bërë, që vërtet është pak.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Është koha e fundit që institucionet e Republikës së Kosovës, konkretisht dhe vendosmërisht të neutralizojnë ndikimet negative e ekspansioniste të Serbisë dhe njëkohësisht të fuqizojnë prezencën e tyre atje.

Kur shpresuam se situata do të vazhdojë të stabilizohet me heqjen e barrikadave, drejtuesit e Komunës në veri të Mitrovicës, të nxitur nga Qeveria e Serbisë u përkujdesën që kjo të mos ndodhë, duke ndërtuar një mur në cepin verior të urës kryesore të lumit Ibër, në mënyrë të jashtëligjshme dhe të papranueshme. Situatë kjo që i irritoi pa masë qytetarët e të gjitha përkatësive etnike.

Ky veprim i drejtuesve të Komunës në veri të qytetit vetëm se e konfirmon qëllimin e Beogradit që ndarja të jetë e vazhdueshme, derisa kjo ndarje të bëhet përfundimtare.

Përderisa Serbia me gjithë potencialin e saj punon për ndarje, Komuna e Mitrovicës në pjesën jugore me të gjitha mundësitë angazhohet për bashkim, kurse institucionet qendrore, me qëndrime janë apatike e inekzistente atje, duke mos investuar as energji e as financa.

Prandaj, të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kërkojmë nga ju që të miratoni vendimin, të cilin duhet ta zbatojë Qeveria e Kosovës që ai mur sa më shpejt të rrënohet dhe të kthehet normaliteti në qytetin e Mitrovicës dhe për kthyer ky normalitet shteti ligjor duhet të funksionojë në gjithë territorin e vendit.

Angazhimi i Qeverisë së Kosovës duhet të jetë i vendosur dhe i pandalshëm, sepse çfarëdo hapi i lënë për gjysmë, mund të na kthehet bumerang dhe ta përkeqësojë edhe më tepër situatën e përgjithshme këtu.

Shpresoj se deputetët e Kuvendit seriozisht do ta marrin parasysh këtë apel timin që njëkohësisht është edhe apel i qytetarëve të Mitrovicës.

Kryetari i Komunës: Zoti Agim Bahtiri”. Faleminderit!

KRYETARI: O Agim Bahtiri, Bekim Haxhiu, çka po do, nuk replikohet, me kë replikë? Po ajo e lexoi letrën, ajo nuk lexoi asgjë, ajo zëdhënësja e Agimit që, asgjë tjetër. Urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Unë e përgëzoj Albulenën që është bërë zëdhënëse e Agim Bahtirit, më vjen mirë, keni arritur shumë lart, por do të doja sinqerisht të jeni e sinqertë, cila ishte shpifja që janë ndërtuar 202 shtëpi në veri, që janë të përzënë 13 mijë shqiptarë prej atje, se s’është punuar prej 2013 asgjë për veriun nga Agim Bahtiri dhe ju tani po e mbroni atë, se ka biseduar vetëm pa asnjë përgjegjës të Komunës së Mitrovicës në veri dhe tani jeni në koalicion me të, doni ta mbroni për këtë. Tani e keni marrë përsipër ta mbroni murin që ai tha do të bëjmë shkallë dhe kërkoni të rrënohet.

Tani jeni në bashkëqeverisje me të, trego a jeni që të rrënohet muri, apo jeni që ai mur të bëhet shkallë? Cila është kërkesa juaj? Ishe zëdhënëse e Agimit, tani personalisht si deputete, por trego çka, e more, e lexove, ne e dimë të gjithë edhe se si shkruan Agimi, edhe theksin e Agimit edhe tuajin, prandaj të përgëzoj për rolin e ri që e ke marrë si zëdhënëse e Agim Bahtirit apo çka? Thoni që nuk ka pasur zhvendosje dhe ndërtim të shtëpive nga viti 2008 deri në vitin 2013, këtë e kundërshtoni. Këtë e ka bërë Hashim Thaçi dhe Partia Demokratike, the nuk i ka shfrytëzuar mjetet që i ka pasur, nuk deshi t’i përmendë ato, i ka pasur mjetet për rindërtim dhe nuk i ka shfrytëzuar. Pse s’i ka shfrytëzuar ato mjete? Tregoni cilit qytetar të veriut të Mitrovicës sot i

paguhet qiraja? Cilit qytetar sot i hiqen shpenzimet? Cila është, ai as vend në Komunën jugore nuk u ka lejuar qytetarëve të veriut, as vend nuk kanë qytetarët e veriut në Komunën jugore, nuk kanë asnjë mbështetje. Faleminderit!

KRYETARI: Vetëm pak, ke kërkuar fjalën, më erdhi keq, do ta them publikisht. Ke kërkuar fjalën me insistim dhe në fund e ke lexuar letrën e huaj. Pra, a po do publikisht, e ke kërkuar për shkak të gjendjes tënde personale, ke manipuluar moralisht, edhe pastaj e ke lexuar vetëm letrën e huaj, s'ke bart farë qëndrim politik.

Agim Bahtiri mund të vijë, e thërrasim edhe këtu në seancë, nuk e ka të ndaluar fare, thjesht. Vetëm se të tjera herë mirësjelljen time nuk është mirë ta abuzosh.

Rrustem Berisha e ka fjalën, ose tërhiqe fjalën ose vazhdo.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar qytetarë,

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Për ata është duke e gëzuar pushtetin ai, po Rrustem Berisha vazhdon fjalën, ka fituar në mënyrë demokratike ai.

RRUSTEM BERISHA: Ndërtimi i murit te ura e Ibrit është një shqetësim tejet i madh për të gjithë qytetarët e Kosovës, edhe për deputetët, besoj, të të gjitha partive, por në të njëjtën kohë është një provokim tepër i madh për institucionet e sigurisë dhe për shtetin e Kosovës.

Unë mendoj se ne duhet të sillemi si shtet, çka do të thotë kjo? U tha më herët se muri është ndërtuar brenda natës.

Ndërtimi i murit ka zgjatur 7 ditë. Pyetja që unë e ngre dhe çështja që dua ta ngre këtu ka të bëjë: A kanë qenë të informuar institucionet e sigurisë që po ndërtohet ai mur dhe njëkohësisht vendimmarrësit, kryeministri Mustafa, presidenti, ju zoti kryetar, a keni qenë të informuar nga institucionet, nga shteti i Kosovës që po ndërtohet ky mur? Dhe kur do të ngrihet niveli i shtetit tonë që ne t'i paraprijmë situatës dhe jo të merremi me pasojat? Edhe nëse rrënohet ky mur, unë jam i bindur se ata nuk do të ndalen me atë mur, por do të vazhdojnë me provokime të tjera.

Situata e Mitrovicës, problemet që janë te ura e Ibrit nuk datojnë prej ngritjes së këtij muri, u tha edhe prej kolegëve më herët, por shteti duhet t'u paraprijë situatave të cilat janë në vijim. Çka do

të thotë kjo? Institucionet e sigurisë duhet të thirren në përgjithësi, a kanë pasur informata, ku janë, kujt ia kanë dhënë, nëse i kanë dhënë, cilat janë veprimet që i kanë marrë institucionet tona për parandalimin e ndërtimit të këtij muri? Kjo është çështje me të cilën ne duhet t'i nxjerrim mësimet e mësuara dhe vërtet të sillemi si shtet. Nuk duhet të gjejmë fajtorin këtu në mesin tonë, në mesin e deputetëve, përgjegjësia institucionale duhet të jetë e pranishme edhe në nivelin qendror, por edhe në nivelin lokal. Nuk ka mundësi të ndërtohet aty brenda natës, sikurse thanë kolegët, të sillet e të vendoset aty muri, së paku 7 ditë, 5 deri në 7 ditë ka zgjatur ndërtimi i atij muri.

Prandaj, mendimi është që ne në të ardhmen duhet ta kemi një strategji për veriun dhe jo që të presim të merremi me pasojat, por t'i parashohim cilat janë mundësitë edhe veprimet që ata mund t'i ndërmarrin përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Buja, fjala për ju. Më fal zoti Buja, a ka mundësi, i kam premtuar më herët zonjës ministre të flasë, në ndërkohë. Kërkoj falje! Ne duhet përkundrazi si deputetë, se e kemi ministren e cila për dialog çdoherë përgjigjet, ne do të duhej të ishim të shqetësuar në qoftë se kjo do të largohej. Më fal, zoti Buja! Urdhëro, zonja ministre!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Deputetë të nderuar,

Unë dola për të dhënë edhe disa sqarime, sidomos në lidhje me këtë çështje dhe Marrëveshjen e Brukselit.

E para, dëshiroj të ju them që Qeveria e Kosovës dhe të gjitha instancat, presidenti dhe kryetari i Kuvendit: në emër të institucioneve shtetërore kemi refuzuar çfarëdo opsionesh që BE-ja ka provuar t'i propozojë për këtë çështje. Çështja është e mbyllur dhe porosia e qëndrimi shtetëror është nuk ka negociim për këto çështje, ka vetëm heqje muri. Pra, ekzistojnë komunikimet zyrtare për këtë çështje.

E dyta, desha të them që pasuria strategjike që e kemi në veri, jo vetëm minierat, por edhe uji ndoshta kanë qenë ndër arsyet kryesore pse Kosova ka qenë e kolonizuar dhe e okupuar 100 vjet. Dhe, kur u çliruam nuk ishte rastësi që Serbia vendosi strukturat paralele në pjesën veriore. Tjetra? Kosova nuk është shteti i parë as i fundit që e ka përfunduar luftën, por pastaj ka pasur edhe disa probleme. Më lejoni t'ju përmend Kroacinë, e cila e ka përfunduar luftën, por është ballafaquar me kërcënimet e Serbisë në Sllavoninë lindore, sikur ne u ballafaquam që nga '99-ta.

Sllavonia Lindore si rast është shumë i ngjashëm me problemin që ne e kemi pasur me strukturat paralele dhe atyre u kanë shkuar 15 vjet derisa i kanë shuar strukturat paralele dhe e kanë integruar komunitetin serb në sistemin shtetëror të Kosovës. Për disa që nuk po i shohin rezultatet e dialogut, e që kanë filluar me Qeverinë e kryeministrit Thaçi dhe po vazhdojnë me

kryeministrin Mustafa, unë do t'u them edhe një herë shkurt se cilat janë rezultatet e këtij dialogu.

E para është shtrirja e sovranitetit në shumë fusha në këtë pjesë të vendit. Largimit të diskursit që e kemi dëgjuar aty-këtu për ndarje të Kosovës ky dialog i ka dhënë fund, sepse strategjikisht e kemi vënë kufirin së pari pastaj jemi marrë me shuarjen e strukturave paralele. Poshtërimi i institucionit në këtë pjesë të vendit, si dhe dialogu i Brukselit ka ndihmuar që pesë vende mosnjohëse ta mbështetin rrugën euroatlantike të Kosovës.

Unë po dëgjoj disa deklarata të tilla, të lehta, shumë të lehta - "kurrgjë s'ka nga rezultatet e dialogut". Ju lutem, me një fjalë, nuk mund të bëhet kualifikimi i proceseve, jo vetëm për këtë punë të rëndë e strategjike, por edhe në jetën e përditshme me një fjalë - mohim dhe pohim - s'mund të bëjmë vlerësime. Prandaj, edhe sonte po i ftoj të gjithë ata deputetë që kanë fakte, por jo fjalë, që mohojnë rezultatet e dialogut, ja ku është Parlamenti, i bisedojmë. Por, mohimet vetëm me një fjalë janë vetëm për të treguar që nuk i studiojmë gjërat, nuk i shohim seriozisht dhe më lehtë e kemi që ta mohojmë se sa të hyjmë dhe t'i analizojmë.

Dhe, e fundit, mos harroni, këtë provokim për destabilizim të Kosovës që e ka bërë Serbia tash, nuk është as i pari as i fundit. Prapë mund të ketë provokime për destabilizim, sepse ne po e shohim një dinamikë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare, një paradigmë që po ndryshon me agjendat gjeopolitike. Agjenda gjeopolitike e vendeve joperëndimore është shumë agresive dhe paqartësia e Serbisë nëse dëshiron me Brukselin apo me Moskën po i krijon edhe këto provokime, por e jona është që si shtet të dimë ta mbrojmë shtetin, ta heqim murin, por ta ruajmë stabilitetin. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Buja, kërkoj falje! Fjala është për ju. Faleminderit për mirëkuptimin!

SHUKRI BUJA: Para se të filloj diskutimin, dëshiroj ta shpreh një çështje që prej kur jam në Parlament e kam kërkuar vazhdimisht fjalën dhe kam mbajtur fjalimet e mia, por gjithmonë në fund.

Nuk e di, ndoshta pa qëllim, por është çështja e dytë, sa herë duhet ta marr fjalën unë ndërpritet transmetimi televiziv, edhe kjo ndoshta pa qëllim. Po besoj që kryetari i Kuvendit më ka shumë dëshirë dhe po më lë sikur ëmbëlsirën për fund.

Të nderuar deputetë,

Para se ta shtroj çështjen për të cilën po diskutojmë, dëshiroj t'i them disa fjalë për ato që u thanë për luftën.

Vërtet isha pjesë e luftës, e nisëm luftën, ndoshta s'luftuam boll, mund të ndodhë edhe s'bëmë sa duhet, edhe s'e përfunduam, por diçka bëmë. Po na sulmojnë, disa pse e nisët luftën, s'e kemi mundur me politikë paqësore. Të tjerët na sulmojnë tash, pse s'e vazhduat luftën për ta çliruar krejt. Ne jemi në hall! E kush po na sulmon? Ata që s'bënë kurr gjë, ama bash hiç kurr gjë. Po faleminderit së paku që po na përmendin nganjëherë.

Unë do ta shtroj fjalimin tim në dilemën: është ligji dhe dialogu që e bënë murin, apo është muri ai që po e bën ligjin dhe po e orienton dialogun. Ju lutem, pse po bëjmë demagogji? Më 2008, Parlamenti e ka shpallur pavarësinë në bazë të planit të Ahtisarit. Pakoja e Ahtisarit i ka disa ligje. Pse bëhet demagogji dhe dalin e thonë kemi për ta bashkuar Mitrovicën, kemi për ta bërë këtë e atë. Me ligj është e ndarë Mitrovica në formë administrative. Ligji për kufijtë administrativë të komunave e ka Mitrovicën, Mitrovica Veriore dhe Mitrovica Jugore.

Pse bëjmë demagogji dhe s'e themi këtu qartë që për ta ndryshuar këtë dhe që ta bashkojmë Mitrovicën ne jemi Legjislativi dhe mund ta rishqyrtojmë, mund ta amendentojmë, mund ta ndryshojmë Ligjin për kufijtë administrativë të komunave në qoftë se kemi guxim politik. Unë nuk kam guxim, se s'po kam guxim që të shkoj në Mitrovicën e Veriut, jo për tjetër, por se mund të më arrestojë Policia e Serbisë në Mitrovicën e Veriut edhe mbetem në burg pastaj. Për atë s'po kam guxim. Me armë nuk mund të shkoj se s'ma lejon ligji, kështu që po rri, më mirë s'po shkoj hiç.

Ne e kemi bërë ligjin, dhe mos shitni demagogji të gjitha partitë politike, sepse të gjithë jemi përgjegjës. Ne e kemi bërë, a është bërë mirë a është bërë keq, është diçka tjetër. Unë e di që "Vetëvendosja" thotë "jo ne s'jemi". Jo, jo! "Vetëvendosja" ka deputetë që kanë qenë në atë Legjislative, ose ka deputetë që kanë qenë parti politike, sepse kanë qenë në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, ka deputetë që ka qenë në PDK, "Nisma" kanë qenë në PDK, Aleanca e ka përkrahur e tjerë, e tjerë.

Individualisht, edhe unë s'kam qenë në Legjislative, por kam qenë në Këshillin Drejtues të Partisë Demokratike. A e kam kundërshtuar apo jo, s'kam arritur ta ndalë këtë punë. Jam edhe unë fajtor. Por, pavarësisht kësaj, do të na gjykojë dikush tjetër a e kemi pasur mirë a keq, a kemi bërë mirë apo s'kemi bërë mirë. Po si pasojë e ligjit ka ardhur edhe te dialogu, e pasojë e dialogut, deshëm apo s'deshëm, është muri. Dhe, pse po them këtë? U tha se nuk kemi përmendur mur, nuk kemi aprovuar mur, s'ka pas kurr gjë me atë mur. Por, përderisa një rrugë e quajtur "Kralj Petar" është biseduar në Bruksel dhe është shndërruar në shëtitore, normalisht që ata që dialogojnë, pjesa që nuk ka dëshirë për ta shtyrë këtë punë dhe të të orientojnë dikah tjetër bën destruksion.

Dhe, ka bërë destruksion, e ka filluar dhe e ka ndërtuar atë mur, që t'u japin kah bisedimeve, edhe ne të na japin kah, të mos merremi me probleme tjera të të bërit të ligjit vetë atje, por të

merremi a është i mirë muri, a është i hijshëm, apo s'është i hijshëm. Prandaj, edhe kahun po ia jep edhe dialogut në bisedime.

Çështja tjetër, apo dilema që u shtrua këtu, a po e bën ligjin muri dhe a po e orienton dialogun? Se po e orienton dialogun e sqaruar, por muri a është i mirë a i keq, a është i hijshëm nuk çon peshë, por muri e ka një mesazh, mesazh shumë të qartë: dëshiron të tregojë me simbolikë se në atë pjesën veriore ligjin e bën dikush tjetër, e jo institucionet e Republikës së Kosovës. E ka një mesazh shumë të qartë se dëshiron ta bëjë demarkimin e kufirit dhe thjesht e ka një mesazh tepër të keq, tepër të rëndë për Parlamentin dhe për institucionet e Kosovës.

Prandaj, muri mund të thuhet se po e bën ligjin në atë pjesë dhe ligjin edhe për targat edhe për tjerat.

Po thuhet këtu se i hoqëm barrikadat. Është fakt, s'mund ta mohojmë. E bëmë këtë, e bëmë atë, të mos i theksoj. Po, nuk e mohoj, por cili është çmimi që do ta paguajmë është një pikëpyetje tepër e madhe dhe për këtë ne si institucione duhet të jemi të kujdesshëm se çfarë çmimi do të paguajmë. Unë nuk dëshiroj të vazhdoj më tutje, por t'ju them se si Legjislativ që jemi, nëse kemi guxim politik, nëse dëshirojmë ta rregullojmë këtë punë dhe nëse na lejojnë, atëherë kjo çështje rregullohet nëpërmjet amendamentimit të Ligjit për kufijtë administrativë të komunave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Buja! Fjalën e ka Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Nuk di edhe çka të them pas fjalës së Shukri Bujës. Me të vërtetë ishte një fjalim jashtëzakonisht i mirë, por unë do të ndalem pak te bisedimet, te fjalimi i kryeministrit, i cili e shfaqëson veten gjoja se nuk është fajtor për fillimin e bisedimeve me Serbinë.

Me një pjesë të fjalimit jam dakord se përgjegjës numër një për fillimin e bisedimeve ka qenë zoti Thaçi. Por, prej përgjegjësisë nuk mund të ikën as zoti kryeministër tash, sepse ka qenë në atë kohë kryetar i partisë më të madhe opozitare, LDK, e cila pa izën e kryeministrit as deputetët e LDK-së nuk kanë mundur ta votojnë rezolutën, ose fillimin e bisedimeve me Serbinë. Kurse tash si kryeministër është përgjegjësi kryesor për bisedimet dhe rrjedhën e tyre ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si nga ana pozitive, ashtu edhe negative.

Kisha dashur që t'i numërojmë disa anë pozitive të këtyre bisedimeve, por nuk ka, e pasi nuk ka kisha kërkuar nga kryeministri që t'i ndërpresë këto bisedime dhe të marrë vendime të duhura, ashtu siç tha këtu në foltore se ai muri nuk do të jetë, muri do të hiqet nga aty. Por, pak besoj në këto çka tha kryeministri, sepse deri më sot nuk ka treguar se me të vërtetë është kryeministër, me të vërtetë është i zoti i këtij vendi.

Do të ndalem pak edhe te ju zoti kryetar, se e pate një fjalim të mirë, por përgjegjësisë për Mitrovicën dhe për Kosovën nuk mund as ti t'i ikësh, sepse edhe ti ke qenë një zyrtar, ose zyrtarisht ose jo zyrtarisht, goxha i lartë, meqë fjala ka qar peshë në Partinë Demokratike të Kosovës. Kërkove fonde, fonde për ndërtimin e shtëpive, kërkove fonde për pagesën e qirave, kryetar i Parlamentit ti e di shumë mirë se në Mitrovicë në pjesën jugore të saj shumë qytetarë nga kombësia shqiptare i kanë shitur pronat. Ti e di shumë mirë këtë.

Dhe, kurrë zëri juaj nuk është ngrehur për këtë çështje. Dhe, sot zoti kryetar është shumë vonë dhe përgjegjës kryesor për këtë vonesë jeni ju, sepse fjala juaj në Partinë Demokratike ka çuar peshë që nga 2007-ta e deri më tash, edhe më herët, dhe e keni udhëhequr Qeverinë për tri mandate, ju si kryetar i Parlamentit bashkë me atë mikun tuaj e tonin, zotin Thaçi.

Kështu as ju, as kryeministri i Kosovës nuk mund t'i largoheni përgjegjësisë. Ju jeni kryesorët që e keni sjellë gjendjen në këtë vend qysh është sot dhe sot besoj që është shumë vonë. Zoti kryeministër, në këtë Parlament është diskutuar shumë edhe kur ka ardhur te pjesa e Gjyqësorit, edhe te Prokuroria, edhe te strukturat paralele, të cilat i keni instaluar nëpër institucione, por prapë ka struktura paralele në Mitrovicë.

Jeni përgjegjës edhe për zhvillimin e zgjedhjeve në Mitrovicë, ku keni thënë që ne po mbajmë zgjedhje në Mitrovicë, e të gjithë ne dimë që në Mitrovicë nuk ka pasur zgjedhje. Kanë ardhur kutitë e mbushura nga një dorë e pjesës jugore të Mitrovicës dhe si rezultat i atyre votimeve ka dalë Lista serbe, e cila është pengesë e zhvillimit të shtetit të Kosovës, është pengesë e krijimit të ushtrisë, prandaj mos e ul kokën po ngrite dhe merre përgjegjësinë, thuaj "po, unë jam përgjegjës, por s'kemi mundur çka të bëjmë më tepër".

Nuk po dua më tepër ta zgjas, sepse u bë e tepërt, të gjithë deputetët e thanë atë çka duhet ta thonë, por përgjegjësisë nuk është mirë t'i ikim as ju, e as ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Haxhi Shala! Ndoshta në fund do ta bëj një gjysmë replike, pastaj po të përmbledhur. Po nga fundi, nëse mbetet bile një deputet këtu.

Tani shkojmë prapë te opozita. Bali Muharremaj e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Unë dua ta tërheq fjalën, arsyeja është se kemi mbetur diku 35 deputetë dhe ne mundemi ta dëgjojmë njëri-tjetrin, por vendime s'mund të marrim dhe për këtë arsye po e tërheq fjalën, le te marrë kush të dojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lëvizja “Vetëvendosje” Ismajl Kurteshi, bëhet gati Shpejtim Bulliqi nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Sonte këtu u dëgjua shpeshherë konstatimi “le të hiqet muri, e le të normalizohet jeta në veri”. Ky është ai fat që të ishte ky mur krejt problemi i veriut.

Është shumë me rëndësi të hiqet muri, por nuk mendoj që jeta do të normalizohet në veri, sepse është shumë më e komplikuar se ai mur për të cilin po ashtu u tha që është ndërtuar për shtatë ditë, e është ndërtuar natën, e është ndërtuar ditën.

Mendoj që ky mur ka filluar të ndërtohet në vitin 2006, kur paria e këtij vendi ka pranuar që vendin ta ndajnë në baza etnike, e që ajo ndarje është quajtur decentralizim. Ndërtimi i këtij muri ka vazhduar në vitin 2011, kur i kemi proklamuar disa bisedime - ata që i kanë përkrahur bisedimet - si bisedime teknike për të kaluar në bisedime kryekëput për çështje të brendshme të Kosovës dhe e kemi faktorizuar Serbinë brenda Kosovës.

Muri, “Lugina e Diellit², strukturat paralele, pengesa e lëvizjes së lirë, dalja nga kontrolli i komunave në veri dhe jo vetëm i atyre në veri, edhe i atyre që janë në këtë pjesën jugore, e që kanë shumicë serbe, pengesat e inkuadrimin të Kosovës në institucione ndërkombëtare, e veprime të tjera antikushtetuese, janë rezultat i dialogut pa kriter Kosovë - Serbi, në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Janë rezultat i moskryerjes së obligimeve ligjore, kushtetuese të Qeverisë së Kosovës, apo më mirë të them të qeverive të Kosovës gjatë këtyre viteve. Janë rezultat i tolerancës së tepruar ndaj komunitetit serb, të cilit asnjëherë nuk i kemi pasur borxh ta privilegjojmë, e të drejtat e barabarta i ka pasur menjëherë pas luftës.

Problemi në veri, dhe jo vetëm në veri, zgjidhet duke i ndërprerë këto bisedime që po çojnë drejt ndarjes së Kosovës me mur e pa mur, edhe pa këtë mur ndarës, nëse vazhdohet kështu për ta faktorizuar Serbinë, dhe në një anë themi se jemi shtet i pavarur, e mandej edhe për çështje të imëta siç është ky mur kërkojmë nga Bashkimi Evropian që të vijë dhe t'i prishë këto mure, atëherë vërtet po e shoh se as vetë nuk e kemi të qartë se cili është statuti ynë, cilat janë obligimet tona, cilat janë detyrat tona dhe çka mund të kërkojmë nga ndërkombëtarët, në këtë rast nga Bashkimi Evropian.

Duke pranuar të negociohet vetëm atëherë kur Serbia ta pranojë pavarësinë e Kosovës, natyrisht që shumë probleme do të zgjidhen. Muri, “Lugina e Diellit”, strukturat paralele dhe shumë shkelje të tjera nuk zhbëhen me deklaratat ofenduese, ose me deklaratat të pavërteta, siç ishin ato të ministres për Dialog, e edhe të kryeministrit Mustafa. Të gjitha këto të këqija zhbëhen vetëm kur Qeveria e Kosovës vepron në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, karshi mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Përveç Qeverisë, një pjesë të mirë të përgjegjësive e bart edhe ky Kuvend, i cili shpeshherë ka kontribuar, herë me marrje të vendimeve, të cilat kanë qenë të dëmshme për këtë vend, e herë duke hezituar që të marrë vendime, të cilat do ta ndihmonin zgjidhjen e këtij problemi. Ju, zoti kryetar i Kuvendit, më herët i propozuat propozuesit të këtij debati që në konkluzione të fusë edhe disa elemente të tjera, e unë dëshiroj të jua përkujtoj që në një interpelancë të ftuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” para një muaji janë kërkuar vetëm këto dy çështje: njëra ka qenë që Qeveria e Kosovës të angazhohet ta pengojë ndërtimin e shtëpive në atë të ashtuquajturën “Lugina e Diellit”, kurse kërkesa tjetër ka qenë që Qeveria e Kosovës të angazhohet t’i ndihmojë shqiptarët e dëbuar nga veriu që t’i ndërtojnë shtëpitë e veta dhe këto dy kërkesa që kanë qenë edhe të drejta, edhe shumë elementare, por nuk janë votuar nga shumica e deputetëve, e që pjesa dërrmuese i takon subjektit që ju e udhëhiqni, por edhe LDK-së.

Për të ardhur deri te ajo që po kërkojmë të gjithë sonte, pra për ta hequr atë mur dhe për të filluar normalizimin e gjendjes në veri, është vetëm një ilaç, e është ndërprerja e bisedimeve me Serbinë, mandej vjen edhe Bashkimi Evropian me ekskavatorë e qysh t’i kërkojmë, edhe e heq murin, edhe i heq shumë pengesa tjera. Derisa Serbia provokon, Serbia destabilizon, Serbia del hapur kundër shtetit të Kosovës dhe ne jemi shumë këmbëngulës t’i vazhdojmë bisedimet me Serbinë, ne po kontribuojmë që të gjitha këto të zeza të na i bëjë Serbia, e ne të rrimë vetëm duke shprehur dëshira e duke vajtuar se çfarë po ndodh me ne nga dikush që jo me vite, jo me muaj, por me shekuj është kundër ekzistencës, jo vetëm të Kosovës si shtet i pavarur, por i ekzistencës së subjektivitetit shqiptar kudo qoftë në Ballkan. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bulliqi, fjala për ju.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

I respektuar ministër,

Kolegë deputetë,

Jemi të vetëdijshëm që problemi i Mitrovicës nuk është problem i ri, është që nga paslufta e deri më sot. E tani, sot gjatë diskutimit tonë shpesh u zu në gojë se kush ka faj më shumë dhe kush ka faj më pak. Unë e them që të gjitha qeveritë nga paslufta, të gjitha në njëfarë forme duhet ta pranojnë një pjesë të fajit të tyre për arsye se asnjëra prej tyre nuk e ka bërë punën në mënyrën më të mirë të duhur, në mënyrë që ne sot të mos ballafaqohemi me gjithë këto probleme, të cilat ekzistojnë në veriun e vendit tonë.

Në Kosovën tonë pasluftës, çdo ditë që kalon po del në sipërfaqe ndonjë temë e re që faktikisht ne duhet ta trajtojmë. Jemi të vetëdijshëm që përkrahja nga ndërkombëtarët për pavarësinë e Kosovës, e ka pasur një çmim. E ai çmim është brenda Pakos së Ahtisarit, sepse në atë pako janë bërë lëshime të mëdha që me të drejtë dikush edhe mund të pyesë nganjëherë nëse e vënë në dyshim ndonjëherë edhe funksionalitetin e shtetit tonë.

Krejt kjo besoj që ka ndodhur jo krejtësisht për shkak të presioneve të ndërkombëtarëve ndaj kosovarëve, por për faktin që Kosova edhe sot e kësaj dite në shumë resorë të vet vazhdon të përfaqësohet nga politikanët dhe negociatorët e dobët që në shumë raste nënshtrohen dhe marrin rolin e servuesve të dëgjueshëm, edhe atëherë kur procesi shkon në dëm të vendit. Vlen të përmendet se të gjithë ne menduam se me Pakon e Ahtisarit janë shterur të gjitha kompromiset e Kosovës ndaj Serbisë. Mirëpo, po duket që kemi gabuar të gjithë për arsye se ndoshta për një pjesë të fajit, edhe falë negociatorëve tonë, të gjithë me radhë po them, që për mendimin tim shpeshherë kanë qenë relativisht të dobët në fusha adekuate, janë nxjerrë edhe një sërë kompromisesh tjera, të cilat vërtet po e dëmtojnë shumë rëndë stabilitetin e vendit.

Këto ditë është aktualizuar muri i Mitrovicës, i cili në realitet doli si kërpudhë pas shiut, ndërsa negociatorët tanë, të prirë nga ministrja, për çdo ditë në diskutimet dhe deklaratat e tyre na flasin për bashkimin e Mitrovicës dhe proceset të cilat realisht po ecin përpara, e në fakt praktika po e tregon të kundërtën.

Sapo u shfaq si çështje muri i Mitrovicës pranë urës, menjëherë negociatorët tanë me grupin e tyre prapë filluan të na bombardojnë me deklarata se ky nuk do të ekzistojë dhe kjo në realitet u tha edhe shumë herë sonte, për çka dua të besoj që do të ndodhë diçka e tillë dhe në një afat të shkurtër kohor do të ketë mundësi që eventualisht ky mur të mënjanohet nga aty. Mirëpo, krejt proceset që po zhvillohen deri në këto momente, edhe nga pala serbe, edhe nga kryetari i Komunës veriore të Mitrovicës, faktikisht po tregojnë dhe po flasin për një proces, i cili nuk është kah shkon në rrugën kah realisht ishte dashur të shkojë.

Bartësit e institucioneve tona po na e bëjnë qefin, edhe qytetarëve të Kosovës po ua bëjnë qefin që do të hiqet ky mur, mirëpo faktikisht ne jemi dëshmitarë të asaj që janë në diskutim variantet e ndryshme, në të cilat variante për fat të keq janë involvuar edhe instanca tjera ndërkombëtare lidhur me mënyrën se si do të hiqet, sa pjesë e këtij muri do të hiqet dhe si do të rivitalizohet çështja e këtij muri në të ardhmen.

Kësisoj, negociatorët tanë për periudha të tëra kohore faktikisht po tregojnë jo një qëndrueshmëri dhe stabilitet me këto negociata, duke lëshuar pe në dëm të shtetit dhe në dëm të qytetarëve të Kosovës. Tash sigurisht që jemi të obliguar ta përmendim çështjen e fusnotës për të cilën na u tha shumë herë që ajo shpejt do të shkrihet, por për fat të keq sot e kësaj dite nuk është shkriur. Na është përmendur lëvizja e lirë, e cila edhe sot e kësaj dite për fat të keq nuk po ndodh, na është përmendur çështja e njohjes së targave, edhe kjo çështje faktikisht nuk ka ndodhur, edhe shumë prej këtyre premtimeve që na janë dhënë deri tash dhe të cilat eventualisht edhe janë shkruar në letër, faktikisht asnjëra prej tyre nuk është bërë praktike në terren.

Sigurisht që një prej këtyre lëshimeve dhe koncesioneve të mëdha që janë bërë është edhe çështja e marrëveshjes për asociacionin, e cila në fillim na është servuar si një organizatë joqeveritare,

pa kompetenca, ndërsa më vonë, kur faktikisht çështja shkoi deri në nivelin e Gjykatës Kushtetuese, ajo e verifikoi se këtu vërtet kemi më se 20 pika të ndryshme, të cilat faktikisht e kanë prekur frymën kushtetuese dhe shkelin frymën kushtetuese të Kosovës.

Ndërsa, faktikisht, negociatorët tanë, ata të cilët kanë nënshkruar, gjithmonë na kanë thënë që nuk ka asnjë problem dhe, faktikisht e praktikisht, Kosovës nuk do t'i bëhet dhe nuk do t'i shkaktohet asnjë problem me këto marrëveshje. Unë mendoj që krejt këto lëshime, të cilat janë bërë në këto procese, një pjesë relativisht e madhe të dëmit janë duke e shkaktuar vetë negociatorët, të cilët faktikisht po marrin ose po pranojnë poste të ndryshme ministrore dhe poste të ndryshme negociatore për të lejuar që interesi i shtetit të dëmtohet dhe sigurisht që po bëhen nganjëherë edhe koncesione të dëmshme në tavolinën e bisedimeve, të cilat sigurisht që do t'u kushtojnë relativisht shumë gjeneratave të ardhshme dhe do të shkojnë të gjitha këto në drejtim të dëmit që do t'i shkaktohet Kosovës.

Mendoj se sa më shumë që personat e tillë të qëndrojnë në këto pozita ministrore, faktikisht edhe në pozicionet e negociatorëve, Kosova do të vazhdojë të dëmtohet në të gjitha fushat dhe me të vërtetë do ta vërë në pikëpyetje funksionalitetin e shtetit. Nëse sot liderët tanë institucionalë mendojnë që çështjet madhore për vendin dhe integritetin territorial do ta mbrojnë me duartrokitje frenetike nëpër tubimet a përvjetorët me qëllim që të krijojnë huti në opinionin publik dhe qytetarët e Kosovës, atëherë e kanë shumë gabim, sepse po qe se vazhdohet kështu nuk do të jetë çudi që nesër të dalin dhe të thonë se këtë mur na e kanë përcaktuar të tjerët dhe duhet të thonë se këtu është ose mund të jetë kufiri i ardhshëm i Kosovës me shtetin fqinj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Bulliqi! Qysh po e shoh, Kryesia e Kuvendit e ka një konsultim për t'ua ndal mëditjet kolegëve deputetë, të cilët nuk janë në seancë duke marrë pjesë deri në përfundim. Kështu që u ndalet mëditja kolegëve deputetë që nuk janë në seancë. Kështu, le të kthehen para se t'u ndalen.

Jo, e kemi seriozisht, le të kthehen, e në fund ua japim mëditjet. Nga kolegët e "Vetëvendosjes", Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

U bënë pesë orë prej kur po debatojmë, e po diskutojmë, ku ndër të tjera u thanë shumë të vërteta, mirëpo edhe të pavërteta.

Unë po i referohem diskutimit të Kadri Veselit, i cili ndër të tjera tha se duhet të punojmë që të sigurojmë apo ta bëjmë një shëndetësi apo sistem shëndetësor të fortë. Unë i bëj pyetje Kadri Veselit: Pse nuk lejoi që në qershor të vitit '99, punëtorët shëndetësorë të kthehen në vendet e

tyre të punës? Unë e di se ju e dini që bashkë me Hashim Thaçin jeni njëri ndër personat, të cilët i keni penguar punëtorët shëndetësorë, po ashtu i keni penguar edhe qytetarët e Mitrovicës që të kthehen në vendin e tyre, apo në shtëpitë e tyre.

Derisa atëherë nuk ju kam njohur se kush jeni, e kam njohur vetëm Hashim Thaçin, më vonë e kam parë nëpër video, të cilat janë dëshmi që janë të incizuara dhe ku shiheni ju aty, kur u thoni qytetarëve se shumë shpejt ju do të ktheheni në vendet tuaja të punës, apo do të ktheheni në shtëpitë e juaja. Derisa më parë, atëherë u kanë besuar qytetarët, u bënë 17 vjet ata nuk janë në shtëpitë e tyre dhe nuk janë vendet e tyre të punës.

E si t'u besojnë tash kur ata që e kanë ndarë tani do ta bashkojnë Mitrovicën, prandaj qytetarët tanimë e kanë shumë të ditur se ju që e keni ndarë Mitrovicën, ju që qeverisni tani nuk mund ta bashkoni kurrë atë.

Po ashtu, edhe Bekim Haxhiu tha se te ura e Mitrovicës, tash rruga "Kralj Petar" a s'di si e ka emrin ajo rrugë, se nuk jam prej asaj pjese, që është duke e penguar tani qeverisja, apo Agim Bahtiri. Pikërisht në këtë rrugë ju i keni penguar punëtorët shëndetësorë që të shkojnë në Spitalin Regjional të Mitrovicës. Unë po kërkoj përgjigje nga ju pse e keni bërë një gjë të tillë, e tani këtu kinse jeni ju ai që ju do të punoni për bashkimin e Mitrovicës. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja deputete, detyra partiake e ekzekutuar, keni qenë aksioniste, po pasi s'po e di Mitrovicën, por do të përgjigjem nga fundi, të përgjigjem ngadalë, por veç e the publikisht që unë e kam ndarë Mitrovicën. Dhe, ti a je e bindur, edhe njëherë ta jap fjalën, se unë e kam ndarë Mitrovicën? Vetëm, të lutem, që publikisht ta thuash edhe një herë, se po kam dëshirë dhe edhe vëmendje e mediave se unë e kam ndarë Mitrovicën?! Urdhëroni!

BESA BAFTIJA: Jeni njëri ndër përgjegjësit. Këtë na e kanë thënë edhe kolegët tanë mjekë, të cilët i kemi vizituar. Jeni ndër përgjegjësit që keni penguar...

KRYETARI: Zonja deputete, mos eskivo, por bëhu e sinqertë se je femër shqiptare. Unë e kam ndarë Mitrovicën, e the.

BESA BAFTIJA: Jeni përgjegjës...!

KRYETARI: Cili doktor ta ka thënë, mos të vë në situatë për ta turpëruar vetveten!

BESA BAFTIJA: Janë incizimet, janë videot ku shihen...

KRYETARI: Cili doktor? Propagandë e shërbimeve të huaja, a? Cili doktor ta ka thënë, fol! Pasi po i njeh aq mirë.

BESA BAFTIJA: Janë publike videot në YouTube ku shiheni ju me Hashim Thaçin kur i pengoni punëtorët shëndetësorë që të shkojnë në vendet e tyre të punës dhe pikërisht ju thoni që shumë shpejt do të shkoni në vendet tuaja të punës.

Janë bërë 17 vjet ata nuk janë kthyer. Kjo është evidente, këtë e dinë të gjithë.

KRYETARI: Kush ka qenë në incizim? Cilin e ke parë? Cili ka qenë publik, kanë qenë të gjitha televizionet, se ju po mendoni se krejt më '99, në botën e teknologjisë moderne, kur kanë qenë të gjitha kamerat ndërkombëtare dhe televizionet ato të cilat kanë mundur të jenë, edhe shqiptare. Ju po flisni për spekulativ në qershorin e viti '99, kur ka qenë publike?

Ju lutem, partia të ka mësuar mirë! Albin, e do fjalën ti, pasi e paske mësuar kaq mirë! Unë e paskam ndarë Mitrovicën! Fol publikisht!

BESA BAFTIJA: Jeni përgjegjës!

KRYETARI: Fol publikisht, mos u frikëso! Urdhëroni, në qoftë se dëshironi! Mos e futni ashtu në kurth kolegen deputete, flisni cili të doni. Merrni përgjegjësi, “unë e kam ndarë Mitrovicën”.

Ju, pasi luftëtarët e paepur të bashkimit kombëtar, Visar Ymeri fjala për ju.

VISAR YMERI: Lëre deputeten të flasë, mos i ndërhyj në fjalë. Nëse do pastaj të replikash, ja ku është foltorja, dil e repliko. Mos e keqpërdor pozitën, të kam thënë 100 herë!

KRYETARI: Ooo, komandant i fortë je ti! Veç të është prishur frizura pak. Të lutem, e do fjalën? Besa e përfundoi, tha “s’po dua”. Po mos e komandoni njeriun dhe mos abuzoni me deputetët. Urdhëroni, zonja Besa Baftija, vëmendja është për ju, ju kisha lutur për transmetim televiziv, se Shukri Buja tha po e ndal e po e lëshoj transmetimin televiziv.

BESA BAFTIJA: Jo vetëm tani, por ju edhe pak më parë bëtë padrejtësi kur koleges sime Albulena Haxhiu nuk ia dhatë fjalën, ndërsa kolegut tuaj të subjektit tuaj po. Kjo është një padrejtësi, ndonëse po mundoheni që të paraqiteni kinse ju e jepni fjalën apo jeni shumë më liberal, mirëpo po vjen momenti kur ju po e tregoni fytyrën e vërtetë.

Prandaj, edhe një herë po them po e lidh me temën ku e kemi diskutimin, që të mos dal jashtë saj - Partia Demokratike është përgjegjëse për atë që ka ndodhur në Mitrovicë.

KRYETARI: Jo, jo partia! Të lutem, publikisht. The: Kadri Veseli e ka ndarë Mitrovicën. A është e vërtetë?

BESA BAFTIJA: Ju jeni përgjegjës, po!

KRYETARI: E kam ndarë Mitrovicën!

BESA BAFTIU: Po!

KRYETARI: Edhe ti do ta bashkosh?! Bekim Haxhiu, mjaft sot replika. A shkojmë më tutje, të lutem! Po ajo vetë po thotë se as nuk e di çka është Mitrovica, s'jam nga andej. Çka ke për t'u përgjigjur, Bekim?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

E nderuar Besa Baftija, vërtet po më dhimbseni. Po më dhimbseni për pozicionin që ju kanë vënë tutorët tuaj që të akuzosh. Atëherë më '99 problemi paska qenë ndërmjet Kadri Veselit, Hashim Thaçit, Bekim Haxhiut, se këta i paskan penguar, do të thotë u paskan bërë problem doktorëve atje.

Në kohën e grekëve, përveç tradhtisë edhe mosmirënjohja ka qenë e ndëshkueshme. Unë jam arrestuar, Besë, me doktorët në pjesën veriore nga KFOR-i dhe jam larguar në pjesën jugore, dhe këta që kanë bërë "machiato" në Londër nuk i dinë këto probleme, vetëm të futin në to. Ruaje nivelin dhe respektin që e ke. Ruaje këtë nivel! Mos i dëgjo këta!

KRYETARI: Së pari e vazhdojmë debatin, por shpeshherë në këtë Kuvend as nuk dihet çka flitet. Lëshohet fjala si ta lëshosh... ruana Zot!

Kush e dëshiron fjalën tash? Lëvizja "Vetëvendosje" prapë, Driton Çausi e ka fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të pranishëm,

Me gjithë rëndësinë që çështja të cilën po e trajtojmë, ajo që po shpërfaqet pas të gjithë këtyre orëve është shumë e qartë se fatkeqësisht e kemi një Ekzekutiv të paaftë për ta trajtuar këtë çështje dhe për të gjetur zgjidhje, por mbi të gjitha është transmetim i Kuvendit të Kosovës dhe duket shumë qartë që gjithashtu kemi edhe një Kuvend totalisht joefektiv në trajtimin e kësaj çështjeje, dhe këtu e kam fjalën në radhë të parë për deputetët e koalicionit qeverisës, të cilët, nuk e njeh përkatësinë politike dhe partiake të tyre, tingëllojnë shumë të avancuar në ndalimin e kësaj që po ndodh në Mitrovicë dhe është tepër hipokrizi e madhe kur shohim deputetët e Partisë Demokratike që kërkojnë përgjegjësi nga kryetari i partisë së tyre për ndërhyrjen në veri dhe zgjidhjen e çështjes, si dhe largimin e murit.

Ministrja Tahiri kërkoi fakte për ta demantuar atë që është arritur me negociatën, kurse njëra prej arritjeve që e përmendi tha se është ndaluar poshtërimi i institucioneve të Republikës së Kosovës

në veri. Unë nuk di cili është, si mund të ketë poshtërim më të madh se sa kur zëvendëskryeministri dhe kryeministri nuk guxojnë të qarkullojnë të lirë, të lëvizin të lirë në veri. Pra, ky mund të jetë një fakt që mund ta trajtoni, zonja ministre.

Kurse kryetari i Kuvendit tha disa herë se ky mur do të rrëzohet në një kohë të caktuar dhe nëse nuk rrëzohet në një kohë të caktuar, atëherë do ta rrëzojmë ne. Ky është ofendimi dhe tallja më e madhe që bëhet me qytetarët, duke përdorur këso fjalish të pakuptimta, duke i trajtuar qytetarët si analfabetë kur thua “do të trajtohet”, ose “do të rrëzohet në një kohë të caktuar”. Çfarë kuptimi ka kjo, përpos një shmangie e përgjegjësisë dhe tallje me qytetarin.

Ndërsa sa i takon kryeministrin Mustafa, ai disa herë tha se janë hequr barrikatat, e thanë shumë deputetë, nuk dua të zgjatem tani që vetë parku i cili është planifikuar përtej atij muri është qartë barrikadë dhe këtu përgjegjësi nuk mund të kërkojmë prej autoriteteve lokale të pjesës jugore të Mitrovicës. Pra, përgjegjësia duhet të jepet nga kryeministri, nga koalicioni qeverisës, pse është lejuar një gjë e tillë, pse është lejuar bllokimi i lëvizjes së automjeteve përtej urës.

Gjithashtu, unë nuk di se si kryeministri mund të mburret me arritjet gjatë këtyre negociatave, kur ai nuk lejohet të kalojë andej përderisa një zyrtar serb futet në Kosovë dhe përruron koloni serbe. Ju kujtoj, më 10 qershor ka filluar ndërtimi i të ashtuquajturës “Lugina e Diellit”, e më 29 shtator e kemi pasur një debat këtu në Kuvend dhe ende nuk kemi asnjë veprim, përtej të gjitha premtimeve ajo vazhdon duke u ndërtuar dhe ajo që kërkohet janë banorët e rinj që do të sillen nga Serbia për të banuar në këto ndërtesa.

Kur zyrtari i ashtuquajtur drejtor i Zyrës për Kosovësn, Gjuriq, erdhi në Mitrovicën e veriut, Ministria e Jashtme e lëshoi një deklaratë, është mirë që ministri është këtu, dhe e trajtoi si një përpjekje të dëshpëruar në karrierën politike të zotit Gjuriq futjen e tij në Republikën e Kosovës në veri. Po, si mund të jetë përpjekje e dëshpëruar kur ai futet i lirë, edhe pse e ka formalisht të ndaluar, dhe përruron pika, pompa të benzinës, të cilat janë pronë ruso-serbe, është kompani publike serbe dhe i përruron ato në territorin e Republikës së Kosovës.

Si mund të jetë kjo përpjekje e dëshpëruar e të mos e trajtojmë të tillë përpjekjen e kryeministrin që nëpër rrugë malore të lëvizë në veriun e Kosovës. Unë e kam të qartë që kjo Qeveri dhe ky kryeministër në asnjë mënyrë nuk mund të jenë pjesë e zgjidhjes së këtij problemi, pra një njeri i cili është në gjendje që për mbijetesën e tij politike ta degradojë dhe ta dështojë një kryeqytet, e i cili është i njëjti njeri që nënshkruan marrëveshje, siç është ajo për “Zajednicën”, natyrisht që për mbijetesë politike, për të njëjtin motiv, do të jetë i gatshëm të rrënojë çfarëdo lloji të sovranitetit dhe të mirëqenies, e të zhvillimit ekonomik që mund të ketë Republika e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Kanë mbetur edhe tre nga opozita, do të shkojmë me Lahi Brahimaj, ndërkohë përgatitet Visar Ymeri.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht desha të falënderoj për fjalimin aq të mirë, por sigurisht që nuk do duhej të drejtohesh nga ne, por nga ata që i kishe në shpinë, nga kryeministri i cili iku dhe ministrja për Dialog.

Muri i Mitrovicës, jo vetëm që është ndarje, por do të sjellë edhe shumë urrejtje. Kur prishen sheshe me emra të luftëtarëve të UÇK-së, siç ishte edhe ai me emrin e komandantit legjendar Adem Jashari në Mitrovicë, në shtator të këtij viti, sigurisht që edhe serbëve u japin frymëzim që t'i ndërtojnë edhe këto mure.

Historikisht kur Kosova ka qenë në teh të shpatës, në krye të saj kanë ekzistuar njerëz si puna e kësaj qeverie. Kosova edhe në ditët më të vështira të saj ka qenë më mirë dhe më unike sesa është sot. Në arsyetim se po e hiqni një pikë ndarëse në Mitrovicë dhe duke rivitalizuar urën e Ibrit, ju nuk bëtë asgjë më shumë sesa vetëm zhvendosjen e kësaj pike ndarëse. Pra, një herë me ura, tash po lejoni që qyteti i Mitrovicës të ndahet me mure dhe ju, siç zakonisht dini të bëni, lëshoni vetëm deklaratat të forta, por veprimet tuaja janë prej një kikirezi, të cilit as zëri nuk i shkon dhe iku edhe tani nga salla, e lëre më të bëjë diçka më tepër.

Ne çka po kërkojmë nga ju Qeveri e Kosovës është që ta sqaroni për publikun nëse ky mur ka qenë si pjesë e një marrëveshjeje për rivitalizimin e urës, sepse i kemi disa deklaratat që e demantojnë njëra-tjetrën, duke filluar nga zëdhënësja Mogerini që thotë se ura duhet ta ketë një dizajn të kënaqshëm për të dyja palët. Nuk e dimë çka nënkupton kjo!

Pastaj, deklaratat e Qeverisë se muri është pjesë e një marrëveshjeje, herë duke thënë se do të hiqet, e herë duke thënë se do të pritet, pastaj kryetari i Komunës së Mitrovicës të pjesës jugore, i cili duke u habitur krejtësisht tha se muri mbiu sikur kërpuçka pas shiut. Pastaj, deklarata e kryebanditit të pjesës veriore, Rakiq, i cili thotë se nuk do të hiqet ky mur, dhe se për këtë janë në dijeni edhe Qeveria e Prishtinës, edhe BE-ja. Këtu ose ka shumë të vërteta që janë fshehur për publikun, ose vërtet ju si Qeveri jeni të mjerë, të frikësuar dhe të paguximshëm për të qenë të zotë për shtëpinë e juaj, e mozomakeq që i keni rënë hise këtij vendi.

Ju nëpërmjet një marrëveshjeje të rivitalizimit të urës vetëm sa e keni thëlluar ndarjen e Mitrovicës duke lejuar që të ngrihet një mur prej betoni, që gati dhjetë vjet pasi ju dy partitë keni ardhur në pushtet, në këtë pjesë të Kosovës ka vetëm gjemba, barrikada, mure, kontrabandë, krim të organizuar dhe struktura paralele, që tash i sollët edhe në institucionet e Kosovës. Pra, qytetarët në atë pjesë, pa marrë parasysh cilit komuniteti i takojnë, kanë qenë në duart e disa strukturave për të cilat edhe ju keni qenë në dijeni, por nuk keni pasur muskuj për ta çliruar njëherë e mirë nga këto dukuri, e për ta bërë këtë pjesë të Kosovës të jetueshme për të gjithë që jetojnë atje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Visar Ymeri e ka fjalën, dhe pastaj Mytaheri.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Mbiemri im i ka pesë shkronja: Y-M-E-R-I. Kadri Veseli që dy vjet s'mund t'ua qëllojë vetëm katrave, njërën gjithmonë e bën I, të parën. S'po mund ta kuptoj këtë, prej pesë shkronjave katra i lexon qysh duhet, e një e huq, paramendo më shumë!

Por jo, problemi është më i madh. Problemi është këtu kjo videoja për të cilën foli deputetja Baftija është publike, është shpërndarë, me sa më kujtohet mua në portalin "Zëri", dhe pastaj nëpër kanalet tjera. Aty shihen shumë qartë edhe Hashim Thaçi edhe Kadri Veseli me disa ushtarë francezë që u dalin në ballë protestave të organizuara në Mitrovicë dhe u thonë "shkoni nëpër shtëpi" dhe pastaj "do të vijë shumë shpejt koha kur ju do të shkoni nëpër vendet tuaja të punës".

Pra, kjo është publike, nuk mund ta fshihni. Ju mund të reagoni qysh të doni, po nuk mund ta fshihni dhe ky reagimi yt në fakt nuk po më çudit, sepse natyrisht për njerëzit si ti e vërteta dhemb. Po, çka më çuditi ishte reagimi i deputetit Haxhiu, i cili për mua, të paktën e lexova si simptomatik, se a dëgjuat me vëmendje çfarë tha? Bekim Haxhiu tha kështu, mes tjerash e kërcënoi pra Besa Baftiun se tha "mosmirënjohja tha është e ndëshkueshme", por nuk kallëzoi si do ta ndëshkojë, si mendon ky ta ndëshkojë këtë mosmirënjohje, mirëpo tha unë tha "kam qenë i arrestuar në veri me mjekët dhe pastaj jam bartur këtu". Por, nuk tha kurrëgjë për Kadriun dhe Hashimin. Për këta tha, "po ashtu është, por unë s'kam qenë aty, se këta të dy po".

Që i bie praktikisht se domethënë paska qenë e vërtetë, edhe ky e di sigurisht. Ka mundësi ky të mos ketë qenë, nuk po dyshoj aty. Por, unë e kam vërejtur një gjë, ju të SHIK-ut ishit kështu, si po e shihnit anijen duke u fundosur, ju njëri-tjetrin po e gjuanit, domethënë po e flaknit tutje veç për të shpëtuar vetë.

Këtu e dëgjuam disa herë që muri është i paligjshëm. U tha edhe nga përfaqësuesit e Qeverisë - Ekzekutivit, edhe nga disa deputetë të koalicionit qeverisës, dhe kjo po dakord, domethënë është në kundërshtim me Ligjet e planifikimit hapësinor e kështu me radhë. Mirëpo, çka na duhet neve ky konstatim, për këtë debat po flas. Në debatin që po e zhvillojmë në Kuvend për murin, konstatimi që muri është i paligjshëm çfarë pune kryen? Sepse që muri është i paligjshëm është konstatuar që në fillim kur është ndërtuar ai, apo jo?

Pra, çka i bie tash që ne të mblidhemi këtu si deputetë, të flasim se si muri është i paligjshëm dhe të dakordohemi bashkë për një datë kur do ta rrëzojmë atë, pak a shumë siç u tha nga një numër i madh i deputetëve këtu, një afatizim i ditës kur do të duhej të largohej muri, që i bie praktikisht Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të mblidhet dhe të diskutojë bashkë me Qeverinë për ta vendosur datën kur do të fillojmë ta zbatojmë ligjin.

A po e shihni kështu, e përmbledhur, sa absurde tingëllon kjo që e kemi thënë deri tash, të shkapërderdhur nëpër fjalime të ndryshme dhe në anën tjetër, u tha këtu që ne nuk mund të bëjmë asgjë, nuk duhet të drejtojmë gishta, faji qenka i të gjithëve, kujt më shumë e kujt më pak, por duhet të kërkojmë dy gjëra. Pra, në njërin anë nga BE-ja që ta rrëzojë këtë mur dhe në anën tjetër, u tha po ashtu që Serbia nuk do të pranohet kurrë në BE, nëse nuk e njeh Kosovën.

Pra, ne këtu si Kuvend po flasim se si ne Qeverisë sonë s'mund t'i themi asgjë, nuk mund ta detyrojmë Qeverinë tonë, të cilën e ka zgjedhur ky Kuvend, Qeverinë e Republikës së Kosovës, nuk mund, madje, as ta nxisim atë që ta zbatojë ligjin, por mund ta kontrollojmë se çfarë të bëjë BE-ja me murin edhe me Serbinë. Pra, gjëra që absolutisht nuk i kemi në kontroll, ne kërkojmë t'i shndërrojmë në vendime të Kuvendit e ato që i kemi në kontroll themi t'i lëmë për një ditë tjetër, ose të mos i përdorim fare. Por, prapë edhe në këtë nivel, mendoj që ky debat është absurd, sepse po, këtu të gjithë thanë që muri është i paligjshme dhe duhet rrëzuar.

Unë vërtet e pash një pajtueshmëri të të gjitha grupeve parlamentare, deputetëve që kanë folur edhe të përfaqësuesve të Qeverisë që kanë folur, të cilët thanë që ky mur duhet të zhduket. Ku është problemi atëherë? Pse kaluan kaq ditë e ky mur nuk u rrëzua, meqenëse të gjithë e paskemi mendimin e njëjtë, pra edhe ekzekutivi edhe legjislativi, pse paska pasur nevojë për këtë seancë të Kuvendit, meqenëse muri, po pajtohemi të gjithë, po u dashka të rrëzohet dhe pse nuk po rrëzohet? Po, kjo është pyetje interesante në këtë konstalacion, sepse unë këtu nuk e dëgjova askënd që e mbron murin, ose që thotë se ai duhet të qëndrojë atje.

Pra, deputetët e Listës serbe nuk janë këtu dhe rrjedhimisht kurrkush nuk e tha këtë. Pse atëherë, muri nuk është rrëzuar ende? Edhe çka duhet të ndodhë, edhe çka duhet të presim, që ligji të fillojë të zbatohet në territorin e Republikës së Kosovës? Kjo është një pyetje, s'qenka këtu, vetëm dy ministra qenkan, por jo edhe kryeministri, të cilën do të duhej ta kthenin përgjigje këta përfaqësuesit e Qeverisë, të cilët janë këtu për t'i ekzekutuar ligjet dhe vendimet që i nxjerr ky Kuvend.

Po, unë e kam edhe një pyetje tjetër edhe për deputetë dhe për të gjithë të tjerët. Po çka, kur të rrëzohet muri, se hajde po e zëmë që muri do të rrëzohet një ditë, pra u dhanë zotime këtu, edhe kryetari i Kuvendit e tha, edhe kryeministri e tha, edhe të tjerët e thanë, edhe deputetët kërkuan, edhe po, po u rrëzuaka muri. E pastaj, çka? A do ta lëmë, më nuk do të diskutojmë për veriun? Do të konsiderojmë që me këtë problemi i veriut u zgjodh dhe rrjedhimisht, nuk kemi më nevojë të merremi me atë punë dhe të vazhdojmë jetën tutje? Sepse, nëse ne nuk e njohim faktin, që muri të cilin po e shohim sot në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës është vetëm mur objektiv, që shihet, po ka edhe shumë mure të tjera politike atje, të cilët nuk shihen e të cilët duhet rrënuar.

Pra, nëse kjo nuk është qëllim i këtij Kuvendi dhe i shtetit, ose Republikës, atëherë kot po flasim për këtë murin që po e shohim, se atë edhe mund të mos shohim nesër, por prapë mure të tjera të

padukshme atje, do të jenë të përhershme, nëse ne nuk veprojmë si shtet, si Republikë. Pra, cilat mure? Se, këtu është problemi që nuk po duan t'i shohin ato të tjerat, jo që ato nuk ekzistojnë, se po të kishte qenë që i shohim ato mure e po të kishim pasur diskutim këtu në Kuvend, që ta gjejmë modalitetin e rrënimin të tyre, ky diskutim do të kishte pasur kuptim. Po këtu, nga ministrja për dialog, nga Qeveria, e që besa edhe nga një numër i koalicionit qeverisës, deputetëve të koalicionit qeverisës, këto mure mohohet se ekzistojnë. Këtu edhe është problemi! Për shembull, muri në telekomunikacion, me marrëveshjen për telekomunikacion. A nuk është ky mur, a nuk është ky legalizim i ndërhyrjes së deritashme ilegale të Serbisë në Kosovë? A nuk është ky rast i paprecedent kur prona publike në Kosovë i jepet një kompanie serbe dhe kështu hapet një derë jashtëzakonisht e rëndësishme e plotësimin të pjesshëm të kërkesave të Serbisë, për sa i përket pronës në Kosovë? A nuk është edhe një mur tjetër që po ndërtohet, që e ndalë sovranizimin e Kosovës në fushën e telekomunikacionit me kodin gjeografik, që e ka pranuar Qeveria, ose në energjetikë për shembull, a nuk është muri në energjetikë sot pengesa kryesore pse Kosova nuk mund të realizojë të mirën e unifikimit të dy sistemeve elektroenergjetike përmes ndërtimit të infrastrukturës për të, të lidhjes së konjeksionit të lartë me Shqipërinë? A nuk është pengesa nga Serbia, që rrjedhë nga marrëveshja për energjetikë, pengesa kryesore në këtë drejtim dhe a nuk e kishim të ashtuquajtur e Hashim Thaçi thoshte fajet i ka Shqipëria e jo Serbia? Pra, edhe ky është mur!

Këto mure si do t'i rrënojmë? Ose, më mirë thënë, a keni vullnet me i rrënuar këto mure? Se, po e patët vullnetin me i rrënuar këto mure, ky tjetri rrënohet shumë më lehtë, besomëni! Natyrisht, se nuk po dua me e mbrojt këtë mur, natyrisht se nuk po them që ky nuk duhet rrënuar, ky duhet rrënuar domosdoshmërisht, por rrënimin nuk është i plotë, nëse nuk rrënohen të tjerët, nëse nuk integrohet i tërë territori i Kosovës në një funksion unik institucional, legjislativ dhe të gjyqësorit. Dhe, kjo nuk po ndodhë, madje ka pasur tendencë me e shpërbë këtë në pafundësi, në pa kthim, më falni, me marrëveshjen për "Zajednicën", e cila falë gazit lotsjellës këtu, u ndal, se përndryshe do të ishte realitet sot. Ju e dini të gjithë, janë marrë vesh në Bruksel, që ajo të ekzistojë prej 25 dhjetorit të vitit 2015. Sot do të flisnim për njëvjeçarin e "Zajednicës" këtu, po falë gazit lotsjellës nuk po flitet për atë njëvjeçar edhe mirë që nuk po flitet.

Janë dy leva që Kosova i ka kushtëzime karshi Serbisë. Këtë duhet ta kemi parasysh dhe ta përdorim. E para është, dialogu me Serbinë, sepse dialogu me Serbinë ka rezultuar të jetë jo vetëm i dobishëm për Serbinë, por edhe i nevojshëm për Serbinë në rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian. Pra, Serbia e Daçiqit dhe Vuçiqit kishte nevojë të paraqitej kinse nuk ka probleme me fqinjët, "ja, me Kosovën po dialogojmë"... Rrjedhimisht, rrugëtimi drejt Bashkimit Evropian duhet të jetë i garantuar dhe ky dialog ia mundësoi atë. Pra, po të mos e pranoni dialogun kështu do ta kushtëzonim Serbinë. Dhe e dyta, që po përmendet shumë më rrallë, është tregtia me Serbinë. Sa para i merr të gatshme Serbia përmes tregtisë së mallrave nga Kosova?

Për ato katër javë, që u bllokuan mallrat e Serbisë këtu, ju kujtohet në vitin 2011, a e keni parë çfarë reagimi kanë pasur zyrtarët e Serbisë ndaj bllokadës së mallrave që futen këtu në Kosovë? Pra, a e keni pa se çfarë fuqi ka Kosova karshi Serbisë? Tash, mospërdorimi i levave kushtëzuese kur i ke, nuk...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Bekim, të kisha kërkuar... jo, jo, të vazhdojmë seancën, se edhe kështu... mua dhjetë herë ma kanë përmendur, në fund një herë ishalla më lënë veç dy minuta, tre... kisha pasur dëshirë edhe unë... Kujt ia përmendi emrin? Do t'ua jap kundër-replikën.

Atëherë shkojmë më tutje. Bekim, të lutem veç shkurt, se po më vjen keq, se po ua ndali pastaj... duke qenë kryetar i Partisë, po më vjen keq, po të lutem mos...

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Është e drejtë me Rregullore dhe nuk e pata dëshirën, po vërtet po më vjen shumë mirë që Visar Ymeri doli nga ajo gëzhoja e tij dhe e tregoi, që ky është ai tutori, më erdhi shumë mirë kjo.

Po dua ta sqaroj atë që e thashë. E thash, që në të kaluarën në Greqinë e vjetër, përveç tradhtisë ka qenë e ndëshkueshme edhe mosmirënjohja. Këtë e thash, si virtyt edhe i Visar Ymerit, domethënë si mosmirënjohës i lirisë që e ka. Më vjen mirë, që jam i atakuar prej Visar Ymerit sot, sepse kontributin tim në Mitrovicë e njohin qytetarët dhe kjo e pengon Visar Ymerin.

Visar Ymerin e kemi dëgjuar duke përmendur SHIK-un me mijëra herë, por Visar Ymerin kurrë s'e kemi dëgjuar duke përmendur funksionimin e BIA-s në veri dhe në Kosovë. S'e pengon BIA Visar Ymerin, shërbimi inteligjent serb nuk e pengon këtë milingonë të tyre, nuk e pengon ajo. Këtë e pengojnë njerëzit që kanë punuar për Mitrovicën dhe ky prandaj merret me këto incizime, ç'incizime, deklarime publike, për njerëzit që janë të përkushtuar për vendin. Por, ky nuk e ka atë hall. Kjo milingonë nuk e ka atë hall.

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar, a ta përmendur emrin që po kërkon replikë. Atëherë, nuk ka replikë. Glauk, urdhëro, merre fjalën, merre se duhet me tu protokollua.

GLAUK KONJUFCA: Jepja Hajdar Beqës e të gjithëve, se ua ka përmendur SHIK-un, si t'ua përmendësh SHIK-un këta kërcejnë përpjetë.

KRYETARI: A po të pengon më shumë SHIK-u a Serbia, Glauk? A UDB-a a SHIK-u...

GLAUK KONJUFCA: Jo, po më pengon, që ju eksponentët e SHIK-ut, së bashku me qatë BIA-n, që po e përmend, kanë qenë bashkë,...

KRYETARI: Bashkë, a?... Kanë bashkëpunua a?...

GLAUK KONJUFCA: Jo, kanë bashkëjetuar, ka qenë njëfarë martese...

KRYETARI: A të ka kallëzua dikush ty, ndonjë tezak, a ndonjë...

GLAUK KONJUFCA: Dëgjo veç pak, shiko nuk ke nevojë me qenë...

KRYETARI: Kush të ka tregua ty? Ndonjë tezak, a ndonjë.... e din ti...

GLAUK KONJUFCA: Shiko, nuk ke nevojë të jesh...

KRYETARI: Po, kush të ka treguar ty?... Fol, se fole publikisht...

GLAUK KONJUFCA: Nuk ka nevojë të jesh inteligjent sa ti, për me e marrë vesh që kjo ka qenë një realitet, në të cilin kanë...

KRYETARI: Ama, kush të ka treguar?

GLAUK KONJUFCA: S'ka more nevojë të tregoj, ne jetojmë këtu, kush...

KRYETARI: Ah, se ti je i mençëm, e ke zbuluar...

GLAUK KONJUFCA: S'ke nevojë as me më tregua, as ku e kam pa në televizor, as ku e kam dëgjua në radio, këtu kemi jetuar, ne këtu e dimë që Mitrovica është ndarë për shkak se... edhe strukturat e juaja e kanë kontrolluar atje. Strukturat e juaja, tu e pa njëra tjetrën, me krimin e organizuar atje kanë bashkëjetuar. Kjo është e vërteta e Mitrovicës.

E tash, njeri qohet këtu e akuzon Lëvizjen “Vetëvendosje” njeriu, i cili për shkak se kryetari juaj ka qenë atje, kryetar në Mitrovicë, blen tituj për vete, personal, blen tituj “qytetar nderi” e këso farë hajgaresh. E këtu, njeriu që blen tituj e akuzon “Vetëvendosjen” e i shet moral!

KRYETARI: Kush ka blerë tituj, kallëzona...

GLAUK KONJUFCA: Ai që foli më herët.

KRYETARI: Çka ka ble? Vallahi, keni për ta zbuluar ju shpejt edhe një komb të ri. Mjaft, mjaft, tash po shkojmë, po veç më specifik, se po më pëlqen kjo gjuha e komunikimit... Hajdar, një minutë, se pasi është ora 10 e gjysmë, s'kemi kohë.

HAJDAR BEQA: Kryetar!

Unë nuk desha të them diçka tjetër, përveç asaj që koalicioni “Vetëvendosje” dhe AKR janë në Mitrovicë, ku kanë pranuar që muri i ndarjes, muri i turpër, të ridizajnohet. Ne të gjithë këtu thamë, edhe deputetët e “Vetëvendosjes” e thanë, që nuk pranohet asnjë ridizajnim. Kurse, kryetarin me të cilin këta kanë marrëveshje dhe kanë koalicion në Mitrovicë e ka pranuar një gjë të tillë. Këtë marrëveshje në mes Agim Bahtirit dhe Goran Rakiqit e konfirmon edhe zyra e BE-së në një deklaratë të datës 9 dhjetor, ku thuhet se muri do të ridizajnohet në formë të shkallës me 80 cm lartësi.

Të njëjtën e konfirmon edhe Agim Bahtiri në emisionin info-magazinë të Klan-Kosovës, më datë 9 dhjetor, po ashtu edhe Goran Rakiqi. Pra, “Vetëvendosja” patriotike, në thonjëza, folklorike, patriotë të vonuar, se këta edhe ato video që janë publike i kanë pa prej diasporë, e kanë pasur moshën edhe Glauku edhe Visari për ta mbrojtur edhe Mitrovicën edhe Kosovën, si çdo ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Republikës së Kosovës apo si çdo qytetar që ka ndenjur në Kosovë, kur ka qenë lufta. E tash, është lehtë të flasim 17 pas lufte. Unë i kuptoj që ua ke mbetur merak, ju ka mbetur shumë merak me dhënë një kontribut, por janë të vonuar. Duhet me ua lënë edhe fëmijëve të tyre s’ka me u ra të ketë luftë në Kosovë, e lëre këta. E nuk është mirë me i lejuar të bëjnë këso shpifjesh me figura e me personalitete, që nuk mund të shkruhet historia e jetësimit të Kosovës pa ta.

Andaj, unë, secili... Kosova është e vogël, ne njihemi në mes vete dhe e dimë të kaluarën, edhe të këtyre, edhe tonën, edhe familjare, mund të hyjmë me baballarë, me babagjysh, a me cilin të duam, të shohim cilat veprime i kemi. Për këta kemi lypë edhe ligje paraprake. Unë e kuptoj edhe zotin Kurti, se çdoherë po i këshillon këta dy dhe këta dy po e dëgjojnë mirë. Ishalla, u ka thënë ndonjë gjë, ta shohim çka u ka thënë. Faleminderit!

KRYETARI: Kush mbet patriot, kush tradhtar, këtë s’po e marrim vesh? Vetëm se, ky debat veç për Mitrovicën nuk është, kjo është e rënda, Pal, po, po, emrin jo, jo, po më vjen keq prej këtyre kolegëve, deri në sa të keni qejf, vetëm bëhuni, unë kur po ju pyes, veç po ju pyes më specifik, se është çështja e Mitrovicës është e ndjeshme dhe për besë, kushdo që e ka nda Mitrovicën meriton në bazë të himnit kombëtar. Kjo është.

Urdhëroni, kush dëshiron të flasë? Albin, gjithsesi, se ti je kryeidologu, ti duhet...

ALBIN KURTI: Ne nuk ia mohojmë meritën asnjë luftëtari të UÇK-së dhe jemi krenarë, kemi respekt e nderim të përjetshëm për ta. Mirëpo, duhet ta kuptoni një gjë. Askush nuk mund të tradhtojë sikur ata që kanë luftuar, prandaj ata e kanë edhe përgjegjësinë më të madhe. Dhe, ju e dini shumë mirë atë fjalën e urtë të popullit, që pesë minuta para vdekjes mundesh me u koritë, lëre më 5 vjet, e 15 vjet e 50 vjet. Esat Pashë Toptani ka luftuar ndoshta edhe më shumë, se shumica juaj, po e dha Shkodrën. Për të tradhtua nuk është vonë kurrë, prandaj keni mendjen.

Patriotizmi nuk është si fruthi, ose si fakulteti që e kryen një herë. Duhet të jesh patriot tërë jetën, bile është në traditën e kulturën shqiptare, që edhe të varrosesh me flamur, që në fakt i bie që patriotizmi vazhdon edhe pas vdekjes. Prandaj, nuk mund të thuash luftova një herë edhe u krye përgjithmonë e tash t'i maltretoj ata që ndoshta s'kanë pasur as moshë për atë kohë, se në Lëvizjen "Vetëvendosje" mosha mesatare është shumë e re. Bile, edhe Ali Shukriu dikur u thoshte atyre të demonstratave të '81-shit e të '68-ës, ku keni qenë në luftë ju? Edhe Ali Shukriu kështu ka thënë. Po, nuk shkon historia ashtu, bre! Ky është keqkuptim i madh. Faleminderit!

KRYETARI: Ti e Visari, bash të rinj nuk jeni, po sido që të jetë. Albin, po bashkëbisedojmë pasi që u bë shumë vonë. Po të kisha folur unë çka fole ti, automatikisht do të më ishte orientuar kryetari i partisë tënde, siç më orientohet çdo ditë "çka deshe të thuash me atë thënie, se "mundeni me e vetëvra veten", kishe thënë se Esat Pasha ka konotacion me Avni Rustemin. Ha, ha...!

Dëgjo, kjo është, Besa e ka filluar, e ka zbuluar "tradhtarin" edhe ju jeni duke e vazhduar për ndarjen e Mitrovicës. Shpresoj, se do ta gjeni edhe Avniun ju, shpresoj! Kush e dëshiron tash fjalën? Më shumë, se po më pëlqeni shumë. Lëvizja "Vetëvendosje", Visar e dëshiron fjalën? Thash se... të pash duke reaguar.

Të dalim deri te e vërteta historike. Të shkojmë... Raif, je më i butë, ndoshta e zbutë, edhe kështu i ke nja 14 vjet burg, mos ke qenë edhe ti aty në mes...

RAIF QELA: Të nderuar kolegë deputetë,
E nderuar ministre,

Muri për të cilin po diskutojmë sot, i ndërtuar në dalje të urës, që lidh pjesën jugore me atë jugore të qytetit të Mitrovicës, nuk është thjesht një mur nga betoni e çeliku. Ai është një mur, i cili në themelet e veta i ka zgjidhjet e gabuara politike, që janë bërë në bisedimet dhe marrëveshjet e Vjenës dhe të Brukselit.

Këto zgjidhje politike i kanë dëmtuar rëndë interesat e popullatës shumicë shqiptare, por edhe të komuniteteve joshumicë në Kosovë. Duket paradoksale, por këto zgjidhje e kanë dëmtuar edhe vetë pakicën serbe në Kosovë. Të gjithë e dimë, se ndarja e Mitrovicës dhe spastrimi etnik i pjesës veriore të qytetit, dëbimi i popullsisë joserbe nga ajo pjesë e Kosovës, janë procese që kanë filluar menjëherë pas luftës dhe po vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Zgjidhjet e gabuara politike, që kanë dalë si rezultat i bisedimeve dhe marrëveshjeve të Vjenës dhe të Brukselit e kanë konfirmuar këtë spastrim dhe këtë ndarje dhe kanë prodhuar marrëveshje të tilla, të cilat do të prodhojnë në vazhdimësi tensione, mure e pengesa të ndryshme.

Muri i tanishëm në Mitrovicë nuk e ka qëllimin vetëm pengimin e qarkullimit të lirë të qytetarëve, por shumë më tepër. Serbët e veriut të Kosovës me anë të këtij muri duan t'i mbrojnë rezultatet e veprimeve të tyre kriminale. Ata me këtë mur po na e bëjnë me dije, se nuk besojnë as në zgjidhjet e arritura në Vjenë dhe në Bruksel, të cilat janë skajshmërisht privilegjuese për ta dhe tepër të dëmshme për shqiptarët. Dhe, s'kanë se si të besojnë.

Uzurpatorë e kriminelë serbë të veriut të Mitrovicës kanë vrarë, dëbuar e kanë përvetësuar tokat, banesat e pasuritë e shqiptarëve, prandaj çfarëdo zgjidhje që u mundëson shqiptarëve qasje në pronat e veta dhe çfarëdo zgjidhjeje që do të ofronte drejtësia për ta trajtuar veriun e Kosovës, çfarëdo zgjidhje e tij i rrezikon seriozisht uzurpatorët dhe kriminelët serbë.

Të nderuar deputetë,

T'i quajmë gjërat me emrin e vet të vërtetë, ashtu siç janë. Bisedimet dhe marrëveshjet në Vjenë e në Bruksel ua kanë dhënë një pakice minore të drejtën kushtetuese, që ta bllokojnë Kuvendin e Kosovës, pothuajse kur të duan. E kanë legjitimuar ndarjen e qytetit të Mitrovicës në komunë jugore dhe veriore, respektivisht në "Mitrovicë shqiptare" dhe "Mitrovicë Serbe".

Kanë formuar komuna serbe, do të formojnë "Asociacion të Komunave Serbe" e të tjera. Të gjitha këto lëshime nuk e kanë kënaqur dhe nuk do ta kënaqin komunitetin serb, sepse ata nuk e njohin dhe nuk e pranojnë shtetin e Kosovës. Ata kanë frikë nga e kaluara, nga e tashmja dhe nga e ardhmja. Prandaj, natyrshëm do të kemi herë tela me gjemba, herë park për ndarje, herë roje të urës, herë mure e herë ndonjë pengesë tjetër.

Të nderuar deputetë, zgjidhjet që nuk janë zgjidhje, domosdo prodhojnë tensione, mure e pengesa të ndryshme. Kosova duhet të lirohet nga këto zgjidhje, nëse dëshiron të bëhet vërtet sovraane dhe nëse dëshiron t'ia hapë vetes rrugën e përparimit e të zhvillimit. Faleminderit!

KRYETARI: Fisnik Ismajli e ka fjalën, ndërkohë bëhet... Ok! Më fal! Nga Lëvizja "Vetëvendosje", Mytaher edhe ju keni mbetur dhe pastaj Fisniku po dëshiron në fund. Disa kolegë deputetë të tjerë e kanë fjalën, në qoftë se kisha pasur mirëkuptimin, nja dy fjalë në fund edhe unë, jo si kryetar i Kuvendit, si deputet.

MYTAHER HASKUKA: Së pari, domethënë këtë debat po e bëjmë për murin e Mitrovicës dhe për me lyp përgjegjësi për atë që ka ndodhur në Mitrovicë dhe për ndarjen që po bëhet në Mitrovicë.

Edhe në atë aspekt çështja është përgjegjësia institucionale, nuk është personale. Domethënë, për mua, kryeministri Isa Mustafa nuk është problem si person, është problem si kryeministër, njëjtë është edhe për ministren për dialog. Ajo çka ndodhë në Mitrovicë dikush duhet me dhënë përgjegjësi dhe përgjegjësia duhet të jetë institucionale.

Po këtu, gjatë tërë debatit dhe gjatë diskutimeve edhe të kryeministrit dhe të ministres e të tjerëve, po ashtu edhe të deputetëve nga koalicioni qeveritar, është një tendencë për të ikur nga përgjegjësia institucionale dhe për tu kthyer në debat personal, që nuk është me qëllim. Qëllimi është të gjenden problemet në aspektin institucional dhe të mundohemi të gjejmë mënyrën se si mund ta bashkojmë edhe Mitrovicën po edhe serbët t'i integrojmë në institucionet e Kosovës.

Nëse shikojmë Isa Mustafën, ai doli këtu dhe foli, na kërkoi neve që të shkojmë dhe ta prishim murin, kështu diçka doli, tha: mos rrini te telat, shkoni deri te muri, e kështu me radhë... Këtë s'mund ta thotë një kryeministër. Kryeministri e ka përgjegjësinë dhe e ka komandën e Policisë së Kosovës dhe të të gjitha institucioneve shtetërore. Nëse e quajmë veten shtet, nëse mendojmë se jemi shtet, edhe nëse kryeministri mendon se është kryeministër i Republikës së Kosovës, e jo e ndonjë NGO-je, ose ndonjë organizate të shoqërisë civile, atëherë ai ashtu siç ka thënë, sipas ligjit, duhet të veprojë dhe të shkojë atje dhe të prishë murin, që të veprojë sipas ligjit. Nuk mund të thotë, se komuna e ka përgjegjësinë aty, nga se ajo është rrugë, rrugë magjistrale faktikisht. Dhe kur dikush e bllokoi rrugën magjistrale, duhet të veprojë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kryeministri ende s'e ka kuptuar, edhe pas tre vjetësh, që është kryeministër i shtetit dhe kërkon prej Brukselit të intervenojë, jo ajo, jo kjo... nëse ne nuk e respektojmë vetveten, kurrkush nuk na respekton neve, domethënë ne duhet të kemi respekt ndaj shtetit tonë dhe pastaj edhe Brukseli ka me pas respekt, po edhe Beogradi.

Përndryshe, Isa Mustafa për ta mbrojtur rançin e vet, i përdor krejt institucionet e Policisë, bile edhe njësitë speciale, vetëm që aktivistët e "Vetëvendosjes" mos ta qesin një pankartë, ndërsa në anën tjetër ndërtohen rrugë dhe bllokohen rrugët magjistrale, ai nuk vepron asgjë dhe kërkon nga Bashkimi Evropian të ndërhyjë. Kjo është... s'po di si të them... domethënë, aspak institucionaliste, si thonë në partinë e tij.

Po ashtu, kryeministri u mundua të ikë nga përgjegjësia, edhe me fjalitë e tij, edhe me, me këto, po iku edhe kështu, fizikisht, sepse s'ka si të mbrojë të që po ndodhë. Këta shkuan të bëjnë marrëveshje në Bruksel për të hequr disa saksia prej rrugë dhe përfunduan në mur. Unë po frikohem, që nëse vazhdojmë me këtë tempo, atëherë "Republika Sërpska" brenda Kosovës do të jetësohet edhe më keq se sa në Bosnje dhe në të njëjtën kohë, kur Serbia nuk na njeh, faktikisht, nuk jemi duke fituar asgjë nga këto negociata.

E shikova raportin e ministres për dialog për vitin 2016. Aty s'ka faktikisht kurrgjë, domethënë të gjitha "sukseset", që po paraqiten aty, asnjëra nuk është implementuar, nuk kemi asnjë diplomë e cila është dhënë nga Kosova, që është pranuar nga Serbia, me targa të Kosovës nuk mund të shkojmë në Serbi, e kështu me radhë...

Në anën tjetër, po dua ta lexoj vetëm një fjali që thotë, si për shembull, “Të arriturat në dialogun e Brukselit gjatë këtij viti mund të konsiderohen mjaft substanciale, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për vendin tonë.” Kjo fjali, fjali hyrëse, tregon që edhe ata që e kanë shkruar këtë raport, po edhe ata që po bëjnë negociatat, s’po kanë ide se çfarë janë duke bërë. Domethënë, “substanciale” dhe “e rëndësishme” është send i njëjtë, kjo është njëjtë si “forca e bën fuqinë”. Kur s’ke çfarë të thuash, vetëm thua fjali qarkore, të cilat vetveten e vazhdojnë.

Muri nuk është problem arkitektonik, as urbanistik, muri është problem politik dhe këtu s’mund të themi që mos ta politizojmë murin. Muri s’mund të mos politizohet, sepse nuk është... nuk mund ta trajtojmë nga perspektiva urbanistike murin, duhet të trajtohet si problem politik, që ka ardhur si rrjedhojë e këtyre negociatave.

Përndryshe, murin po e bëjnë partnerët qeveritarë të Listës serbe, domethënë ju i keni partnerë në Qeveri dhe ata po e bëjnë murin, s’mund t’ia hedhim fajin këtu kurrkujt tjetër, pos Qeverisë dhe partnerëve tuaj qeveritarë.

Në anën tjetër, janë dy gjëra që në fund kisha dashur t’i them. Nëse shikojmë gjithë këtë proces negociator, ne faktikisht tërë kohën kemi biseduar vetëm për Kosovën e asgjë për kërkesat e Kosovës ndaj Serbisë. Në atë aspekt, nëse nuk dizajnohet ky proces, unë nuk kam kurrfarë pritjeje që Serbia ndonjë ditë do të na njohë e as s’ka logjikë të na njohë, kur ne i japim krejt çfarë Serbia kërkon prej Kosovës. Në momentin që ke problem me një njeri dhe i jep të gjitha që ai kërkon, ai pastaj s’ka nevojë, pse t’i vazhdojë bisedimet me ty, se gjithsesi i ka marrë krejt çfarë kërkon prej teje.

Në atë aspekt, ne po shkojmë çdo ditë e më tepër në integrimin e Serbisë, ose integrimin e Kosovës brenda Serbisë, se faktikisht, Serbia po merr çdo ditë e më shumë kontrollin, prej postës e telekomit, energjisë elektrike e aspekteve tjera e në anën tjetër, integrimi i serbëve të Kosovës nuk po ndodh, vetëm sa po kemi më shumë ndarje. Në atë aspekt, unë shpresoj që ato që thatë këtu, që muri do të largohet, nuk janë si premtimet parazgjedhore për 200 mijë vende pune apo për fondin zhvillimor apo për liberalizimin e vizave, formimin e ushtrisë apo për luftimin e korrupsionit.

Shpresoj, që me të vërtetë ka ardhur koha që të mendojmë për të ardhmen e Kosovës e të mos mendojmë vetëm për karriget tona në aspektin e pushtetit, po edhe të rishikohet kjo me seriozitet dhe të mos të merret ashtu si pozitë-opozitë, po si diçka që është për interesin e përbashkët të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fatmir Shurdhaj e ka fjalën.

FATMIR SHURDHAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Ministre për dialog,
Të nderuar të pranishëm,
Qytetarë të republikës së Kosovës,
Sot ne kemi ardhur këtu, fatkeqësisht, për një të vërtetë skandaloze, që po ndodh në Mitrovicë, ndërtimi i murit i ndërtuar nga strukturat paralele, në pjesën veriore të Mitrovicës.

Më vjen keq, që nuk janë deputetët serbë këtu, të Listës serbe, të cilët janë të deleguar ekstra me vende të garantuara dhe të rezervuara këtu, për ta mbrojtur këtë të vërtetë që po ndodh.

Është për keqardhje, mua si deputet i ri, kur ju shoh juve opozitën-pozitën, më shumë u jepni zor flamujve politikë, për të treguar veten sa jeni të fuqishëm edhe për ta fyer njëri-tjetrin, për ta fyer kryeministrin, kryetarin e Kuvendit, deputetët, përfaqësuesit politikë, që udhëheqin negociatat, që i kemi zgjedhur, se sa të nxjerrim një vendim me të cilin qytetarët e Republikës së Kosovës do të binden se ju i përfaqësoni.

E tha deputeti Sadriu, se historia e këtij muri rrjedh nga plani i Ahtisarit, i përmendi të gjitha ato koncesione. E vërtetë është se plani i Ahtisarit ka krijuar sovranitet politik në Kosovë, të cilin të gjithë ju deputetë e keni miratuar, disa kanë qenë në parti të ndryshme, e tha zoti Buja, por disa edhe kanë qenë në pozita shtetërore dhe në pozita të tjera udhëheqëse.

Edhe ky sovranitet politik, fatkeqësisht, u derdh në sovranitet juridik përmes procesit të decentralizimit e kjo po na ndodh në veri, tash po e quajmë veri e ajo është Kosovë. Çka bëmë me këtë? Ne i forcua atje strukturat paralele, ne u dhamë fuqi kryetarëve që të përfaqësojnë, të marrin vendime në vija etnike, sikurse u kemi dhënë fuqi sovranitetit politik këtu në Kuvend me vendet e garantuara dhe të rezervuara, që për mua si deputet i ri, ky Kuvend më shumë e ka funksionin e dydhomëshe, se sa... ne jemi në një dhomë, për faktin se vendet e garantuara, të rezervuara, kur të duan dhe sa herë të duan ta rrëzojnë çdo vendim dhe s'mund ta marrësh.

Nuk është faji vetëm tek ju, deputetë, por është faji edhe te ndërmjetësimi ndërkombëtar që po e bëjnë këtu, bashkësia ndërkombëtare. E tha ministrja, e cila është përfaqësuese për negociatat Kosovë Serbi me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian. Elaboroi shumë gjëra, për besë, nganjëherë më dukej se po më reciton poezi. Jo, zonja ministre, kufiri nga bregu i Pançevqit po zhvendoset tek ura. Kufiri Kosovë Serbi është te "Pançeqi vrhovi", bregu i Pançevqit 2017 metra lartësia mbidetare, në Kopaonik, tash po vjen te ura.

Ku mur nuk është mur ky, ky është gurë. Le ta dinë ndërmjetësuesit e Bashkimit Evropianë se në mënyrë "De marke la frontier" Kosovë e Serbi, po ua them frëngjisht, ndoshta s'ua thash mirë,

po ky është një mur që po do ta demarkojë Kosovën me Serbinë te ura në Mitrovicë dhe të na bëjnë kusht neve, siç po na e bëjnë për liberalizim të vizave për demarkimin e kufirit atje te kulla.

Problemi është tek ne, deputetë të nderuar, sepse ne merremi më shumë me fyerje në mes vete, me akuza, se paskan shkuar çlirimtarët me nda Mitrovicën e me shitë Mitrovicën, se paska pasur video, po ekzistuan filma, se sa merren me problemet reale të qytetarëve të Kosovës, që i përfaqësojmë ne këtu.

Kryeministri Mustafa elaboroi problemin nga këndi i Qeverisë, i cili ka obligime kushtetuese dhe ligjore për ta trajtuar problemin, sepse është mandatuar për këtë punë. Por, jo të na japë neve kureshtje për t'i marrë hyxhym Mitrovicës. Jo, duhet të zbatohet ligji dhe mandatin të cilin e ka kryeministri dhe kjo Qeveri dhe ne si deputetë. Ne, nëse në Mitrovicë tentojmë ta bëjmë si në 2004-ën ne i dëmtojmë interesat e qytetarëve të Kosovës. Edhe këta deputetë serbë që nuk janë sot këtu e është dashur të jenë, duhet ta kenë të qartë, se ata duhet t'i mbrojnë interesat e qytetarëve serbë e jo të krijojnë barrikada, jo të krijojnë mure ndarëse.

Ne mbetëm në orët e vona në këtë Kuvend duke debatuar, kush kujt po mundet ta akuzojë, t'ia thotë një fjalë të keqe, edhe me u marrë portalet edhe me fitua portalet me klikime. Kjo nuk i takon një deputeti të Kuvendit të Kosovës e aq më pak nuk i takon në këtë kohë, ku bashkësia ndërkombëtare, e cila po ndërmjetëson negociatat Kosovë-Serbi, po e favorizon Serbinë. Qëllimshëm, po e favorizon Serbinë. Çdo qytetar i Kosovës edhe ne si deputetë, e dimë shumë mirë taktikën dhe strategjinë e negociatave të Serbisë, e cila po përfiton në kohë dhe hapësirë, për t'i ikur përgjegjësisë kolektive për krime lufte dhe për gjenocid që ka bërë në Kosovë dhe për ta favorizuar veten në marrëdhënie ndërkombëtare, ndërsa ne po merremi me vetveten.

Lufta e Serbisë është për ta bërë Kosovën shtet kukull në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ne po shkojmë kësaj rruge! Ky mur që është simbolik, po tregon se Kosova po shkon drejt sovranitetit të disiplinuar. Kështu është, të nderuar deputetë, Bosnja e Hercegovina, e njëjta gjë ka ndodhur në Bosnjë, as më pak e as më shumë. Ka shumë shtete në marrëdhëniet ndërkombëtare, të cilat diktohen nga korporatet trans-nacionale, ato quhen shtete kukulla. Nëse ne lejojmë që të diktoheni në këto forma, jemi duke i dëmtuar interesat e qytetarëve, jemi duke i shkelur të gjithë ata që kanë dhënë djersën, mundin dhe gjakun për lirinë e vendit.

Nuk na takon ne këtu të fyhemi e të shahemi, për shkak të luftës për pushtet që jemi duke bërë. Aleanca ka ngritur debatin dhe duhet të nxjerrim rekomandime për këto. Të paktën, ta dijë bashkësia ndërkombëtare se është duke ndërmjetësuar. E shfajësoi Ilir Deda bashkësinë ndërkombëtare. Jo, jo, nuk është për t'u shfajësuar, se ka dorë, sepse nuk po e thotë të vërtetën për këtë gjë, sepse po i bllokoi negociatat me Kosovën, sepse zonja Tahiri nuk mund t'i vërë temat për të cilat ka nevojë Kosova, po ata i diktojnë temat.

Në vend, se me diskutua në temën e pensioneve, që na u ka vjedhur fondi pensional, ne merremi me problemet në mes vete tashti, jo kjo parti po e qet gurin, jo ti po e qet murin, jo ti e ke atje kontrabandën... jo ti, jo... ne e kemi amnistuar si Qeveri, si deputetë, edhe krimin në veri, edhe spitalet, edhe fakultetet që kanë dhënë diploma fals, madje ka pasur edhe rafineri të petrollit, që e kanë pru uljen prej Serbie dhe e kanë bërë naftë në veri, i kemi amnistuar me të vetmin qëllim me i integrua në institucionet e Kosovës.

A kemi fituar prej kësaj pune? Ne po i shohim. Del ministri i Qeverisë së Kosovës, zgjidhët prej Qeverie, del nëpër Evropë flet çfarë të dojë, bën çfarë të dojë, ia merr mendja që e ka privat shtetin, e ka bërë të vetin. Kjo nuk është në rregull. Qeveria e ka mandatin, e ka besimin e deputetëve, duhet të marrë vendime ta zbatojë ligjin e jo të luajmë filma ne këtu, “jo ti je më patriot, jo ti je më tradhtar...”. T’i harrojmë këto fyerje.

Zonja ministre, shumë respekt për profesionalizmin tënd, negociatave u ka ardhur fundi. Negociatat nëse vazhdojnë kështu nuk kanë mundësi të përfundojnë me traktat të pages, sepse po ne vihen mure brenda territorit të Kosovës. Negociatat nuk shkojnë, sepse doli Agim Bahtiri dhe u bë strateg i negociatave në mes Serbisë dhe Kosovës dhe tregonte me centimetra, se sa do të jetë muri. Tha, unë me Rakiqin merrem vesh këtu. Po, kjo nuk ka kuptim, a është Agim Bahtiri me Rakiqin duke i udhëhequr negociatat Serbi - Kosovë apo ministrja, e cila është e deleguar nga Kosova. Dalin këtu deputetë dhe bëhen zëdhënës të komunës së Mitrovicës apo të Agim Bahtirit. Ju lutem mos luajmë filma, nuk kemi nevojë të luajmë filma ne.

E thash edhe një herë, kjo simbolikë e këtij muri është për ta legjitimuar edhe asociacionin, po, sepse asociacioni në mandatin e kaluar kur është miratuar në Qeveri, ka qenë OJQ, ndërsa në negociatat në Bruksel na ka dalë jo OJQ. Edhe ky asociacion ka fituar shumë të drejta, po na del njëfarë shtetësie brenda shtetit të Kosovës. Kosova si Bosnja e Hercegovina nuk mund të funksionojë. E thanë këtu deputetët, pse nuk po shkoni në Mitrovicë, pse nuk po shkon kryeministri, pse s’po shkojnë ministrat... unë personalisht kam qenë në Mitrovicë kur kanë ndodhur ngjarjet në Mitrovicë. Kam qenë zëvendësministër i ministrit Nenad Rashiç edhe e kam lutur, hajde se dua të shkoj në Mitrovicë t’i shoh serbët, shqiptarët, romët, boshnjakët, të gjithë. Dhe, kam shkuar i kam vizituar.

Edhe liderët politikë të Kosovës të të gjitha partive politike, pse nuk uleni ju e të filloni të bisedoni me serbët e Kosovës, drejtpërdrejtë pa ndërmjetësim dhe tu tregoni se ju mund t’i kryeni këto punë, se është atdheu juaj, është vendi juaj. Ne i kemi diskriminuar pozitivisht ata. Nuk di në Botë, në marrëdhënie ndërkombëtare që ka diskriminim më të madh për minoritetet, nuk di.

Mirëpo, është gabimi juaji, sepse këtu më shumë po bëhet luftë për pushtet, sesa luftë për ta mbrojtur territorin, sovranitetin territorial.

Ju lutem, në këto orë të vona, nxirrni rekomandimet për çfarë jemi mbledhur e t'i lëmë fyerjet, se nuk na takon. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Për ko incidencë, isha pro shtyrjes së këtij debati dhe besoj që në disa pika u tregua edhe arsyeshmëria pse, siç duket edhe Kuvendin edhe deputetët i ka zënë të papërgatitur, në kuptimin se çfarë po dëshirojmë dhe cili është qëllimi ynë kryesor, jo vetëm për relativizmin e problemit si problem i cili diskutohet vazhdimisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe normal që është interes i veçantë. Por, ajo që mungon, gjithmonë është dhënia e zgjidhjes apo dhënia e alternativave se si do të dalim nga ky problem, i cili po atakon edhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm të Kosovës.

Kritikat për dialogun mendoj që nuk janë të shpikura tash, kanë arsyeshmërinë e vet. Ajo çfarë është kërkuar shpeshherë në Kuvendin e Kosovës është kërkuar transparenca, që deputetët të njoftohen pas çdo temash të marrëveshjeve dhe sigurisht, se kjo po të ndodhte në mënyrë reciproke, kontinuele, ndoshta edhe do të eliminohej shumë keqkuptime, dilema, që ngritën dhe mbi të gjitha, ndoshta nuk do të lejonim që elementet propagandistike, populliste, të krijojnë hapësirë, mundësi që të shfryhen në atë kuptimin edhe personal edhe individual, pa ndonjë koncept të qartë të dhënies së një zgjidhjeje konkrete të problemeve.

Dhe, për këtë arsye, besoj që ndonjëherë edhe njerëzit duhet të reformohen, nëse jo vetvetiu, të reformohen në ecjen e gjithëmbarshtëm. Ndoshta, shembulli më i mirë ishte edhe deputeti paraprak, që ka ardhur i ri dhe e dha një mesazh shumë pozitiv në aspektin se si ndonjëherë duhet temat nacionale të diskutohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe unë personalisht i çmoj disa pika që besoj se ishin edhe pjesë e disa fjalimesh këtu edhe të kolegëve, me dashamirësi, mbi të gjitha duke u munduar që t'i japim një kahe pozitive për një temë e cila është ngritur, pavarësisht edhe nuancave të atyre rekomandimeve, që janë politike, mund të jenë edhe personale edhe subjektive, por gjithçka mendoj që mbetet në vullnetin e mirë, që ky problem për murin të diskutohet në mënyrën më të mirë, por t'i japim zgjidhje, t'i japim edhe zgjidhje kohore por gjithmonë duke shikuar që tutje të mos përcillet apo të mos krijohet një problem i ri.

Unë besoj edhe në atë, se Serbia nuk është ajo që ndonjëherë do të heq dorë nga ato, ta quaj, ambiciet e tyre të vjetra. Fatkeqësisht, edhe përkundër presionit ndërkombëtar të fuqive të mëdha, po flas, edhe këto evropiane, por edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që të heqë dorë nga ambiciet e tyre dhe të heqin dorë nga ëndrra e tyre për rikthimin në Kosovë. Por,

asnjëherë nuk duhet neve të na gjejnë të papërgatitur dhe sidomos, kështu me këtë gjuhë politike, sidomos në institucionin më të lartë të Republikës së Kosovës.

Zonja ministre,

Nuk është hera e parë që po flasim për veriun, nuk është hera e parë që po flasim për dialogun, besoj që shpeshherë nuk jemi pajtuar, shpeshherë kemi pritur të pajtohemi nga rezultatet e pritshme, që kanë ndodhur. Ndoshta, duhet të kuptoni edhe deputetët, sepse për së afërmi, pak a shumë, nuk janë njohur me këto problematika, por kjo nuk do të thotë që ne duhet të kërkojmë apo të insistojmë në kërkesën për llogaridhënie, gjithmonë sipas Kushtetutës dhe ligjeve, të cilat janë në fuqi, pavarësisht edhe partneritetit që e kemi ndërtuar dhe synimeve tona për integritet në strukturat evropiane dhe euroatlantike.

Ajo që është e domosdoshme në këtë kohë, është që ne të krijojmë një figurë të mirë unifikuese, që tendencat e Serbisë të këtij lloji, siç është krijimi i ndonjë muri ndarës apo insistimi populist që me lojën e të kthyerve në pjesën veriore, por edhe në pjesë tjera të Kosovës, të jemi të kujdesshëm dhe mbi të gjitha, gjuhën tonë. Unë ju përkrah, që të jemi të kujdesshëm në atë që mos ta lëndojmë procesin dhe mos të krijojmë figura populiste, nuk po i quaj tash patriotike, sepse është demoduar edhe ky fjalor, por të insistojmë në vlerat që i ka Kosova dhe në vlerat që paraqesin institucionet e Republikës së Kosovës.

Dhe, kjo është ambicia jonë edhe integruese edhe e shtetformimit, mbi të gjitha edhe e guximit, shprehjeve, ambicie tona qofshin ato politike po qofshin edhe për të udhëhequr me vendin.

Mbi të gjitha, edhe kur kemi probleme, besoj se nuk kemi nevojë të fshihemi, qoftë ndonjëherë edhe në ecjen tonë, që mund të ketë edhe ndonjë gabim konceptual apo edhe procedural, të kërkojmë përkrahje nga Kuvendi, të kërkojmë përkrahje nga qytetarët, për të arritur aty ku po duam të arrijmë.

Synimi ynë është integrimi dhe në këtë integrim, besoj që herët a vonë, edhe pjesa veriore dhe serbët do ta kuptojnë, edhe kolegët tanë këtu që janë, të komunitetit serb, ajo që neve na takon, besoj që duhet të jemi të guximshëm ta themi, që t'ju krijojmë këtë mundësi, por gjithmonë duke mos e shkelur Kushtetutën dhe duke mos i shkelur vlerat që ka krijuar Republika e Kosovës dhe populli shqiptar.

Në këtë aspekt, mendoj që shumë lehtë mund t'ia arrijmë, pavarësisht luftës politike të brendshme këtu, që ka derivuar edhe me pakënaqësi edhe popullore edhe qytetarët shpeshherë kur e shohin nga jashtë e kanë kuptuar tashmë qartë, sepse ne kemi kontakte të përditshme, e kanë kuptuar edhe këtë gjuhën agresive, e kanë kuptuar edhe gjuhën populiste, sepse duan veprime konkrete. Mbi të gjitha, shumica e qytetarëve të Kosovës e njohin më mirë se shumë deputetë, se çfarë ndodhë në pjesën veriore të Kosovës dhe në Mitrovicë. Njerëzit udhëtojnë,

komunikojnë, kanë familjarë, i njohin brengat e tyre, problemet e tyre ekonomike, ndërsa unë jam i bindur dhe këtu po shihet, se shumë deputetë deklarojnë që edhe në Mitrovicë vetëm kur ndoshta kanë kaluar për ndonjë vizitë zyrtare, por asnjëherë private, personale apo ajo çka i ka munduar për ta zgjidhur ndonjë problem të qytetarëve të asaj pjese, që për mendimin tim, janë më të vuajturit në Republikën e Kosovës dhe në shtetin e ri të Kosovës, nga padrejtësitë që u kanë ndodhur.

Ajo çfarë kërkojmë është, disa punë të mira që janë nisur. Janë nisur, nën një është debatuar shumë në Kosovë ndërtimi i shtëpive të të kthyerve shqiptarë, domethënë pjesë ku është munduar që edhe ekonomikisht të ndihmohet edhe në këtë aspekt, në këtë proces të dialogut duhet t'u jepni hapësirë, t'ju krijoni edhe atyre mundësi partneriteti që fjala dhe zëri i tyre të dëgjohet, pasi që po shihet që Prishtina, ta quaj këtu dhe Kuvendi i Kosovës më shumë i përdor për çështje elektorale se sa për avancimin apo plotësimin e kërkesave dhe nevojave të banorëve, sidomos shqiptarë se në mënyrë të padrejtë edhe sot e asaj dite nuk mund të kthehen në tokat e tyre.

Sa i përket murit, u kuptua dhe u tha, kërkojmë një afat kohor dhe personalisht mendoj se duhet të jetë një vijë për të cilin edhe ju mendoni që në këtë partneritet të vazhdueshëm, por të guximshëm dhe politik, që ai mur të mos duket, sepse është shembull i keq, në fund të fundit dhe mbi të gjitha simbolizon ndarjet etnike e nacionale dhe, për mendimin tim, botës demokratike i takojnë shekullit të kaluar, por sido që të jetë, ne jemi akoma në luftën politike dhe konceptuale me shtetin serb dhe këtë duhet ta kuptojmë, pavarësisht edhe tendencës së bashkësisë ndërkombëtare dhe neve si shumicë që t'i rregullojmë marrëdhëniet dhe të krijojmë një Kosovë, ku edhe ata do ta ndjejnë veten mirë dhe ta njohin për shtet të tyre.

Shembuj të mirë ka. Ka shembuj edhe të këqij, por besoj se angazhimi ynë duhet të jetë në këtë formë dhe gjuha politike, pavarësisht asaj, unë ju inkurajoj se në temat konkrete t'i shprehni ashtu, jo vetëm si i kemi dëgjuar nga deklaratimet publike, por nga veprimet konkrete dhe që në shumë forma kanë treguar rezultat. Mirëpo, aty ku nuk është treguar rezultat, të insistojmë, të kërkohet ndihma e Kuvendit, të kërkohet ndihma e qytetarëve që marrëveshjet të implementohen dhe mbi të gjitha të gjejmë edhe një mënyrë të komunikimit pak ndryshe edhe me bashkësinë ndërkombëtare dhe, në fund të fundit, mendoj se ka ardhur koha që edhe forma e dialogut të ndryshohet me atë që të kemi hapa konkretë dhe të shohim edhe afate, qofshin ato ditore a javore të implementimit të këtyre marrëveshjeve.

Tek atëherë besoj se nuk do t'u krijohet mundësi faktorit destabilizues në pjesën veriore të Kosovës që të ndërtojë mure apo edhe të luajnë në forma të ndryshme, qoftë të mosnjohjes së institucioneve apo stërvarritjes së implementimit, sidomos në integrimin e plotë në ato struktura që janë edhe gjyqësore, edhe të shëndetësisë, arsimit dhe të gjitha pjesëve të tjera.

Prandaj, besoj që edhe për rekomandimet që janë paraqitur sot, kisha menduar të kemi një harmonizim, njëfarë forme të përbashkët, pa atë tendencën që të kërkohen masa ekstreme nga ajo se asgjë s'është bërë dhe gjithçka duhet të fillojë nga zero, por të kërkojmë hapa konkretë, sidomos në eliminimin e kësaj çështjeje, e cila ka ngritur pakënaqësi shumë të madhe edhe te qytetarët e Republikës së Kosovës, jo vetëm të asaj pjese, por edhe anembanë Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe për këta deputetët që kanë mbetur këtu, kaq pak, dhe po dëgjojnë. Ministre, pak vonë është bërë për ty, ndoshta, sonte, por qysh na ka zënë ne nata, edhe ty, besoj se do ta kalojmë.

Për të folur për çështjen e Mitrovicës, çështjen e Kosovës, çështjen e Shqipërisë, çështjen e Malit të Zi, çështjen e Maqedonisë, çështjen e Preshevës, Medvegjës, të Bujanovcit, tani besa edhe të Novi-Pazarit duhet folur, se edhe atje del që po flasin shqip.

Mendoj se në një fjalim të presidentit që e pati sot, po i bie sot, dhe edhe pak ka mbetur, tha se muri duhet të prishet, ose duhet të hiqet.

Në një fjalim tjetër që e tha kryeministri, po në një fjalim edhe të kryetarit të Kuvendit, ky mur nuk do të ekzistojë, do të hiqet.

Do ta bëj një parafrazim se, sikur unë të isha në vend të kryetarit të Kuvendit sot, nesër nuk do ta shihnim murin.

Po, nuk jam atje, jam këtu, prandaj po flas ndoshta pak më lehtë. Unë mendoj se ndoshta te Qeveria ekziston një neglizhencë apo një mosgatishmëri të përballet me sfida.

Kur më 25 korrik hynë forcat speciale deri atje, nuk është dashur shumë. Veç kur e dëgjuam, brenda ditës, mbërritën në kufi. Po nëse e kemi një guxim të tillë, në mëngjes s'kemi mure. Prandaj, te Qeveria, te institucionet duhet të ekzistojë përgjegjësia dhe guximi.

Kemi një Qeveri, mund të them, inerte. Te ne popullorçe thonë: "Uji që nuk rrjedh, nuk lëviz, nuk pihet". Prandaj edhe Qeveria ka mbetur "As me shehër, as me Barilevë", s'është duke ditur kah t'ia mbajë tash.

Unë nuk po dua të merrem me Agim Bahtirin, e as me zëdhënësit, por mund të them se është një sfidë që e kanë prezantuar në aspektin politik, në aspektin e vendosjes të një pike që ne duhet të merremi me atë pikë për t'u ikur disa temave, sfidave që do të vijnë.

Muri ne na bashkon, na çon në një kah të përbashkët, në unitetin e qëndrimeve për heqjen e tij, me dallime specifike, por neve na shtyn që këndej ta orientojmë kahen sikur që s'po ndodh asgjë në veprimet, fushat ose temat e tjera që e preokupojnë Kosovën dhe gjykatat e Gjykatën Speciale.

Ne merremi tamam me murin, e andej diskutohet, anash e fshehurazi me shumë konspiracion Gjykata Speciale, veprimet e saj, puna e saj dhe EULEX-i.

Unë them se çështja e integritimeve, se shumë janë përmendur integrimet, integrimet ndaj Bashkimit Evropian, ndaj NATO-s, ndaj të gjitha fushave, edhe brenda Kosovës.

Integrimet në BE nuk bëhen në këtë formë, duke vendosur mure. Integrimet në BE bëhen duke hequr mure, duke krijuar ura, për të cilat u fol shumë.

Po, integrimet për të cilat ne thirrmi vazhdimisht në BE dhe ministren që e kemi në dialog, që thotë për BE-në vazhdimisht, mendoj se duhet të gjykojmë a do të ekzistojë BE-ja në 2017-ën?

Mendoj se BE-ja është plakur, Bashkimi Evropian është plakur. Bashkimi Evropian tregoi se më 2016 ekzistoi një "Brexit", më 2016 tregoi se ekziston një Itali që është e gatshme të dalë nga BE-ja. 2016-a tregoi se Finlanda i ka mbledhur 30.000 nënshkrime për ta futur si pikë të rendit të ditës referendumin për dalje nga BE-ja. E ne, vazhdimisht thirrmi te BE-ja.

Po a kemi menduar ndonjëherë që ne duhet të integrohemi brenda vetes, me kombin tonë, me Shqipërinë?

Veç themi: kur të takohemi në Bruksel, e nuk dimë me kë do të takohemi në Bruksel, kur ne nuk jemi të gatshëm të takohemi brenda vetes.

Kemi pasur shumë integritime në fushën e arsimit, në fushën e ekonomisë me Shqipërinë, kemi pasur integritime të patateve me Shqipërinë, kemi pasur tash këto ditë integrimet e mandarinës që vijnë prej Shqipërisë dhe na i kanë liruar çmimet. Kjo është një gjë e mirë. Por, nuk kemi pasur integritime të librit, nuk kemi pasur integritime të shkencës. Nuk kemi pasur integritime me Shqipërinë thuaja aspak.

Të analizohet ekonomia, sigurisht që profi e di atje, çfarë qarkullimi kemi me Serbinë dhe sa kemi qarkullim me Shqipërinë. Tani flasim për integritime dhe kah po shkojmë.

Mendoj edhe diçka, që për ta hequr murin, kush është nostalgjik, mund ta kuptojë më mirë, por ma kujton atë këngën e moçme kur e dëgjonim Shqipërinë: “Moj parti ta lujsha syrin, s’guxon kush me ta prek kufirin”. E vetmja mundësi për ta hequr këtë mur është ajo këngë, që mendoj, kryetar, dhe po të them kryetar i Partisë Demokratike, mendoj se duhet bërë veprim për ta hequr këtë mur.

Prandaj, mendoj se me guximin që e kemi, duhet ta bëjmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hasani! Zonja ministre e ka fjalën, që të na japë ende sqarime që lidhen me diskutimet tuaja. Jemi pothuajse në përfundim. Ju falënderoj për prezencën, edhe pse është obligim, por shpresoj se kolegu i mediave sigurisht është nga Klan Kosova atje lart, apo Rrokumi, që ua vënë këtë prezencë në spikamë kolegëve deputetë se shumë i kanë dhënë zjarr e ikën shumica.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të nderuar,

Desha t’i them edhe disa fjalë në formë të asaj që unë nxora si konkluzione dhe si rekomandime.

E para, dëshiroj të them se qëndrimi shtetëror i Republikës së Kosovës është i qartë, se nuk do të ketë mur. Muri do të hiqet dhe do të ruhet stabiliteti, si dhe nuk do të shohim procesin e krijimit të marrëdhënieve paqësore mes Kosovës e Serbisë si shtete të pavarura dhe sovrane të thjeshtë dhe pa probleme.

Ne duhet të jemi vigjilentë se mund të ketë edhe provokime të tjera në të ardhmen, por ajo që është me rëndësi, ne kemi qëndrim të prerë, kemi bërë ndryshime të rëndësishme në kuptim të integritetit edhe të komunitetit serb, por edhe shtrirjen e sovranitetit, do të vazhdojmë ta kryejmë këtë proces.

E dyta. Debati në fillim shprehu një unitet të spektrit politik në kërkesën për heqjen e murit dhe në mbështetje të vendimeve dhe ekzekutimit nga ana e Qeverisë dhe institucioneve për heqjen e murit dhe zgjidhjen e këtij problemi.

Më vonë debati filloi të degjenerojë, kaloi në çështje personale. Filluan përfitimet politike, e madje-madje nuk na kishte hije që luftën e madhe që e bëri edhe UÇK-ja, po edhe Lidhja Demokratike, edhe i gjithë njëqindvjetëshi, ne vetë filluam të merremi me to.

Ju lutem, nuk ka histori më të lavdishme se fakti që ne jemi fitimtarë të kësaj lufte. Serbia nuk e ka parë ëndërr në kohën kur ishte agresore në shumë shtete që do të bombardohet nga SHBA-ja dhe NATO-ja për shkak të Kosovës.

Sot Serbia është e kushtëzuar në rrugën e saj për integritet evropian, për normalizim të marrëdhënieve me Kosovën dhe nuk do të mund të ecë për Bashkimin Evropian pa e njohur pavarësinë e Kosovës.

Dhe, e fundit, që desha të them. Marrëveshja për rivitalizimin e urës në Bruksel është marrëveshje e arritur në nivelin e shtetit. E, po më vjen keq që dolën edhe emra kryetarë komunash se gjoja kanë qenë vendimmarrëse, u lexua një letër, apo tjetër.

Në delegacionin e Republikës së Kosovës kanë qenë, në krye kryeministri, zëvendëskryeministri, kam qenë unë, ka qenë përfaqësuesi i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, ka qenë kryetari i Komunës, zoti Bahtiri. Prandaj rolin e tij duhet ta shihni si anëtar të delegacioni dhe kursesi jo si përfaqësues të bisedave në mes të komunave.

Për shtetin vendosin institucionet shtetërore dhe unë kisha dashur edhe Parlamenti sonte ta thotë fjalën e fuqishme që do të ishte një rekomandim, apo çfarëdo që mendoni për heqjen e murit, sepse nuk do të ketë asnjëherë mure, do të ruhen themelet e shtetit të Kosovës që ka lindur pas 100 vjetësh dhe institucionet përgjegjëse, përfshirë edhe Qeverinë, duhet ta realizojnë obligimin kushtetues. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuredin Ibishi e ka kërkuar fjalën! Zonja Haxhiu, doni replikë a? Atëherë le ta marrë fjalën Nuredin Ibishi, e pastaj ju.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar,

Nënkryetar,

E nderuar ministre,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se veriu i Mitrovicës që nga përfundimi i luftës së Kosovës ka qenë përherë si konflikt i ngrirë, por me provokacione të vazhdueshme. Se kush është fajtor për gjendjen e vazhdueshme atje, e që së fundi ka edhe indikacione të zhvillimeve, të them, pozitive, së pari pas ndërhyrjes me forca speciale dhe rënien heroike të policit Enver Zymberi, kur edhe u kthye kontrolli në dy pikat kufitare 1 dhe 31 si dhe që filloi zbatimin e pjesërishëm të ligjit në veri.

Me rëndësi është edhe fillimi i bisedimeve, por njëkohësisht edhe integriteti i strukturave deri atëherë ilegale në Policinë e Kosovës si dhe në emergjencë.

Se cilat metoda e mjete do të përdorin ekstremistët serbë në veri, duke filluar nga ndarja dhe bllokada në lumin Ibër me roja të urës, pastrimin etnik në veri, pastaj ndërtimet në të ashtuquajturin “Parku i paqes” dhe pas “Parkut të paqes”, statuja e Carr Llazarit, pas Llazarit ndërtimi ilegal i vendbanimit të veriut, tashmë në fund edhe muri i ndarjes, si kushtëzim i radhës.

Në Policinë e Kosovës duhet ta kujtoj atë kohë, pra vitin '99 kur filloi krijimi i policisë lokale apo Shërbimit Policor të Kosovës, unë isha atëherë udhëheqës i asaj gjenerate, pra me 176 pjesëtarë, ku filluam punën në gjithë Kosovën, ndër to edhe në veriun e Mitrovicës dhe më kujtohet edhe tregimi i një zyrtari policor i përkatësisë etnike malaziase, i cili në vitin 2000, duke përcjellë një familje shqiptare në banesën e tyre në veri të Mitrovicës u sulmua brutalisht nga strukturat ilegale të MUP-it në prani të policisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it francez.

Nga kjo ndërhyrje pësuan familjet shqiptare dhe polici i Shërbimit Policor të Kosovës.

Ndërsa, këto dy strukturat e sigurisë ndërkombëtare ishin njëmend vëzhgues pa ndërmarrje të asnjë veprimi mbrojtës.

Lidhur me këtë ngjarje dhe shumë raste të tjera, sa isha atëherë në Shërbimin Policor të Kosovës, kam dërguar informacione te liderët tanë politikë dhe autoritetet ndërkombëtare të sigurisë, por që asgjë nuk u ndërmor për ta ndryshuar gjendjen atje.

Për mua nuk janë shumë shqetësuese veprimet destruktive të ekstremistëve serbë, por çka po ndërmarrim ne si autoritete të sektorit të sigurisë dhe të ekzekutivit atje. Veriu është bërë si “Perëndimi i egër” dhe sinonim i së keqes.

Dhe, sa jemi ne prezentë atje dhe a po i zbatojmë detyrat dhe autorizimet shtetërore, dhe jo vetëm të sigurisë, por edhe qasjet në aspektin e zhvillimit ekonomik, kulturor, sportiv dhe formave të tjera të bashkëpunimit me veri.

Sa nga ne kemi shkuar zyrtarisht në veri? Tash së fundi, ishte edhe kryeministri që shkoi, por Komisioni ynë për Punë të Brendshme, Siguri dhe FSK vizitoi veriun e Kosovës dhe vizituam Policinë e Kosovës. Mund të them se ata na informuan përgjithësisht për gjendjen e sigurisë atje, me gjithë ato problematikat që janë specifike për pjesën veriore, por sido që të jetë, nuk është gjendja ashtu krejt e zezë, ashtu si përshkruhet edhe në mjetet e informimit tonë, sepse pa shkuar e pa e parë gjendjen reale atje, njeriu nuk mund të flasë në bazë perceptimeve apo përshkrimeve nga të tjerë.

Pra, mendoj se ne duhet të jemi më shumë si qytetarë, por veçanërisht si Komision Funkcional i Kuvendit të jemi më shumë prezentë në veri, flas për ne nga Kuvendi, por njëkohësisht edhe autoritetet e ekzekutivit, në këtë rast sektori i sigurisë, pa marrë parasysh i cilit nivel, duhet të jenë prezentë aty, sepse nuk është edhe ashtu si po prezantohet gjendja.

Shqetësimi im është edhe diku tjetër: kur dhe si e kuptuam ne apo morëm informacionin për murin atje? A është dashur të dimë para se të fillojë ndërtimi i urës dhe a ka mundur të pengohet paraprakisht ndërtimi i saj? Me këtë aludoj edhe në atë se tash, kur kemi arkitekturën e plotë të

sektorit të sigurisë vendore, me autoritetet përgjegjëse kompetente, si funksion sistemi i hetimit inteligjent, do të thotë edhe nga shërbimi i inteligjencës, por edhe nga Policia e Kosovës për shqyrtimin apo pranimin e informacionit në sistemin e analitikës, distribuimit dhe informimit të autoriteteve kompetente, si dhe masat që duhet t'i ndërmarrin për raste të caktuara.

Unë, por edhe të tjerët, pyesim se ku është transparenca e institucioneve dhe autoriteteve të sektorit të sigurisë për dukuritë që mund të krijojnë shqetësim në opinion, sikur që është muri në veri. Ne kemi pasur edhe rastin tjetër, rastin e Kumanovës, për çka edhe ka mbetur i paqartësuar deri në fund.

Përveç informimit të drejtë dhe me kohë të opinionit, ekzekutivi me faktorin ndërkombëtar prezent si mision në Kosovë, në këtë rast Brukselin, duhet ndërmarrë masa të menjëhershme për parandalim të ndonjë dukurie, por edhe masa të tjera, pra të reagimit.

Mbështes iniciativën e zotit Pal Lekaj dhe njëkohësisht edhe të Aleancës që ndërmjet këtij debati të shprehim reagimin tonë edhe nëpërmes një rezolute që do të miratohet dhe me të ta obligojmë ekzekutivin dhe faktorin ndërkombëtar për ndërmarrjen e masave të duhura lidhur me largimin apo rrëzimin e murit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, meqë e kërkoi fjalën. Urdhëroni!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Në fjalimin tim pak më herët vërtet, jo pse desha të kursej ministren Tahiri, por për shkak të lodhjes së deputetëve, sinqerisht, edhe për shkak të efikasitetit të punimeve të Kuvendit në këtë rast. Por, pse po nguteni, zonja Tahiri, ta merrni fjalën vetëm për të dalë e të thuash diçka.

Sinqerisht, qysh ditën kur është ndërtuar muri, ju jeni ngutur, si zakonisht, prej kur e keni marrë këtë detyrë që jua ka dhënë Hashim Thaçi fillimisht, presidenti aktual, kryeministri Mustafa që ju ka lënë vetëm, sikur çdoherë që ka ditur, e po nguteni ta merrni fjalën. Edhe këtu jeni ngutur edhe atëherë, qysh ditët e para të ndërtimit të këtij muri ju keni deklaruar nëpërmjet radios, nëse s'gaboju në Radio-Dukagjini, dhe ju kam dëgjuar, keni thënë: "Muri do të rrënohet komplet para mbajtjes së interpelancës".

Ne e kemi thirrur interpelancën më 9 dhjetor, po ju citoj. Sinqerisht ajo nuk ka ndodhur dhe sikur të kishit pasur diçka të re sot të na ofroni, kishte qenë mirë të dilni e ta thoni. Përndryshe, kishit bërë mirë të mbani shënime, dhe në fund, sa për të thënë, dy fjalë.

KRYETARI: Faleminderit! Bislim Zogaj dhe Fisnik Ismajli, në fund e ka fjalën.

BISLIM ZOGAJ: Përshëndetje, kryetar!

Realisht unë prej momentit që e kam shtypur sustën për të marrë fjalën, pothuaj të gjitha ato që desha t'i them, u thanë.

Dhe, mbeti pa u thënë ajo që zakonisht disa tema që po hapen me qëllimin më të mirë, shpeshherë po keqpërdoren dhe pastaj, mendoj se edhe po bastardohet i gjithë ai qëllim i mirë nga ndonjë grup apo individ. Prandaj, po them, po bastardohen, sepse këtu që 7-8 orë që jemi duke diskutuar, në shumtën e rasteve janë përsëritur gjërat, në të shumtën e rasteve janë thënë ato që duhet të thuhet dhe ato që nuk duhet të thuhet, por mendimi im është se sa i përket temës konkrete, ai mur duhet të hiqet.

Sa i përket bastardimit, vërtet nganjëherë është goxha vështirë të qëndrosh në këtë seancë, sidomos kur dëgjohen disa diskutime të disa deputetëve dhe ta kisha marrë shembull, po të flasë Lahi Brahimi për trimëri, besoj jam i gatshëm të pres me orë të tëra ta dëgjoj, sepse e ka dëshmuar trimërinë.

Mirëpo, kur po ia nis Visar Ymeri të flasë për trimëri, për besë, e vështirë. Bile Visar Ymeri kur po ia nis të flasë për trimëri dhe nganjëherë me një fjalë kur po thotë: “edhe mosmirënjohja dënohet”, pra frikohet prej mosmirënjohjes, kurse një ditë Kadri Veselit i tha: “Pushka top t’u bëftë”!

Tash them, a është trim apo është frikacak? Mua po më mbetet të dyshoj se është frikacak, sepse kur ka qenë koha, Visari s’ka qëndruar këtu hiq. Mund të thotë: “Po s’kam qenë”. E ai që ka dashur të luftojë ka ardhur prej Amerikës, e ky këtu ka qenë e s’ka guxuar dhe tash prej dy fjalëve frikohet.

Pra, për mendimin tim, është frikacak dhe aman mos na mbaj ligjëratat të trimërisë, sepse prej frikacakut ka vetëm sherr. Më falni, ndoshta e zgjata!

KRYETARI: Faleminderit! A ka replikë? Ka! Fisnik Ismajli e ka fjalën.

FISNIK ISMAJLI: Është fatkeqësi të dish që do tipa çohen e bëjnë një mur atje dhe e bëjnë punën të mblidhemi dhe ta bëjmë një debat kaq të gjatë e kaq të rëndë, e madje-madje të shkohet më larg dhe, mbase s’shkohet, të bëhet edhe temë në Bruksel dhe prej kësaj në fund humb Kosova, që nuk është hera e parë. Dhe, kjo kallëzon çfarë shteti kemi. S’kemi shtet hiq.

Unë sot e lashë fjalimin për në fund, qëllimisht, sepse disa prej jush ndoshta do t’i duket pak më jashtë temës dhe pak më personale, e ndoshta edhe është, por po dua ta përmbyll sot, pasi edhe është fund i vitit dhe është seancë e fundit dhe, në fund të fundit, ka lidhje me Mitrovicën. Dua të flas me njerëz, të cilët e kanë ndërtuar Mitrovicën, para se të ndahet.

Mendoj se ky është një moment shumë adekuat dhe meqë pikërisht sot janë bërë 5 javë prej se ndërroi jetë një burrë i mirë, një veprimtar që ka dhënë shumë për këtë shoqëri, e i cili është përfolur në këtë sallë disa herë dhe i është lakuar emri. Asnjëherë pa e pasur rastin të jetë prezent këtu, për t'i thënë disa fjalë vetë, sepse ai vendosi të shkojë në heshtje.

Po unë, si bir i tij, ia kam borxh Muharrem Ismajlit, familjes së tij, posaçërisht kësaj Kosove, e cila nganjëherë harron se Kosova ka pasur edhe para lufte, t'i kujtohet se edhe atëherë ka pasur heronj.

Ka pasur burra të mirë, të cilët janë sakrifikuar dhe kanë kontribuar, duke vendosur themele të një shteti të ardhshëm, në të cilët na është dashur sot të ndërtojmë, e jo ta rënojmë.

Muharrem Ismajli ka qenë një prej tyre. Ishte një prej ekonomistëve më shumë të Kosovës, një intelektual, i cili me shumë mund gjatë shumë vjetëve të karrierës së tij ka udhëhequr organizata që e kanë ndërtuar këtë shoqëri. Ai e ngriti Fabrikën e Amortizatorëve deri në suksesin më të madh të saj, ndonjëherë, duke eksportuar pjesë për prodhimin e amortizatorëve për kompaninë e famshme të veturave "Peugeot" në vitet e 80-ta.

Të njëjtën fabrikë, që ju e shitët, pothuajse për kurrgjë. Veç pajisjet në atë fabrikë, ashtu të vjetruara, kanë kushtuar më shtrenjtë se çmimi me të cilin është privatizuar komplet kjo fabrikë para pak vitesh, e atij, shumë i është dhimbsur kjo.

Muharrem Ismajli ishte edhe kryetar i klubit futbollistik Prishtina, në vitet më të mira të saj, kur janë korrur fitore në mes të Beogradit, me një trajner i cili shumë vite më vonë edhe është shpallur më i miri në botë.

Po e citoj babanë: "Fis, në atë kohë janë mbledhur më shumë tifozë jashtë stadiumit të Prishtinës, sepse nuk kishin bileta të futen brenda, se sa që i sheh sot në tribuna". Ishin këto suksese në futboll që sot rrafsh 30 vjet më vonë ju s'po mund t'i arrini.

Babi ka qenë edhe guvernator i Bankës Popullore të Kosovës, pastaj drejtor i "Bank-kosit", deri e hoqi regjimi i Milosheviqit me masa të dhunshme më 1989, si krejt shqiptarët e tjerë. Po, jo pa u ndihmuar shumë qytetarëve t'i shpëtojnë kursimet e tyre, pak para se t'i mbyllë Serbia ato banka dhe duke i marrë paratë e njerëzve të fituara me djersë, para të cilat ju sot e kësaj dite nuk jeni në gjendje t'i ktheni prej Serbisë, por jo pa ndihmuar të ndërtohet Pallati i Rinisë në Prishtinë, Pishinën e Prishtinës, shumë fabrika e institucione të tjera në Kosovë, përfshirë edhe shkolla gjithandej, madje edhe në Drenicë, objekte këto plot prej të cilave i keni privatizuar me mënyrat më të dyshimta, dhe i keni kallur dëshmitë.

Lista është shumë e gjatë dhe nuk ka njeri në botë që ia mohon atij këto vepra. Në këtë sallë ka edhe deputetë që e kanë njohur personalisht babain tim, si njeri, dhe e keni respektuar për punën dhe veprën e tij, që nuk i dolët në mbrojtje kur disa këtu në Kuvend shpifën për të, unë ju kuptoj. Ishte, sepse unë i përkas një subjekti tjetër, atij të zëshmit, të drejtit, sepse babi më ka mësuar gjithmonë të jem veç i drejtë dhe i guximshëm. Sepse, ishte pikërisht Muharrem Ismajli ai që ka pasur guximin t'i bëjë ballë Milosheviqit, kur ky i fundit ishte në kulmin e pushtetit të tij. Asokohe e mbaj mirë unë, isha shumë i ri, 17 vjeç.

Për të arsyetuar vjedhjen e kursimeve të shqiptarëve prej bankës së Kosovës, serbët e akuzuan babanë se i ka marrë paratë dhe ka ikur jashtë vendit. Por, ai nuk lëvizi nga Prishtina asnjëherë, e dëshmoi të kundërtën.

Prandaj, për të shpifjet, këto të fundit që ndodhën në Kuvend, nuk ishin kurrgjë e re. I keqi, shpesh më ka thënë, për t'i mbuluar të zezat e tij gjithmonë do të mundohet ta njollosë edhe të drejtin e faqebardhin. Ky Slobodan Milosheviqi, gjatë gjykimit të tij në Hagë, e ka përdorur një strategji: e ka sulmuar klasën intelektuale shqiptare të atëhershme, në mënyrë që ata sot prej juve të quhen "njerëz të Serbisë".

Gjatë krejt gjykimit të tij ai ka përmendur mbi 40 mijë emra të intelektualëve shqiptarë, të cilët pastaj të njollosur prej këtij monstrumi kanë heshtur për të mos pësuar familjet e tyre edhe prej jush.

Një prej atyre intelektualëve ishte edhe babai. Ai ka heshtur për të mos pësuar as unë nga ju. Por unë nuk jua kam frikën, prandaj jam edhe këtu, ballë me juve.

KRYETARI: Regjia, ia ndërprisni, sepse po e keqpërdor foltoren. Po politizon, e unë ta dhashë fjalën me vetëdije dhe po thyej çdo rregullore vetëm për hir të humanizmit, e ti po sulmon, Fisnik. Fol vetëm për babanë tënd. Unë e dita pse po e kërkon fjalën, por mos sulmo. Shprehu qetë, ama fol vetëm për babanë tënd.

Regjia ia vazhdoni fjalën, por nëse vazhdon me akuza për njerëzit që nuk janë këtu, ia ndërprisni.

(Ndërhyrje)

Po për njerëz që nuk janë këtu po flet, Fisnik, të lutem! Fol për babain tënd dhe do të dëgjojmë secili prej nesh.

FISNIK ISMAJLI: Kjo ia dha mundësinë Hashim Thaçit dhe njerëzve të tij.

KRYETARI: Fisnik, je duke përmendur emra konkretë. Nëse ka mundësi, mos përmend emra, sepse s'janë prezentë dhe fol vetëm për babanë tënd. Unë s'po dua të jem mosrespektues për ndjenjat tuaja si fëmijë, pavarësisht cila është e vërteta e babait tënd, prandaj fol për babanë tënd. Ia lejoni fjalën, regjia.

FISNIK ISMAJLI: Kjo u dha individëve në pushtet jo vetëm për të zhdukur klasën intelektuale në Kosovë, por për ta vendosur veten në këtë pushtet, prandaj ju jeni ku jeni, kështu qysh jeni.

Ishte ky pikërisht qëllimi i Milosheviqit, t'i largojë të diturit dhe t'i fuqizojë të paditurit.

Sot, pa kurrfarë fakti e dëshmie shumë prej juve ia bëni si Milosheviqi, vazhdoni t'i eliminoni kundërshtarët, intelektualët, duke i quajtur "udbashë", duke i quajtur "komunistë", duke i quajtur "kumbarë të Slllobës" e "bashkëpunëtorë të Serbisë". Derisa po ia ktheni Kosovën me duart tuaja Serbisë.

Këso shpifje, meqenëse zoti Latif Gashi është këtu. Më falni, Nuredin Ibishi. Edhe Latif Gashi...

KRYETARI: Fisnik, të lutem, mos ta prishim, jemi kah fundi. Merre përgjegjësinë, nuk po ndalesh duke përmendur emra, për njerëz të cilët nuk janë këtu.

FISNIK ISMAJLI: Të lutem mos më ndërprisni! E sheh edhe vetë ku do të dal. Kryetar, të lutem, mos paragjyko, të lutem!

KRYETARI: Mos përmend emra, Fisnik, vazhdo.

FISNIK ISMAJLI: Zoti Nuredin e ka konfirmuar se babën tim e kanë ndalë gjatë kohës së luftës në një post-blok, e besoj se edhe ju e dini këtë punë, i keni gjetur revole dhe pas pak e keni lëshuar. Babi i ka urreyer revolet. S'ka pasur shans të ketë pasur.

Po unë, gjithmonë kam dashur ta di një send prej juve. A keni pasur ndonjë dëshmi për këtë? Dhe, pasi s'është zoti Latif, atëherë kjo pyetje ju shkon juve, nëse doni ndonjëherë të përgjigjeni. Pse nuk ia keni marrë revolen, pse nuk e keni arrestuar nëse ishte bashkëpunëtor i Serbisë, pse nuk e keni përmendur asnjëherë deri sa u bë djali deputet e kundërshtar juaj politik? Kjo po më intereson mua. Pse keni folur gjëra të pavërteta për të?

E mbi të gjitha, ju kisha pyetur: Qysh e keni lejuar djalin e një bashkëpunëtor i Serbisë t'u bashkëngjitet radhëve të UÇK-së? Qysh? Unë kam qenë ushtar në Brigadën "Agim Ramadani" dhe i kam raportuar direkt Rustem Berishës dhe Anton Çunit. Të dytë janë deputetë në këtë Kuvend, në dy subjekte të ndryshme. Të dytë e kanë ditur djali i kujt jam. Të dytë ma kanë besuar një prej detyrave më të ndjeshme strategjike dhe konfidenciale të Betejës së Kosharës, të

cilët, nëse donë, ju tregojnë vetë, e kam kryer me përgjegjësinë më të plotë pa dështuar asnjëherë. Kush kishte guxuar t'ia jepte tërë këtë përgjegjësi djalit të një udb-ashi?! Më tregoni! Askush, po ju them që tash.

A e dini pse? Sepse njerëz si Muharrem Ismajli i kanë bërë më shumë rezistencë Serbisë atëherë, ashtu të robëruar, se që po bëni ju sot në liri.

Prandaj, ju që shpifët për Muharrem Ismajlin këtu në Kuvend, bashkë me ata pisat në mediat, dhe po ju them pisa me dy kuptime të fjalës....

KRYETARI: Regjia, ia ndaleni fjalën! Fisnik, e keqpërdore... E unë po shoh se çdo mirësi të njeriut, e Albini edhe po qesh, sepse është krenar për këtë, dhe është si taktikë Albin, a? Ke fituar shumë!

Fisnik, jo vetëm se po krijojnë aversion edhe më shumë se sa ka qenë më herët. Je duke e abuzuar Kuvendin. Profesor, është duke e abuzuar edhe kryetarllëkun tim.

(Ndërhyrje)

Urdhëro, Fisnik, ndali fyerjet dhe shpreh atë që po flet, ka shumë debat për Mitrovicën, por deshe për babain tënd, urdhëro, vazhdo, por të lutem, mos fyej, dhe emrat, pasi s'janë këtu, mos i përmend.

FISNIK ISMAJLI: Dy paragrafë i kam! Dhe, e pata me njerëz që shpifën për të. Pse po ma ndaleni kur mendoni se s'ka njerëz që kanë shpifur për të, dhe atëherë mos ma ndaleni. Unë për ata që shpifën për babën tim...

Dhe, një po e them, burra të ndershëm si Muharrem Ismajli s'do të bëheni kurrë, e intelektualë edhe më hiç. Dhe sot, jeni duke shndërruar në diçka, kurse Muharrem Ismajli s'ka qenë kurrë bashkëpunëtor ië Serbisë. Fjala e tij e fundit me mua, pasi e pyeta se a e njohu personin që sa e vizitoi, njeriu i fundit që e vizitoi, fjala e tij ishte: Shpendi. Dhe, qeshi shumë, me plot shpresë. Dhe, Shpendi ishte aty, për ta parë. Kishte shpresë në gjeneratën e intelektualëve në ardhje, e cila veçse ka nisur ta ndërtojë këtë kryeqytet.

Dhe, sa të jemi gjallë ne, do të sigurohemi se njerëzve që kanë kontribuar për Kosovën me dekada edhe para lufte, atëherë kur Mitrovica ishte qytet, e Trepça ishte krenari kombëtare, do t'u jepet respekti i merituar. Natën e mirë!

KRYETARI: Unë, edhe si kryetar, nga pjesa e fundit do t'i thosha vetëm dy-tri fjalë. Edhe Fisniku u lut, dhe ndoshta vetë natyra ime shpeshherë mundohem në aspektin njerëzor, unë e di

se ka dhembje për prindërit e vet, e ai e ka prind, siç kemi edhe ne të gjithë prind, historia e secilit është për vetvete.

Por, u kërkoi falje të gjithë atyre që nuk kanë qenë këtu, e që janë përmendur. E të tëra këto çështje kanë mundur të përdoren në media dhe të kërkohet dialog e komunikim.

Vazhdojmë. Zoti Ibishi, a e do fjalën? Urdhëroni!

NUREDIN IBISHI: Zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti deputet Fisnik Ismajli,

Ju e dini fort mirë kur e kam marrë fjalën, unë kam qenë jashtë, në bufe prapa. Në TV më është drejtuar Lata, shef i Shtabit, nëse të kujtohet ai moment. Unë kam hyrë brenda dhe duke përfillur atë që më është përmendur mua emri si shef i Shtabit, e realisht s'kam qenë atëherë shef i Shtabit, ka të bëjë me shtatorin, pjesën e parë të muajit shtator të vitit 1998 dhe kam qenë komandant i Brigadës 151 "Zahir Pajaziti".

Dhe vërtet i kujtoni mirë fjalët që i kam thënë unë, kur e kam marrë fjalën. Do të thotë është raportuar se zoti Muharrem Ismajli është gjetur, të kuptohemi, unë s'kam qenë prezent. Kështu e kam thënë dhe të mos më ndryshohet përmbajtja, se ashtu ka qenë raporti: "Muharrem Ismajli është gjetur me një automjet pasi ka qenë një aksident te Lupçi i Poshtëm aty diku, dhe ka devijuar nga rruga për shkak të aksidentit". Atëherë ishim në pritje të një ofensive të shtatorit, u është gjetur atyre, dhe tash unë s'mund ta personifikoj cilit, një revole në automjet dhe disa, një sasi e madhe e të hollave. Tash çfarë kanë qenë atëherë, nuk mund ta di. Dhe këtë raport e kam marrë.

Vetëm një moment, të përfundoj. Dhe kam kërkuar falje në paraqitjen time të dytë që s'ka pasur të bëjë me kurrfarë ndërhyrje tjetër, se e kam njohur Muharremin dhe nuk kam dashur të ndërhyj në aspektin e duelit verbal mes Latës e teje. Të kujtohet mirë që e kam thënë këtë në ndërhyrjen e dytë.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: A vazhdojmë seancën, ju lutem, të kthehemi në seancë. Urdhëro, zoti Ibishi, vazhdo.

NUREDIN IBISHI: Pyetjen e bëre, Fisnik, nëse mund të ma përsëritësh. Ndoshta pate një pyetje të veçantë?

(Ndërhyrje)

Shiko, unë nuk kam qenë në vend të ngjarjes. Unë e kam marrë si raport dhe atë ta kam thënë herën e kaluar. Unë e kam marrë si emër Muharrem Ismajli me disa serbë dhe një revole brenda me një sasi të hollash, si informacion e kam marrë, jo si prezent në vendin e ngjarjes.

KRYETARI: A ka mundësi ta përfundojmë. Zoti Ibishi, a e përfundojmë me këtë. Shkojmë te pjesa e debatit, sepse janë lajmëruar në ndërkohë deputetë që s'e kanë marrë fjalën.

Shaip Muja, fjalën e ke pasur. Reagim, emri nuk t'u ka përmendur. Të kisha lutur ta tërhiqni.

Fisnik Ismajli e ka pasur fjalën. Nehat Baftiu, a ke diskutuar? Urdhëro, fjalën e ka Nehat Baftiu dhe do ta marrin vetëm këta që s'kanë folur deri tani.

NEHAT BAFTIU: Kërkoj falje që në këto orë të vona marr kohë për të folur, por unë shfrytëzoj rastin që t'u uroj të gjithëve, miqve e shokëve, festën e Krishtlindjeve.

Dhe, desha një pyetje për ministren, por s'e di a mbeti këtu, apo shkoi? Desha vetëm një pyetje lidhur me atë që tha se është e kushtëzuar Serbia për integritet evropian. E tha me bindje, sepse unë e kam një bindje krejt tjetër, se ajo është e kushtëzuar dhe është e lidhur këmbë e krye me Rusinë, dhe nuk i duhet hiq integriteti evropian Serbisë. Faleminderit!

KRYETARI: E, në qoftë se vjen ministrja, ju përgjigjet. Në ndërkohë, zonja ministre e ka fjalën. Janë edhe 2 deputetë që s'e kanë marrë fjalën, Blerta Deliu-Kodra dhe Elmi Reçica.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Më mbeti cigarja përgjysmë, por e bëtë një relaksim shumë të mirë. E bëtë një relaksim të mirë me urimin për Krishtlindje, e edhe unë dëshiroj t'i uroj të gjithë besimtarët.

Tani përgjigjen! Bashkimi Evropian i ka vendosur Serbisë Kapitullin 35. Çdo shtet për integritet evropian i ka 34 kapituj, e Serbia e ka edhe Kapitullin 35, i cili fund e krye e kushtëzon Serbinë me zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të pazbatuara, shfuqizimet ligjore të strukturave paralele si dhe kushtëzon Serbinë që ta arrijë një marrëveshje ligjërish të obligueshme me Republikën e Kosovës, dokumentin e keni edhe në ueb-faqen e Bashkimit Evropian, por edhe unë jua dërgoj dokumentin me e-mail juve dhe të gjithë deputetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti deputet, ke të drejtë reagimi.

NEHAT BAFTIU: Më fal nuk ishte pyetja ashtu, se e kam lexuar, edhe ashtu është qysh e thotë. Por, unë e thashë, pas të gjitha këtyre kontakteve dhe takimeve me delegacionin serb e ka ende bindjen që Serbia është e interesuar për Evropën, për Bashkimin Evropian, sepse me mish e

shpirt është e lidhur me Rusinë. Tash edhe armatimin e ka marrë prej Ruisë dhe çdo gjë ka bërë me Rusinë, ajo po më intereson mua. Qysh është përshtypja e ministres?

KRYETARI: Zoti deputet, po flasim për përshtypje tash. Urdhëro, zonja ministre!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Desha edhe pak ta zgjeroj përgjigjen time. Në Kapitullin 35, sa u takon të gjitha kushteve që janë paraqitur, janë në raportin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që ia kemi dorëzua Brukselit dhe ato janë bartë, janë bërë kushte, plus është shtuar kushti për marrëveshje të obligueshme ligjore.

Sa i takon ku është Serbia sot në raport me qëndrimet të integritit evropian nuk është e qartë në politikën e jashtme, është mes Moskës e Brukselit, kjo është situata e sotme. Mirëpo, është interesimi i Bashkimit Evropian, është edhe një vendim i takimit apo samitit të Selanikut të vitit 2003, ku të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ku përfshihet edhe vetë Kosova, Serbia dhe vendet e tjera, pra Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria, atë kohë ka qenë edhe Kroacia, por është bërë anëtare, Bosnja, të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian. Pse? Sepse është interes strategjik që ndikim rus të mos shtrihet më në Ballkan, pra Ballkani të jetë euroatlantik, ky është interesimi, mirëpo është vendimi i Serbisë a dëshiron të mbetet me Rusinë apo të shkojë në BE. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Reçica dhe zonja Blerta Deliu-Kodra, më nuk ka deputetë. Edhe nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti, ndërkohë po e kërkon fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti nënkryetar, Haliti,

E nderuar ministre,

Kolegë të respektuar,

Realisht jemi këtu që disa orë dhe po shihet që nuk jemi shumë në kondicion për të bërë debat, e le më për të bërë diçka më tepër për veriun e Kosovës.

Mirëpo janë disa çështje, të cilat vërtet pata nevojë dhe po e shoh të arsyeshme ta marr fjalën dhe t'i them disa fjalë, të cilat besoj nuk janë jashtë asaj që u thanë deri më tash.

Çështja, temën të cilën po e diskutojmë, është shumë e vërtetë që është shumë intriguese dhe është pjesa më e ndjeshme në Kosovën e pasluftës, do të thotë çështja e Mitrovicës dhe ne kur flasim për Mitrovicën, flasim për veriun.

Mirëpo, duke parë dhe duke përcjellë diskutimet çfarë kanë ndodhur në Mitrovicë dhe çfarë ka ndodhur në veriun e Kosovës dhe si ka ardhur deri te ajo, gjithnjë njeriut i shkon ndërmend sidomos t'i shohë konstatimet e disa nga kolegëve tanë të "Vetëvendosjes".

Çështjet të cilat janë thanë në vazhdimësi dhe realisht nuk janë të vërteta, por edhe ata të cilët i thonë e dinë që nuk janë të vërteta.

Për shembull, është thënë për NDSH-në që e ka krijuar OZNA, është thënë që Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve të Adem Demaçit e ka krijuar UDB-a, është thënë që Adem Demaçi po rri jo burgjeve të Serbisë, po nëpër hotele, është thënë që '81-shin e ka organizuar Rusia ose është thënë që Ali Lajçi po rri në Dubrovnik dhe jo nëpër burgje të Serbisë. E tash konstatimet e tilla që UÇK-ja ka qenë e krijuar prej Serbisë ose SHIK-u dhe BIA ose gjëra të tjera. Nuk e di se ku e merrni ju realisht atë informacion ose atë dezinformacion, ose ku e merrni atë guxim të deklaroni gjëra të tilla.

Dhe, është shumë me rëndësi që ju flitni pikërisht kur debatohet për Mitrovicën dhe për një urë, që është pasojë e shumë zhvillimeve, e shumë situatave dhe pikërisht tash flisni për atë çështje.

Dua të kthehem te debati, vërtet te interpelanca që u shndërrua në debat. Unë kam qenë jashtë vendit kur i nderuari zoti Lekaj më ka thirrur në telefon dhe ka kërkuar një mbledhje urgjente të Komisionit Parlamentar, ku jemi bashkë. E di që zoti Lekaj e ka pasur dhe e ka shumë sinqerisht atë angazhim, shumë sinqerisht e ka pasur këtë debat. Dhe, në vend se ne tash të debatojmë dhe të shohim a kemi ndonjë pikë ku jemi unikë, a jemi diku që do të duhej të jemi bashkë dhe kur garantohet dhe kur thuhet që tekstualisht ajo urë nuk ekziston në projekt, ai mur nuk ekziston në projekt, ekzistojnë vetëm sheshet e rrugët. Pse duam ne domosdo të krijojmë situatë të tillë që ka mure në ato projekte dhe ka një komplot të brendshëm, për çfarë arsye? A jemi të atillë që i gëzohemi çdo fatkeqësie që mund të na ndodhë në këtë vend, apo duhet të jetë e kundërta dhe pikërisht ata që janë më të zëshmit në atë që duan ta rregullojnë këtë situatë dhe këtë çështje.

Unë e përgëzoj zotin Lekaj për këtë debat dhe unë besoj që do të vijmë në përfundime të përbashkëta që janë në interes të këtij vendi, janë interes i Kosovës, interes i veriut. Shumë nga çështjet u përmendën dhe u theksuan, ne duhet të bashkëpunojmë, ta integrojmë atë vend, jo të debatojmë këtu se kush flet më shumë ose kush mund të shpifë më shumë. Nuk na bënë nder kjo, asnjëri prej neve dhe veçanërisht atyre që janë patriotë profesionistë. Veçanërisht ty, Glauk, po të drejtohem, t'i babain e ke pasur dhe e di çfarë është folur për babanë tënd, e ti pikërisht thua UDB-a, BIA, e gjëra të tilla. Po, jo, dëgjo, ti nuk duhet të flasësh, ti s'guxon të flasësh. Visarit i shkon, të kam thënë edhe një herë, po ty nuk të shkon, sinqerisht po të them, dhe po më vjen keq që po them, po pikërisht për atë, në situata të tilla nuk duhet të përdorësh fjalor të tillë.

Unë dua të them, për fund, se ka shumëçka të diskutohet dhe ka shumëçka të thuhet.

Ne duhet t'i nxjerrim konkluzionet e përbashkëta dhe në qoftë se merremi vesh edhe për një riformatim të këtij dialogu dhe domosdo ministrja në një raportim para komisionit e ka thënë dhe e ka prezantuar si dokument dhe do të duhej të insistojmë këtë dhe do të duhej të veprojmë

bashkërisht, pikërisht ky është vendi, pikërisht ne jemi deputetë që përfaqësojmë të gjitha opsionet politike, kushtimisht të them.

Faleminderit! Edhe unë nuk kam çka të shtoj më tepër, por veç kisha bërë ftesë që vërtet të mos u gëzohemi gjërave të tilla dhe të mos u gëzohemi pse po ndodhin mure të tilla dhe gjëra të tilla në mandatin tonë qeverisës, së bashku me partnerët e LDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po, po, Glauk, Visar, Albin, Visar, reago, të lutem se unë po mundohem, po nuk po shoh. Tash e pashë. Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Është shumë mirë kjo, është një efekt pozitiv, do të duhej të gëzohesh edhe ti.

Për zotin Reçica, një gjë që mbase po do ta keqkuptosh. Atë që e thamë ne është si pyetje, si u bë që SHIK-u ka vepruar prej vitit 1999 në territorin e Republikës së Kosovës, ka qenë Shërbim Informativ i Kosovës apo jo, edhe asnjëherë nuk rastisi ta takojë BIA-në, UDB-në, që po thoni se është në territorin e Kosovës, se unë e pranoj që është, dakord jam, këtu jam dakord me juve, BIA-a, UDB-a janë këtu, po si u bë që nuk po takoheni kurrë ose që nuk jeni takuar deri tash? Kjo është për t'u çuditur, sepse keni vepruar në të njëjtin territor, të dyja kanë qenë shërbime inteligjente. Për BIA-në, UDB-në e dimë që punon për Serbinë, këtu jemi dakord të gjithë, SHIK-u si u bë që nuk e luftoi kurrë, kjo është pyetja.

Tjetra, pse u fol këtu edhe më herët, shiheni. Një gjë që këtu nuk po diskutohet, që po doni ta shmangni është se çka të bëhet me veriun? Si pyetje, si temë. Kjo është kryesorja. Mund të thoni ju çka doni: jo kemi qenë andej, kemi qenë kënde, çka do të bëjmë me veriu, çka do të bëhet me dialogun? A po e shihni që dialogu po e kthen nga pak-nga pak, pjesë-pjesë Kosovën nënë Serbi, në ndikimin serb, jo klasik, jo në mënyrë klasike të bëhet pjesë e Serbisë, po nën ndikimin serb. A po e shihni që dialogu po e shndërron Kosovën në sferë të interesit të Serbisë dhe kështu, natyrisht, që po e largon prej Shqipërisë. Për shembull, si u bë që Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk ia ndaloi Gjuriqit të hyjë në territorin e Kosovës, por Bojken Abazit dhe Dejona Mihalit po. Tash a janë këto veprime patriotike tuaja, përgjigjuni, kjo është pyetja, se kjo është duke ndodhur tash, ju për këtë s'po përgjigjeni. Ti na tregove historinë, dakord ne jemi edhe me historinë që tregove, ashtu ka qenë, është shpifur edhe atëherë, edhe sot ju shpifni qysh "Vetëvendosja" është e krijuar prej Ruisë, e jo bashkëpunon me këtë, e jo i kontribuon asaj. A po e shihni që ju jeni ata të cilët po i kritikoni për të kaluarën, ju sot veproni ashtu, ju mendoni sot ashtu. Ju sot na thoni që me bashkësinë ndërkombëtare do ta kryejmë këtë. Ne nuk kemi kaçik, shteti brirë s'ka, a po ju kujtohet, ky lloj ligjërimi politik, ju sot po e bëni këtë.

KRYETARI: Kundër-replikë, zoti Reçica, a po shkojmë nga përfundimi se edhe kështu u bë ora 24:00.

ELMI REÇICA: Një minutë,

E para, Visar, ju nuk e dini çfarë kemi bërë ne në atë kohë, ju s'e keni pasur shërbimin qysh e keni tash, tash e keni dhe i dini.

E dyta, çfarë kontakte, a e di si po ma rikujton kjo, ju jeni vonuar edhe atë aty, tash jeni duke i bërë ato gjëra të cilat kanë kaluar dhe ka qenë koha. Ka nga ju që kanë qenë në raporte edhe në kontakte dhe i dini shumë mirë. Po, në esencë, ne jem përpjekur të bëjmë punën më të mirë të mundshme, edhe në këtë aspekt dhe kur s'e kemi bërë vetë, shumë është e drejtë edhe çfarë e tha, se nuk kemi pasur kaçik as takat ta bëjmë vetë.

Çështja tjetër, të cilën ti e përmend, prej fillimit të dialogut është shumë e vërtetë, i numëroi edhe ministrja Tahiri, janë fakte konkrete, ka përparime. A është rrumbullakuar krejt procesi? Nuk është rrumbullakuar, por ka përparime jashtëzakonisht të mëdha. Është duke ndodhur proces i kundër. Një kohë ne nuk kemi guxuar as të shkojmë në veri, tash e kemi një kontroll kufitar, e kemi një doganë, e kemi një polici që së paku në hyrje i kontroll dhe i legjitimon. A janë zhdukur ose a janë shpërbërë të gjitha strukturat, është e vërtetë që s'janë shpërbërë dhe është e vërtetë që ka edhe këtu në Prishtinë, edhe në Graçanicë, edhe në vende të tjera që veprojnë kundër Kosovës dhe kundër këtij vendi, po mos i ndihmoni ju.

Ju me veprimet tuaja jeni duke i ndihmuar ata, me vetëdije ose pa vetëdije. Kaq!

KRYETARI: Kjo është stër-replikë, Visar, stër-replikë, Visar, merre fjalën, edhe pak edhe e përfunduar, edhe një deputet e kemi. Po tash na hidhërohen, mendojnë që po i lë pa fjalë. Fol, Visar, a bën një minutë, të lutem, të mos shkojmë gjatë. Të shkojmë drejt përfundimit, të lutem.

VISAR YMERI: Është e pakuptimtë të thuhet që mirë kemi punuar, ka rezultate pozitive, por punët i kemi keq, sepse po të kishte pasur rezultate pozitive, po të kishte ecur siç duhet procesi, atëherë kishin qenë punët më mirë. Pse nuk i kemi më mirë? Pse, për shembull, sot ne kemi forca politike që thonë se e përfaqësojnë Beogradin, kur deri dje kemi pasur forca politike që kanë thënë se i përfaqësojnë qytetarët serbë të Kosovës. A nuk është ky degradim dhe kjo ka ardhur si pasojë e dialogut vetvetiu. Pastaj, e përmenda edhe aty marrëveshjen për telekomunikacion, marrëveshjen për energjetikë. Kjo është kthim prapa, kjo është më keq se që ka qenë, ajo ka qenë prani ilegale, në vend se prania ilegale të shuhet ju e keni legalizuar ilegalitetin. Ky nuk është avancim, ky është regres, duhet ta kuptoni këtë. Nëse nuk e kuptoni këtë punët Kosova nuk do t'i ketë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj falje se ka kaluar ora 24 e natës, ndoshta një pjesë e madhe e diskutimeve janë thënë edhe prej kolegëve tanë deputetë. Fatkeqësisht, debati po shkon aty kah nuk do të duhej të shkonte dhe është për keqardhje që gjithmonë për tema kaq të rënda dhe të rëndësishme ne e bëjmë një tejkallim të tillë dhe merremi me çështje që fare s'janë preokupim yni si deputetë.

Unë e falënderoj kolegun Lekaj, sepse e kemi mbështetur në komision dhe mendoj që është rast i mirë që e ka sjellë këtë diskutim dhe këtë debat në Parlament. Ka qenë shqetësim i të gjithë anëtarëve të Komisionit për Politikë të Jashtme, dhe jo vetëm, edhe i deputetëve të tjerë. Ne kemi pasur takime të vazhdueshme dhe së fundi edhe me ministren për Dialog që ka qenë në Komision për Politikë të Jashtme, po ashtu edhe me KDI-në, dhe jemi munduar që në njëfarë forme t'i qasemi edhe me një vizitë të fundit që është organizuar nga kryetari i komisionit në atë pjesë dhe ku ka pasur takim me strukturat atje, por që fatkeqësisht nuk ka pasur informacione se do të ketë ndërtim të një muri, i cili ka ndodhur vetëm dy ditë pas vizitës së Komisionit për Politikë të Jashtme në atë pjesë.

Është e rëndë, është indinjues fakti që përkundër këtij dialogu të Brukselit, që është investuar me vite, tinëzisht dhe natën është ndërtuar një mur në Mitrovicë, në të cilin është i involvuar direkt edhe Brukseli. Mendoj se kanë kaluar më shumë se dy javë që nga ndërtimi i këtij muri dhe që ka pasur vetëm dhe vetëm një qëllim, vetëm e vetëm që të krijojë ndarje. Ndërkohë që nuk ka pasur veprime konkrete të institucioneve tona, ka pasur deklarata, të cilat i kemi dëgjuar nga zyrtarë qeveritarë, por që sot ky debat mendoj që e ka sjellë edhe një qasje të re dhe ne do të presim se cilat do të jenë zhvillimet e fundit në këtë drejtim.

Është pak për çudi hezitimi i institucioneve tona që të ndërmarrin hapa ndoshta pak më të shpejtë dhe të mos ketë vonesa. E kemi pasur një vendim të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe kam pritur që ky vendim do të zbatohet. Nga marrëveshja e palëve në Bruksel është e qartë se projekti për të cilën është arritur pajtueshmëri nuk parasheh kurrfarë muri, por parasheh vetëm dy rrethrotullime në të dyja anët e urës me të cilat nuk do të pengohet lëvizja e lirë. Po e them lëvizja e lirë, sepse vazhdimisht ka qenë njëra prej pengesave kryesore dhe qëllim i institucioneve ka qenë promovimi i kësaj lëvizjeje të lirë që qytetarët të lëvizin lirshëm në të dyja anët.

Rivitalizimi i urës në Ibër është paraparë që t'i bashkojë komunitetet dhe ta ofrojë lirinë e lëvizjes, muret nuk bashkojnë asnjëherë, as shoqëritë, as kombet, e aq më pak dy shoqëri, të cilat e kanë kaluar një fazë kaq të rëndë, këto mure do t'i ndajnë vazhdimisht. Mendoj që është e rëndë që 17 vjet pas luftës ne ende nuk kemi arritur që ta ndërtojmë një vend ku do të garantohet lëvizja e lirë. Kosova ofron shembuj të mirë të komunave tjera me diversitetin e saj kulturor, me atë religjioz dhe etnik që ka arritur t'i integrojë edhe komunitetet tjera, të cilat sa më shumë kanë

kontribuar drejt zhvillimit, por që po e them që ajo që po i ndodh sot vendit tonë, jo vetëm me mure ndarëse, por edhe ajo sot çka ndodhi në Parlament, është e papranueshme.

Kemi dëgjuar deklarata, edhe deklarata të përfaqësuesve, të cilët nuk janë këtu, që kanë dërguar letra në drejtim të seancës së sotme. Ne jemi përfaqësues të popullit dhe unë do t'i lexoj përherë shqetësimet, do t'i përçojë shqetësimet e qytetarëve këtu. Mendoj që ky mur, përpos që është agresion i hapur i Beogradit, është edhe dëshmi që ka zyrtarë të partive politike të papërgjegjshëm ndaj shtetit dhe Kosovës, por edhe ndaj sovranitetit të vendit, e të cilët sot gjatë gjithë ditës gojën e patën plot moral politik dhe plot akuza ndaj kolegëve të koalicionit qeveritar.

Koalicioni VV & AKR në Mitrovicë, së fundi i themeluar, e ka pranuar njëfarë forme që ky muri i turpit dhe ky mur i ndarjes të ridizajnohet. U tha edhe nga kolegët e mi paraprakisht, nga kolegët e mi deputetë këtu, këtë nuk po e them unë, këtë e kanë konfirmuar edhe vetë kryetari i Komunës së Mitrovicës, Bahtiri, dhe këtë mund ta gjeni në emisionin e tij në “Info Magazina”, të datës 9. 12. 2016.

Këtë fakt të rëndë vazhdon ta konfirmojë edhe homologu i Bahtirit në veri, Goran Rakiq, dhe përderisa ne si anëtarë të komisionit kemi kërkuar, e edhe deputetët tjerë, edhe zoti Haliti, sepse i kam dëgjuar deklaratat e tij, që ky mur të rrënohet, në atë pjesë është diskutuar se cili do të jetë formati i këtij muri, a do të ketë shkallë, sa centimetra do të zvogëlohet, por assesi nuk është diskutuar që ky mur ndarës të rrënohet njëherë e përgjithmonë.

Këtë marrëveshje, e cila e thashë është bërë ndërmjet zotit Bahtiri dhe përfaqësuesve të tjerë, e ka konfirmuar edhe vetë Bashkimi Evropian që nëpërmjet komunikatës në faqen e tyre zyrtare thuhet se BE-ja i ka takuar të dyja palët për t'i qartësuar çështjet të cilat kanë mbetur peng të implementimit të këtyre marrëveshjeve. Pra, të nderuar kolegë deputetë, “Vetëvendosja” bashkë me anëtarin e koalicionit qeverisës të asaj pjese, Agim Bahtirin, po del që në njëfarë forme e kanë pranuar edhe vetë një ndarje të Kosovës me atë mur për të cilin sot u fol aq gjatë.

Është mirë që kolegët tanë deputetë të Lëvizjes “Vetëvendosje” të na tregojnë për konferencat e përbashkëta që kanë mbajtur me Agim Bahtirin në Mitrovicë, e ku në njëfarë forme e kanë pranuar këtë marrëveshje për ridizajnimin e murit, por edhe lejimin e ndërtimit të shkallëve bashkë me Goran Rakiqin, që në njëfarë forme i tejkalon qartë kompetencat ligjore të tij si kryetar i Komunës.

Dhe, para se ta përbyll këtë diskutim, unë dëgjova me vëmendje të them rrëfimin e kolegut të “Vetëvendosjes” për prindin e vet. Unë i shpreh ngushëllime, sepse e kuptoj sa e rëndë është që ta humbë dikush një prind të vetin, por që u tentua që të moralizohet dhe madje edhe dje në këtë sallë të Kuvendit, njëra prej kolegeve deputete tha që “na keni lodhur me çështjen e veteranëve”, sot këtu u vazhdua që të thumbohesh ushtarët e UÇK-së, madje ushtarët e UÇK-së - themeluesit e

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - sot u quajtën “tradhtarë” nga po këta kolegë deputetë, dhe ata ushtarë kanë edhe fëmijë të tyre, të cilët do të kishin folur me të njëjtin ton dhe me të njëjtën gjendje emocionale siç foli kolegu im nga radhët e “Vetëvendosjes” sot. Fundja janë fëmijët, të cilët i kanë humbur prindërit e tyre në luftë, e të cilët sot janë ndjerë keq, madje më kanë shkruar mesazhe që ndihen keq që prindërit e tyre që dhanë jetën për këtë vend sot po quhen me emra “tradhtarë”.

Madje, u shkua aq larg, sa që ata u krahasuan edhe me Esat Pashë Toptanin. Merreni me mend, të nderuar kolegë deputetë, kur një ushtar i UÇK-së që e dha djersën, gjakun dhe mundin e vet krahasohet me figurën e Esat Pashë Toptanit dhe unë nuk di se deri në çfarë mase shkon kjo keqardhje. Unë po ndihem e turpëruar që sot në këtë Parlament i kam dëgjuar fyerjet më të ashpra dhe po bëj edhe një herë thirrje që njëherë e përgjithmonë të ndalen linçimet karshi ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Po e mbylli këtu me shpresë që ne do të kemi edhe diskutime, dhe do të kemi rekomandime nga kolegu Lekaj.

KRYETARI: A të ka përmendur? Xhavit Haliti e ka fjalën, nuk të ka përmendur Glauk. Çdo moment, partitë po e përmendin njëra-tjetrën.

XHAVIT HALITI: Edhe unë dua ta përshëndes debatin për murin, por nuk jam dakord që të diskutohej në këtë formë dhe në këto mënyra për një çështje që është problem i Kosovës, është bërë problem edhe ndërkombëtar muri, por unë mendoj që s’kemi nevojë të frikësohemi kaq shumë!

Çka po frikësohemi ne prej atij muri, se nuk e kanë pushtuar Kosovën. Serbia s’ka hy me forcë në Kosovë. E ka ndërtuar një mur shpresoj me material ndërtimor vendor dhe ai që është vendor e prishim prapë dhe nuk bëhet kiameti. Ne i kemi dy komuna andej, me Kushtetutë po flas, komuna veriore dhe kjo e jugut. Ata e kanë ndërtuar, s’po them kush e ka ndërtuar fizikisht, por dihet që e kanë ndërtuar atë mur dhe deklarimi decidiv i institucioneve të Kosovës është shprehje e mospajtimit të të gjithëve, kështu që ne po flasim dhe po mbetemi pa gjumë, por po shpresoj që ajo që e dëgjuam edhe nga presidenti, nga kryeministri edhe nga kryetari i Parlamentit do të realizohet.

Unë e kam një qasje krejt tjetër në këto raporte, dhe unë mendoj që nganjëherë po i kontribuojmë ne ndërtimeve të mureve këtu në Kuvend me diskutime tepër nacionaliste dhe duke pasur parasysh, duke mos e marrë parasysh që ne e kemi edhe një komunitet mjaft të madh serb në Kosovë, me kompetenca të caktuara dhe pa të cilin realisht Kuvendi si institucioni më i lartë i vendit është i mangët për shumë arsye. Edhe nëse nesër ju zotërinj të “Vetëvendosjes” e merrni

pushtetin keni për të qenë me ta në pushtet, s'e s'keni për të mundur vetë të sundoni, se nuk ju lejon as Kushtetuta dhe s'keni për të mundur pa ta.

Politikat ndryshojnë në hapësirë dhe në kohë, dëshirat mbeten dëshira, por në politikë më vjen keq, por nuk bëhet politikë me këtë mentalitet. Kufijtë e shqiptarëve kudo që janë nuk i ka caktuar asnjëherë shqiptarët, ju e dini atë dhe meqenëse është kështu e kemi një situatë që e kemi, po luftojmë së bashku, po angazhohemi së bashku maksimalisht, por jo duke pretenduar që jemi të fortë dhe desha ta ndryshoj pak me një batutë: Kishte qenë pirë lepuri njëherë, dhe çohet e doli në pazar, thotë e kam rrahur luanin e kam mbytur. E kam rrahur mbrëmë e kam rrahur, nejtë mirë boll. Të nesërmen ishte lodhur lepuri prej pijes dhe ishte ulur, cucërruar një vend, dhe po vjen luani andej, i thotë: “Hë lepur, çka ka?”. Lepuri ia kthen: “Eh kjo goja ngrëntë ashtu, a po e di, se po flet nganjëherë, po flet kur po pihet”.

Kështu që nuk është mirë të flasim ne si ta kemi ndonjë farë fuqie ku ta di se çfarë, e kemi këtë mundësi që e kemi, kemi aleanca të cilat nëse i ruajmë janë në interes tonin të madh. Është hera e parë në historinë e kombit shqiptar që prej 7 fuqive veç një e kemi kundër. I kemi me ne dhe nuk është mirë t'i humbim, t'i humbim me veprat tona, me veprimet tona, duke u përpjekur që të bëjmë më shumë, nganjëherë pa qëllim të keq i bëjmë dëm vetes.

Unë e di që është shumë lehtë të thuhet të ndërpritet dialogu, por në këtë shekull që jemi popujt po dialogojnë, është lëvizja populiste që e tha dikush këtu, po fuqizohet në Evropë dhe është shqetësim i madh, ashtu siç po fuqizohen ata që larg qofshin, s'po i përmendi hiç, dhe që kanë sjellë shqetësim në rajon, kanë sjellë shqetësim në Evropë dhe janë kërcënuar që për sa orë mund ta marrin Evropën.

Tani në këtë zallamahi, ne i kemi hallet tona dhe e dimë me kë jemi dhe kush është me ne, prandaj nuk kisha për të thënë që është e mirë që të përcaktohem për politikën, të cilat nuk i sjellin kurrëgjë të mirë Kosovës, nuk na sjellin asnjë mundësi që t'i bashkojmë politikën për interes të vendit, sepse kur kemi kaq shumë diferenca njëri me tjetrin, kur e kundërshtojmë njëri-tjetrin për gjithçka, atëherë normalisht që të tjerët përfitojnë dhe lind pyetja kush përfiton. Kush përfiton? Ne apo ata që duan të na mundin dhe realisht, po u përplasëm bashkë atëherë ata janë më të fortë se ne.

Unë po çuditem pse po prodhojmë veç urrejtje. Pse? Dhe pse gabimet tona po i arsyetojmë si suksese. Pse u dashka që të themi në Parlament që gazi ka qenë më i mirë? Për çka?! Kur nuk ka qenë i mirë, kur përveç asaj, përveç që na keni helmuar, na keni shurdhuar, në krejt botën ka qenë pasqyra më e keqe e mundshme e Parlamentit të Kosovës. Dhe, s'keni arritur bash kurrëgjë. Sepse, i kemi pasur institucionet, institucionet janë përcaktuar, të tri këto duhet të ndodhin: edhe muri do të rrëzohet, edhe demarkacionit do të bëhet, edhe Asociacioni sipas Kushtetutës së Kosovës do të bëhet.

Tani, ju thoni, për shembull, për demarkacionin, kryeministri tha të matet Kosova, sa kemi hapësirë tokësore. Ok! Unë e di që ka mundësi, por pse të mos matet. Nëse janë aq, në rregull jemi, nëse janë më pak, unë e kam thënë edhe një herë: Mali i Zi po thotë na u ka shtuar toka, ne po themi na u ka shtuar. Të këqyrim kujt iu ka shtuar, e kujt iu ka munguar. Ka mundësi. S'ka nevojë që të përlahemi ndërmjet vete këtu dhe s'ka nevojë të mbetemi deri në gjysmë të natës këtu duke u shtyrë se kush ka qenë më patriot dhe kush s'ka qenë.

Unë besoj që asnjëri këtu nuk është që s'e do Kosovën, asnjëri këtu nuk është që ka problem, e dëshiron atë mur, unë mendoj që strategjikisht ai mur e ka një pengesë krejt tjetër dhe me qëllim krejt tjetër, jo ndarjen e Kosovës, por të mos hyj në anën profesionale të tjetërkujt, por dua të ju bëj thirrje që në momente të tilla kur kemi situata të tilla të gjejmë kanale për t'u ulur, për të biseduar pa kamera, pa zhurmë, që të vijmë në një konkluzion dhe sipas asaj që ekspertët e fushave na referojnë dhe mund të bisedojmë.

Po besoj që organet e specializuara të Kosovës kanë informacione më shumë se ne, se ne po informohemi prej medieve, prej portaleve, por nganjëherë edhe po na dezinformojnë. Andaj, unë edhe një herë dua që të besoj që muri në Mitrovicë do të hiqet në variantin më të mirë dhe dua të besoj që ta dimë rëndësinë se çfarë rëndësie ka që ne ta respektojmë komunitetin serb në Kosovë dhe t'i respektojmë deputetët serbë që janë në Parlamentin e Kosovës. Mendoj që është interes i Kosovës dhe edhe ata besoj, nëse gjejnë respektin tonë, do të jenë vërtet kosovarë dhe duhet të bëhen kosovarë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kërkoj falje...! E unë, në qoftë se e kisha pasur mirëkuptimin tim, para se të flasë propozuesi i seancës, do ta kisha marrë fjalën tre-katër minuta, në qoftë se ka mundësi. Lidhet pikërisht me çështjen e kësaj seanca, këto që biseduam dhe disa çështje, se s'mund të replikoja në çdo deklaram, i cili ishte, i cili ndërli dhej çdoherë, ose me emrin tim, nuk flas për të partisë, ndërli dhej drejtpërdrejtë Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Mirëmbërëma prapë, të gjithëve, ose mirëmëngjesi, sido që të jetë, ky është obligimi ynë.

Zoti Pal Lekaj,

Ne sot për diku rreth 8 orë, më shumë se 8 orë, 9 orë u munduam të diskutonim rreth çështjes, e cila ka të bëjë me një situatë reale në vendin tonë, me një mur i cili ndërtohet në pjesën veriore.

Vërtet është e rëndë pak, kur në një vend siç është Kuvendi i Republikës së Kosovës, niveli më i lartë institucional, kurrë nuk po mund ta arrijmë asnjëherë të merremi vesh, pothuajse për asgjë që do të duhej të ishte substanciale për vetë jetën tonë.

Në këtë Kuvend jam munduar bukur shumë ta shtyj edhe në seancë plenare, në rend të parë, se i bën nder këtij vendi e lëre më këtij Kuvendi, edhe rezolutën kundër krimeve serbe, të cilat janë kryer në Kosovë dhe s'kemi mundur ta arrijmë. I njëjti avaz është edhe prej të njëjtit subjekt politik. Kjo është e rëndë. Në të njëjtën kohë, e kam për Lëvizjen "Vetëvendosje" konkretisht. Konkretisht për ju e kam, pikërisht për arsye se nuk keni lejuar të kalojë gjenocidi, rezoluta për gjenocid, nuk keni lejuar të kalojë këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke reaguar në çdo moment. Vetëm pak, tash të flas.

Shiko, do t'ua jap fjalën edhe për replika edhe për të gjitha, vetëm unë isha, kërkoj falje, derisa isha duke e udhëhequr seancën, për shkak të obligimeve, njeriu shpeshherë nuk po mund t'i përcjell të gjitha lajmet. Keni parasysh, kam dëshirë vëmendja e juaj që jeni këtu edhe e medieve atje. Po qe se, unë ose ai kryeministri, do ta bënte një koalicion pikërisht në momentin kur u vendos muri me neve Agim Bahtiri, po na kishin... s'kish pas gjë që nuk na kishin bërë. Kërkoj falje, kur isha duke e dëgjuar deklaratën, nuk e kam dëgjuar, kolegët e mi të Grupit Parlamentarë e pyetën disa herë, kërkoja të paktën ta dëgjoj, kjo ishte arsyeja. po, kjo është... kjo është hipokrizi, kjo o ma tepër se hipokrizi. Këta bëjnë koalicion, na kanë verbuar për hir të manipulimit emocional tonit, se mendojnë se vetëm çka duket në medie duhet me qenë patriotizmi, të njëjtën kohë bëjnë koalicion me AKR-në, me Agim Bahtirin e aty, merreni shikoni, më 9.12. e keni kur Agim Bahtiri thotë - një marrëveshje fenomenale.

Po, kë po e mashtroni, mor ju? 80 cm mur me shkallë! Si shkallë, si mur, është i njëjti. Çka po mendoni, more ju? Dëgjo, me na fye kaq rëndë, thjesht jeni bërë çerdhe projugosllave, e keni mbushur çerdhe projugosllave, po shikoni kë e keni brenda. Më vjen keq, për disa patriotë, shikoni më së pari, po çfarë mendoni kështu në këtë mënyrë, vetëm me e gjet mënyrën edhe me fy, me fy, me fy... mosni se është gjynah, gjynah është për këtë vend. Po bëni lojën e tjetërkujt. Nuk keni pasur shqetësim fare, prej fillimit deri në fund, për murin.

Po, çka na kishit bërë mua edhe Isa Mustafës, në qoftë se ne do ta bënim një gjë të tillë? asnjë moment deri tani me hipokrizinë e juaj nuk e përmendët. Merreni, ju lutem, në qoftë se dëshironi. Ju kisha lutur, secilin prej juve, shikoni më datën 9 dhjetor, 80 cm duhet me qenë shkallë-shkallë. Po jua them një detaj, të cilin nuk kam deshtë, me vjen shumë rëndë kur bashkëbisedoj, kam marrë telefonatë të drejtpërdrejtë nga Brukseli me kërkesë zyrtare, kemi marrëveshje.

Zoti Pal Lekaj, a është e vërtetë? Kemi marrëveshje, tha, edhe partia juaj duhet të lejojë vazhdimin e punimeve për një mur të shkallëzuar. Mendohej se të mos e marr vesh, kam kërkuar takim me presidentin dhe kryeministrin urgjentisht, po me vjen rëndë pas mesnatës t'i them këto, isha shumë i shqetësuar, jo pse është qyteti im i lindjes, e bëj njëjtë siç është për Gjilanin, se ajo zonja prej Gjilanit kurrkënd nuk e njih edhe e merr një incizim, i cili Associated Press, janë të gjitha mediet botërore aty, kur unë dhe Hashim Thaçi përmes dhunës, përmes atyre

paramilitarëve i dërgojmë shërbimet shëndetësore pikërisht në spital, po turp more, duhet me qenë, turp me qenë. në atë takim kemi dalë unë dhe Hashim Thaçi, është e vërtetë. Masë e cila ka qenë shumë protestuese edhe Bajram Rexhepi edhe kemi dalë, jemi futur pastaj ne të tretë, kemi shkuar me personalin mjekësor në spitalin e veriut, ende ka pasur spitali i veriut. Po, këto manipulime të tilla e kanë mbajtur zbrazjen e Mitrovicës, për arsye se çdo eskalim të manipulatorëve vetëm për përfitime e bënin situatën më të rëndë në pjesën veriore.

E thash edhe një herë, kemi mbajtur takim, ka qenë reagim shumë njerëzor, qoftë i kryeministrit, qoftë i presidentit. Ajo ka qenë sot pse ka folur presidenti në fjalimin e vet vjetor për murin, ky adresim. Vërtet, jemi shumë të shqetësuar, jemi para një situatë kur unë jam ai i cili mbi, jo një herë, me dhjetëra herë, i kam thënë kryetarit të qytetit tim, të lutem, në qoftë se je në një situatë, duke u frikësuar nga përvoja e tij, thuaj, thuaj, Kadri Veseli është pengesë, mos u vë në pozitë të rëndë. Më vjen keq ta them këtë botërisht, le të dalë Agim Bahtiri le ta thotë këtë për ta vërtetuar. E kam takuar me dhjetëra herë, në çdo situatë, kryetar, në qoftë se mbetesh në situatë të rëndë, ku mund të kesh presion mund të kesh një situatë të rëndë, e cila mund të të vërë ty si kryetar komune, thuaj: është kompetencë shumë e kufizuar e imja si kryetar i komunës, është edhe kryetari i Kuvendit, shkoni bisedoni edhe me të.

Ia kam uruar kur ka fituar, vetëm i kam thënë edhe një, ruaju kryetar, Mitrovica nuk është si çdo qytet tjetër. Tha, jam gjysh për gjashtë herë. Ia ruajt Zoti fëmijët! Thash: ruaju për arsye se mund të të mbetet për gjithë jetën njollë. Më vjen keq, shpresoj se s'ka... nuk bën asnjëri gabim të tillë, por ju, ju hipokrizinë e keni të tmerrshme. Në momentin kur bëhet muri, ju bëni koalicion! O... çka mendoni me këtë hipokrizi tuaj.

Agim Bahtiri gabimet e njerëzve si Agim Bahtiri krijojnë mundësi, mere me 9 dhjetor, e ke dëgjuar, kemi bërë thotë, me Bashkimin Evropian, me kryetarin e komunës... e keni a doni ta dëgjoni, asgjë nuk ka në Bruksel për këtë çështje, qe ku e ke, ja ku e ke ministren, e konfirmon edhe Agim Bahtiri, më fal. E konfirmon, në të njëjtën intervistë e keni edhe Agim Bahtiri. E konfirmon të njëjtën intervistë, të lutem, në qoftë se keni durim, rrimë, e keni 10 minuta, dëgjojeni intervistën që e keni më datën 9 dhjetor.

Po, jo, jo, jo, le replikën, gjithë natën, në qoftë se të gjithë shkojnë, unë deri në mëngjes do të rri këtu t'ua jap replikën. Vetëm se është një situatë, se nuk është mirë me luajt me ndjenjat e njerëzve. Është mirë me nxjerr një rezolutë, zoti Pal Lekaj, e cila do të ishte unifikuese për këtë Kuvend, mos me na nda.

Një rezolutë, e cila, më falni, për murin në veri, kur plakemi ndonjëherë, të nderuar heronj të kombit të pasluftës, do të flasim edhe për ballafaqimin me BIA-n, veç kur të plakemi. Do të flasim e do të kënaqemi duke folur, veç askund nuk ju kam parë ju, as në '98, as '99, as 2000, as 2005. Në trust pensional me UNMIK-un, aty të kam parë. Në 2001-ën ka qenë informacioni i

parë, më duket në 2001-ën është botuar në Kohën Ditore, për murin. E keni në kohë ditore, është dorëzuar nga unë, është sensibilizuar në çdo vend ku ka mundur, se nuk mund të ndodh një mur i tillë.

Për të qenë më konkret, i është dorëzuar Baton Haxhiut, i cili e ka botuar. Ky është plan i cili është bërë më 2016, njëjtë. Jemi munduar për gjithë këto vite të qetësohet situata në veri, për arsye se jemi për komunikim, jemi për dialog. Kemi arritur mbi 2 mijë njerëz t'i kthejmë në pjesën veriore të Mitrovicës, kemi arritur në mes plumbash, mos ta harrojmë, ata djem trima, mjeshtër, thjesht të punës, plumba të automatikëve kanë ndërtuar themelet e shtëpive, me një angazhim jashtëzakonisht serioz të zyrtarëve të komunës së Mitrovicës, kryetarit Ylber Hysës, i cili ka qenë i deleguar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Mitrovicën. Nën plumba, i kanë shkuar plumbat nga koka. Është bërë diçka në pjesën veriore.

Ajo kur e thash edhe që kërkoja, zoti Pal Lekaj të futet, nuk është çështje vetëm e Kadri Veselit për Mitrovicë, po që tri vjet 200 mijë euro, të cilat kanë qenë aksion humanitar “Ndhimmo edhe ti”, ende nuk janë shpenzuar. Kanë qenë rreth 500 mijë eurove, kur e ka marrë pushtetin Agim Bahtiri, janë edhe 200 mijë euro të cilat ende nuk janë shpenzuar. Në vend se me i shti, me ndërtua shtëpia të cilat janë të djegura, mos me u marr ne me patriotizëm të thatë e të kotë, në vend se me i kthye njerëzit në pjesën veriore edhe me i qetësua, për atë arsye thash me i punësua në të njëjtën kohë kam kërkuar nuk është e pavërtetë se s’kam kërkuar. Të futen njerëzit e pjesës veriore në forcën e sigurisë së Kosovës dhe në Policinë e Kosovës. Kemi nevojë që të kemi njerëz të tillë, se e ndjejnë veten pak më të sigurt. S’e bëra për patriotizëm.

Zoti Pal Lekaj, ju kisha kërkuar që pasi ta përbyllim këtë seancë, projektrezoluta të harmonizohet me grupet parlamentare, mos na leni mos me e votua edhe këtë projektrezolutë, mos me e paragjykua në baza politike, e cila ndërlihet, qoftë me dorëheqjen e ministres apo me ndërprerjen e dialogut. Mundet me pas, mund të kemi dakordshmëri të përbashkët që procesi politik me mur nuk mund të ketë dialog, të specifikohet, me mur nuk mund të ketë dialog, por mos të hy në paragjykime, të cilat janë dalluese në mes nesh, për arsye se dialogu nuk ka qenë me dëshirën e imponueshme tonën, kur ke forcë e fuqi, në qoftë se do ta kishim forcën e përkrahjen, sigurisht se do të ishte situata më e mirë edhe në veri. Ju e dini sikurse unë këtë që po flas, të gjithë kemi qenë pjesë qeveritare, nuk jam duke iu drejtuar Lëvizjes “Vetëvendosje”, jam duke iu drejtuar juve, si një pjesë e arsyeshmërisë, se keni pasur edhe tri vjet qeverisje në Republikën e Kosovës, mund të arrihet sovraniteti në gjithë hapësirën tonë, vetëm përmes dialogut dhe komunikimit të përbashkët, bashkëpunimit me bashkësinë ndërkombëtare e veçanërisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian.

Por, assesi me konflikt. Kemi me i nxjerr edhe ata qytetarë që janë në atë pjesë, po murin ajo çfarë e them, edhe një herë më herët, ka me u heq muri, për arsye se është kundër marrëveshjes me Brukselin, është kundër marrëveshjes me Qeverinë e Republikës së Kosovës edhe është një...

ta konsideroj këtë në mënyrë edhe publike, dua të dëshiroj vetëm se ka qenë një moment i gabimit gjuhësor të kryetarit tonë të komunës së Mitrovicës, për të cilin kam respekt, që shkallë me bë. Asnjë shkallë, as 18 cm, kjo do të jetë. Faleminderit!

I nderuar kryesues, të kisha lutur, replikën t'ia lejosh Lëvizjes “Vetëvendosje”, sa të duan.

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Sa u takon, në qoftë se e duan fjalën. Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, nuk ka qenë në bisedime me Rakiqin fare për çështjen e murit. Ajo s'ka të bëjë me hapësirën territoriale që është nën administrimin e Komunës jugore të Mitrovicës.

Në bisedime me Rakiqin për këtë çështje ka qenë ministrja, zonja Edita Tahiri, e cila e ka pasur në delegacion edhe zyrtarin Arben Çitaku dhe e ka ftuar Agim Bahtirin. Agim Bahtiri nuk ka kompetencë të flasë në bisedime me askënd për atë pjesë të qytetit të Mitrovicës, fatkeqësisht, për shkak të ndarjes që e ka bërë Plani i Ahtisarit.

Pra, përfundon juridiksioni dhe kompetenca e Agim Bahtirit shumë më herët se sa të shkohet atje ku po ndërtohet muri.

Por, zonja Tahiri e ka ftuar në takim Bahtirin. Dhe, është e vërtetë që Bahtiri nëpër konferenca të ndryshme është takuar me Rakiqin, por a e dini kur? Kur është bërë presion që të heqë dorë nga Suhodolli dhe Kroi i Vitakut. Dhe, ai asnjëherë nuk ka lëshuar pe dhe nuk ka pranuar që, për t'u hapur ura, të heqë dorë nga Suhodolli dhe nga Kroi i Vitakut. Pra, kjo është e vërteta.

Ai, ka qenë në një televizion, unë s'e kam parë se çka ka thënë. Unë e di se çfarë është lexuar sot si fjalë e tij nga deputetja jonë Albulena Haxhiu. Dhe, duhet ta keni një gjë parasysh. Njerëzit janë nëpër koalicione e parti të ndryshme, por kush fillon bashkëpunimin me “Vetëvendosjen” më i mirë bëhet. Më i mirë bëhet!

Kjo rregullisht ka ndodhur në këto 10 vjet prej se ekzistojmë.

Ka njerëz që s'kanë qenë për bashkim kombëtar, kanë ardhur në Lëvizjen “Vetëvendosje” dhe janë për bashkim kombëtar. Ka njerëz të cilët nuk kanë qenë të majtë e socialdemokratë, kanë ardhur në “Vetëvendosje”, janë bërë socialdemokratë. Këto janë zhvillime progresive.

Pra, edhe fjala e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, tash është më e mirë se çdo intervistë e tij. Po, ky është zhvillim pozitiv. Nuk e di unë çka ka thënë Agim Bahtiri para një a dy vjetësh. Shumë mirë që e ka thënë këtë fjalë tash, të cilën e lexoi deputetja Albulena Haxhiu.

Unë besoj se kryetarit të Komunës, Agim Bahtiri, duhet t'ia shikoni fjalën, të cilën e lexoi sot. Dhe ai u ankua se kur u miratua buxheti mbrëmë këtu, fare nuk pati investim për Mitrovicën, as për kthimin e shqiptarëve atje.

Ndërkaq, zoti Veseli këto ankesa që i bëri se nuk po kthehen shqiptarët, se nuk po ndërtohen shtëpitë, se nuk paskan siguri, e pastaj edhe ky Fondacioni “Ndihmo edhe ti”, këto janë ankesa të tij për kryeministrin Mustafa. Unë s’di çfarë ka me ne ky?

Ju jeni në Qeveri me kryeministrin Mustafa. Ia paraqitni këto ankesa atij, nëse ai nuk ua përfill ankesat, dilni prej Qeverisë. Çka keni pse të rrini në atë Qeveri?

Nëse ai s’po u dëgjon juve, ju dilni prej asaj Qeverie. Çka po ankoheni te ne, unë s’di çka keni me ne.

Këto janë ankesa që i keni dhe, ju thashë, s’ka guxim politik, e ku e di unë çka. Këto janë ankesa që i keni për kryeministrin Mustafa, s’keni punë ju me ne.

Pra, shikoni fjalën e Agim Bahtirit që e ka thënë sot këtu në Kuvend, duke e lexuar kolegja ime, Albulena Haxhiu. Ajo është e vërteta.

Me Rakiqin ka negociuar zonja Tahiri. Nuk ka kompetencë Bahtiri të negociojë me Rakiqin dhe s’ka kurrfarë kuptimi kjo punë. Ai mund të ketë marrë pjesë nëpër takime, por s’mund të negociojë ai. Ai i ka thënë të dhënat nga ajo çfarë është folur në takime. Pra, ai ka mundur të njoftojë çfarë ka ndodhur në takime, por jo të marrë vendime. Absolutisht, jo!

KRYESUESI: Zonja Tahiri e ka kërkuar fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Edhe një herë po e përsëris. Marrëveshja për rivitalizim dhe heqjen e barrikadës është arritur në Bruksel mes dy shteteve, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Delegacioni i Kosovës, i udhëhequr nga kryeministri, ka pasur përbërje nga zëvendëskryeministri, unë, zoti Bahtiri si dhe përfaqësuesin, zotin Çitaku, përfaqësuesin e Ministrisë së Ambientit dhe përfaqësuesin e Policisë, zëvendësshefin e Policisë, Rashit Çalaj.

Pra, ky ka qenë delegacioni zyrtar, ndërsa Rakiqi nuk është kurrfarë faktori apo bashkëbiseduesi në këto procese. Kaq, faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Veseli e ka kërkuar fjalën.

KADRI VESELI: Jo, vetëm te pjesa në të cilën unë jam lidhur për fjalë, në qoftë se kanë durim deputetët, ne mund ta tregojmë me projektor, kur thuhet se mbrëmë kemi bërë marrëveshje fenomenale për murin, me shkallë 80 centimetra.

(Ndërhyrje)

A doni ta bëjmë këtë? Pra, e kisha lutur regjinë, është data 9 dhjetor 2016.

(Jepet inserti nga projektori)

Zoti Pal Lekaj, a po e bën rezymimin, e ne në ndërkohë do ta gjejmë atë pjesë dhe do ta vendosim sonte.

(Reagime)

Jemi duke folur vetëm për murin, zoti Kurti, do ta dëgjosh vetë, nuk do të ketë manipulim.

KRYESUESI: Zoti Lekaj, a e kërkove fjalën?

PAL LEKAJ: Për korrektësi, do ta lexoj.

I nderuar kryetar,

Deputetë,

Media që jeni tani tërë ditën duke e përcjellë këtë debat,

Së pari më lejoni t'ju falënderoj juve, deputetë të nderuar, që na dhatë mundësinë që çdonjëri prej nesh të shprehet, e në veçanti edhe kryetarin e Kuvendit që vërtet pati durim dhe kurajë të japë premtime, por edhe të lejojë debatin, edhe pse ngandonjëherë po dalim jashtë vetes, ndonjëherë pa dashje, por jemi njerëz dhe mund të atakojmë njëri-tjetrin, por të jeni të bindur se me ndjenjat më të mira e kemi kërkuar, si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, këtë debat. Jo për patriotizëm, por se kjo çështje është e ndjeshme dhe do zgjidhje urgjente.

Për korrektësi tuajën, po lexoj konkluzionet që vetëm i kemi protokolluar, por me synimin që unë nuk jam këtu dhe kur e kërkoj votën e të gjithë juve që të kemi një unifikim të rekomandimeve, kjo mund të plotësohet e të ndryshohet nga grupet parlamentare dhe ta sjellim një rezolutë që do zgjidhje shumë të shpejtë dhe që vërtet ne njëherë e përgjithmonë, kur është në interes të vendit, të jemi të bashkuar.

Ne mund të ndahemi politikisht dhe çdonjëri përfaqësojmë subjektet tona politike, dikush e zgjedh mënyrën më të shpejtë, dikush zgjedh rrugë të tjera, por synim i të gjithë neve mendoj se është fuqizimi i shtetit të Kosovës.

Unë po e lexoj, dhe po them për korrektësi dhe e përsëris se mund të unifikohet, mund të largohen edhe pika që ndoshta nuk janë të pranueshme për të gjithë deputetët dhe Kuvendin:

1. Kërkojmë nga kryeministri shkarkimin e menjëhershëm të ministres për Dialog, zonjës Edita Tahiri.
2. Qeveria e Kosovës të ndërpresë dialogun me Serbinë deri sa të kemi njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia.
3. Qeveria e Kosovës, nëpërmjet organeve të veta, t'i ndërmarrë të gjitha masat që ai mur, i cili është në ndërtim e sipër, të rrënohet.
4. Të merren masat e nevojshme për t'u mos ndryshuar plani i rivitalizimit të urës së Ibrit.
5. Qeveria e Kosovës të kujdeset që rivitalizimi i urës të përmbajë të gjitha elementet që i ka pasur dikur ura, e jo t'i shtohen elemente të tjera ilegale, siç është muri.
6. Të bëhet e mundur që sa më parë qytetarët të kthehen në pronat e tyre, në dy pjesët e qytetit të Mitrovicës.

Pra, kjo ka qenë kërkesa jonë, por për hir të unifikimit të qëndrimeve, lus edhe kryetarin e Kuvendit që, meqë janë bërë edhe nënshkrimet për një seancë të jashtëzakonshme, nëse ndodh ajo, ne në atë seancë t'i miratojmë këto rekomandime, për të dhënë afat për rrënimin e murit, dhe pastaj, nëse kjo nuk ndodh, atëherë vërtet do të kërkojmë nga zonja ministre Tahiri të japë dorëheqje nga pozita e saj, sepse më nuk ka kuptim nëse nuk i përmbush kërkesat e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Faleminderit për të gjitha dhe ju uroj fundjavë të mirë.

KRYESUESI: Ne ende jemi në proces të diskutimeve. Pas deklaratës së zotit Lekaj, fjalën e ka ministrja Edita Tahiri, e pastaj do të bisedojmë se çfarë duhet të bëjmë.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: T'ju them të drejtën, më pëlqeu shumë propozim-rezoluta e AAK-së.

Mos harroni, nuk i kam pasur të lehta këto 6 vjet të merrem me Serbinë. Prej këtu, është lehtë të flitet. Beteja zhvillohet atje, në Bruksel.

Po a dini pse e kam pranuar këtë detyrë? Edhe pse vij nga një parti e vogël, e kam pranuar, sepse kam besuar në përvojën time, duke qenë se kam qenë ministre e Jashtme 10 vjet, kam punuar për

aleancën Kosovë-SHBA, kam qenë pjesëmarrëse në Rambuje dhe 1 vit para Rambujesë jam shkolluar në Harvard, kam doktoruar në strukturat paralele, pra në zhbërjen e tyre. Prandaj, kam besuar në ekspertizën që kam.

E dyta. Unë nuk jam kandiduar dhe emëruar ministre prej AAK-së. Unë kam partnerin e koalicionit, me të cilin jam tashmë mbi 6 vjet. Konsultohem me partnerin, PDK-në, e pastaj, shohim e bëjmë. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, jemi pas mesnate. Zoti propozues, rezolutën kështu-ashu, s'kemi kuorum ta votojmë dhe do të ishte mirë të ishte e përbashkët. Edhe një herë, shefat e grupeve parlamentare nesër apo të hënën takohen, meqë edhe 40 nënshkrime që janë kërkuar për seancë të jashtëzakonshme, sonte as nuk të merren parasysh.

Pra, të hënën, të martën, ose të mërkurën, kur doni merremi me këtë. Të hënën nuk punohet, ta keni parasysh. Pra, mund të mbahet të mërkurën, nëse e kemi miratimin tuaj. Ndërkohë, para votimit të rezolutës do t'u jepen edhe minutat e sekondat e deklaratës që ka të bëjë me murin 80 centimetra dhe shkallët. Pra, jo me murin, por me shkallët.

(Ndërhyrje)

Atë merre, e ke në "Associedet Press" dhe mbaje në shtëpi, sepse ke stimulim kur më sheh. Pra, ke parasysh, kam dalë mirë aty, kam qenë më i ri, nuk kam qenë kaq i thinjur. Sido që të jetë, do ta lëmë këtë pjesë kështu.

(Ndërhyrje)

Po edhe atë do t'jua sjell, me siguri, por ta mbash në shtëpi dhe t'ia tregosh shtëpisë aty. Mos më nënvlerëso, se kam qenë i ri atëherë. Pra, e ke parasysh!

Të mërkurën, në bazë edhe të 40 nënshkrimeve, do të kemi seancë të jashtëzakonshme.

Kolegë deputetë, në ndërkohë do t'i merrni dy incizimet, edhe atë timin, por në të njëjtën kohë edhe deklarinimin.

(Ndërhyrje)

Dërgoje në Gjykatën Speciale, se edhe kështu të mos mbetet diçka keq, ose te ai tjetri, keni ju shumë. Mos leni derë pa çelë, kudo që të jeni, vetëm vazhdoni dhe mos u ndalni.

Faleminderit shumë për mirëkuptimin! Para se të mbyllim seancën, u lajmërua zoti Ali Sadriu për fjalë. Regjia, aktivizoje mikrofonin!

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Po dua të kam vëmendjen e të gjithëve! E kam një pyetje publike për ju, që jeni të Mitrovicës.

Mu aty ku po ndodhin këto procese, kam një informacion se ka qenë një xhami dhe është djegur para luftës.

Në rezolutë kërkoj që të figurojë ajo dhe ta merremetojmë edhe atë siç i kemi merremetuar shumë objekte të tjera. Këtë po e potencoj në aspektin kombëtar. Pra, le të parashihet kjo.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar koleg deputet! Grupet parlamentare dhe zoti Pal Lekaj e kërkon një takim para të mërkurës dhe e harmonizojnë.

E në ndërkohë i marrin incizimet dhe le t'i përdorin disa për shtëpi, disa për Prokurori.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23 dhe 24 dhjetor 2016

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Para se të futemi në pikën e fundit të rendit të ditës, më lejoni vetëm t’ju paralajmëroj se ka mundësi që do të kemi edhe një pikë të rendit të ditës. Qeveria e Republikës së Kosovës për këtë ka informuar Administratën e Kuvendit. Janë disa amendamente që kanë të bëjnë me Ligjin për veteranët e luftës, është në dakordim ndërmjet shoqatave të luftës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Pra, kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj që deputetët edhe pas votimit të kësaj pike të fundit të rendit të ditës, të qëndrojnë edhe një kohë për të vazhduar seancën plenare, pas një pauze të shkurtër.

E votojmë propozimin lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës. Daut Haradinaj e ka kërkuar fjalën, para se të futemi në shqyrtim të kësaj pike.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në seancën e kaluar u munduam të qartësohemi se kush është përgjegjës për murin në Mitrovicë. Ne i kemi, jo rastësisht, disa materiale të cilat na kanë rënë në dorë kur ministri i Planifikimit Hapësinor e konstaton në bazë të ekspertizës se ky është një mur ilegal dhe si i tillë duhet hequr.

Në anën tjetër, ministrja për Dialog, Edita Tahiri, i shkruan kryeministrit të Kosovës dhe i thotë, dua ta lexoj se është shumë me rëndësi ta dëgjojë opinioni publik.

Ndër të tjera i thotë: “Zoti kryeministër, unë nuk po ia konfirmoj konkluzionet Brukselit, edhe pse që nga dje po më bëjnë presion, sepse dëshirojnë ta heqin murin sa më shpejt. Në linjë me konkluzionet, natyrisht se kjo është përgjegjësi e ministrit Ferati”.

Çfarë ministre mund të jetë ajo që i thotë kryeministrit “janë duke më bërë presion Brukseli e Amerika për ta hequr murin më shpejt” dhe i thotë kryeministrit “gjendu disi, largoma presionin”.

Këqyrni dokumentet ku i keni, nuk do t’i lexoj. Të gjitha i keni, keni vendim të Inspektoratit, keni vendim të ministrit për Planifikim Hapësinor dhe i ke dokumentacionet, të gjitha zyrtare, të nënshkuara nga ministrja Tahiri, e cila i referohet takimit të datës 5, 6, 7, 8, natën vonë, bashkë me kryetarin e veriut, ku deklaroi se muri diku do të jetë 80 centimetra, diku thotë do të jenë shkallë, ndërsa në raport kryeministrin e mashtron, i thotë do të jetë 8 centimetra.

A do të jenë shkallë, a do të jetë mur, a do të jetë urë, a çka do të jetë ajo? Përfundimisht kjo ministre, unë mendoj se po të kishte Qeveri normale në Kosovë ajo sot ishte dashur të shkojë në shtëpi, e nesër të përgjigjet para ligjit, sepse kjo, në fund të fundit, është e kundërligjshme.

Dhe, zoti kryetar do t'i lë këto transkripte, e shpresoj që edhe kryeministri i sheh.

E di që ka pasur takim, kanë qenë kryetari i komunës, zoti Çitaku, sekretar permanent, kryetari i veriut dhe jugut, ministrja ka pasur përfaqësues të Brukselit, përfaqësues të Ambasadës Amerikane. Të gjithë njëzëri janë dakorduar se ky është një projekt ilegal dhe shteti nuk ka funksionuar.

Përkundrazi, këtu në referim thotë: “Ministri për Planifikim Hapësinor po më bën presion ta implementoj ligjin e sa më shpejt për ta hequr murin”. Dhe i thotë, “zoti kryeministër, merr masa kundër këtij ministri”.

Deri këtu ka ardhur situata. A e mbron ajo Kosovën, a e mbron Serbinë a kë dreqin e mbron Edita Tahiri, ec e bjeri në fije?! Po një e vërtetë është, këto materiale janë të saj edhe të nënshkruar prej saj, dhe duhet të përgjigjet ajo zonja se, në fund të fundit, nuk ia ka dhënë Zoti këtë vend.

KRYETARI: Faleminderit! Këto materiale, Daut, t'u shpërndahen deputetëve, se unë s'kam pse i mbaj për vete. I kanë deputetë, ani, administrata i vendos në kutitë për Vitin e Ri.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e marr pak kohën me këtë rezolutë, pasi duhet të kemi pauzë për shkak të amendamentimit të Ligjit për veteranët.

Ju njoftoj se diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare të datës 23 dhe 24 dhjetor 2016. Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotin Pal Lekaj, që në cilësinë e parashtruesit dhe çështjes të paraqesë tekstin e propozim-rezolutës, të harmonizuar edhe me grupe të tjera parlamentare. Urdhëro, zoti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Siç edhe jemi në dijeni, në debatin e javës së kaluar për murin ilegal në veri të Mitrovicës, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kam lexuar një propozim-rezolutë, si propozues të debatit për këtë çështje dhe përkitazi me atë debat, ndër të tjera, kemi kërkuar që kryeministri të bëjë shkarkimin e menjëhershëm të ministres për Dialog, zonjës Edita Tahiri, po ashtu që negociatat me Serbinë të ndërpriten dhe disa pika të tjera.

Duke e parë që dy partitë në pushtet nuk ishin dakord për këto pika dhe ne duke qenë seriozë në kërkesën dhe insistimin tonë që muri i ndërtuar të priset e fokusi ynë tani për tani është te muri, që të mos vazhdojë të betonizohet ndarja e qytetit të Mitrovicës edhe më tej.

Pas një takimi që pata në emër të propozuesit, Grupit Parlamentar të AAK-së, me shefat apo përfaqësuesit e grupeve parlamentare të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetin, shefin e grupit, Zenun Pajaziti, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, deputeti Salih Morina, nga “Vetëvendosja” shefi i grupit, Glauk Konjufca dhe nga “Nisma”, shefja e grupit, Valdete Bajrami, të cilët i falënderoj për bashkëpunim dhe dakordësimin se muri në veri është gjëja më e shëmtuar që mund të ndodhë në zemër të Evropës në shekullin XXI.

Ne edhe pse u dakorduan si të tërë, pastaj lindën disa dilema që unë prapë i falënderoj grupet, edhe Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe të “Nismës” që u dakorduan dhe më lejoni që ta lexoj rezolutën e propozuar nga të gjithë shefat e grupeve parlamentare dhe dakordimin e tyre, por si propozues që është kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

REZOLUTË

1. Të rrënohet muri ilegal në pjesën veriore të Mitrovicës, kjo të ndodhë brenda muajit janar të vitit 2017.
2. Qeveria e Kosovës të angazhohet që organet kompetente për trajtimin e ndërtimeve pa leje t’i ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore për murin që është në ndërtim e sipër në pjesën e urës së Ibrit, i njëjti të trajtohet si veprim politik dhe ndërtim pa leje.
3. Qeveria e Kosovës të marrë masat e nevojshme që të mos ndryshohet ura e Ibrit dhe e njëjta t’i përmbajë të gjitha elementet që i kishte para vitit 1999, e jo t’i shtohen elemente të tjera ilegale, siç është muri dhe shkallët.
4. Të bëhet e mundur që sa më parë qytetarët të kthehen në pronat e tyre, në të dy pjesët e qytetit të Mitrovicës.

Dhe, kërkoj nga kryetari të këtij Parlamenti që ta hedhë në votim këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Pal Lekaj, këto pika që i përmende ishin edhe të “Nismës”, a është në rregull, u harmonizua, mirë është. Faleminderit!

Zoti Bajrami, ju pashë, urdhëro fjala për ju “6+”.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Uzimajući u obzir da ste nas isključili kao grupu "6+" iz ove rezolucije, takođe uzimajući u obzir da smo prilikom diskusije ja u ime Grupe "6+" imao svoj diskusiju, prema tome kao prvo protest zbog isključivanja Parlamentarne grupe "6+" iz potpis ove rezolucije i takođe iz njenog donošenja.

S obzirom da sam jutros saznao da je rezolucija pripremljena bez nas, ja sam odmah gospodinu Palj Ljekaju poslao u pismenoj formi dodatnu tačku za ovu rezoluciju. I sad ću pročitati i na bosanskom, i na albanskom jeziku.

Dakle kao tačka 5. i mislim da sjajno dolazi posle tačke 4. Da Vlada Republike Kosova strogo vodi računa o ravnopravno i zastupljenosti pripadnika svih nacionalnih zajednica prilikom zapošljavanja u civilnoj službi u institucijama na lokalnom nivou u opštinama Mitrovice.

Në shqip: "Që Qeveria e Republikës së Kosovës në mënyrë strikte të kujdeset për përfaqësimin e barabartë të të gjitha komuniteteve nacionale me rastin e punësimit në shërbimin civil në institucionet e nivelit lokal në të dy pjesët e qytetit të Mitrovicës".

Kjo është shumë e arsyeshme, ovo je jako opravdano, jer mi govorimo u tački 4. O povratku, a zapošljavamo svaki dan pripadnike Srpske zajednice u institucijama sjevera, nemamo nijednog zapošljenog ni Bošnjaka, ni Turčina, ni Roma, ni Aškalije, ni druge nacionalne zajednice, isključujem autoktone narode sa sjevera iz procesa zapošljavanja.

Tražimo da se ovo uvrsti kao peta tačka, u protivnom Parlamentarna grupa „6+“ neće glasati za ovu rezoluciju. Hvala!

KRYETARI: Zoti Bajrami, në rend të parë zoti Pal Lekaj ka qenë obligim ta harmonizojë me grupet parlamentar, por pikën të cilën e keni ngritur ju, në qoftë se më kuptoni, ajo është e zgjidhshme vetëm në bazë të ligjit, për arsye se e kemi obligim, ligji e parasheh edhe punësimin e komunitetit, është në bazë të ligjit. Ne e futim në rezolutë, po ligji është më i fuqishëm. Ligji është më i fuqishëm, e kemi në bazë të ligjit. Po tash do të flasim të gjithë deputetët. Zoti Sabri Hamiti, nënkryetari i Kuvendit, pastaj zoti Ibishi të bëhesh gati.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ne kishim një diskutim disaorësh për këtë problem, bile të thirrur me një urgjencë të jashtëzakonshme, me fjalime dramatike, nganjëherë edhe me formulime ekskluzive.

Tash po shoh një formulim, unë ju uroj të gjitha grupeve parlamentare që kanë vendosur ta bëjnë këtë formulim me katër pika. Te ne konsensusi bëhet në pikën e poshtme, që thonë, edhe këtë herë ka ndodhur kështu dhe unë nuk mund të mos bëj një vërejtje.

Ka katër pika, dy i referohen një subjekti, thotë: Qeveria e Kosovës që ka të bëjë me mënyrën e ndërtimit të këtij muri dhe, në anën tjetër, edhe treshi që duhet të kujdeset që ajo urë të ketë funksionin që e ka pasur, funksion komunikimi dhe kurrfarë funksioni tjetër, po të bëhej me esencialisht, formulimi është ky, se është një farë ngatërrim i çuditshëm në formulim.

Sido që të jetë këtu kemi subjekt ku orientohet, po pika numër një edhe pika numër 4 nuk kanë subjekt dhe Kuvendi, unë nuk di pse abstenon në këtë formë dhe flet në këtë formë kaq neutrale pa obligime institucionale, nëse s'do të marrë vetë Kuvendi përgjegjësi, atëherë t'i japë dikujt ose t'i japë edhe vetes, edhe dikujt. Kjo është abstenim, kjo është e folur neutrale që s'i përgjigjet asnjë fije diskutimit disaorësh që ka ndodhur këtu. Atëherë ose diskutimi ka qenë i dramatizuar pa arsye, ose teksti është neutralizuar pa arsye, sepse nuk mund të thuhet "të rrënohet muri ilegal në pjesën veriore të Mitrovicës, kjo të ndodhë brenda muajit janar të vitit", sepse muri nuk vetërrënohet, ka subjekt që e merr këtë përgjegjësi.

Atëherë nëse nuk doni ose nuk thuhet Qeveria, nuk thuhet Kuvendi, ju lutem thoni "institucionet e Republikës së Kosovës obligohen që muri të rrënohet ose ta rrënojnë deri më kaq".

Edhe e fundit prapë, një pikë tjetër që është përtej këtij detyrimi, thotë: "Të bëhet e mundur sa më parë". Po nuk ka formulim më neutral e më të papërcaktuar, të thuhet "të bëhet e mundur, plus kjo, sa më parë", sa më parë është përkufizim kohor krejt i papërcaktuar, për dikë "sa më parë" është një muaj, për dikë "sa më parë" është 10 vjet. Domethënë, ju lutem, nëse në emër të Kuvendit të merret le të formulohet prapë edhe pika 4. "Institucionet e Republikës së Kosovës punojnë fuqishëm në bazë të ligjit që të gjithë banorët e Mitrovicës të kthehen në pronat e tyre", po të bëhet më konkrete, unë nuk do të bëj formulimin, po unë po shpreh pikëpamjet e mia dhe mendoj që assesi pika 1 dhe pika 4 nuk e kanë seriozitetin e tillë me formulimin neutral, pa subjekt veprimi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti nënkryetar! Zoti Pal Lekaj, unë po ju lë në fund, pastaj në qoftë se dëshiron të shtosh apo të heqësh kuptimin këtu nga ky formulim. Zoti Ibishi, kërkoj falje, fjala për ju.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Unë së pari po shpreh një brengosje, pasi që kjo rezolutë mbetet si dokument në Kuvendin e Kosovës, jo vetëm si formë, por edhe si mosveprim për institucionet e Kosovës.

Nesër kur lexohet si një dokument, atëherë nuk kupton lidhjen kauzale mes shkakut edhe pasojës. Kush e bëri këtë mur, ku edhe kur, mendoj që në pjesën e parë, para rezolutës, kur fillon teksti Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të kësaj, të shtohet "kur u ndërtua ky mur, nga

kush” edhe aspekti tjetër, me qëllim që të hyjmë në aspektin tjetër që teksti në vazhdim që ka të bëjë me katër pikat e rezolutës të flasin për masat apo veprimet që duhet ndërmarrë në bazë të asaj. Pra, ne nesër, ku ta di, në mandatin tjetër vjen dikush e lexon edhe nuk di ky mur ku është, cili autoritet e ka bërë apo cila organizatë atje i ka kryer punimet dhe çfarë gjatësie apo çfarë lartësie është.

Mendoj që kjo duhet në pjesën hyrëse, para rezolutës, të ceket këto të dhëna, edhe normalisht data kur është bërë ndërtimi i murit, me qëllim që kjo të jetë, të marrë kuptimin e plotë sikurse thashë mes lidhjes kauzale shkak-pasojë e ndërmarrjes të një veprimi apo vetëmiratimi i një rezolute të tillë. E përkrah edhe zotin nënkryetar, Sabri Hamiti, që në aspektin e subjektivitetit të ndërmarrjes së një veprimit të ceket në tekst.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj, bëhet gati zoti Ferati, ndërkohë edhe “Vetëvendosja”, edhe “Nisma”.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Unë e kam të qartë se edhe Grupi Punues, përfaqësues të grupeve parlamentare sa herë që hartojmë rezoluta sigurisht që përpos atij presionit të ndryshimeve nga sponsorizuesi, përcaktimi i parë, vijnë edhe propozime të tjera dhe mundohemi që të harmonizohen, por sigurisht që duhet ta keni vëmendjen dhe të jemi sa më të qartë edhe në vullnetin politik që do ta ketë Kuvendi për votimin apo mosvotimin e kësaj rezolute, por i cili po mbetet dokument i rëndësishëm dhe, mbi të gjitha, që shihet që ka edhe konsensusin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përpos disa elementeve që i thanë kolegët e mi dhe që duhet të jenë të saktësuara për t’i dhënë përgjegjësi atij që është i obliguar të marrë masat ligjore që ta rrënojë këtë mur, që të gjithë po themi që është ilegal, unë besoj që edhe pika 3 duhet të riformulohet dhe të saktësohet qartë, te plani i urës së Ibrit që quhet këtu, unë mendoj që duhet të jetë plani i urës kryesore mbi lumin Ibër, sepse ka edhe dy ura të tjera dhe apostrofimi që thuhet “të njëjtat t’i përmbajë të gjitha elementet që i kishte para vitit 1999”, më duket që është formulim i cili duhet të jemi të kujdesshëm, sepse tani kemi të bëjmë me një rivitalizim të kësaj ure, dhe i cili përmban edhe elemente të reja, por jo elemente ilegale, siç është muri, shkallët apo diçka tjetër.

Kështu që besoj që duhet t’i shtohet që kjo është ura kryesore mbi lumin Ibër dhe duhet të jetë emërtim i saktë, sepse ekzistojnë edhe disa ura, apo edhe dy ura të tjera, të cilat duhet të jetë si element bazë për atë edhe çka po kërkon Kuvendi i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj, pastaj çka të futni në projektrezolutë i përmbledhim në fund. Zoti Ferati, ndërkohë bëhet gati zoti Berisha, zoti Selimi nga lëvizja “Vetëvendosje”.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Ndoshta një prej mundësive që të kalohet menjëherë në votim dhe të shkohet më tutje, eventualisht ka mundur të mos i mbetet merakut dikujt që ta marrë fjalën, por po që se u dha mundësia që të themi diçka, unë nuk mund të kaloj pa një konstatim, sepse ishte edhe pjesë e debateve, pajtueshmërisë së plotë edhe në debatet që i kemi pasur këtu.

Ajo për çka të gjithë u pajtuam që muri është ligjërisht ilegal, nuk i plotëson kushtet legale, por është edhe i papranueshëm, si i tillë. Dhe, çdoherë kur institucionet e Republikës së Kosovës janë aktorë, edhe në të ardhmen nuk duhet të dyshohet se nuk duhet kurrë të ndodhë pajtueshmëria rreth murit. Prandaj, s'ka çka të zgjatet përveçse konstatimit se muri duhet të rrënohet, sepse nuk është legal dhe është i papranueshëm. Ndërsa, po të shkohet vetëm edhe në një nen tjetër, edhe e kemi parasysh veriu e të mos ceket insistimi i Parlamentit të Republikës së Kosovës në sundimin e ligjit.

Funksionimin e institucioneve konform ligjeve në fuqi dhe të kihet parasysh pozita e atyre, të cilët nuk janë të barabartë në atë pjesë. Në rast se ne kemi krijuar fonde të veçanta nga pika 1. 31 dhe formave të tjera që atje, pra komuniteti joshumicë këtë rast, komuniteti serb të marrë fonde të veçanta, ndërsa ne para syve tanë të ndodhë jobarazia dhe shqiptarët dhe komunitetet e tjera nuk trajtohen të barabartë, unë pajtohem me konstatimin e zotit Bajrami që ne po që se e marrim një listë edhe e shohim se sa shqiptarë dhe të tjerë janë të punësuar atje, ne do të shohim se atje është një diskriminim.

Prandaj, mund ta lëmë edhe për një herë tjetër, sepse ato trajtohen me ligj, por edhe gjithçka çka ne kemi folur këtu trajtohet me ligj. Pra, a dëshirojmë të bëjmë me një peshë të veçantë punësimin e shqiptarëve dhe të tjerëve në atë pjesë, fondet e veçanta për infrastrukturë dhe për mirëqenie, pastaj kthimi i njerëzve në atë pjesë, kjo është çështje e vullnetit të Kuvendit. Por, unë mendoj që kjo rezolutë nuk është e plotës i e tillë, prandaj propozimi im ose duhet të shkohet që muri të rrënohet meqenëse është jolegal dhe i papranueshëm, ose nëse shkohet me pika, atëherë ta peshojmë vërtet situatën reale që është në veri. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Berisha, zoti Selimi bëhet gati dhe zoti Rexhepi, e në fund zonja Halimi.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Meqë u hap debat, thënë të drejtën, unë dua ta mbaj një qëndrim rreth asaj se ka devijuar komplet domethënë rezoluta nga arsyeja për të cilën është thirrur kjo seancë.

Pas debatit mbi 8 orë është gjet një konsensus i përafërt, mirëpo me këtë rezolutë përsëri domethënë devijojmë nga konsensusi që ka dalë nga debati dhe unë po mendoj se nga ajo që tha veçanërisht zoti Daut Haradinaj rikthehet pika e parë e rezolutës për dorëheqjen e ministres

Tahiri, për shkak se në rast se qëndron ai komunikim, në fakt, komunikimi ka të bëjë me sfidimin e ligjit dhe Kushtetutës dhe, natyrisht në rast se kemi kësi ministra në Qeveri, domethënë që komunikojnë me këtë gjuhë në disfavor të shtetit të Kosovës, atëherë faktikisht ata do ta sfidojnë edhe këtë rezolutë koti, të cilën jemi duke e nxjerrë sa për të bërë rendin si Parlament.

Përndryshe, zoti Hamiti kishte plotësisht të drejtë, përndryshe rezolutat pa subjekt, koha ka treguar se kanë qenë shumë formale dhe nuk janë zbatuar ose nuk janë marrë parasysh asnjëherë dhe, në fund, dua të them se rezoluta, e cila është bërë në minutat e fundit, është gjetur një konsensus, domethënë tregon një joseriozitet të jashtëzakonshëm të institucioneve. Në fund të fundit, pse duhet të kemi rezolutë për diçka që është kundërligjore dhe ilegale? Po meqë ky Parlament në këtë vit nuk ka përmbushur as 30% të objektivave të veta, ne do të vazhdojmë të bëjmë debate shterpë pa mbulesë për të arsytuar se ekziston ky Parlament, përndryshe ne jemi jashtë funksionit dhe përgjegjësisë që kemi si Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Selimi e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati zoti Rexhepi.

REXHEP SELIMI: Jam shumë i vetëdijshëm që tash po flasim për tekstin, sepse debati i përket një dite tjetër të diskutimit, edhe nëse flasim për tekstin, po ashtu s'kam se si të mos pajtohem me profesor Hamitin, e sidomos për pikat që ai i përmendi. Është e vërtetë që teksti, të cilit ne po i referohemi, duhet të ketë një adresim, duhet të ketë një subjekt.

Dhe, dua të shpreh edhe një herë pajtimin me profesor Hamitin, por po ashtu po duket e nevojshme që tash jo për qëllimin, por për tekstin të diskutojmë, sepse unë për qëllimin nuk do të dyshoja asnjë pikë te ata çka e kanë sponsorizuar këtë projektrezolutë. Por, po ashtu unë mendoj që përveç që duhet të gjendet subjekti se kush do ta bëjë, do të duhej të përcaktohej edhe për cilin mur bëhet fjalë, sepse këtu po thuhet "muri ilegal në pjesën veriore të Mitrovicës" dhe po ju konfirmoj edhe njëherë se ka aq shumë mure ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës, sa që jo pse ne nuk e dimë për cilin mur bëhet fjalë, por pse të mos saktësohet këtu për cilin mur bëhet fjalë. Ose të caktohet i ndërtuar me datën kaq, ose të thuhet "pranë urës" ose të përcaktohet me koordinata.

Pra, do të duhej të përcaktohet edhe kush do ta rrëzojë edhe cilin mur do ta rrëzojë, sepse ndoshta mbesim qesharak në fund.

Mendoj që sot do ta kemi komoditetin e mjaftueshëm për ta bërë një tekst si projektrezolutë, i cili do të kalonte në këtë seancë.

KRYETARI: Zoti Rexhepi, pastaj zonja Halimi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Po në kuadër të këtij debati që u shtrua edhe unë kisha ndërmend t'i them dy-tri fjalë lidhur me rezolutën e propozuar. E vlerësoj qëllimin e drejtë, të arsyeshëm të të gjithë deputetëve, edhe të sponsorizuesit, për një temë shumë të rëndësishme që e ka prekur, do të thotë në çështje politike tonat dhe që është e papranueshme, prandaj po pajtohem me kolegët më herët që thanë se çfarë riformulimi duhet t'i bëhet këtij teksti të propozuar, në mënyrë që kjo realisht të jetë shumë më e fuqishme, më e saktë, më konkrete, ashtu qysh duhet të jetë një rezolutë e Parlamentit.

Pra, ky është ai qëllimi pse e mora fjalën dhe duhet thënë nga kolegët disa propozime konkrete. Ndërsa, sa i përket çështjes që e propozuan Grupi "6+", unë mendoj që edhe kolegët deputetë të Grupit "6+" duhet të hyjnë dhe ta pranojnë rezolutën pas korrigjimeve të caktuara, por mendoj që për temën që e shtruan është e një natyre tjetër. Është plotësisht me vend kërkesa që u shtrua nga deputeti Bajrami lidhur me trajtimin e barabartë të të gjitha komuniteteve atje në përfaqësimin e tyre në institucione, por në një moment tjetër, në një kohë tjetër, në një moment kur trajtohet kjo temë atëherë ta peshojmë, ta vlerësojmë dhe të marrim një qëndrim si Parlament dhe si Qeveri për ta realizuar atë barabarësi të cilën e kërkoi. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Halimi, fjala për ju, bëhet gati zonja Osmani. Jemi duke përfunduar, por pasi jemi duke e pritur amendamentimin e Ligjit të veteranëve, tash po më vjen keq.

SELVIJE HALIMI: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar të gjithë ju që jeni duke i përcjellë punimet e seancës,

Unë sot dola të flas jo për rezolutën dhe kërkoj falje për shmangie, kërkoj falje, kryetar. Dola të ngre një shqetësim timin, me një gjuhë që po vazhdon në drejtim të bartësve të përgjegjësive në institucionet e Kosovës. Kjo gjuhë skajshmërisht është duke tejkaluar limitet, çfarëdo që mund të kemi me individët, çfarëdo që mund të jenë individët, qofshin ata meshkuj apo femra, në jetën e tyre private e personale, kur marrin përgjegjësi institucionale përfaqësojnë shtetin e Kosovës dhe institucionin, janë të obliguar të punojnë sipas autorizimeve të dhëna me ligj.

Mirëpo, më befason skajshmërisht rasti kur njerëzit, të cilët burojnë nga familje atdhetare, kur njerëzit, të cilët kanë sakrifikuar shumë për Kosovën, kur njerëzit kanë bartur përgjegjësi shumë të larta në drejtim të mbrojtjes të drejtave dhe lirive të njeriut, në drejtim të promovimit të vlerave njerëzore dhe barazisë gjinore, vazhdojnë që nga dita e pardjeshme, dje dhe sot të mos kursehen më një fjalor të papranueshëm ndaj pozicionit të ministres së Drejtësisë në Kosovë.

Ajo çka më shqetëson është fakti se nga njerëz të tillë është e papranueshme, por edhe nga të gjithë të tjerët që me një fjalor të tillë të shkatërrojnë familjet shqiptare në Kosovë. Mos harroni se jemi duke degraduar dhe duke tejkaluar çdo limit, çdo masë, çdo fjalë, të cilën edhe fjalorit i

vjen rëndë ta bartë në sqarim dhe kjo, si e tillë, po ndikon negativisht dhe kjo, si e tillë, po i shkatërron familjet.

Nëse ne vazhdojmë kështu, atëherë për çka flasim kaq shumë në Kosovë për Kosovën, për tokën e Kosovës, për shtetin e Kosovës, kur shkatërrojmë familjet tona, kur shkatërrojmë ardhmërinë tonë. Kur fëmijët tanë duhet t'i bëjnë pyetje nënës së tyre ose babës: “Pse të quajnë me këtë gjuhë? Pse të quajnë me këtë fjalor”?!

Zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër dhe anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

E nderuar shoqëri civile dhe ju media,

Apeloj te të gjithë që të reagoni, të ngrini zërin ndaj të gjitha këtyre fyerjeve dhe ofendimeve që u bëhen bartësve të institucioneve. Por, njëkohësisht apeloj te të gjithë që të ngrini zërin aty ku ka padrejtësi, aty ku ka shkelje të ligjit, aty ku ka tejkallim të autorizimeve. Por, mos heshtni kur fyhen dhe ofendohen institucionet e Kosovës, bartësit e tyre, familjet tona dhe komplet kombi ynë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Po, zoti Lekaj, është e vërtetë. Të flasësh nganjëherë është argjend, të mos flasësh është ari, më mirë të mos flasësh se njeriu edhe mund të gabojë nga kjo foltore, kur s'kanë burri njerëzit të ballafaqohen drejtpërdrejt. Sido që të jetë, i kemi edhe dy diskutues.

Zonja Osmani e ka fjalën, pastaj zoti Pajaziti, dhe kalojmë në pjesën e votimit.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Shkurt, sa i përket rezolutës dhe tekstit të propozuar. Besoj që ju si kryetar keni të drejtë, që kur të vihet në votim rezoluta, që të propozoni që ajo të votohet me dy vërejtje, që janë esenciale dhe besoj se shumica e diskutuesve u pajtuan me to.

E para, te pika e parë të dihet saktësisht se obligohet Qeveria, sepse nuk ka institucion tjetër që mund ta bëjë një gjë të tillë, që të rrënohet muri ilegal. Dhe, e dyta, të saktësohet që fjala është për murin ilegal në urën kryesore të Mitrovicës, pra ky saktësim të bëhet edhe te pika e parë dhe te pika e tretë. Besoj, që nuk do të duhej të kishte vota kundër lidhur me këto dy saktësime, në mënyrë që rezoluta të jetë efektive dhe me implementim.

E dyta, sa i përket propozimit të kolegut Qerim Bajrami, pajtohem plotësisht që është një çështje që duhet të adresohet, mirëpo në mënyrë që të ketë efekt dhe të zbatohet në praktikë, ai është një ndryshim që do të duhej të bëhet në ligjet në fuqi, në fakt Ligji për shërbim civil tashmë është i qartë, në këtë aspekt. Mirëpo, në qoftë se kërkohet akoma saktësim edhe sa u përket punësimeve në komuna, unë jam e gatshme qysh tani t'ua jap nënshkrimin tim në një propozim-amendament

të tillë, që do të donit ta bënim në Ligjin për shërbimin civil, sepse me rezoluta këto gjëra deri tani nuk janë rregulluar.

Dhe, e fundit, më vjen mirë që më në fund pas dy vjet e ca muaj të funksionimit të këtij Kuvendi kemi një pajtim të të gjitha grupeve, gati, të gjitha grupeve parlamentare, por së paku të të gjitha partive shqiptare për një tekst dhe do të duhej ta përbyllnim vitin me një shembull të tillë. Dhe, meqenëse tashmë iu dha fjala zonjës Halimi për të diskutuar për çështjen e gjuhës që është përdorur kundrejt grave, sidomos atyre që janë të angazhuara në politikë gjatë këtij mandati, dua të them që njëjtë, siç ka qenë e papranueshme edhe gjuha që është përdorur kundër grave të shoqërisë civile, njëjtë siç ka qenë e papranueshme edhe gjuha që është përdorur kundrejt kolegeve të mia në LDK shumë shpesh, kundrejt Vlora Çitakut, kundër Donika Kadajt, kundër Albulena Haxhiut, e shumë kolegeve të tjera në këtë Kuvend, që janë ballafaquar me ofendime të natyrave të ndryshme, njëjtë është e papranueshme edhe gjuha që është përdorur ndaj zonjës Dhurata Hoxha. Besoj që pavarësisht mospajtimeve që mund t'i kemi rreth çështjeve politike, pavarësisht rreth vlerësimeve se mund t'i kemi rreth mënyrës se si dikush e kryen punën e vet apo e bën punën e vet në mënyrë profesionale ose joprofesionale, gjuha e tillë duhet të dënohet nga të gjithë ne dhe nuk duhet assesi të bëhet model i politikëbërjes dhe model i trajtimit të njëritjetrit në Kosovë.

Pra, shpresoj se me një vlerësim të tillë të pajtohemi të gjithë, sepse në qoftë se nuk reagojmë për raste të tilla, atëherë ky do të bëhet model dhe kjo do të jetë gjuha që do ta dëgjojmë çdo ditë në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi para votimit, zoti Pajaziti, kemi largim të disa grave deputete. Tash jemi para votimeve. Albin, e dëshiron fjalën? Urdhëro, Zenun. Pal, në fund është si propozues i rezolutës, e bën një përmbledhje dhe shkojmë në votim.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

E kemi pasur një debat të gjatë në seancën e kaluar për këtë punë, kemi folur prej asaj që shumica jemi pajtuar, gjërave të arsyeshme, debat që deri në orët e vona ka pasur edhe diçka që s'na ka hyrë në punë ndoshta as neve. Po, ajo që po dëshiroj të them është që rreth tekstit mund të kemi edhe tekst më të mirë, po ne jemi takuar edhe është mirë partitë politike t'i dërgojnë njerëzit që merren me tekstin dhe me formulimin edhe ta kemi një qëndrim edhe ta nënshkruajmë pastaj. Ne e nënshkruam një deklaratë, e cila e përmban temën për të cilën folëm.

Ajo që është shqetësuese këtu është largimi i grave, ose disave prej tyre, për shkak të deklaratave të tilla fyese që dalin nga politikanë në Kosovë. Unë solidarizohem dhe është shqetësim i shumicës, besoj. Këto njëherë e mirë duhet të ndalen, është diçka që po instalohet keq në skenën tonë politike.

Edhe rreth propozimit të zotit Bajrami, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike jemi të gatshëm të punojmë, nëse ka një iniciativë për plotësim-ndryshimin e Ligjit për shërbyesit civilë, ose ndonjë rezolutë, ose debat tjetër të veçantë, për sa i përket punësimit të barabartë të pakicave ose të grupeve etnike në institucionet e Kosovës.

Ne jemi pajtuar që në këtë tekst të hiqen edhe disa tema, që s'kanë të bëjnë me këtë. Unë mendoj se kjo rezolutë kështu siç është nënshkruar duhet të kalojë, e ka mesazhin e plotë. Po ashtu, besoj që Qeveria dhe të gjitha institucionet që kanë përgjegjësi, edhe pa u nxjerrë kjo rezolutë mund të veprojnë që ai mur të hiqet sa më shpejt. Jam i sigurt që mesazhi tashmë ka shkuar në drejtimin e duhur, por ne do ta bëjmë edhe rezolutën. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Haxhiu, fjala për ju. Po shkojmë drejt përfundimit të rezolutës.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kam thënë edhe ditën e debatit, mendoj se debati edhe rezoluta do të duhej të ishte shumë më përmbajtjesore, sa i përket çështjes së veriut, jo vetëm të murit. Kam thënë atë ditë dhe po e përsëris që ky mur është ndërtuar nga struktura të krimit të organizuar dhe të kontrabandës në veri, për të vetmin qëllim për të krijuar trazira dhe shqetësime në veri, që ato të zhvillohen edhe më tutje në bizneset e tyre, në kontrabandën e tyre.

Ky mur nuk është as pajtueshmëri e qytetarëve shqiptarë, as serbë e as komuniteteve të tjera në Mitrovicë, në të dy anët e lumit Ibër. Ky mur është bërë për të penguar zhvillimin dhe integrimin e mëtutjeshëm atje dhe nuk kam besuar që vërtet një strukturë kriminale e krimit të organizuar, me veprimet që bën, do ta trajtojmë në këtë formë me anë të rezolutës. Kam menduar se kjo çështje do të zgjidhet brenda institucioneve të vendit, duke respektuar ligjin, ndërsa Kuvendi i takon që vërtet të merret me veriun në mënyrë më të gjerë, më të tërësishme dhe më gjithëpërfshirëse. Me rezolutë Kuvendi do të duhej ta trajtonte veriun në tërësi. e në veçanti, jo të krijohen betonime tani edhe në mes raporteve shqiptaro-serbe edhe më tutje sa i përket integrimin në veri, por ai integrim të jetë domethënës dhe komunikues.

Në veçanti, pas zhvillimeve të fundit politike dhe deklarimeve të Listës serbe, të cilët i anashkalojnë në tërësi institucionet e Kosovës dhe bëjnë edhe shkelje kushtetuese sa i përket dëgjueshmërisë apo pajtueshmërisë së tyre për zbatimin e ligjit dhe qëndrueshmërisë së tyre në institucione dhe e anashkalojnë Qeverinë e Kosovës. Mendoj se me Listën serbe seriozisht duhet të merret KQZ-ja sa i përket dhe decertifikimit të tyre si subjekt politik, ndërsa serbët e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës i takon që të bisedojë me serbët e Kosovës, që ata të jenë të përfaqësuar prej tyre, e jo prej të emëruarve politikë nga Beogradi, por që të kenë përfaqësuesit e tyre në institucionet e Kosovës.

Qytetarët serbë dhe të komuniteteve të tjera duhet t'i kenë në institucionet e Kosovës qytetarët e Kosovës të zgjedhur nga ata, por jo të emëruarit politikë dhe çdo subjekt politik, i cili do të vinte me emërime të tilla politike në institucionet tona nuk do të duhej të lejohej asnjë që të certifikohet.

Prandaj, kam menduar që vërtet si Kuvend do të merremi më seriozisht sa i përket aspektit të veriut, jo vetëm me murin, sepse ai mur as që është dashur të jetë temë, sepse është ndërtuar nga strukturat kriminale dhe të kontrabandës atje dhe është dashur të rrënohet, e në asnjë rrethanë nuk është dashur të negociohet e në veçanti të hyjë në formë të rezolutës këtu.

Sido që të jetë, është pajtueshmëri e gjithë Kuvendit, atëherë na mbetet të gjithëve që ta përkrahim, që vërtet të rrënohet ky mur dhe të adresohen edhe bartësit e institucioneve në bazë të ligjeve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. Zoti Pal Lekaj, fjala për ju! Zoti Pal Lekaj e harmonizoni rezolutën, pastaj e votojmë menjëherë. Thërrisni deputetët.

PAL LEKAJ: Më lejoni t'ju falënderoj të gjithë deputetëve për angazhimin tuaj serioz në trajtimin e kësaj çështjeje që është me rëndësi që të jemi unikë në këtë drejtim dhe pajtohemi edhe me nënkryetarin e Kuvendit, zotin Hamiti, edhe me të tjerët që dhanë propozime, mirëpo ne jemi ulur të gjithë shëfat e grupeve parlamentare dhe unë e lus kryetarin që ta hedhë në votim, që të mos debatojmë më. Mund të ketë tekste shumë më të mira, por ne i jemi referuar edhe Qeverisë, që të marrë edhe obligimet në bazë të ligjit.

Prandaj, zoti kryetar, kërkoj nga ju që ta hidhni në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E hedh në votim tani. Veç "Vetëvendosja" ka mbetur pa folur sot. Po e votojmë një herë, pastaj flasim prapë, kemi kohë.

A ka mundësi deputetët të kthehen në sallë, a kemi kuorum. Po. Atëherë, të nderuar deputetë, e hedh në votim propozim-rezolutën lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike, plus dy kolegë deputetë me dorë, 76. Nga ata 74 janë për, dy vota me dorë janë për, kemi dy abstenime. Kuvendi miratoi rezolutën lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës.

Para se ta përfundoj seancën, ju kisha lutur, kolegë deputetë, në qoftë se e kam mirëkuptimin tuaj, të shkojmë në pushim të drekës deri në orën 15,15. Kemi seancë për... po nuk mundet,

komisionet, ende Qeveria s'e ka... mos e leni për nesër se nuk më... mos e leni për nesër... si të doni ju... a doni sot?

Atëherë, e lëmë në orën 15:15, po frikësohem më herët nuk mundet, se i marrim prej Qeverisë amendamentet për ndryshimin e projektligjit, të cilat janë të harmonizuara edhe me veteranët e luftës, me shoqatat e luftës. Kemi futur edhe një pjesë, ta keni parasysh në kuadër të këtij amendamenti që edhe kategoria e luftëtarëve që kanë vdekur pas qershorit 1999 do të futen në paga nga 250 euro për secilën familje. Do të vijnë amendamentet, kjo është edhe vonesa për amendamente dhe i kalojmë të gjitha, ato që janë propozuar nga veteranët e luftës, nga Qeveria dhe nga ne. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*